

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Fakulteti i Biznesit

Programi i Doktoraturës

“Shkenca Ekonomike”

**STABILITETI POLITIK DHE RRIJTJA EKONOMIKE:
RASTI I DISA VENDEVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR
PAS VITEVE 90’**

Viorela POLENA (AGOLLI)

Udhëheqës Shkencor

Prof. Dr. Agim KUKELI

2015

Copyright

i

Viorela Polena (AGOLLI)

2015

**Udhëheqësi i Viorela Polena, Prof. Dr. Agim Kukeli vërteton se ky është
version i miratuar i dizertacionit të mëposhtëm:**

**STABILITETI POLITIK DHE RRIJJA EKONOMIKE:
RASTI I DISA VENDEVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR
PAS VITEVE 90'**

Prof.Dr. Agim KUKELI

**STABILITETI POLITIK DHE RRIJJA EKONOMIKE:
RASTI I DISA VENDEVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR
PAS VITEVE 90'**

Përgatitur nga:

MSc. Viorela POLENA (AGOLLI)

Dizertacion i paraqitur në

Fakultetin e Biznesit

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës

në përputhje të plotë

me kërkesat

për gradën “Doktor”

Udhëheqës Shkencor:

Prof. Dr. Agim KUKELI

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, Shtator, 2015

Dedikuar prindërve të mi

MIRËNJOHJE

Finalizimi i studimeve të doktoraturës nëpërmjet këtij disertacioni është një arritje e cila vjen si rezultat i përfshirjes dhe kontributit të vlefshëm të shumë personave pa mbështetjen e të cilëve ky punim nuk do të ishte në formën në të cilën prezantohet sot. Për këtë, konsideroj të një rëndësie të madhe shprehjen e mirënjohjes sime të sinqertë për një grup personash nëpërmjet ndihmës e mbështetjes së të cilëve u realizua ky studim. Të shumtë janë personat të cilëve ju drejtohem me ‘Faleminderit’:

Falenderoj me mirënjohje të thellë udhëheqësin shkencor Prof. Dr. Agim Kukeli, i cili më ka udhëzuar e orientuar përgjatë gjithë kësaj periudhe duke më ofruar këshilla, komente, orientime, si dhe sugjerime të vlefshme për të arritur në një punim serioz e me vlera akademike.

Falenderime të sinqerta i drejtohen Rektorit të Universitetit ‘Aleksandër Moisiu’, Prof. Dr. Mit’hat Mema për mbështetjen e shfaqur në këtë proces si dhe për gatishmërinë e pozitivitetin e shfaqur në rritjen e mëtejshme të stafit akademik të UAMD-së.

I rëndësishëm dhe i frytshëm ka qënë kontributi dhe bashkëpunimi me Zyrën e Doktoraturës së UAMD-së, e veçanërisht me Koordinatorin e Studimeve të Ciklit të Tretë Prof. Dr. Kristaq Kume. Orientimi dhe komunikimi me të ka qënë një vlerë e shtuar e të gjithë këtij procesi.

Po kështu, një falenderim i veçantë shkon për përgjegjësen e Departamentit të Shkencave Ekonomike Prof. As. Dr. Ermira Kalaj për mbështetjen e dhënë në rrugëtimin e këtij studimi, si dhe Dekanin e Fakultetit të Shkencave Politike-Juridike, për mbështetjen që ka treguar në nxitjen dhe stimulimin e avancimit tim akademik të mëtejshëm.

Informacionet e përditësuara dhe vlefshmëria e tyre janë thelbësore për cilësinë e një studimi. Për këtë, falenderime përcillen edhe për Departamentin Amerikan të Shtetit, e veçanërisht Oklahoma State University, ku në kuadër të programit semestral të JFDP-së, pata mundësinë të hulumtoj, mbledh e krijoj një bazë të rëndësishme informacioni mbi kontributet më të fundit shkencore të studieveve të fushave të shkencave ekonomike e politike për çështjen nën studim.

Falenderime të sinqerta edhe për të gjithë kolegët dhe miqtë që mbështetën këtë projekt akademik me sugjerime dhe me burime të vlefshme informacioni, duke shfaqur në të njëjtën kohë edhe besimin e vazhdueshëm për vlefshmërinë dhe rëndësinë e kësaj sipërmarrjeje.

Së fundmi, por jo më pak e rëndësishme, dëshiroj të falenderoj nga zemra familjen time, të cilët kanë qënë gjithmonë atje, të gatshëm për të më nxitur e dhënë forcë, edhe në etapat më të lodhshme e angazhuese të këtij punimi.

Faleminderit të gjithëve!

Deklaratë mbi origjinalitetin

Viorela POLENA (AGOLLI)

Deklaroj se kjo tezë përfaqëson punën time origjinale dhe nuk kam përdorur burime të tjera, përveç atyre të shkruajtura nëpërmjet citimeve.

Të gjitha të dhënat, tabelat, figurat dhe citimet në tekst, të cilat janë riprodhuar prej ndonjë burimi tjetër, duke përfshirë edhe internetin, janë pranuar në mënyre eksplicite si të tilla.

Jam i/ e vetëdijshme/shme se në rast të mospërputhjeve, Këshilli i Profesorëve të UAMD-së është i ngarkuar të më revokojë gradën “Doktor”, që më është dhënë mbi bazën e kësaj teze, në përputhje me “Rregulloren e Programeve të Studimit të Ciklit të Tretë (Doktoratë) të UAMD-së, neni 33, miratuar prej Senatit Akademik të UAMD-së me Vendimin nr. , datë _____

Durrës, më _____

Firma, Viorela POLENA (AGOLLI)

PËRMBLEDHJE

Vala e ndryshimeve që preku vendet e Evropës Lindore dhe Juglindore në fillimet e viteve 90', shënoi një etapë të rëndësishme të ridimensionimit politik e ekonomik të këtyre vendeve. Rrjedhimisht, ndryshimi i regjimeve, së bashku me proceset demokratizuese e shtetformuese u shoqërua edhe me ndryshime në mënyrën e organizimit të aktivitetit ekonomik dhe ekonomisë në përgjithësi.

Kështu, makrofusha studimore e këtij disertacioni mbështetet tek ekonomia politike e rritjes, e më specifikisht tek literatura endogjene e rritjes dhe ekonomia e re politike duke vlerësuar, klasifikuar dhe analizuar kërkimin mbi dy fenomene të rëndësishme që kanë shoqëruar ndryshimet politiko-ekonomike në Evropën Juglindore, dhe më specifikisht Ballkanin Perëndimor, siç janë destabiliteti politik dhe rritja ekonomike.

Destabiliteti politik, si një ndër këto fenomene, i vendosur në qendër të literaturës të studimeve të ekonomisë politike dhe teorive të rritjes, konsiderohet i një rëndësie të veçantë pikërisht për të kuptuar e analizuar statusin e zhvillimeve politiko-ekonomike për grup-shtete apo shtete të veçanta. Dhe më specifikisht, është vlerësimi i marrëdhënies ndërmjet këtij fenomeni të karakterit politik në raport me tregues të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik si rritja ekonomike, që përbën thelbin e diskutimeve dhe analizës akademike të theksuar më së shumti kohët e fundit.

Pavarësisht shumësisë së përkufizimeve e operacionalizimeve të destabilitetit politik, ne ofrojmë një konceptim gjithëpërfshirës të tij duke tentuar më pas vlerësimin e marrëdhënies së këtij fenomeni me rritjen ekonomike për rastin e Ballkanit Perëndimor viteve 90'. Testimi i kësaj marrëdhënieje për rastin disa vendeve të Ballkanit Perëndimor ofron perspektiva orientuese të politikave e strategjive zhvillimore të mundshme të së armdhes të këtij grupi vendesh.

Korniza teorike e studimit, së bashku me bazën e studimeve empirike evidentojnë lidhje shpjeguese të rritjes jo vetem nga variablat ekonomike, por edhe nga variablat e tjerë të karakterit politik e më konkretisht stabiliteti politik, demokracia e më pas korrupsioni. Marrëdhënie kjo e cila ndërmjetësohet edhe nga ndikimi i tërthortë i këtyre regresorëve të fundit kundrejt investimeve, shpenzimeve qeveritare e arsimit. Megjithatë, studimi parashtron edhe nevojën për të vazhduar hulumtimin e kësaj marrëdhënieje (sistem politik-sistem ekonomik) në kuadrin e ekonomisë politike të rritjes, e cila aktualisht dëshmon për një mungesë studimesh të kësaj natyre për Ballkanin Perëndimor e më gjerë.

Fjalë kyçe: rritje ekonomike, destabilitet politik, zhvillim ekonomik, demokratizim, institucione

SUMMARY

The wave of changes that took place in the early 1990's in Eastern and South-eastern Europe marked an important stage of political and economic formatting of these countries. As a result, the change of regime types, along with democratization and state-building processes, was accompanied with changes in the organization of the economic activity and economy as a whole.

Thus, the macro-field of study of this dissertation is based on the political economy of growth, and more specifically in the endogenous growth literature and the new political economy, by evaluating, classifying and analysing the research over important phenomena that have accompanied political and economic changes in South-eastern Europe and more specifically the Western Balkan, such as political instability and economic growth.

Political instability, as one of these phenomena, placed at the centre of the political economy literature and growth theories, is considered of a specific importance in understanding and analysing the status of political and economic developments in a group of states or in individual states. And more specifically, it is the evaluation of the relationship between this political phenomenon and important indicators of the economic development, such as economic growth, that constitute the centre of academic debates and analyses recently.

Despite the availability of a wide range of definitions and indicators of political instability, we present a composite definition of it, by then evaluating its relationship towards economic growth in the case of some Western Balkan countries after the 1990's. The empirical evidence of this relationship for Western Balkan countries tends to offer possible future perspectives for development policies and strategies in these countries.

The theoretical framework of the study, along with the empirical part evidence a good relationship and interaction of economic growth not only because of economic repressors, but also because of a set of political variables such as political instability, democracy and corruption. The validity of this relationship is tested through direct and indirect paths. However, the study points out the need for continuous research concerning this relationship in the framework of the political economy of growth, which, currently testimonies a lack of proper studies of this kind in the Western Balkans and beyond.

Key words: economic growth, political instability, economic development, democratization, institutions

PËRMBAJTJA E LËNDËS

MIRËNJOHJE	fq v
PËRMBLEDHJE	fq vii
LISTA E FIGURAVE	fq xiv
LISTA E TABELAVE	fq xii
KAPITULLI I	
HYRJE	
1.1 Konteksti i kërkimit	fq 3
1.2 Qëllimi i kërkimit	fq 6
1.3 Korniza teorike	fq 8
1.4 Problemi i kërkimit dhe pyetja kërkimore	fq 11
1.5 Çështjet e kërkimit	fq 12
1.6 Metodologjia	fq 13
1.7 Risia e studimit	fq 13
1.8 Strukturimi i studimit	fq 15
PJESA I	
PËRQASJE TEORIKE: KORNIZA TEORIKE, KONCEPTET, TREGUESIT, MODELET	
KAPITULLI 2	
STABILITETI POLITIK DHE RITJA EKONOMIKE	
2.1 Hyrje	fq 20
2.2 Teoria e modernizimit	fq 22
2.2.1 Modernizimi dhe demokratizimi	fq 25
2.2.2 Demokracia dhe rritja ekonomike	fq 31
2.2.3 Perspektivat teorike (përmbledhje)	fq 34
2.2.4 Stabiliteti politik dhe korrupsioni	fq 35
2.3 Stabiliteti politik dhe institucionalizmi	fq 40
2.3.1 Lloji i formës së qeverisjes dhe stabiliteti politik	fq 43
2.3.2 Ndërveprimet ndërmjet aktorëve dhe institucioneve	fq 44
2.4 Rishikimi i literaturës në përkufizimin e stabilitetit politik	fq 46
2.4.1 Treguesit dhe modelet në studimin e stabilitetit politik	fq 52
2.4.2 Indekset për matjen e stabilitetit politik	fq 56

KAPITULLI 3

STABILITETI POLITIK DHE RITJA EKONOMIKE

3.1 Hyrje	fq 62
3.2 Teoritë ekonomike të rritjes	fq 64
3.3 Rishikim i literaturës në marrëdhënien ndërmjet stabilitetit politik	fq 69
3.3.1 Korniza teorike e marrëdhëniës destabilitet politik-rritje ekonomike: modelet kryesore	fq 70
3.3.1.1 <i>Rritja ekonomike dhe destabiliteti politik</i>	fq 72
3.3.1.2 <i>Rritja ekonomike dhe demokracia</i>	fq 74
3.3.1.3 <i>Rritja ekonomike dhe institucionet</i>	fq 78
3.3.1.4 <i>Rritja ekonomike dhe korrupsioni</i>	fq 81
3.3.1.5 <i>Modelet kryesore</i>	fq 84

KAPITULLI 4

MARRËDHËNIA DESTABILITET POLITIK-RRITJE EKONOMIKE: RASTI I BALLKANIT PERËNDIMOR: NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

4.1 Hyrje	fq 94
4.2 Vendet e Ballkanit Perëndimor: trendet politiko-ekonomike	fq 94
4.3 Rasti i Shqipërisë	fq 105
4.3.1 Përmbledhje e zhvillimeve politike në Shqipëri pas ndryshimit të regjimit politik	fq 115

PJESA II

PËRQASJE PRAKTIKE: VLERËSIMI DHE TESTIMI EMPIRIK

KAPITULLI 5

METODOLOGJIA

5.1 Hyrje	fq 122
5.2 Konteksti i kërkimit	fq 123
5.3 Pyetja kërkimore dhe hipotezat e studimit	fq 125
5.4 Të dhënat e përfshira në studim	fq 127
5.5 Modeli empirik	fq 130
5.5.1 Përzgjedhja e modelit	fq 132
5.5.2 Hipotezat e studimit	fq 133
5.5.3 Përkufizimi, shpjegimi i modelit	fq 134
5.5.4 Variablat: variablat e varuar dhe të pavarur	fq 135
5.5.5 Supozimet e modelit	fq 137

KAPITULLI 6

ANALIZA E REZULTATEVE DHE DISKUTIMI I TYRE

6.1 Hyrje	fq 139
6.2 Analiza e statistikave përshkruese të modelit	fq 139
6.3 Analiza e regresionit linear për vërtetimin e hipotezave të modelit dhe diskutimi	fq 149

KAPITULLI 7

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

7.1 Përfundime të përgjithshme teorike	fq 159
7.2 Përfundime të përgjithshme praktike	fq 161
7.3 Rekomandime	fq 162
7.4 Kufizimet e studimit dhe kërkimi i mëtejshëm shkencor	fq 163

SHTOJCA	fq 165
----------------	---------------

BIBLIOGRAFIA	fq 171
---------------------	---------------

LISTA E TABELAVE

Tabela 2.1 <i>Vëzhgimet vjetore sipas nivelit të të ardhurave dhe llojit të regjimit</i>	fq 29
Tabela 2.2 <i>Tipologjia e regjimeve dhe ritmi i parashikuar i rritjes ekonomike</i>	fq 30
Tabela 2.3 <i>Kriteret për/dhe shfaqjet e stabilitetit/destabilitetit të sistemit politik</i>	fq 55
Tabela 2.4 <i>Përshkrimi i treguesve të destabilitetit politik</i>	fq 55
Tabela 2.5 <i>Përmbledhje e Indekseve të Stabilitetit Politik</i>	fq 58
Tabela 3.1 <i>Përmbledhje e studimeve empirike mbi marrëdhënien rritje-destabilitet politik</i>	fq 91
Tabela 4.1 <i>Ballkani Perëndimor, treguesit makroekonomikë 2011, 2012 (vlerësime)</i>	fq 95
Tabela 4.2 <i>Ballkani Perëndimor, Rritja reale e PBB-së dhe projeksionet, ndryshimi në përqindje, 2001-2012</i>	fq 96
Tabela 4.3 <i>Rritja reale e PBB-së për disa vende të Ballkanit Perëndimor</i>	fq 97
Tabela 4.4 <i>Ritmet e ndryshimeve ndërmjet viteve 2008-2012</i>	fq 97
Tabela 4.5 <i>Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit, Transparency International</i>	fq 99
Tabela 4.6 <i>Kuadri institucional për vende të Ballkanit Perëndimor sipas treguesve të tranzicionit të ERBD</i>	fq 100
Tabela 4.7 <i>Shtyllat e Konkureshmërisë Botërore të WEF, renditjet, 2012-2013</i>	fq 101
Tabela 4.8 <i>Treguesit e qeverisjes për vitin 2013 për vendet e Ballkanit Perëndimor (Kaufman et al., 2013)</i>	fq 102
Tabela 4.9 <i>Të dhëna krahasimore mbi vendet e Ballkanit Perëndimor në lidhje me stabilitetin politik e mungesën e dhunës, Worldwide Governance Indicators</i>	fq103
Tabela 4.10 <i>Treguesit e qeverisjes për Shqipërinë përgjatë dekadës së fundit, trendi 2002, 2007, 2012</i>	fq 109
Tabela 4.11 <i>Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit për Shqipërinë, 1999-2012</i>	fq 110
Tabela 4.12 <i>Një tipologji e korrupsionit</i>	fq 111
Tabela 5.1 <i>Analiza dytësore në perspektivë</i>	fq 128

Tabela 5.2 <i>Përmbledhje e variablave të modelit të regresionit</i>	fq 135
Tabela 6.1 <i>Liritë politike dhe të drejtat civile, 1996-2012 (mesatarja e lirive politike e të drejtave civile, Freedom House)</i>	fq 144
Tabela 6.2 <i>Regresioni i vlerësimit të rolit të grup variablave politikë tek rritja e PBB-së</i>	fq 151
Tabela 6.3 <i>Regresioni i ekuacionit ndihmës me variabël të varur investimet</i>	fq 155
Tabela 6.4 <i>Regresioni i ekuacionit ndihmës me variabël të varur shpenzimet qeveritare</i>	fq 156
Tabela 6.5 <i>Regresioni i ekuacionit ndihmës me variabël të varur arsimin</i>	fq 157

LISTA E FIGURAVE

Figura 2.1 <i>Teoria e Modernizimit, marrëdhënia demokraci-zhvillim</i>	fq 27
Figura 2.2 <i>Destabiliteti politik nëpër botë</i>	fq 60
Figura 3.1 <i>Korrelacioni ndërmjet zhvillimit dhe demokracisë</i>	fq 71
Figura 4.1 <i>Performanca demokratike e Ballkanit Perëndimor sipas kategorisë</i>	fq 98
Figura 4.2 <i>Ecuria e reformës institucionale në ekonomitë e tranzicionit, 1991-2002</i>	fq 101
Figura 4.3 <i>Shqipëria 1996-2012, treguesi i agreguar: stabiliteti politik dhe mungesa e dhunës</i>	fq 109
Figura 4.4 <i>Korrupsioni dhe regjimi në Shqipëri</i>	fq 111
Figura 4.5 <i>Disa nga treguesit themelorë makroekonomikë për Shqipërinë</i>	fq 112
Figura 4.6 <i>PBB në miliard dollarë për Shqipërinë përgjatë tre dekadave të fundit</i>	fq 113
Figura 4.7 <i>PBB për banorë, 1980-2013</i>	fq 113
Figura 6.1 <i>Trendi i ecurisë së rritjes ekonomike për grup-shtetet e Ballkanit Perëndimor</i>	fq 140
Figura 6.2 <i>Investimet për grup-shtetet e Ballkanit Perëndimor për periudhën 1996-2012</i>	fq 141
Figura: 6.3 <i>Ecuria e vlerësimit të lirisë ekonomike sipas Indeksit të Lirisë Ekonomike, 1996-2012</i>	fq 142
Figura 6.4 <i>Shpenzimet qeveritare për periudhën 1996-2012 për grup shtetet e Ballkanit Perëndimor</i>	fq 142
Figura 6.5 <i>Ecuria e demokratizimit për grup shtetet e Ballkanit Perëndimor për periudhën 1996-2012</i>	fq 143
Figura 6.6 <i>Liritë politike dhe të dretjtat civile, 1996-2012 (mesatarja e lirive politike e të drejtave civile, Freedom House)</i>	fq 144
Figura 6.7 <i>Investimet dhe rritja e PBB-së në Shqipëri për periudhën 1996-2012</i>	fq 145
Figura 6.8 <i>Liria ekonomike në Shqipëri për periudhën 1996-2012</i>	fq 145

Figura 6.9 <i>Ecuria e demokratizimit në Shqipëri për periudhën 1996-2012</i>	fq 146
Figura 6.10 <i>Ecuria e Indeksit të Destabilitetit Politik për Shqipërinë</i>	fq 147
Figura 6.11 <i>Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit për Shqipërinë 1996-2012</i>	fq 148
Figura 6.12 <i>Liritë civile dhe të drejtat politike në Shqipëri sipas Freedom House</i>	fq 149

KAPITULLI 1

HYRJE

Më shumë se dy shekuj më parë, në një qëndrim që mbetet i vlefshëm edhe ditët e sotme për rolin e qeverisë në sistemin social e ekonomik, Madison është shprehur se ‘në modelimin e një qeverie që administrohet nga njerëzit tek njerëzit, vështirësia e madhe qëndron në faktin se: së pari, duhet mundësuar një qeveri që të kontrollojë të qeverisurit; dhe së dyti, të detyrohet që të kontrollojë veten’ (Madison, 1788). Ideja e kontrollit mbi veten e të tjerët, përveç të tjerave, lidhet edhe me nevojën për të garantuar rendin e për të mbërritur drejt një stabiliteti qeverisës. Ky element i fundit ka përbërë dhe përbën një nga kërkesat kryesore të zhvillimit dhe ecurisë së entiteteve politike në të tre dimensionet kryesore të tyre: dimensionin politik, ekonomik e shoqëror. Madje, pavarësisht se mënyrat e organizimit politik kanë ndryshuar me kalimin e kohës, stabiliteti politik ka qenë përcaktues i ecurisë dhe zhvillimit të tyre deri tek shtetet e sotme.

Mbërritjen tek shtetet e sotme moderne mund ta shohim si etapën fundore (jo përfundimtare) të një procesi të filluar që prej lashtësisë, proces ky i cili ka prodhuar formate të ndryshme të organizimeve politike që nga qytet-shtetet, principatat, perandoritë, mbretëritë, etj. Logjika mbizotëruese e këtij procesi i përgjigjet edhe vlerësimit të një prej themeluesve të shkencës politike, Aristotelit, sipas të cilit qënia njerëzore është e orientuar drejt përmirësimit të jetesës së vet në shoqëri¹. Pra, i gjithë ky proces që ka prodhuar shtetet si formën mbizotëruese të organizimit politik të sotëm,

¹ Aristoteli, *Politika*, 2003, Plejad, Tiranë.

tregon përpjekjet e vazhdueshme të komuniteteve njerëzore për t'u përmirësuar dhe zhvilluar.

Zhvillimi dhe progresi i shteteve është padyshim rezultat i realizimit të aktivitetit politik. Kjo sepse, politika, me qëllimin parësor empirik për të vendosur rendin dhe qetësinë brenda komunitetit që drejtohet², mundëson më tej realizimin e aktiviteteve të tjera të natyrave dhe dimensioneve të ndryshme. Rrjedhimisht, krijohet mundësia që komuniteti të përfitojë e të zhvillohet. Nën këtë perspektivë, shohim se stabiliteti është kërkesa parësore për mirëfunksionimin e shteteve të sotme. Pikërisht, për shkak të kësaj rëndësie që përfaqëson koncepti i stabilitetit, ai është vendosur vazhdimisht në fokus të studimeve e analizave të shumta. Shumësia e qasjeve prej të cilave mund të vlerësohet ky fenomen, prodhohet edhe nga fakti se rendi politik identifikohet në tre dimensione të “politikës”. Kështu, dimension i parë ka të bëjë me procesin politik, ose referuar fjalës anglisht me “politics”. Ky proces politik është i karakterizuar nga bashkëveprimi, konkurrenca apo konflikti mes aktorëve të ndryshëm politikë, të cilët tentojnë të përmbushin interesat e ndryshme që përfaqësojnë. Për këtë, një rol të rëndësishëm luajnë institucionet të cilat me veprimtarinë e tyre synojnë të akomodojnë përplasjen e interesave dhe preferencave duke ushqyer frymën bashkëpunuese dhe arritjen e konsensusit. Nga ana tjetër, korniza e përgjithshme e rregullave në shoqëri përbën atë që quhet “polity”. Brenda kësaj kornize të përgjithshme ‘loja politike’ zhvillohet nëpërmjet një tërësie procesesh të cilat përfshijnë institucionet e aktorët e tjerë, dhe që finalizohet në zgjidhje politike apo “policy” e cila reflekton mënyrën se si janë zgjidhur konfliktet apo se si janë akomoduar interesat, kërkesat dhe preferencat konkurruese. Ky finalizim i procesit politik konsiderohet nga Shepsle si ‘mbërritja tek një ekuilibër’³. Pra, mund të themi se mungesa e stabilitetit politik mund të konsiderohet si një mungesë ekuilibri në procesin politik të prodhuar brenda shoqërisë.

Ky proces përfshin anëtarët e shoqërisë (individët), ndërveprimin e tyre, formatin politik ku ata veprojnë, si dhe pasojat e kësaj marrëdhënieje. Ndërveprimi prodhon politikën, ose në kuptimin më të gjerë të saj ‘veprimtarinë me anë të së cilës njerëzit, bëjnë, ruajnë apo ndryshojnë rregullat e jetesës në shoqëri’⁴. Nga ana tjetër, ndërveprimi mundësohet nga individë të cilët kanë role të caktuara dhe për të cilat anëtarët e tjerë të shoqërisë kanë pritshmëri të njohura. ‘Tërësia e roleve politike në një shoqëri të caktuar krijon strukturën politike të asaj shoqërie, si një sistem i shkëmbimeve politike’⁵. Nëpërmjet njohjes së kësaj logjike marrëdhëniesh brenda një formati politik, mund të identifikohet një koncept fillestar por shumë i rëndësishëm i stabilitetit politik. Sipas Ake, stabiliteti politik është ‘rregullsia e rrjedhës së shkëmbimeve politike, apo masa që anëtarët e një shoqërie e kufizojnë veten brenda tipareve të sjelljes të cilat janë brenda kufijve të vendosur nga pritshmëritë e roleve politike’⁶.

Mirëpo, kjo nuk është e mjaftueshme në vlerësimin e stabilitetit politik. I aplikuar në nivelin mikro të studimit, ky përkufizim i paraqitur bën të nevojshme operacionalizimin

² Della Porta, D., (2002), *Introduzione alla scienza politica*, il Mulino, Bolonja, fq. 14.

³ Shepsle, K. A., (1995), ‘Studying institutions: some lessons from the rational choice approach’, *Political Science in History*, Cambridge University press, Kembrixh, fq. 284.

⁴ Heywood, A., (2008), *Politika*, Duda, Tiranë, fq. 24.

⁵ Ake, C., (1975), ‘A definition of political stability’, *Comparative Politics*, Vol 7(2):271-283, fq. 272.

⁶ *ibid.*, fq. 273.

dhe evidentimin e aspekteve të daljes jashtë formatit të pritshmërive të roleve politike si dhe njohjen e mëtejshme të asaj që përbën strukturën politike të një vendi të caktuar. Ndërsa, në nivelin studimor makro nevojitet të identifikohen logjikat e përgjithshme të vlerësimit të aspekteve të stabilitetit politik, e sidomos diferencat në variablat shpjegues të marra në konsideratë për vende të ndryshme.

Nga ana tjetër, ditët e sotme, në kushtet e vështirësive dhe sfidave me të cilat po përballet ekonomia ndërkombëtare, dhe në një nivel mikro ekonomitë shtetërore, e një rëndësie të veçantë për ekonomistët e politikëbërësit mbetet ndërmarrja e veprimeve dhe politikave reaguese. Sigurisht që nevoja për të rregulluar aktivitetin ekonomik nëpërmjet politikave ekonomike është një nga aspektet kryesore të qeverisjes, dhe kjo në funksion të qëllimit kryesor të qeverisjes: ‘maksimizimit të mirëqënies sociale në afatgjatë në një mënyrë të barabartë dhe të qëndrueshme’⁷.

Mirëqenia sociale, e përcaktuar së fundmi si ‘pika e ekuilibrit ndërmjet tërësisë së burimeve që individi ka në dispozicion dhe sfidave me të cilat përballet’⁸, si dhe përmirësimi e deri maksimizimi i saj, ka reflektuar edhe mënyra të ndryshme veprimi nga ana e qeverive. Qasjet e tyre në funksion të përmirësimit të mirëqënies sociale variojnë nga përqendrimi tek shkurtimi i shpenzimeve në periudha rënieje ekonomike, tek rritja e taksave në periudha të rritjes ekonomike, e deri tek përqendrimi tek rritja e investimeve në fushën e teknologjisë, arsimit e infrastrukturës në periudhë krizash⁹.

Një vëmendje e veçantë në lidhje me mënyrën e rregullimit të aktivitetit ekonomik dhe qasjen ndaj tij, përqendrohet tek vendet në zhvillim. Kjo, jo vetëm për shkak të specifikave dhe karakteristikave të ndryshme socio-ekonomiko-politike që shfaqin këto shtete, por edhe për shkak të dy dinamikave kryesore që janë pjesë e politikave shtetërore ekonomike të kësaj kategorie vendesh. Ato janë demokratizimi dhe zhvillimi, apo siç etiketohet ndryshe nga Stiglitz *et al.*, ‘zhvillimi demokratik’¹⁰. Pra, nëpërmjet kësaj logjike kuptojmë se ecuria e proceseve demokratizuese dhe e proceseve të zhvillimit ekonomik është përcaktuese në një masë të konsiderueshme në maksimizimin e mirëqënies sociale.

1.1 KONTEKSTI I KËRKIMIT

Proceset demokratizuese të ndërmarra në fillim të viteve 90’ përfaqësuan procesin kryesor për vendet e Evropës Lindore dhe Juglindore. Politikisht, demokratizimi si proces morri jetë në një periudhë kur për pjesën më të madhe të këtyre vendeve, eksperiencat jodemokratike kishin shterur mundësitë e mbijetesës e vazhdimit të mbajtjes së pushtetit. Kalimet nga regjimet jodemokratike në regjime demokratike përfshinë periudha të caktuara kohore për secilën prej kësaj kategorie vendesh, edhe pse në kohëzgjatje të ndryshme.

⁷ Stiglitz, J. Ocampo, A. J. Spiegel, Sh. Ffrench-Davis, R. Nayyar, D., (2006), *Stability with Growth: Macroeconomics, Liberalization and Development*, Oxford University Press, Nju Jork, fq. 11.

⁸ Dodge, R., Daly, A., Huyton, J., & Sanders, L., (2012), ‘The challenge of defining wellbeing’, *International Journal of Wellbeing*, 2(3), 222-235. doi:10.5502/ijw.v2i3.4, fq. 230.

⁹ OECD, (2009), *Policy responses to the economic crises: investing in innovation for long-term growth*, fq. 25-31.

¹⁰ Stiglitz, J. Ocampo, A. J. Spiegel, Sh. Ffrench-Davis, R. Nayyar, D. *opcit.*, fq. 11.

Megjithatë, periudha kohore përgjatë së cilës u mundësua procesi i ndryshimit të formatit nga jodemokratik në demokratik përfshiu tre etapa të rëndësishme: së pari, zëvendësimin e regjimit jodemokratik; së dyti, institucionalizimin e demokracisë; dhe së treti, konsolidimin e saj¹¹. Nëse secila prej tyre do të përvijohet në terma të parakushteve të nevojshme për tu konsideruar e realizuar, atëherë sipas Schmidt¹², për fazën e parë duhet pranimit i parimeve e ideve demokratike në një vend, si dhe një strukturë sociale jo e konfliktuar, pluraliste e me kapital të rëndësishëm human. Zëvendësimi i regjimit nuk është i mjaftueshëm për të përfunduar procesin e demokratizimit, e si rrjedhim për këtë kërkohet institucionalizimi i demokracisë, etapë kjo që favorizohet më së shumti në format parlamentare të qeverisjes si dhe në ato vende të cilat aplikojnë sistemin zgjedhor proporcional për të mundësuar përfaqësimin e të gjitha grupimeve sociale. Ndërsa, konsolidimi i demokracisë mundësohet kur ky format legjitimohet nga qytetarët (pra njihet e pranohet prej tyre), kur ka qëndrueshmëri ekonomike dhe sociale, e kur vendi karakterizohet nga një elitë e shëndetshme politike.

Nëse iu referohemi vendeve post-socialiste të Evropës Lindore dhe Juglindore, shohim se ky etapëzim standard i procesit të demokratizimit nuk gjen zbatim të njëjtë në këtë grupshitetesh. Veçoritë me të cilat janë prezantuar sistemi ekonomik e ai politik nga pikëpamja e organizimit bëjnë të mundur evidentimin e tre rrugëve kryesore të zhvillimit, të cilat nëse i referohemi Bunce janë: e para është rruga ku demokracia dhe kapitalizmi bashkë-ekzistojnë në një mënyrë të qëndrueshme dhe mbështetëse (pas një rënije të fortë në fillim), dhe si rezultat ka stabilitet politik e rritje ekonomike të qëndrueshme; rruga e dytë është ajo ku kemi bashkëjetesën e politikës autoritare me ekonomiskin gjysëm-socialist, ku sërish rezultati është politika relativisht stabël dhe një performancë ekonomike e mirë; ndërsa në rrugën e tretë e cila përfshin pjesën më të madhe të shteteve, përfaqësohet si një rrugë e mesme, e pozicionuar ndërmjet demokracisë dhe diktaturës e ndërmjet ekonomiksit socialist dhe kapitalist. Pikërisht, tek shtetet që prezantojnë këtë situatë të fundit, politika tenton të jetë më shumë jostabël dhe ku performanca ekonomike është më e dobët¹³.

Pra, në tërësi ndryshimet e realizuara në sistemin politik të këtyre vendeve, strukturën e tyre institucionale, proceset e mënyrën e mbërritjes në rezultate të caktuara politikash, tentuan drejt konsolidimit të regjimit demokratik.

Pikërisht, një prej politikave më të rëndësishme, subjekt i rregullimit nga sistemi politik është politika ekonomike, e cila në kuadrin e proceseve demokratizuese në vendet në zhvillim, iu nënshtrua reformimit përkatës paralelisht me ndryshimet politike. Sigurisht, qëndrimet e mbajtura ndaj reformës ekonomike ishin të ndryshme (në terma të alternativave të ndjekura nga vendet në zhvillim të Evropës Lindore dhe Juglindore), pavarësisht se qëllimi kryesor ishte kalimi drejt një ekonomie tregu të hapur, liberalizimit, dhe privatizimit në masë. Këta elementë ishin edhe pjesë e ‘Konsensusit të Uashingtonit’, ‘një politikë reforme e sugjeruar nga SHBA dhe institucionet financiare ndërkombëtare për të rritur rritjen ekonomike nëpërmjet një sërë instrumentesh si: liberalizimi i tregëtisë, rritja e investimeve të huaja të drejtpërdrejta, privatizimi,

¹¹ Schmidt, G. M., (2012), *Teoritë e demokracisë*, Botart, Tiranë, fq. 444.

¹² *ibid.*, fq. 444-446.

¹³ Bunce, V. (1999), ‘The Political Economy of Post-socialism’, *Slavic Review*, Special Issue: Ten Years after 1989: What Have We Learned?, Vol. 58(4):756-793, fq. 761.

reduktimi i rolit të shtetit në ekonomi. Pra, një qasje neoliberales e fokusuar tek rëndësia e stabilitetit makroekonomik dhe integrimi në ekonominë ndërkombëtare¹⁴.

Gjithsesi, zbatimi i ‘Konsensusit të Uashingtonit’, për fazën e parë të transformimit të ekonomive të vendeve në zhvillim nuk pati rezultatin e parashikuar dhe të pritur. Kritikët e reformave që kjo politikë sugjeronte, i shohin dështimet të lidhura me idenë bazë që përfaqësoi ‘Konsensusi i Uashingtonit’: fundamentalizmin e tregut apo me besimin se tregjet kanë aftësi të arrijnë vetë eficientë ekonomike, mosmarrjen parasysh të ndryshimeve teknologjike, apo rolin shumë të kufizuar të shtetit¹⁵. Dhe pikërisht, tek ky element i fundit është mbështetur ‘Post-Konsensusi i Uashingtonit’: roli ndoshta jo mirë i përcaktuar i shtetit në reformën ekonomike. Pra, për vazhdimësinë e mëtejshme të reformave ekonomike e një rëndësie të madhe për ‘Post-Konsensusin e Uashingtonit’ tashmë ishte çështja e marrëdhënies ndërmjet shtetit dhe aktivitetit ekonomik, e madje një nevojë për të mos u mjaftuar me rolin minimal të shtetit në ekonomi sipas qasjes neoliberales¹⁶. Kjo nevojë dëshmon jo vetëm rëndësinë e komunikimit ndërmjet sistemit politik dhe atij ekonomik, por edhe një nivel më të lartë varësie të këtyre dy sistemeve nga njëri-tjetri. Pra, fenomene, ngjarje, e dukuri të caktuara përkatësisht të aspektit ekonomik e politik ndikojnë në rezultatet (outputet) e proceseve ekonomike e politike.

Të gjithë këta elementë: ndryshimet transitore politike dhe ekonomike, koncepti i zhvillimit demokratik, konsensusi dhe post-konsensusi i Uashingtonit, etj., kanë të nevojshëm matjen e vlerësimin e tyre përgjatë kohës qoftë kjo, në grup-shtete apo shtete specifike. Në kontekstin e këtyre zhvillimeve, dy elementë shndërrohen në përcaktues: stabiliteti politik nga njëra anë dhe rritja ekonomike nga ana tjetër. Pra, ecuria e zhvillimeve si të karakterit politik, ashtu edhe të karakterit ekonomik ka një konvergencë tek këta elementë të cilët, sidomos për vendet që i janë nënshtruar procesit të tranzicionit demokratik, marrin një rëndësi të veçantë.

Të ndërgjegjshëm për rëndësinë që përfaqëson për ecurinë e zhvillimeve politiko-ekonomike kjo marrëdhënie, ne tentojmë që brenda këtyre dinamikave zhvillimore të fokusohemi në rastin e disa vendeve të Ballkanit Perëndimor (Shqipëria, Maqedonia, Bosnjë Hercegovina dhe Kroacia) për të hulumtuar, testuar e vlerësuar raportin (de)stabilitet politik-rritje ekonomike tek këto vende. Natyrisht, ashtu si vende të tjera të Evropës Lindore e Juglindore, ato u bënë pjesë e ndryshimeve të karakterit politik e ekonomik për të mundur kalimin nga një regjim komunist drejt një formati demokratik qeverisjeje. Mënyra se si u realizuan këto ndryshime, aktorët e përfshirë në to, rezultatet e prodhuara brenda kontekstit shtetëror, sigurisht që prezantojnë specifikat e veta në raport me shtete të tjera të rajonit të Ballkanit e më gjerë. Kjo, pikërisht për arsye edhe të ndryshimeve në përbërjen sociale, stratifikimin e shoqërisë, kulturën politike, pozicionin gjeografik, mënyrën e organizimit të pushtetit politik, ushtrimit të autoritetit brenda kufijve shtetërorë, etj.

¹⁴ Konsensusi i Uashingtonit, OBSH, <http://www.who.int/trade/glossary/story094/en/>

¹⁵ Stiglitz, E. J., (2004), ‘Post Washington Consensus’, Initiative for Policy dialogue, prezantuar në Barcelonë në konferencën “From the Washington Consensus towards a new Global Governance”, fq, 3-4.

¹⁶ *ibid.*, fq, 5-7.

Tashmë, pas dy dekadash e gjysëm prej etapës së parë të tranzicionit demokratik, asaj të ndryshimit të regjimit politik, vërejmë se, nga një vështrim i përgjithshëm i proceseve demokratizuese për vendet e Ballkanit Perëndimor, specifikisht, sistemi politik shqiptar është përballur me sfida të shumta. Sipas Bideleux dhe Jeffries, nëse në vendet e tjera si: Mali i Zi, Bullgaria, Rumania apo Serbia, strukturat dhe rrjetet e pushtetit të trashëguara nga e kaluara komuniste u ruajtën edhe pas ndryshimeve të regjimit, në Shqipëri, të gjithë këto struktura të së kaluarës komuniste u shkatërruan, dhe pikërisht për këtë arsye ‘përpyjekja e vazhdueshme për të vendosur demokracinë liberale është penguar nga një mungesë e theksuar e pushtetit të strukturave të caktuara dhe lidhjeve sociale të çdo lloji’¹⁷. Edhe konstatimi i Bideleux dhe Jeffries na drejton tek çështja sesi është menaxhuar vetë tranzicioni, dhe padyshim roli që elementë të veçantë si qëndrueshmëria e qeverisjes apo ecuria e zhvillimit ekonomik kanë patur në akomodimin e ndryshimeve në lidhje me strukturën e tregut dhe formatin qeverisës.

Së fundmi, konteksti i mësipërm studimor është legjitimues edhe i arsyeve të përqendrimit të studimit në peridudhën paskomuniste, prej të cilave më specifikisht do të identifikonim: së pari, nevojën për të mundësuar vlefshmërinë e analizës teorike për periudhën e marrë në konsideratë, si dhe supozimet e përfundimet që kjo e fundit mundëson; së dyti, nevojën për të testuar në mënyrë më të plotë e më në thellësi një periudhë të rëndësishme kohore për rastin e këtyre vendeve, jo vetëm nga pikëpamja e dinamikave të stabilitetit (destabilitetit) që shoqëruan kalimin nga një regjim politik në një tjetër, por edhe për të vlerësuar ndërveprimin e këtij variabli me një tregues të rëndësishëm makroekonomik siç është rritja ekonomike; së treti, për të garantuar qëndrueshmërinë e variablave të përfshirë në model në pikëpamje të vlefshmërisë dhe uniformitetit të kuptimit që prezanton secili prej tyre.

1.2 QËLLIMI I KËRKIMIT

‘Zhvillimi demokratik’ nëpërmjet rritjes ekonomike, si proces, na mundëson ndërlidhjen me disa dinamika të ndryshme që marrin jetë brenda shteteve, si: zhvillimi, demokratizimi, institucionalizimi, etj., të cilat patjetër mund t’i shohim në kuadrin e makroprocesit të tranzicionit demokratik dhe ekonomik. Një dinamikë e rëndësishme brenda këtij makroprocesi është trendi i stabilitetit politik, si dhe përgjigjja e sistemit ekonomik ndaj tij. Natyrisht, ka një sërë treguesish makroekonomikë të cilët mund të jenë reagues ndaj ndryshueshmërisë së niveleve të stabilitetit politik të një vendi, por një ndër më kryesorët prej tyre, me të cilin identifikohet edhe procesi i zhvillimit është rritja ekonomike.

Duke u përqendruar në një rastin e disa vendeve të Ballkanit Perëndimor, ky studim ka për qëllim kryesor identifikimin e natyrës së marrëdhënies që ka ekzistuar përgjatë periudhës së pas viteve 90’ ndërmjet stabilitetit politik e ndryshorëve të tjerë ngushtësisht të lidhur me të, me rritjen ekonomike dhe elementët që kjo e fundit përfshin. Sidoqoftë, identifikimi i këtij boshti qendror mbi të cilin organizohet studimi, si dhe përcaktimi i aspekteve kohore dhe fizike të tij nuk janë plotësisht shterues. Kur themi identifikimin e

¹⁷ Bideleux, R. Jeffries, I., (2007), *The Balkans: A post-communist history*, Routledge, Londër & Nju Jork, fq.72.

marrëdhënies ndërmjet stabilitetit politik dhe rritjes ekonomike, marrim parasysh se qëllime të tjera më specifike synojnë të përmbushen në funksion të zërthimit të këtij qëllimi kryesor.

Kështu, së pari, ne synojmë të identifikojmë dinamikën e përgjithshme në kontekstin e së cilave zhvillohet marrëdhënia destabilitet politik-rritje ekonomike. Kjo kërkon prezantimin e qasjeve si ajo e modernizimit, demokratizimit, institucionalizimit, teorinë e rritjes, etj. Së bashku, ato na ofrojnë bazën shpjeguese në perspektiva të ndryshme të raportit që tentojmë të studiojmë.

Së dyti, studimi i një marrëdhënieje, fillimisht bën të nevojshëm analizimin dhe operacionalizimin e koncepteve të përfshira në të. Literatura akademike regjistron kontribute të shumta të studiuesve në lidhje me përkufizimin e konceptit të stabilitetit politik. Nga njëra anë politologët fokusohen në aspektet thelbësisht politike të këtij koncepti, ndërsa nga ana tjetër ekonomistët përqendrohen në përvijimin e tij në funksion edhe të karakteristikave ekonomike të një sistemi. Shumësia e mënyrave prej nga shihet koncepti i stabilitetit politik bën pra të nevojshme identifikimin e qëndrimit që do të mbahet në këtë studim, kur ky koncept vlerësohet në raport me rritjen ekonomike.

Megjithatë, identifikimi i një përkufizimi të qëndrueshëm dhe të plotë, është vetëm njëri aspekt i analizës së konceptit. Për këtë, synohet edhe operacionalizimi i tij në mënyrë që të bëhet i mundur testimi empirik i marrëdhënies në fjalë. Ndërsa, përse i përket konceptit të rritjes, kjo bën të nevojshme edhe prezantimin e teorive të lidhura me të si dhe mënyrës së matjes së saj në kontekstin e këtyre teorive.

Së treti, studimi i marrëdhënies destabilitet politik-rritje ekonomike bazohet në supozimin e përgjithshëm logjik, atë të komunikimit që ekziston ndërmjet sistemit politik dhe sistemit ekonomik brenda kontekstit shtetëror. Kjo na orienton tek ideja tjetër, ajo e nevojës së studimit të komunikueshmërisë ndërmjet këtyre sistemeve, dhe më specifikisht duke u bazuar tek elementë ngushtësisht të lidhur me variabëlën stabilitet politik brenda sistemit politik, dhe variabëlën rritje ekonomike brenda sistemit ekonomik. Kjo sepse, si stabiliteti, ashtu edhe rritja nuk zhvillohen si trende krejtësisht të izoluar. Ato marrin e japin me elementë të tjerë të këtyre sistemeve. Marrja në konsideratë edhe e këtyre elementëve të tjerë si: niveli i demokratizimit, institucionalizimi, korrupsioni, niveli i shkollimit, etj., plotëson kontekstin e studimit.

Së fundmi, nëpërmjet kësaj tematike studimore, ne tenojmë të testojmë edhe empirikisht marrëdhënien ndërmjet variablave. Kjo mënyrë testimi përfshin nevojën për të identifikuar edhe mënyrën e vlerësimit të këtij fenomeni. Edhe pse indekset ndërkombëtare të prodhuara nga agjenci dhe insitucione të tjera që bëjnë matjen e niveleve të destabilitetit politik janë në numër të konsiderueshëm, nevojitet gërshetimi i këtij informacioni me qëllim kapjen e të gjitha aspekteve të stabilitetit politik prezent në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Përqendrimin në këtë grup-shtetesh, ne e shpjegojmë nëpërmjet disa argumenteve.

Nëse i referohemi përkufizimit të njohur të Ake për stabilitetin politik, si 'rregullsia e rrjedhës së shkëmbimeve politike'¹⁸, për të ofruar një analizë të plotë studimore në lidhje me këtë koncept, është e nevojshme njohja e strukturës politike të vendit dhe e pritshmërive të roleve politike të krijuara nga shoqëria. Studimi i ndryshimit të bazës së strukturës politike me kohën (gjatë periudhës demokratizuese), si dhe evidentimi i mënyrës se si anëtarët e shoqërisë janë shprehur nëpërmjet roleve të tyre politike brenda kësaj strukture, mundëson një vlerësim racional e më objektiv të trendit të këtij fenomeni për rastin e këtyre vendeve.

Po kështu, analiza e marrëdhënies nën studim zhvillohet më e plotë dhe më përfshirëse nëse fokusohemi tek një grup-shtetesh, i cili është në qendër të vëmendjes edhe në politikën ndërkombëtare, e sidomos në ato integruese.

Nga ana tjetër, ashtu siç e dëshmon edhe literatura në studimin e marrëdhënies destabilitet politik-rritje ekonomike, nisur nga mënyrat e ndryshme të testimit të kësaj marrëdhënieje, nuk mbërrihet në rezultate të konsoliduara e përfundimtare nga të gjithë studiuesit e çështjes në fjalë. Ata ndahen, përse i përket kahut të marrëdhënies, si dhe ekzistencës apo jo të një ndikimi të stabilitetit politik tek rritja ekonomike. Rrjedhimisht, mungesa e rezultateve përfundimtare në lidhje me këtë raport, bën shpesh të nevojshëm studimin dhe analizën e tij rast pas rasti ose në grup-shtetesh të cilat janë karakterizuar nga dinamika politike e ekonomike të ngjashme me njëra-tjetrën.

Argumenti i fundit i të zgjedhurit të këtij grupi shtetesh ecën paralelisht me atë që Bunce e quan 'thjeshtësia e kuantifikimit të parasë'¹⁹. Ndryshe nga treguesit makroekonomikë dhe performanca ekonomike, të cilët janë më lehtësisht të matshëm në terma sasiorë, koncepti i stabilitetit politik duke qenë cilësor, dhe për shkak të shumësisë së dimensioneve që e përcaktojnë, paraqet vështirësi apo probleme vlerësimi. Për këtë arsye, përfshirja në një studim e një kampioni shtetesh të ndryshme, jo vetëm mundëson kapjen e plotë të të gjithë dimensioneve nëpërmjet të cilave fenomeni i stabilitetit politik shfaqet, por edhe rrit qëndrueshmërinë dhe vërtetësinë e rezultateve që prodhohen nga testimi empirik nën këtë numër vëzhgimesh.

1.3 KORNIZA TEORIKE

Koncepti i stabilitetit politik është një nga tematikat më të diskutuara në hulumtimin shkencor të politologëve dhe ekonomistëve. Trajtimi i konsiderueshëm që ka marrë kjo çështje shpjegohet me lidhjen e ngushtë që studiuesit vlerësojnë se ekziston midis sistemit politik dhe atij ekonomik, e respektivisht midis stabilitetit politik dhe variablave ekonomike. Kjo literaturë, e cila merr në konsideratë trajtimin e çështjes së marrëdhënies midis stabilitetit politik dhe disa kushteve të veçanta ekonomike, është e larmishme si në aspektin cilësor dhe në atë sasior të kërkimit. I tillë është edhe kontributi i studiuesve të cilët fokusohen vetëm tek fenomeni i stabilitetit politik e elementëve të tjerë politikë me të cilët ky i fundit është i lidhur, apo i studiuesve të tjerë të cilët vlerësojnë marrëdhënien e rritjes ekonomike në raport me të tjerë elementë nga sistemi ekonomik dhe ai politik.

¹⁸ Ake, *opcit.*, fq. 273.

¹⁹ Bunce, *opcit.*, fq. 772.

Interes të madh studimor paraqet hulumtimi e kërkimi mbi konceptin e stabilitetit politik, e sidomos mbërritja tek një përkufizim i pranueshëm që të kapë gjithë kompleksitetin dhe dinamikat me të cilat ky i fundit shfaqet. Mbërritja tek një përkufizim i tillë përfaqëson edhe një sfidë studimore, duke qenë se ky koncept paraqet vështirësi jo vetëm në çështjen e përkufizimit, por edhe në operacionalizmin dhe matjen e tij.

Teoricienët politikë, prej shumë kohësh e kanë vendosur çështjen e stabilitetit politik në qendër të diskutimeve të tyre. Që në lashtësi shohim refleksionet e para mbi këtë koncept nga Aristoteli, i cili i kushtoi vëmendje të veçantë stabilitetit të regjimeve dhe përshtatshmërisë së tyre. Në përpjekjet për të ofruar një përkufizim për konceptin e stabilitetit politik, një pjesë e madhe e studiuesve përqendrohen tek dhuna e përdorimi i saj. Të tillë autorë përmendim Hurwitz (1973), Hibbs (1973), Bollen dhe Jones (1982), Mishler dhe Hildreth (1984), etj. Në një mënyrë, kjo linjë autorësh kanë në fokus të tyre regjimin politik dhe mënyrën sesi ai mban veten, qoftë kjo nëpërmjet shfaqjes së llojeve të ndryshme të dhunës (protestat antiqeveritare, grushet e shtetit, ngjarjet me sulm të armatosur, vrasjet apo vdekjet nga dhuna politike, etj) apo nëpërmjet mungesës së prezencës së formateve të dhunshme të organizimit politik. Në një këndvështrim tjetër, autorë të tjerë si Gurr (1974), Bunce (1999) përqendrohen tek aftësia përshtatëse dhe rregulluese e regjimit politik apo sistemit politik. Më specifikisht, Cukierman, Edwards, dhe Tabellini (1992); Alesina dhe Perotti (1994); Alesina, Ozler, Roubini, Swagel (1996); Brunetti dhe Weder (1995); Taylor dhe Herman (1971), e shohin stabilitetin politik apo prezencën e destabilitetit politik nisur nga përbërja e ekzekutivit, ndryshueshmëria apo kohëzgjatja e tij. Të tjerë autorë, si Feierabends (1966), Margolis (2010), Chan (2006), etj e shohin atë të lidhur me kontekstin social dhe me elementë specifikë të karakterit social apo psikologjik të tij.

Përveç kontekstit cilësor, në aspektin e përcaktimit të (de)stabilitetit politik, ky studim i është referuar edhe literaturës sasiore në të cilën prezantohen marrëdhënie specifike brenda dinamikës *stabilitet politik-rritje ekonomike*. Nga vlerësimi i marrëdhënies destabilitet-rritje, studimet fokusohen në kahun e marrëdhënies dhe në nivelin e ndikimit të variablave tek njëri-tjetri. Autorë si Ali (2001), Pitlik (2008), Jong-A-Pin (2006), Aisen dhe Vega (2011), Zureiqat (2005), Alesina *et al.* (1996), etj evidentojnë një marrëdhënie negative ndërmjet destabilitetit politik dhe rritjes ekonomike me kah nga destabiliteti tek rritja.

Në vlerësimin e marrëdhënies *demokraci-rritje ekonomike* vëmë re se rezultatet nuk janë përfundimtare në lidhje me llojin (pozitiv apo negativ) të ndikimit të demokracisë tek rritja ekonomike. Disa autorë evidentojnë një ndikim pozitiv të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë të demokracisë tek rritja, si: Friedman (2005), Barro (1996), Polterovich e Popov (2007), Plümper dhe Martin (2003), Gerring *et al.*, (2005), Kaufman e Kraay (2002), Mobarak (2005), etj; dhe të tjerë studiues dalin në përfundime të një ndikimi negativ të demokracisë tek rritja ekonomike, si: Galenson (1959), de Schweinitz (1959), Moore e Smitz (2008), etj. Një ndikim negativ i demokracisë tek rritja ekonomike ligjërohet nga logjika e prezencës së një shumësie grupesh në një shtet të caktuar, të cilat në kushtet e lirisë për të vepruar e për të përmbushur interesat e tyre politike shpesh të kundërta mund të prodhojnë bllokime të procesit të vendimmarrjes, pikërisht në sajë të aksesit që kanë në sferën politike.



Në pikëpamje të marrëdhënies së *institucioneve dhe rritjes ekonomike*, literatura bazë kryesisht evidenton një marrëdhënie pozitive të ndikimit të institucioneve tek rritja ekonomike. Studiues që konfirmojnë këtë linjë të përgjithshme rezultatesh janë: North (1990), Aron (2000), Mamoon e Murshed (2009), Mijiyawa (2008), Beck e Laeven (2005), etj. Ajo që vëmë re janë mënyrat e ndryshme, në varësi të natyrës së studimit, sesi janë konceptualizuar insitucionet për tu testuar më pas me rritjen ekonomike e me variabla të tjerë ndërhyrës. Operacionalizimin e konceptit dhe indekset që përdoren në matjen e tij mund t'i shohim kryesisht në dy dimensione kryesore. Nga njëra anë, një pjesë e studiuesve përqendrohen tek aspekti cilësor dhe i performancës së institucioneve (përfshirë këtu specializimin burokratik, sundimin e ligjit dhe së drejtës, kontrollin e korrupsionit në administratë, etj); ndërsa, nga ana tjetër vlerësohet aspekti strukturor i tyre ngushtësisht i lidhur me formatin qeverisës dhe llojin e sistemit zgjedhor.

E lidhur ngushtësisht me marrëdhënien institucione-rritje është ndërhyrja edhe e variabëlilit të *korruptionit*. I parë si një variabël me një ndikim negativ tek rritja ekonomike me autorë përfaqësues, si Mauro (1995, 1997, 2007), Drury *et al.*, (2006), Minassian (2002), etj, vlerësimi i korruptionit realizohet kryesisht brenda llojit të regjimit politik. Pra, nëse kemi të bëjmë me demokraci të konsoliduara, demokraci në tranzicion, apo regjime jodemokratike. Më pas, nivelet përkatëse të korruptionit të evidentuara sipas renditjeve të caktuara të agjencive dhe institucioneve ndërkombëtare testohen në modelet empirike në marrëdhënie me rritjen ekonomike e ndikimin e tij tek ky variabël i fundit (rritja ekonomike).

Baza teorike ku këto marrëdhënie marrin jetë fillon që me procesin e modernizimit, të cilin ky studim e vendos në kontekstin e instrumentit kryesor teorik prej nga ku zhvillohen dinamika demokratizuese, institucionale dhe ajo e zhvillimit ekonomik, apo ndryshe nga ku prezantohen modernizimi politik dhe ai ekonomik duke u përqendruar në kontributin e rëndësishëm të Lerner (1958), Huntington (1965, 1968, 2006), Lipset (1959, 1960), Przeworski (1991, 2004), Przeworski *et al.* (1997, 2000), etj. Kështu, modernizimi politik apo zhvillimi politik i referohet kryesisht ndryshimeve në: konceptimin e autoritetit dhe në mënyrën e shpërndarjes së tij, si dhe angazhimin social të shprehur nëpërmjet pjesëmarrjes në politikë. I parë në këtë këndvështrim, modernizimi shihet si një fenomen, i cili politikisht ka prodhuar bazat e mirëfillta të funksionimit të shteteve moderne duke krijuar mundësitë për rritje të pjesëmarrjes së qytetarëve në politikë, karakteristikë kjo e regjimeve demokratike dhe padyshim pjesë e procesit të demokratizimit. Pikërisht, si rrjedhojë e kësaj logjike, Huntington vlerëson se koncepti i modernizimit politik apo zhvillimi politik (si koncepte të barasvlershme të përdorura nga studiuesit) nënkupton tre dimensione të rëndësishme: racionalizimin, shtet-formimin, dhe demokratizimin²⁰. Si rrjedhim, edhe procesi i demokratizimit përfshin një tërësi procesesh të cilat ndihmojnë në mbajtjen dhe konsolidimin e mëtejshëm të regjimit politik në tërësi. Nëse, do të tentonim ta përvijonim në formë skematike marrëdhënien ndërmjet demokracisë dhe zhvillimit brenda lëmit të qasjes modernizuese do të identifikonim një kah shkakësie nga zhvillimi tek demokracia si dhe një korrelacion

²⁰ Huntington, P. S., (1965), 'Political development and political decay', *World Politics*, Vol 17(3): 386-430, fq. 388.

pozitiv linear ndërmjet këtyre dy variablave. Kjo marrëdhënie përmbledhet nëpërmjet prezantimit grafik të mëposhtëm²¹.



Megjithatë, për raste të veçanta, nevojitet vlerësimi real në një shtet të caktuar i marrëdhënies destabilitet politik-rritje ekonomike, së bashku me variablat e tjerë që përfshihen në këtë marrëdhënie, si mjete kryesor që kemi për të konfirmuar apo jo rezultatet e mësipërme.

1.4 PROBLEMI I KËRKIMIT DHE PYETJA KËRKIMORE

Proceset transformuese që përfshinë Evropën Lindore dhe Juglindore në fillimet e viteve 90' prekën sistemet politike, ekonomike e sociale të këtyre vendeve. Procesi bazë që përfshiu këto sisteme dhe që prodhoi ndryshime specifike në secilën prej tyre ishte ai i demokratizimit. Gjithsesi, pavarësisht karakteristikave dhe dinamikave të përbashkëta që ka prodhuar ky proces për këtë grup shtetesh, secili shtet veçmas, për shkak të ndryshimeve në përbërjen sociale, stratifikimin e shoqërisë, kulturën politike, pozicionin gjeografik, mënyrën e organizimit të pushtetit politik, e ushtrimit të autoritetit brenda kufijve shtetërorë ka prezantuar dinamika specifike.

Megjithatë, që prej viteve 90', një ndër fenomenet që ka shoqëruar ndryshimet ekonomiko-politike të vendeve të rajonit ka qenë ai i destabilitetit politik. Paralelisht me këto zhvillime, edhe sistemi ekonomik, i orientuar drejt një tregu të hapur konkurrencial pësoi ndryshimet përkatëse të shprehura nëpërmjet trendeve që treguesit makroekonomikë kanë ndjekur në këto vende.

Një çështje e rëndësishme që sintetizon këto dy linja zhvillimesh dhe nevojën për t'i dhënë përgjigje e shpjegime këtyre rrugëve të zhvillimit, është vlerësimi i marrëdhënies destabilitet-rritje ekonomike. Ndryshe, e paraqitur kjo në formën e një pyetjeje kërkimore: cila është marrëdhënia midis destabilitetit politik e rritjes ekonomike në disa vende të Ballkanit Perëndimor pas viteve 90'? Në zbërthimin në elementë më të veçantë të kësaj pyetjeje do të veçonim: a ndikon destabiliteti politik rritjen ekonomike?; cili është niveli i këtij ndikimi?; a ka pasur ecuri paralele të rritjes me destabilitetin përgjatë

²¹ Chen, E. L., 'Development First, Democracy Later? Or Democracy First, Development Later?: The Controversy over Development and Democracy, 1-36.

kësaj periudhe?; a ndikon niveli i demokratizimi rritjen?; cili është roli i korrupsionit në këtë marrëdhënie?, etj.

Në përpjekjen për t'iu dhënë përgjigje këtyre pyetjeve, studimi do të gërshetojë dy linja analize: analizën teorike dhe atë sasiore bazuar në testimin empirik të ecurisë së variablave të përfshirë në studim. Nëpërmjet tyre ne presim që të përftojme një analizë të qartë dhe vlerësim empirik të rastit të Ballkanit Perëndimor nisur nga këto marrëdhënie, për të prodhuar më pas sugjerime konkrete në ecurinë e zhvillimeve të fenomeneve ekonomiko-politike.

1.5 ÇËSHTJET E KËRKIMIT

Në funksion të përmbushjes së qëllimit kryesor dhe qëllimeve të tjera që derivojnë prej tij, si dhe në tentativë për t'iu dhënë përgjigje pyetjeve që ky punim shtron për tu diskutuar dhe vlerësuar, kërkimin në këtë dizertacion e kemi orientuar drejt disa çështjeve kryesore. Nëpërmjet analizës së tyre mundësohet prodhimi i bazës logjike prej nga ku prodhohet modeli i testimit empirik të studimit, si dhe elementët që ky i fundit përfshin. Natyrisht, çështjet e kërkimit, në përputhje edhe me metodologjinë, përfaqësojnë dy linjat kryesore të punimit. Pra, nga njëra anë, është e nevojshme që kërkimi të orientohet tek baza teorike dhe kontributet e studiuesve të tjerë për të sqaruar, sistematizuar, dhe vlerësuar këto kontribute. Ndërsa, nga ana tjetër, çështje të tjera specifike, të prodhuara edhe nga baza teorike, nevojitet të gjejnë mbështetje përpos asaj teorike edhe në realitetin empirik të grup-shteteve të marra në studim.

Si të tilla, çështjet kërkimore ku mbështetet ky studim janë:

- i. Analizimi i konceptit të destabilitetit politik apo prezencës së stabilitetit politik dhe mbërritja në një përcaktim që të përfshijë dimensionet kryesore të këtij koncepti.
- ii. Operacionalizimi i konceptit të destabilitetit politik nëpërmjet treguesve të veçantë të cilët evidentojnë dimensionet e konceptit në fjalë.
- iii. Identifikimi i indekseve ndërkombëtare që mundësojnë matjen e fenomenit të destabilitetit politik në funksion të evidentimit të një indeksi të agreguar në përmbushje të nevojës studimore për rastin e shteteve nën studim.
- iv. Analiza e trendeve zhvillimore politike dhe ekonomike në periudhën pas viteve 90' për vendet e Ballkanit Perëndimor.
- v. Vlerësimi empirik i marrëdhënies destabilitet politik-rritje ekonomike në kontekstin paskomunist.
- vi. Vlerësimi i nivelit ndikimit të demokratizimit, stabilitetit politike e korrupsionit tek rritja ekonomike në rastin e marë nën studim.
- vii. Analizimi i makromarrëdhënies ndërmjet sistemit politik dhe atij ekonomik, mbështetur në analizën e grupvariablave politikë dhe ekonomikë për rastin në fjalë.

1.6 METODOLOGJIA E STUDIMIT

Vlerësimi i stabilitetit politik apo pranisë të destabilitetit politik synon të prodhojë një analizë të strukturuar të këtij fenomeni për vendet e Ballkanit Perëndimor pas viteve 90' duke u fokusuar në testimin empirik në një grup më specifik të tyre. Nëpërmjet përfundimeve të nxjerra nga kjo analizë tentohet jo vetëm të kapet e analizohet stabiliteti politik përgjatë kësaj periudhe, por edhe shpresohet që nëpërmjet mënyrës së strukturimit të ngjarjeve e fenomeneve të tjera të lidhura me të, të vlerësohen edhe ndikimet e mundshme të këtyre ngjarjeve përgjatë kohës tek trendi i rritjes ekonomike.

I orientuar drejt këtij qëllimi të përgjithshëm, ky projekt studimor zhvillohet në dy linja të përgjithshme. Linja e parë e trajtimit përqendrohet në një analizë sistematike hulumtuese të literaturës që përqendrohet në konceptet dhe marrëdhëniet që ky studim përfshin. Në këtë linjë, studimi prodhon një vëzhgim të kontributit të politologëve dhe ekonomistëve në kuadrin e ekonomisë politike të rritjes duke organizuar rezultatet e studimeve dhe natyrën e tyre. Nëpërmjet lëvrimin të kësaj linje metodike, synohet të ofrohet baza teorike e legjitimitetit të marrëdhënies nën studim, qartësimi i koncepteve të përfshira në të, operacionalizimi në terma të treguesve me të cilët identifikohet secili koncept si dhe mënyra sesi ata janë parë të modeluar në marrëdhënie me njëri-tjetrin.

Të gjithë këta elementë i shërbejnë dhe janë në funksion të linjës së dytë studimore, asaj empirike. Në këtë linjë, studimi, nëpërmjet përdorimit të të dhënave sasiore dytësore të prezantuara nga indekse të agjencive apo institucioneve ndërkombëtare, prodhon një instrument matës të destabilitetit politik i cili tenton të kapë dimensionet e rëndësishme të tij. Po kështu, nëpërmjet të dhënave dytësore zyrtare të variablave të tjerë testohet empirikisht, nëpërmjet modelit të regresionit, marrëdhëniet e tyre me rritjen ekonomike, si dhe niveli i endogjenitetit midis dy variablave kryesorë rritje-destabilitet.

1.7 RISIA E STUDIMIT

Përqendrimi i studimit tonë tek mënyra se si fenomene specifike të karakterit politik ndikojnë në tregues të caktuar makroekonomikë, siç është rritja ekonomike, lidhet ngushtë me një disiplinë relativisht të re studimore e cila është ngritur si e tillë në sajë të kontributit të ekonomistëve dhe politologëve. Ajo është ekonomia politike apo ekonomiksi politik, siç shihet të përmendet në literaturë nga autorë të ndryshëm, e cila ndërthur perspektivat e tre disiplinave të tjera studimore, si: shkolla e vjetër e zgjedhjes publike, teoria e ekuilibrit të politikës makroekonomike, dhe shkolla e zgjedhjes racionale në shkencat politike²². Më specifikisht, duke qënë se fokusohemi tek rritja ekonomike, studimi zhvillohet në kontekstin e një fushe më specifike brenda ekonomisë politike, që është ekonomia politike e rritjes. Ajo çka është e një rëndësie studimore në këtë aspekt, është fakti se nëpërmjet logjikave vepruese të kësaj fushe, studiuesi nuk izolohet në studimin e aspekteve të veçanta të një apo disa variablave të së njëjtës natyrë duke e përjashtuar kështu studimin nga ndikimi i mundshëm i faktorëve të tjerë. Përkundrazi, për të ofruar një analizë më të shëndoshë e më të plotë të një apo disa marrëdhënieve, bëhet e

²² Persson, T., (2002), 'Do Political Institutions Shape Economic Policy?', *Econometrica*, Vol. 70(3): 883-905, fq. 883.

domosdoshme marrja në konsideratë e komunikimit mes variablave të natyrave të ndryshme (ekonomike, politike e sociale).

Kjo bëhet jo vetëm në funksion të plotësisë së studimit, por edhe për shkak të vetë natyrës së fenomeneve që merren nën vlerësim. Kështu, që në mënyrën e perceptimit të destabilitetit politik paraqitet nevoja për të parë komunikimin ndërmjet sistemit ekonomik e politik. Rrethi vicioz nëpër të cilin kalon marrëdhënia paraqitet edhe nga Shepherd sipas të cilit 'stabiliteti nënkupton një mjedis politik të parashikueshëm, i cili nga ana e vet tërheq investimet, si nga brenda ashtu edhe nga jashtë. Kjo, më pas reflektohet në reduktimin e varfërisë, krijimin e vendeve të punës, rritjen e të ardhurave shtetërore, dhe investime në mirëqenie dhe arsim duke i sjellë përfitime të gjithëve në shoqëri, kështu që një rikthim tek dhuna ose kaosi nuk është në interesin e askujt²³.

Risi, gjithashtu në kuadrin e këtij studimi përbën edhe aspekti hapësinor i tij, apo hapësira ku përqendrohet në vlerësimin e aspekteve politike në ndërveprimin e tyre me sistemin ekonomik, e më specifikisht me rritjen ekonomike. Kështu, pjesa më e madhe e literaturës aktuale që teston marrëdhënien ndërmjet variablave politikë dhe ekonomikë, përqendrohet në studime empirike të të dhënave në një numër të konsiderueshëm shtetesh, ose në grup-shtete për periudha të ndryshme kohore, ku në këto grupime përfshihen shtete me karakteristika krejt të ndryshme të dinamikave politike e ekonomike. Ky punim vjen i veçantë në faktin se i trajton ato duke u përqendruar në një grup-shtetsh specifike, sic është rasti i Ballkanit Perëndimor dhe disa shteteve specifike të tij. Kjo, në të njëjtën kohë përbën një risi si dhe një sfidë hulumtuese.

Sfidë, sepse për realitetin pas viteve 90' të Ballkanit Perëndimor, pjesa më e madhe e studimeve janë të një karakteri përshkruar, apo edhe në rastin e mbledhjes së të dhënave për fenomene të veçanta, këto të fundit nuk testohen empirikisht nëpërmjet modelimit. Në këtë mënyrë, ne synojmë që nëpërmjet testimit empirik të prodhojmë rezultate të një rëndësie praktike për rastin studimor të marrë në konsideratë, si dhe të nxisim ndërmarrjen e studimeve të tjera të mëtejshme sidomos në fushën e ekonomisë politike, e cila gjën jo shumë lëvrime real në kontekstin shqiptar, nëpërmjet testimit të raporteve e marrëdhënive të ndryshme politiko-ekonomike për këtë rast.

Nga ana tjetër, duke evidentuar shumëdimensionalitetin e fenomenit të destabilitetit politik, por edhe shfaqjet e ndryshme të tij, ne paraqesim mënyrat e ndryshme të matjes së tij nëpërmjet indekseve ndërkombëtare. Për këtë, ne tentojmë të përdorim një indeks të destabilitetit politik i cili të jetë i përshtatshëm në kapjen e dinamikave historike e politike për hapësirën specifike të Ballkanit Perëndimor për të mbërritur në një analizë të vlefshme të çështjeve në diskutim.

Për më tepër, duke u përqendruar tek dinamika tranzicionale dhe ajo e ekonomisë politike të rritjes, ky studim, synon të sjellë në vëmendjen e studiuesve një fenomen siç është ai i destabilitetit politik, duke vendosur një lidhje të ngushtë të tij me rritjen ekonomike në zhvillimet e Ballkanit Perëndimor. Nga ana tjetër, ne synojmë të kontribuojmë sadopak në literaturën vendase duke e përcaktuar natyrën e kësaj

²³ Shepherd, B., 'Political stability: crucial for growth?', Department of International Relations, London School of Economics, 1-11, fq. 8.

marrëdhënieje, kahun dhe fortësinë e saj, mbështetur edhe në variabla të tjerë ndërmjetësues të karakterit ekonomiko-politik.

1.8 STRUKTURIMI I STUDIMIT

Zhvillimet ekonomike e politike gjatë procesit demokratizues janë përballur me sfida e problematika të cilat kanë ndikuar reciprokisht këto sisteme. Mirëpo, kjo është një premisë shumë e përgjithshme dhe e gjerë për tu vlerësuar plotësisht në realitetin empirik, dhe për më tepër për tu thjeshtëzuar nga pikëpamja operacionale. Kjo, sepse për të mbërritur në një analizë të plotë, nuk është e mjaftueshme vetëm vlerësimi i komunikimit ndërmjet të dy këtyre sistemeve. Mbërritja tek një njohje e plotë e dinamikave politike e atyre ekonomike në Ballkanin Perëndimor pas viteve 90' bën të nevojshme marrjen në konsideratë të një game të gjerë variablash të llojeve të ndryshme si dhe marrëdhëniesh varësie e ndërvarësie midis tyre. Të ndërgjegjshëm për gjerësinë studimore që paraqet kjo premisë e përgjithshme, si dhe për nevojën e një analize të thellë studimore të këtyre variablave veçmas, ne fokusohemi në studimin e marrëdhënies ndërmjet stabilitetit politik dhe rritjes ekonomike në grupin e disa shteteve që sot konsiderohen pjesë e Ballkanit Perëndimor.

Për të mundësuar zbërthimin e plotë të marrëdhënies në fjalë, studimi zbërthehet në disa nivele më specifike të cilat përfshihen brenda linjës teorike e asaj praktike. Secili prej tyre përfshin dinamikën e ndryshme së bashku me argumentet përkatëse të variablave politike kundrejt atyre ekonomike në testimin e marrëdhënies. Kështu, shkallë mbas shkallë punimi zhvillohet nëpërmjet analizës dhe trajtimit të këtyre linjave: kapitulli i dytë dhe i tretë mundëson trajtimin e bazës teorike të koncepteve që janë në qendër të studimit së bashku me teorinë që i shpjegojnë ato; kapitulli i katërt fokusohet në terrenin e Ballkanit Perëndimor si dhe disa shteteve specifike pjesë përbërëse e kësaj hapësire gjeografike duke trajtuar konkretisht konceptet e elementët teorikë të trajtuar në dy kapitujt e mëparshëm; kapitulli i pestë zbërthen aspektin praktik të punimit, metodikën e ndjekur, si dhe mënyrën e testimit të variablave me njëri tjetrin; kapitulli i gjashtë prezanton rezultatet empirike të prodhuara nga modeli i testuar si dhe diskutimet përkatëse që këto rezultate shtrojnë të nevojshme; ndërsa, kapitulli i shtatë paraqet prezantimin e përfundimeve në të cilat mbërrin ky studim si nga aspekti teorik, ashtu dhe nga aspekti praktik së bashku me disa rekomandime specifike për zhvillimet ekonomiko-politike në Ballkanin Perëndimor.

Trajtimi i linjës teorike që zhvillohet në *kapitullin e dytë dhe të tretë* mundëson një panoramë tre nivelëshe të dy shtyllave qendrore rreth të cilave organizohet studimi ynë. Në një nivel makro, tentohet të ofrohet një paraqitje e qasjeve kryesore teorike të cilat përfshijnë konceptet e rëndësishme të stabilitetit politik dhe rritjes ekonomike në logjikën e tyre shpjeguese të përgjithshme. Në një nivel të mesëm, synohet të zhvillohen elementët, fenomenet, për të mbërritur deri tek treguesit, të cilët plotësojnë logjikën shpjeguese të këtyre dy koncepteve të rëndësishme të sistemit politik dhe atij ekonomik. Ndërsa, në nivelin mikro fokusohemi në evidentimin e më pas vlerësimin e logjikave makro së bashku me përbërësit e nivelit të mesëm për rastin specifik studimor të disa vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Më konkretisht, në këta dy kapituj trajtohen këta elementë: *së pari*, realizohet një paraqitje e teorisë së modernizimit e më pas e qasjes demokratizuese, e parë nga pjesa më e madhe e studiuesve në kuadrin e dinamikave demokratizuese; *së dyti*, kësaj qasjeje i bashkëngjitet paralelisht edhe korpusi i përgjithshëm teorik i marrëdhënies ndërmjet demokratizimit dhe zhvillimit ekonomik; *së treti*, mbi këtë bazë teorike mbështetet dhe zhvillohet analiza e konceptit të destabilitetit politik duke përfshirë këtu përkufizimin, operacionalizimin si dhe treguesit nëpërmjet së cilave ky fenomen mund të operacionalizohet; *së katërti*, realizohet prezantimi i konceptit të zhvillimit ekonomik së bashku me përfshirjen e rritjes ekonomike në të dhe kuadrin teorik ekonomik që mbështetet tek rritja ekonomike; *së pesti*, trajtohet literatura dhe kontributi i studiuesve të ndryshëm, politologë dhe ekonomistë, në lidhje me marrëdhënien midis destabilitetit politik, demokracisë, kuadrin institucional e korrupsionit me rritjen ekonomike; *së gjashtu*, zhvillohet një organizim i modeleve empirike të marrëdhënieve të sipërpërmendura nga studiuesit e mësipërm;

Më konkretisht në **kapitullin e katërt** ofrojmë një prezantim të përgjithshëm të dinamikave dhe trendeve të ndjekura nga vendet në tranzicion në aspekte të veçanta politike e ekonomike, por duke u parë si një grup zhvillimesh të përbashkëta; *si dhe*, ofrohet një panoramë e përgjithshme e këtyre dinamikave për rastin në fjalë, çka mundëson edhe lidhjen me logjike me nevojën për të testuar empirikisht këto marrëdhënie në Ballkanin Perëndimor.

Testimi empirik, modulimi dhe organizimi i tij realizohet në **kapitullin e pestë** të studimit. Duke marrë parasysh disponueshmërinë e të dhënave, zhvillimet politike dhe ekonomike brenda së cilave synohet të studiohen dinamikat politikisht stabilizuese ose destabilizuese, rëndësinë që paraqesin ndryshimet politike të regjimit për të studiuar më pas më në detaj vijimësinë e fenomeneve të brendshme të proceseve demokratizuese, periudhën e mjaftueshme kohore (pas viteve 90³) për të testuar marrëdhënien mes variablove, kapjen më të plotë të specifikave të tranzicionit të këtyre vendeve në raportin midis sistemit politik dhe atij ekonomik në përqendrohemi në testimin praktik të tyre përgjatë një periudhë prej afro dy dekadash.

Kështu, në këtë kapitull, *së pari* bëhet një prezantim i kontekstit të kërkimit, aspektit kohor e fizik ku ai është i përqendruar; *së dyti*, prezantimi i kontekstit mundëson lidhjen me prezantimin e pyetjeve kërkimore dhe hipotezat e studimit; *së treti*, kapitulli vijon me shpjegimin e të dhënave të përfshira në studim, mënyrës së mbledhjes së këtyre të fundit, plotësisë e besueshmërisë së tyre; *së katërti*, vijohet me modelin empirik, shpjegimin e përzgjedhjes së tij dhe përkufizimin e shpjegimin e vetë modelit. Më pas brenda kësaj linje, vazhdohet me prezantimin e variablove të varur e të pavarur, supozimet e modelit për realizimin e testimit konkret.

Rezultatet e përfuara nga modeli empirik, i nënshtrohen analizës në **kapitullin e gjashtë**. *Së pari*, tek ky kapitull, në prezantojmë rezultatet e përfuara në vlerësimin e marrëdhënies ndërmjet variablove, konfirmimit apo jo të hipotezave të studimit, shkallën e korrelacionit ndërmjet variablove, e shkallën e shpjegimit të tyre tek variablat e varur. *Së dyti*, niveli tjetër i zhvillimit të këtij kapitulli vijon me çështjen e diskutimeve. Në këtë

nivel ne prodhojmë një vlerësim të rezultateve të përfuara, përputhshmërisë së tyre me bazën teorike, logjikave që ligjërojnë secilin prej rezultateve, qofshin ato të pritshme apo jo.

Në *kapitullin e shtatë*, ne realizojmë një përmbledhje të logjikave se si kanë konverguar linja teorike me atë praktike për studimin e marrëdhënies destabilitet-rritje në rastin e disa vendeve të Ballkanit Perëndimor. Kjo përmbledhje, *së pari*, evidenton përfundimet në lidhje me çështjet kërkimore të prezantuara jo vetëm brenda bazës praktike, por edhe asaj teorike. Përfundimet i referohen çështjeve zhvillimore tranzicionale të rastit të Ballkanit Perëndimor me karakter politik e ekonomik. *Së dyti*, ne tentojmë të ofrojmë disa rekomandime bazë për përgjigjshmërinë ndaj këtyre zhvillimeve ekonomiko-politike në terma të veprimeve e politikave për tu ndërmarrë në afatshkurtër dhe afatmesëm.

PJESA I

PWRQASJE TEORIKE:

**KORNIZA TEORIKE, KONCEPTET, TREGUESIT,
MODELET**

Trajtimi hulumtues dhe analitik që zhvillohet në këtë pjesë të parë të disertacionit synon të ofrojë një panoramë tre nivelëshe të dy shtyllave qendrore rreth të cilave organizohet ky punim. Në një nivel makro, tentohet të ofrohet një paraqitje e qasjeve kryesore teorike të cilat përfshijnë konceptet e rëndësishme të stabilitetit politik dhe rritjes ekonomike në logjikat e tyre shpjeguese të përgjithshme. Në një nivel të mesëm, synohet të zhvillohen elementët, fenomenet, për të mbërritur deri tek treguesit, të cilët plotësojnë logjikën shpjeguese të këtyre dy koncepteve të rëndësishme të sistemit politik dhe atij ekonomik. Ndërsa, në nivelin mikro, fokusohemi në evidentimin e më pas vlerësimin e logjikave të nivelit të parë së bashku me përbërësit e nivelit të mesëm për rastin e vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Më konkretisht, në punim realizohet një paraqitje e teorisë së modernizimit e më pas e qasjes demokratizuese, e parë nga pjesa më e madhe e studiuësve në kuadrin e dinamikave modernizuese. Kësaj qasjeje i bashkangjitet paralelisht edhe korpusi i përgjithshëm teorik i marrëdhënies ndërmjet demokratizimit dhe zhvillimit ekonomik. Kështu, nëpërmjet kësaj baze identifikohet rëndësia e fenomenit të stabilitetit politik për një shtet, dhe nga ana tjetër, nëpërmjet politikës ekonomike të rritjes identifikohet rëndësia që ka rritja për zhvillimin dhe marrëdhënia e mundshme e saj me sistemin politik. Nëpërmjet gërshetimit të këtyre dy logjikave të përgjithshme, paraqiten argumentet e ndryshëm të literaturës akademike për mënyrën, kahun si dhe nivelin e bashkëveprimit ndërmjet sistemit ekonomik e atij politik. Më pas, mbërrihet në trajtimin e rastit të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Kjo, fillimisht duke prezantuar dinamikën e tranzicionit demokratik, dhe duke u përqendruar më pas në një paraqitje të përgjithshme të zhvillimeve politiko-ekonomike të lidhura me rritjen dhe stabilitetin për rastin specifik të Shqipërisë.

KAPITULLI 2

STABILITETI POLITIK

Përmbledhje

Në këtë kapitull synohet të trajtohet koncepti i stabilitetit politik brenda logjikave teorike mbizotëruese të cilat e trajtojnë atë. Për këtë, tre janë dinamikat kryesore me të cilat vijohet. *Së pari*, përpiqemi të analizojmë fenomenin e stabilitetit politik në kuadrin e teorisë modernizuese duke përfshirë këtu lidhjen e ndikimin e saj edhe tek sistemi ekonomik. *Së dyti*, ofrojmë një analizë përmbledhëse të përcaktimeve më shumë të përdorura të stabilitetit politik. Kjo, jo vetëm për të identifikuar këndvështrimet e të parit të këtij fenomeni, por edhe për të trajtuar pikërisht këto këndvështrime në raport me çështje të natyrave të ndryshme (demokracia, korrupsioni, efektiviteti i qeverisjes, etj). *Së treti*, tentojmë që nëpërmjet analizës në thellësi të fenomenit të stabilitetit politik, të mbërrijmë tek operacionalizmi i konceptit, së bashku me treguesit përbërës të tij. Kjo, duke përfunduar me një trajtesë përmbledhëse të indekseve të stabilitetit politik të përfutur nga hulumtimi, së bashku edhe me treguesit e veçantë me të cilat identifikohet secili prej tyre.

2.1 HYRJE

Fjala *stabilitet*, etimologjikisht me origjinë nga fjala frënge e shek. XII (*stabilité*) dhe ajo latine (*stabilitās*), sipas fjalorit të Oksfordit, i referohet ‘cilësisë ose gjendjes së të qenit stabël (e palëvizshme)’²⁴. Më tej, fjalori i Oksfordit në një kuptim të dytë e shpjegon stabilitetin e një gjendjeje jomateriale si ‘imunitetin nga shkatërrimi ose nga një ndryshim thelbësor, një cilësi e qëndrueshme, që zgjat’²⁵. Në të njëjtën linjë, Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe e lidh fjalën stabilitet me qëndrueshmërinë²⁶. Pra, në nivelin etimologjik, koncepti i stabilitetit identifikohet me një gjendje të qëndrueshme e cila mund të jetë e natyrave të ndryshme. Kështu, ajo mund të shfaqet me natyrë politike, sociale, ekonomike, etj, në varësi të tematikës në studim.

Në këtë kontekst, do të pohojmë se sociologët janë më të interesuar në studimin e stabilitetit social, politologët në stabilitetin politik dhe ekonomistët në studimin e stabilitetit të treguesve makroekonomikë. Të shumta janë edhe qasjet studimore të cilat orientohen tek analiza e marrëdhënieve bashkëvepruese midis këtyre llojeve të stabilitetit. Një pjesë e studiuesve përqendrohen në qasje krahasuese të studimit të rasteve të veçanta, të tjerë autorë në trendet historike të niveleve të stabilitetit politik e komponentëve të tij, si dhe në të dhëna statistikore në seri të prodhuara nga institucione dhe agjenci ndërkombëtare që mundësojnë analiza të mirëfillta të këtyre të dhënave. Madje, të shumta janë rastet kur stabiliteti politik vihet në qendër të studimit si të politologëve ashtu edhe të ekonomistëve, në varësi të natyrës të studimit, e sidomos për çështje që i përkasin fushës së ekonomisë politike.

Teoricienët politikë, prej shumë kohësh e kanë vendosur çështjen e stabilitetit politik në qendër të diskutimeve të tyre. Që në lashtësi shohim refleksionet e para mbi këtë koncept nga Aristoteli, i cili i kushtoi vëmendje të veçantë stabilitetit të regjimeve dhe përshtatshmërisë së tyre. Në identifikimin e formave kryesore të shtetit, Aristoteli, vlerëson rëndësinë që ka shtresa dhe gjendja e mesme në demokraci ‘pasi aty nuk ka përçarje; atje ku klasa e mesme është e madhe, ka më pak mundësi për të krijuar përçarje dhe polemika’²⁷. Që në këto reflektime dhe përsiatje të para në analizën e formave të shtetit, koncepti i stabilitetit të entitetit politik vlerësohet si një tipar i formave të mira të qeverisjes, të cilat nga pikëpamja normative duhet të jenë të dëshirueshme për shoqëritë.

Duke mbërritur në kohët moderne, reflektime të tjera po mbi këtë koncept kanë kapur vëmendjen edhe të fizikantëve, prej të cilëve përmendim Erwin Schroedinger. Pavarësisht nivelit të lartë të abstragimit, trajtesa e tij në lidhje me këtë koncept, edhe pse e parë në këndvështrimin e pastër fizik, ka vlerë të veçantë. Kjo sepse, deduktivisht mund të kalojmë nga vlerësimet e tij fizike në ato sociale, ashtu siç sugjeron edhe vetë ky autor. Kështu, sipas Schroedinger mund të indentifikojmë dy lloje stabiliteti: stabiliteti statistikor dhe stabiliteti i organizimit. Stabiliteti statistikor i referohet tendencës

²⁴ *Oxford English Dictionary*, (2011), <<http://www.oed.com/view/Entry/188535?redirectedFrom=stability#eid>>, parë më 03, Dhjetor, 2012.

²⁵ *ibid.*, 2012.

²⁶ *Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe*, Akademia e Shkencave të Republikës së Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, 1980, Tiranë, fq. 1785.

²⁷ Aristoteli, (2003), *Politika*, Plejad, Tiranë, fq. 122.

mesatarizuese të numrave të mëdhenj, i cili në fushën e fizikës lidhet me aftësinë e pjesëzave të një elementi për të qënë të pavarura në lëvizjet e tyre, por pavarësisht kësaj, mesatarja e tyre i jep stabilitet elementit. Nga ana tjetër, stabiliteti i organizimit shfaqet në shumëllojshmërinë e paraqitjes së lëndës si: atome, molekula, botë, etj, të cilat në strukturën e ekzistencës së vet paraqesin gjithashtu një masë të caktuar stabiliteti²⁸. Sipas Wright, nëse këto dy koncepte do t'i aplikojmë në realitetin social, 'stabiliteti politik në kushtet aktuale, mund të ketë vetëm stabilitet të organizimit, por vlerat e diversitetit kulturor dhe lirisë kombëtare e individuale na sugjerojnë që organizimi universal të jetë me centralizim minimal, i ndërtuar mbi një sistem të komplikuar të kontrollit dhe balancave'²⁹. Sërish shohim të vlerësohen si përcaktuese tendencat mesatarizuese, ashtu si edhe për Arsitotelin.

Edhe pse në rendin botëror sot mund të flasim për një stabilitet të përgjithshëm strukturor, ngjarje apo procese që prekin zona të veçanta të tij kapin menjëherë vëmendjen e publikut të gjerë, politikëbërësve dhe ekonomistëve. Një prej dinamikave të tilla të viteve të fundit kanë qënë edhe ngjarjet e 'pranverës arabe'³⁰, të cilat përveç ndikimeve të shumta politike, ekonomike e sociale kanë ritheksuar rëndësinë e stabilitetit politik dhe nevojën e vlerësimit të tij të vazhdueshëm përgjatë kohës.

Në studime e analiza të tilla, stabiliteti i politik është trajtuar dhe trajtohet si rezultat i faktorëve ndikues të natyrave të ndryshme, kryesisht i lidhur me elementë të karakterit social, politik dhe ekonomik, pavarësisht se variablat specifike të marrë në konsideratë brenda secilës kategori janë të ndryshëm. Për rrjedhojë, edhe përkufizimet, matjet e vlerësimet që kryhen në drejtim të këtij fenomeni janë të shumëllojshme e shumëdimensionale. Kjo, nga ana tjetër, e ka bërë të vështirë mbërritjen në një koncept të gjithëpranuar nga ana e politologëve dhe ekonomistëve të stabilitetit politik, të cilët nisen nga premisa fillestare të ndryshme në studimin e këtij fenomeni e në marrëdhënien e tij me fenomene të tjera.

Në përpjekjen tonë për të mundësuar një të kuptuar më të plotë të këtij koncepti dhe marrëdhënies së tij me elementë të tjerë, shohim të nevojshme paraprakisht vlerësimin e kornizës së përgjithshme të rregullimit të politisë nën procesin e demokratizimit, si dhe kontekstit konkret brenda së cilit zhvillohet 'loja politike' referuar më tej rastit të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

²⁸ E. Schroedinger, *What is life?*, Cambridge University Press, 1946.

²⁹ Wright, Q., (1953), 'Economic and Political Conditions of World Stability', *The Journal of Economic History*, Vol.13(4), Cambridge University Press, fq. 368-369.

³⁰ Shënim: "Pranvera arabe" është një term i cili përmbledh të gjithë vendet e botës arabe të cilat u përfshinë nga një vale revolucionare demokratizimi e cila është shfaqur nëpërmjet, demonstratave, protestave, revolucioneve, luftave, me fillesa në Dhjetor të vitit 2012 në Tunizi, e më pas e përhapur në vende të tjera si: Egjipt, Libi, Jemen, Siri, etj.

2.1. TEORIA E MODERNIZIMIT

Demokracitë e sotme liberal-përfaqësuse, së bashku me tiparet dhe karakteristikat që prezantojnë janë në qendër të diskutimeve e analizave të shumanshme nga ana e teoricienëve dhe e studiuesve. Jo vetëm kaq, por ato shihen si një destinacion përfundimtar edhe për ato shtete të cilat janë duke kaluar në procese tranzitore të ndryshimit të llojit të regjimit, apo që janë në fillimet e këtyre proceseve. Kjo, natyrisht, shpjegohet me elementët me të cilët identifikohen demokracitë si dhe me vlerësimin pozitiv që ekziston në lidhje me këto të fundit.

Një nga elementët ku konvergjon pjesa më e madhe e ideve të studiuesve është fakti se në demokracinë liberale ekziston një prag minimal konsensusi në lidhje me vlerat e saj, i pranueshëm dhe i njohur nga të gjithë. Nëse vijojmë në këtë logjikë, rrjedhimisht, ekzistenca e konsensusit mbi këtë bashkësi vlerash të qenësishme të liberal-demokracisë shërben edhe si një kusht paraprak që i mundëson sistemit politik qëndrueshmërinë dhe menaxhimin e konflikteve. Pra, bashkëndarja midis individëve të një shoqërie e një sistemi vlerash sociale, politike dhe ekonomike, si dhe angazhimi i tyre ndaj këtyre vlerave kontribuon në stabilitetin e strukturës sociale e politike.

Në këtë kontekst, vlerësohet se në demokracinë liberale ekziston një konsensus minimal i cili legjitimon ekzistencën e formatit politik, që nga ana tjetër i shërben edhe stabilitetit të këtij formati. Kjo konfirmohet nga Almond dhe Verba ku sipas tyre ‘ndjenja e detyrimit për të qenë të informuar dhe pjesëmarrës në çështjet publike me kompetencë të mjaftueshme dhe efektshmëri në kërkesën e llogarisë ndaj elitave’ karakterizon kulturën politike të demokracive të suksesshme në krahasim me demokracitë më pak të suksesshme³¹. Vlerësimet e Almond dhe Verba janë në të njëjtën linjë me dimensionin e kontestimit publik dhe pjesëmarrjes të prezantuar nga Dahl, të cilat, sipas këtij të fundit janë zhvilluar falë një vargu shndërrimesh të vazhdueshme në përpjekjen për të mbërritur tek ‘poliarkia’. Pavarësisht natyrës hipotetike të këtij lloji regjimi politik të cilin mund ta paralelizojmë me demokracinë liberale, ekziston një konsensus fillestar në lidhje me vlerat që e përfaqësojnë atë. Vlera të tilla si: rend social-ekonomik i decentralizuar dhe i lirë, nivel i lartë i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror, nivel i ulët i pabarazive dhe pluralizmit nënkulturor, etj³², i garantojnë, sipas Dahl, qëndrueshmërinë regjimit politik. Këto qëndrime përmbledhen edhe në përcaktimin që Fukujama jep për stabilitetin politik ‘si aftësia e një sistemi politik për të qëndruar i bashkuar ose dominues ndaj organizimeve sociale në kuadrin e ndryshimeve social-ekonomike që është edhe virtyti më i madh për çdo shtet³³.

Pikërisht, ky konsensus vlerash i pranuar dhe i njohur brenda një shoqërie demokratike krijon kontekstin për ngritjen dhe konsolidimin e strukturave demokratike apo të gjithë sistemit politik. Në një kuptim të gjerë, sistemin politik mund ta shohim si ‘një mjet nëpërmjet të cilit dëshirat e anëtarëve të një shoqërie shndërrohen në vendime

³¹ Mayer, L., (2003), *Politikat krahasuese: kombet dhe teoritë në një botë që ndryshon*, Botime Ora, Tiranë, fq. 41.

³² Dahl, R., (2005), *Poliarkia: pjesëmarrja dhe opozita*, Pegi, Tiranë, fq. 203.

³³ Fukuyama, F., (2005), ‘Stateness First’, *Journal of Democracy*, Vol. 16 (1): 83-88.

detyruese³⁴, ose ndryshe, si rregullimin politik kryesor nëpërmjet të cilit qeveriset shoqëria e një shteti të caktuar³⁵. Rrjedhimisht, për ekzistencën dhe qëndrueshmërisë e tij, e një rëndësie të veçantë është marrëdhënia ciklike me qytetarët e një shoqërie. E quajmë ciklike, sepse mbërritja tek vendimet si produkte të sistemit politik është rezultat i një procesi ndërveprimi. Lënda e parë e këtij procesi merret nga qytetarët. Kërkesat, nevojat, qëndrimet e besimet e tyre shprehen nëpërmjet ndërveprimit politik me sistemin. Megjithatë, kjo nuk është shpjeguese e qartë e faktit se përse dhe si realizohet ky ndërveprim politik. Sipas Easton dhe Dennis, ky proces nxitet nga ekzistenca në një shoqëri të caktuar e tre elementëve kryesorë: ‘një tërësie normash e rregullash të cilat orientojnë sjelljen e qytetarëve, disa shtrëngesa (kufizime) minimale mbi qëllimet e përgjithshme të anëtarëve të saj, dhe strukturave të autoritetit nëpërmjet të cilave anëtarët e sistemit veprojnë në prodhimin dhe zbatimin e vendimeve politike’³⁶.

Të tre elementët me të cilat Easton dhe Dennis e lidhin ndërveprimin politik në procesin ciklik të sistemit politik, mund t’i vlerësojmë me një emër të vetëm: regjim politik. Në fakt, regjimi politik është baza më e gjerë mbi të cilën ngrihen dy elementët e formacionit politik të një shteti: sistemi politik dhe forma e qeverisjes. Rrjedhimisht, si sistemi politik i një vendi, ashtu edhe forma e tij e qeverisjes janë të varur nga performanca e regjimit politik. Ndryshe, kjo përkthehet si një marrëdhënie e ngushtë varësie midis vazhdimësisë së ekzistencës së regjimit politik dhe ecurisë së prodhimit të vendimeve apo lëndës përfundimtare nga sistemi politik.

Duhet theksuar se kur i referohemi konceptit të stabilitetit politik, në varësi të kontekstit nën të cilin shihet, literatura akademike bën dallimin midis stabilitetit të regjimit politik, dhe stabilitetit të sistemit politik. Një pjesë e studiuesve përdorin këto koncepte në mënyrë të ndërsjelltë, ndërsa të tjerë e konsiderojnë regjimin politik si tërësia apo bashkësia e rregullave dhe parimeve nëpërmjet të cilave organizohen strukturat politike në një shtet, ose sipas Della Porta (2003), si bashkësia e normave, vlerave dhe strukturave të autoritetit që janë në qendër të marrëdhënieve politike në një territor të caktuar³⁷. Dhe nga ana tjetër, identifikojnë veçmasi sistemin politik si mënyra specifike e rregullimit të marrëdhënieve ndërmjet strukturave në një shtet të caktuar. Paralelisht, shohim se koncepti i stabilitetit politik të regjimit i referohet ‘jetëgjatësisë së autoritetit qeverisës në një vend ku ky autoritet qeverisës mund të jetë një parti e vetme në një sistem një-partiak, ose nën një regjim autoritar, ushtarak, apo do të jetë një parti e vetme ose një koalicion disa-partiak në një sistem politik shumë-partiak, por e rëndësishme është që ky autoritet qeverisës për një periudhë të gjatë kohore pa trazira e rrëmujë’³⁸. Ndërsa, alternativat në lidhje me stabilitetin e sistemit politik (të cilat identifikohen edhe përgjatë studimit), iu referohen karakteristikave të veçanta të sistemit, si përbërja e qeverisë, ndryshueshmëria e ekzekutivit, etj.

³⁴ Easton, D. Dennis, J., (1967), ‘The child’s acquisition of regime norms: political efficacy’, *The American Political Science Review*, Vol. 61(1): 25-38, fq. 25.

³⁵ Gurr, T. R., (1974), ‘Persistence and Change in Political Systems, 1800-11971’, *The American Political Science Review*, Vol. 68(4), fq.1482-1504.

³⁶ Easton, D. Dennis, J., (1967), ‘The child’s acquisition of regime norms: political efficacy’, *The American Political Science Review*, Vol. 61(1): 25-38, fq. 25.

³⁷ Della Porta, D., (2002), *Introduzione alla scienza politica*, il Mulino, Bolonja, fq. 26.

³⁸ Samimi, J. A. Monfared, M. Moghaddasi, R. Azizi, K., (2011), ‘Political Stability and FDI in OIC Countries’, *Journal of Social and Development Sciences*, Vol. 1(1):18-23, fq.18.

Kështu, një aspekt i rëndësishëm i të parit të kësaj marrëdhënieje është stabiliteti i regjimit, qëndrueshmëria e të cilit prodhon kushtet për ekzistencën e vetë sistemit politik. Kjo do të thotë se garantitë që prodhon sistemi politik bazuar edhe në vendimet e tij, e mënyrën se si e menaxhon ndërveprimin politik, janë përcaktuese në ekzistencën e tij. Pra, ideja kryesore është se niveli i legjitimitetit të një vendi të caktuar ndikohet në mënyrë të konsiderueshme nga përmbushja dhe realizimi nga ana e sistemit politik të këtyre dimensioneve të performancës politike.

Në një studim për të vlerësuar variablat shpjegues të legjitimitetit në një grup prej 72 shtetesh, Gilley prezanton elementët e performancës politike të sipërpërmendur si pjesë të një teorie shkakësore me korrelacion të lartë. Sipas tij, ‘sa më shumë të përpiqen shtetet në ofrimin e një qeverisjeje të cilësishme, në garantimin e të drejtave demokratike, dhe shtetit të mirëqenies, aq më shumë do të mund të jenë ata në gjendje për të fituar mbështetjen e qytetarëve të tyre’³⁹.

Kështu, shohim se mbështetja politike e qytetarëve ka një vlerë të veçantë, sepse ajo prodhon një prej elementëve nëpërmjet të cilëve sistemi politik garanton mbarëvajtjen e procesit të ndërveprimit politik dhe në fund të fundit qëndrueshmërinë e regjimit politik: socializimin politik. Socializmi politik shihet si një proces nëpërmjet të cilit mësohen vlerat politike dhe supozimet faktike në momente të caktuara të jetës së një individi, sidomos gjatë fëmijërisë, e në dobësim e sipër kur ne rritemi⁴⁰. Pra, ky proces përfshin përbrendësimin e vlerave, normave e qëndrimeve të qytetarëve ndaj regjimit politik duke mundësuar në këtë mënyrë edhe legjitimitimin e tij. Duke e konsideruar regjimin politik si të drejtë, qytetarët ndërveprojnë me sistemin politik bazuar në këtë bashkësi normash e vlerash, ku këto të fundit shprehen nëpërmjet formave të ndryshme të pjesëmarrjes politike.

Nëse marrim në konsideratë regjimin demokratik, mund të themi se qëndrueshmëria e këtij regjimi garantohej në thelb nga elementët përbërës të tij, ku një rol të rëndësishëm luajnë edhe një bashkësi normash e vlerash të pranuar nga qytetarët, të cilat përbëjnë edhe bazën e komunikimit të tyre me sistemin politik.

Përveç elementëve të brendshëm të demokracive të cilët ndihmojnë në vlerësimin e qëndrueshmërisë së regjimit, vëmendje i duhet kushtuar edhe nivelit të demokratizimit në vetvete; pra, nëse i referohemi një demokracie të plotë apo një demokracie të pjesshme e cila është nën një proces demokratizimi. Kështu, demokracitë e plota në krahasim me shtete të cilat rishtazi kanë hyrë në një proces demokratizues sipas Donovan *et al* ‘kanë më pak gjasa që të jenë subjekt i shfaqjes së destabilitetit politik apo rrëmujës politike’, siç është cituar nga Leftwich⁴¹. Ndërsa, nga ana e marrëdhënieve ndërmjet vendeve demokratike vlerësohet se demokracitë liberale nuk hyjnë në luftë me njëra-tjetrën⁴². Kjo,

³⁹ Gilley, B. (2006), ‘The determinants of state legitimacy: results for 72 countries’, *International Political Science Review*, Vol. 27(1): 47-71, fq.61.

⁴⁰ Shivley, W.P., (1993), *Power and Choice: An Introduction to Political Science*, McGraw-Hill, Inc.

⁴¹ Leftwich, A., (2005), ‘Democracy and development: is there institutional incompatibility’, *Democratization*, Vol. 12(5):686-703, fq. 687.

⁴² Goldstein, J. S., (2001), *Marrëdhëniet Ndërkombëtare*, Dituria, Tiranë.

sepse shtete të tilla bashkëndajnë të njëjtin sistem vlerash, qëndrimesh e besimesh, çka i largon nga qëndrimet armiqësore ndaj njëra-tjetrës.

Mirëpo, nëse i referohemi kontributit të një sërë autorësh, qëndrueshmëria e një formati të caktuar të regjimit shihet edhe në marrëdhënie me elementin pasuror të një shteti. Kështu, vlerësohet se demokracitë e pasura dhe demokracitë që kanë mbijetuar një kohë të gjatë kanë pak gjasa të dështojnë⁴³. Koncepti i pasurisë së demokracive si dhe ai i qëndrueshmërisë së tyre në kohë nuk çon domosdoshmërisht në cilësi të lartë të demokracisë⁴⁴. Kjo sipas Ringen, sepse ‘demokracitë e stabilizuara ndryshojnë gjerësisht nga njëra-tjetra në cilësinë e demokracisë’⁴⁵. Pavarësisht se, edhe midis demokracive të stabilizuara ka diferenca në terma të cilësisë e përgjigjshmërisë së tyre ndaj qytetarëve, për interesin studimor të këtij punimi, i referohemi demokracive të stabilizuara për të vlerësuar stabilitetin e tyre politik e për të hulumtuar në dallimet me nivele të ndryshme demokratizimi në vende të ndryshme.

Pra, shohim se stabiliteti është filli i cili bashkon të gjithë elementët e ‘ekuacionit’ të sipërrajtuar të kuadrit politik duke filluar nga sistemi themelor i vlerave i regjimeve demokratike, formati i organizimit institucional, ndërveprimi mes tyre e aktorëve të tjerë, etj.

2.2.1 Modernizimi dhe demokratizimi

Nëse fokusohemi më vertikalisht në llojin e regjimit (në këtë rast tek demokracia) dhe në procesin demokratizues, domosdoshmëria kryesore që lind është njohja e kontekstit nga prodhohen këto elementë. Rolin qendror në këtë aspekt e ka procesi i modernizimit. Ai shihet si ‘një process i shumëanshëm i cili përfshin ndryshime në të gjithë dimensionet e mendimit dhe aktivitetit njerëzor’⁴⁶. Huntington kuoton Lerner në përcaktimin shumë të rëndësishëm që ai i bën modernizimit nëpërmjet aspekteve që ky i fundit përfshin, si ‘urbanizimi, industrializimi, sekularizmi, demokratizimi, edukimi, e pjesëmarrja mediatike’⁴⁷. Huntington dhe Lerner i shohin të gjithë këto aspekte të ndërlidhur me njëri-tjetrin. Modernizimi, si një proces shumëdimensional ka prekur edhe dimensionin ekonomik duke shkaktuar ndryshime në mënyrën e organizimit dhe funksionimit të këtij sistemi të rëndësishëm të shoqërisë njerëzore. Po sipas Huntington, ‘nga pikëpamja ekonomike, ka një ndryshueshmëri veprimesh pasi disa profesione të thjeshta u hapin rrugën atyre më komplekse; niveli i mjeshtërive në punë rritet në mënyrë të ndjeshme; raporti kapitali-punë rritet ...Në rrugën e duhur, niveli i mirëqenies ekonomike rritet dhe pabarazitë në mirëqenien ekonomike ulen’⁴⁸. Pavarësisht logjikës së thjeshtë që kanë në

⁴³ Przeworski, A. Alvarez, M. Cheibub, J. A. Limongi, F., (2000), *Democracy and Development: Political Institutions and Well-being in the World 1950-1990*, Cambridge University Press.

⁴⁴ Shënim: kjo marrëdhënie rimerret në shqyrtim në pjesët e mëtejshme të këtij studimi duke u përqendruar më në detaj në ndërveprimin midis demokracisë e nivelit të të ardhurave.

⁴⁵ Ringen, S., (2011), ‘The measurement of democracy: towards a new paradigm’, *Society*, Vol. 48: 12-16, fq. 13.

⁴⁶ Huntington, S., (2006), *Political Order in Changing Societies*, Yale University, Londër, 2006, fq.32.

⁴⁷ *ibid.*, fq.32.

⁴⁸ Huntington, *op.cit.*, fq.33.

përmbajtjen e tyre këto dy koncepte të ndryshme, modernitetin mund ta konsiderojmë si gjendjen e arritur, ndërsa modernizimin si procesin për të mbërritur tek moderniteti.

Nga qasja që Huntington prezanton, kuptojmë se ndikimi që mund të ketë modernizimi identifikohet me mobilizimin social dhe zhvillimin ekonomik. Rrjedhimisht, lind nevoja për të vlerësuar rolin dhe kuptimin që merr mobilizimi social në suazën e transformimeve shumëdimensionale të fenomenit të modernizimit. Karl Deutch e quan mobilizimin social si ‘procesin gjatë së cilit grupet e mëdha të angazhimeve të vjetra sociale, ekonomike dhe psikologjike shkatërrohen ose thyhen dhe njerëzit bëhen më të disponueshëm për modele të reja të socializimit dhe sjelljes’⁴⁹. Nga ana tjetër, edhe zhvillimi ekonomik pëson rritje si pasojë e proceseve modernizuese. Kjo vihet re në rritjen e aktivitetit dhe produktit ekonomik në një shoqëri të caktuar⁵⁰. Pra, shohim se sistemi ekonomik, së bashku me sistemin social, janë faktorë përcaktues të ecurisë modernizuese të sistemit politik. Në logjikën shkak-pasojë të analizës së modernizimit politik është e nevojshme të vlerësojmë edhe aspektet e ridimensionuara të politikës si pasojë e faktorit ndryshues social dhe ekonomik.

Modernizimi politik apo zhvillimi politik i referohet kryesisht ndryshimeve në: konceptimin e autoritetit dhe në mënyrën e shpërndarjes së tij, si dhe angazhimit social të shprehur nëpërmjet pjesëmarrjes në politikë. I parë në këtë këndvështrim, modernizimi shihet si një fenomen, i cili politikisht ka prodhuar bazat e mirëfillta të funksionimit të shteteve moderne duke krijuar mundësitë për rritje të pjesëmarrjes së qytetarëve në politikë, karakteristikë kjo e regjimeve demokratike dhe padyshim pjesë e procesit të demokratizimit. Pikërisht, si rrjedhojë e kësaj logjike, Huntington vlerëson se koncepti i modernizimit politik apo zhvillimi politik (si koncepte të barasvlershme të përdorura nga studiuesit) nënkupton tre dimensione të rëndësishme: racionalizimin, shtet-formimin, dhe demokratizimin⁵¹. Megjithatë, edhe procesi i demokratizimit përfshin një tërësi procesesh të cilat ndihmojnë në mbajtjen dhe konsolidimin e mëtejshëm të regjimit politik në tërësi.

Por, jo të rralla kanë qenë rastet kur vetë ekzistenca e demokracive është vënë në pikpyetje, për shkak të revoltave, protestave, grushteve të shtetit, etj, gjatë këtij procesi modernizimi. Të gjitha këto, të përkthyer në terma të pasojave në sistemin social, ekonomik dhe politik prodhojnë situata jo të ekuilibruara, apo destabilitet në shtetet ku shfaqen. Rrjedhimisht, konfirmohet një lidhje midis qasjes modernizuese dhe fenomenit të stabilitetit politik. Mbështetësi i kësaj teze janë Huntington dhe autorë të tjerë (në vijim), të cilët vlerësojnë se stabiliteti politik i shteteve, në kuadrin e proceseve modernizuese është i lidhur ngushtësisht me dy elementë të rëndësishëm: mobilizimi social dhe zhvillimi ekonomik, të dy produkte të ndryshimeve që përfshijnë sistemin social dhe atë ekonomik. Këtë, mund ta shohim si një marrëdhënie pozitive që ndryshe përkthehet si: vende të cilat karakterizohen nga nivele të larta të proceseve modernizuese dhe rrjedhimisht nivele të larta të zhvillimit ekonomik e mobilizimit social, do të jenë më

⁴⁹ K.W.Deutch, (1961), ‘Social Mobilization and Political Development’, *American Political Science review*, Vol. 55, fq. 494.

⁵⁰ Huntington, *op.cit.*, fq.33.


⁵¹ Huntington, P. S., (1965), ‘Political development and political decay’, *World Politics*, Vol. 17(3): 386-430, fq. 388.

të qëndrueshme e stabël politikisht. Kjo sepse, ‘urbanizimi, rritja e numrit të të arsimuarve, arsimit, ekspozimi ndaj medias, etj, të gjitha ndihmojnë në theksimin e aspiratave dhe pritshmërive, të cilat nëse nuk përmbushen, galvanizojnë individët dhe grupet në politikë, gjë e cila në mungesë të institucioneve të forta e të qëndrueshme përkthehet në destabilitet dhe dhunë’⁵².

Rrjedhimisht, sipas kësaj logjike, shtetet të cilat tashmë janë të modernizuara janë më stabël sesa ato në proces modernizimi. Po kështu, shtetet të cilat janë prekur fare pak ose aspak nga proceset modernizuese janë më stabël sesa shtetet në proces modernizimi.

Nisur nga pikëpamja se modernizimi përfshin edhe procesin demokratizues, një vëmendje e veçantë duhet t’i kushtohet edhe kësaj marrëdhënieje. Kjo, sepse njohja e lidhjes ndërmjet modernizimit dhe demokratizimit na ndihmon në vlerësimin e mëtejshëm të elementëve të shfaqura nën procesin e demokratizimit të një vendi ku një prej tyre është edhe stabiliteti politik. Lipset ka qenë ndër të parët autorë që ka prezantuar këtë lidhje ndërmjet politikës dhe modernizimit. Në artikullin e tij të famshëm të 1959, Lipset e konsideron demokracinë dhe stabilitetin e saj ‘të lidhur me gjendjen e zhvillimit ekonomik dhe legjitimitetin’. Më konkretisht, këtë e përkthehen se ‘sa më mirë ekonomikisht të jetë një komb, aq më të mëdha do të jenë shanset që ai të mbështesë demokracinë’⁵³. Pra, në këtë mënyrë është sistemi ekonomik ai që kryesisht nëpërmjet treguesit të të ardhurave për frymë përfshihet si ndërmjetësues i modernizimit dhe demokratizimit. Kjo logjikë mbështetet edhe nga përcaktimi fillestar i kontribuesit të parë të teorisë së modernizimit Lerner, sipas të cilit një prej treguesve të modernizimit është edhe mirëqënia e individëve të një shoqërie⁵⁴.

Nëse, do të tentonim ta përvijonim në formë skematike marrëdhënien ndërmjet demokracisë dhe zhvillimit brenda lëmit të qasjes modernizuese do të identifikonim një kah shkakësie nga zhvillimi tek demokracia si dhe një korrelacion pozitiv linear ndërmjet këtyre dy variablave. Chen ofron këtë paraqitje skematike të marrëdhënies në fjalë:



⁵² Huntington, *op.cit.*, fq.47.

⁵³ Lipset, S, M, (1959), ‘Some Social Requisites of Democracy: Economic Development and Political Legitimacy’, *American Political Science Review*, Vol. 53: 69-105. doi:10.2307/1951731.

⁵⁴ Lerner, D., (1958), *The passing of the traditional society: modernizing the middle east*, Nju Jork: Free Press.

Figura 2.1: Teoria e Modernizimit, marrëdhënia demokraci-zhvillim⁵⁵

Këto vlerësime e përfundime të hershme të marrëdhënies midis demokratizimit dhe zhvillimit politik, të pasuara edhe nga studimet më të avancuara në kohë, e sidomos ato të dhjetëvjeçarit të fundit, mbështesin idenë kryesore se vendet më të pasura kanë gjasa më të mëdha për të qenë vende demokratike. Megjithatë, nuk ka shumë konsensus në lidhje me ndikimin që mund të ketë zhvillimi ekonomik në mundësinë e kalimit (tranzicionit) në një format demokratik. Pikërisht, në linjën e ndikimit që paraqet stabiliteti politik në ndryshimet e regjimeve fokusohen edhe Gleditsch dhe Choung⁵⁶ (2004). Sipas tyre, mosmarrja në konsideratë e diferencës midis regjimeve jo-demokratike stabël që vazhdojnë të mbeten jo-stabël dhe atyre jo stabël të cilat çojnë në një ndryshim regjimi është identifikimi i gabuar i shkaqeve që mund të çojnë në tranzicionin drejt demokracisë. Realizimi i tranzicionit demokratik, nuk vjen për shkak të faktorëve ekonomikë, por kryesisht nga ndikimi i eksperiencave të mëparshme demokratike dhe nga faktorët e jashtëm ndërkombëtarë.

Nëse tentojmë të realizojmë një organizim të qëndrimeve kryesore të politologëve dhe ekonomistëve (Huntington, Dahl, Boix dhe Stokes, Epstein *et al*, Przeworski *et al.*, etj) për qëndrimin që mbajnë në lidhje me marrëdhënien e mundshme ndërmjet rolit që ka zhvillimi ekonomik në procesin e demokratizimit, identifikojmë dy drejtime të ndryshme. Dallimi midis këtyre qëndrimeve fokusohet në ndikimin që kanë të ardhurat në tranzicionin drejt demokracisë apo në konsolidimin e mëtejshëm të saj, kur kalimi në demokraci tashmë është realizuar. Sipas Przeworski *et al.*, zhvillimi ekonomik nuk prodhon formatin demokratik, por gjasat e mbijetesës së demokracive janë më të mëdha në shoqëritë e pasura⁵⁷. Ky qëndrim është në vijueshmëri të përfundimeve tek të cilat arrijnë Przeworski dhe Limongi (1997) ndaj qasjes deterministe të modernizimit mbi demokracinë. Sipas këtyre dy autorëve ‘demokracia nuk është një produkt i zhvillimit ekonomik dhe mund të shfaqet në çdo nivel të zhvillimit. Shtrëngesat ekonomike luajnë rol vetëm në momentin kur demokracia është vendosur, dhe shanset për mbijetesën e saj janë më të mëdha kur vendi është më i pasur’⁵⁸. Sipas tyre, marrëdhënia midis nivelit të zhvillimit ekonomik dhe nivelit të demokratizimit mund të shpjegohet nga perspektiva e stabilitetit politik, nivelet e të cilit janë më të larta tek demokracitë e pasura. Këtë, Geddes e përmbledh me idenë se ‘edhe pse demokracitë e varfra ndonjëherë bien dhe kthehen në diktatura, kjo nuk është e vërtetë për demokracitë e pasura, çka me kalimin e kohës çon në një përqindje të lartë të të demokracive të pasura në grupin e demokracive’⁵⁹.

⁵⁵ Chen, E. L., ‘Development First, Democracy Later? Or Democracy First, Development Later?: The Controversy over Development and Democracy, 1-36, fq. 17/ i disponueshëm në: <www.democracy.uci.edu/files/democracy/docs/conferences/.../chen.pdf>

⁵⁶ Gleditsch, S. K. Choung, L. J., (2004), ‘Autocratic transitions and democratization’, prezantuar në International Studies Association, Montreal dhe në konferencën ‘Bringing leaders and politics back into international relations’.

⁵⁷ Przeworski, A. Alvarez, M. Cheibub, J. A. Limongi, F., (2000), *Democracy and Development: Political Institutions and Well-being in the World 1950-1990*, Cambridge University Press.

⁵⁸ Przeworski, A. Limongi, F., (1997), ‘Modernization: theories and facts’, *World Politics*, Vol. 49(2):155-183, Cambridge University Press, fq. 177.

⁵⁹ Geddes, B., (2007), ‘What causes democratization?’, fq. 317-339, në *The Oxford Handbook of Comparative Politics*, redaktuar nga Boix, C. Stokes, S., Oxford University Press, fq. 320.

Në të tjera rezultate mbërrijnë Epstein *et al.* Në studimin e marrëdhënies midis të ardhurave për frymë dhe demokratizimit, ata arrijnë në përfundime të cilat kundërshtojnë qëndrimet e grupit të parë të autorëve. Nëpërmjet përdorimit të një analize dhe kategorizimi të ndryshëm regjimesh, Epstein *et al.*, vlerësojnë se modernizimi i shfaqur edhe nëpërmjet zhvillimit ekonomik dhe më specifikisht të ardhurave për frymë, ‘rrit gjasat e regjimeve demokratike, duke ndihmuar jo vetëm konsolidimin e demokracive ekzistuese, por edhe duke promovuar tranzicionet nga sistemet autoritare drejt atyre demokratike’⁶⁰. Mbërritja në rezultate të ndryshme lidhet me diferencimin që Epstein *et al.* (2006), bëjnë për regjimet politike duke i kategorizuar ato në ‘demokraci të plota’, ‘demokraci të pjesshme’ dhe në ‘autokraci’. Të njëjtën linjë logjike e rezultatesh mbështesin edhe Boix e Stokes, në vlerësimin e probabilitetit të një tranzicioni demokratik që mund të ndodhë në një vend si rezultat i kushteve ekonomike, dhe më specifikisht zhvillimit ekonomik. Sipas tyre, zhvillimi ekonomik i një vendi, jo vetëm që ndihmon në konsolidimin e qëndrueshmërisë të një regjimi tashmë demokratik (rezultate këto të evidentuara edhe nga Przeworski *et al.*), por rrit edhe probabilitetin e tranzicionit drejt demokracisë⁶¹. Tabela e mëposhtme ofron një prezantim të kësaj marrëdhënieje përgjatë viteve 2000’ për vendet e botës.

Tabela 2.1: Vëzhgimet vjetore sipas nivelit të të ardhurave dhe llojit të regjimit

	<i>Totali</i>	<i>Regjimet autoritare</i>	<i>Regjimet demokratike</i>	<i>Përqindja demokracive</i>
0-\$2,000	2,016	1,690	326	16.2
\$2,001-\$4,000	842	511	331	39.3
\$4,0001-\$6,000	431	212	219	50.8
\$6,001-\$7,000	158	33	125	79.1
\$7,001-	679	35	644	94.8

Burimi: Boix, C, Stokes, S., (2003), bazuar në Przeworski et al. (2000), Tabela 2.3

Ndikimi i të ardhurave tek demokracia është padyshim i lidhur me kontekstin vendor të shtetit që, ose po kalon në një etapë transitore drejt demokracisë, ose është në konsolidim e sipër të rendit demokratik. Kontekstin vendor, Boix e konsideron si faktorin e parë që shpjegon ndikimin e kushtëzuar së të ardhurave mbi demokracinë. ‘Tranzicioni në demokraci (ose stabilizimi i institucioneve demokratike) mund të arrihet pasi një vend kalon një prag të caktuar (pra nëse vendi është në tranzicion apo është shndërruar në një vend plotësisht demokratik)’⁶². Në po të njëjtën linjë, Jung dhe Sunde përpos vlerësimit të marrëdhënies ndërmjet demokratizimit dhe rrethanshmërisë institucionale, së bashku me rendin ligjor, në demokracitë e shfaqura në shoqëritë heterogjene, përgjigjen se ‘shpërndarja e faktorëve ose të ardhurave, janë çelësi për shfaqjen e demokracisë, dhe jo niveli i zhvillimit ekonomik’⁶³. Pra, shpërndarja e faktorëve të prodhimit brenda

⁶⁰ Epstein, L. D. Bates, R. Goldstone, J. Kristensen, I, dhe O’Halloran. SH., (2006). ‘Democratic transitions’, *American Journal of Political Science*, Vol. 50(3): 551-569, fq. 24; kopje e disponueshme në: <http://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=92018>.

⁶¹ Boix, C, Stokes, S., (2003), ‘Endogenous democratization’, *World Politics*, Vol. 55(4): 517-549.

⁶² Boix, C., (2009), ‘Development and democratization’, *IBEI Working Papers/26*, fq. 13.

⁶³ Jung, F. Sunde, U, (2010) ‘Lipset reconsidered: A rational theory of the stability of democracy’, fq.21, kopje e disponueshme në,

<<http://www.google.al/#hl=en&tbo=d&scient=psyab&q=++Lipset+reconsidered&oq=++Lipset+reconside>

intervaleve të caktuara i jep mundësi shfaqjes të demokracisë në çdo nivel të zhvillimit ekonomik⁶⁴.

Në fakt, shpërndarja e burimeve, e varur nga ekzistenca e koalicioneve shpërndarëse është një nga tezat kryesore që ngre Olson në *'The rise and decline of nations'*. Sipas tij, jo çdo nivel zhvillimi ekonomik shpjegohet me ekzistencën paraprakisht të stabilitetit apo destabilitetit politik. Ai konfirmon idenë e përgjithshme se vendet stabël janë më të zhvilluara se ato jostabël, dhe rritja më e shpejtë sipas tij ndodh në vende të cilat kanë përjetuar trazira, që megjithatë pritet në të ardhmen të jenë stabël⁶⁵. Këtë, autori e justifikon me koalicionet qeveritare shpërndarëse apo me ekzistencën e destabilitetit, elementë të cilët devijojnë përdorimin e burimeve nga investimet në aftagjatë drejt formave të tjera të pasurisë.

Nisur nga prezenca e niveleve të ndryshme të destabilitetit politik dhe rritjes së ndryshme që kanë shtete të ndryshme, Goldsmith bën testimin e teorisë së Olson duke prodhuar një kategorizim me katër lloje shtetesh si vijon: '(1) shtetet me destabilitet kronik të cilat shfaqin një rritje të ngadaltë të vazhdueshme, (2) shtetet me stabilitet të qëndrueshëm, të cilat duhet të shfaqin një rritje relativisht të shpejtë fillimisht, e cila pëson një trend në rënie me kalimin e kohës, (3) sistemet politike në stabilizim të cilat po vendosen nën një format tjetër të rendit politik të cilat duhet të shfaqin një rritje ekonomike të vrullshme, dhe (4) shtete të cilat po shndërrohen në më pak stabël, pra po destabilizohen, të identifikuar me një rënie të theksuar të rritjes ekonomike'⁶⁶. Tabela e mëposhtme, paraqet në mënyrë të skicuar këtë marrëdhënie ndërmjet tipologjisë së regjimeve dhe ritmeve të rritjes ekonomike:

Tabela 2.2: Tipologjia e regjimeve dhe ritmi i parashikuar i rritjes ekonomike⁶⁷

		<i>Stabiliteti politik në periudhën 1 (P1)</i>	
		Më pak stabël	Më shumë stabël
<i>Stabiliteti politik në periudhën 2 (P2)</i>	Më pak stabël	Kronikisht jostabël: Parashikohet rritje e ngadaltë	Destabilizues: Parashikohet rënie e madhe në rritje
	Më shumë stabël	Stabilizues: Parashikohet rritje e shpejtë	Stabël në mënyrë konsistente: Parashikohet përkeqësim gradual i rritjes

red&gs_l=serp.3...38007.41421.0.41622.19.18.0.0.0.3.975.5891.0j3j5j2j2j3j1.16.0.les%3B.0.0...1c.1.2.ser p.BCQLJsSmv2c&pbx=1&bav=on.2,or.r_gc.r_pw.r_qf.&fp=18778b63627b71c6&biw=1366&bih=643>.

⁶⁴ Jung, Sunde, *op.cit.*, fq. 23.

⁶⁵ Olson, M., (1965), *Rise and Decline of Nations*, Harvard University Press, Kembrixh, fq. 165.

⁶⁶ Goldsmith, A. A., (1987), 'Does political stability hinder economic development? Mancur Olson's Theory and the Third World', *Comparative Politics*, Vol. 19(4): 471-480, fq. 472.

⁶⁷ *ibid.*, fq. 473.

Mirëpo, proceset tranzitore apo edhe ato konsoliduese të demokracisë, pavarësisht kontekstit vendor të shtetit ku shfaqen janë pjesë edhe e një sistemi zhvillimesh historike ndërkombëtare të pavarura prej tyre. Për këtë arsye sipas Dahl, 'demokratizimin mund ta shohim si një varg shndërrimesh të thella historike'⁶⁸, ku një rol përckatues në këto të fundit kanë shtetet e fuqishme. Është pikërisht, roli i fuqive të mëdha në rendin ndërkombëtar, dhe rrjedhimisht në politikën e aleatëve të tyre që konsiderohet nga Boix si faktori i dytë i shpjegimit të ndikimit të ndryshueshëm në kohë së të ardhurave mbi demokracinë⁶⁹.

Pavarësisht ndryshimeve në rezultatet studimore të sipërpërmendura të nivelit të ndikimit të zhvillimit ekonomik mbi demokracinë, ideja qëndrore që bashkon studiuesit është se niveli i zhvillimit ekonomik shihet si një mjet kyç në shpjegimin e proceseve demokratizuese. Grupi i dytë i studiuesve e zhvillon më tej këtë tezë në vlerësimin e modernizimit si një faktor ndikues në marrëdhënie shkakësore me demokratizimin. Pra, në nivelin mikro të një vendi mund të ndërtojmë pritshmërinë se demokratizimi (tranzicioni për në demokraci apo konsolidimi i mëtejshëm e qëndrueshmëria e formatit demokratik) është i lidhur me modernizimin, e më specifikisht me faktorët ekonomikë të ndikuara prej tij.

2.2.2 Demokracia dhe rritja ekonomike

Trajtesa e zhvilluar më sipër, siç mund të vihet re, përveç të tjerash prezanton njëren perspektivë të marrëdhënies ndërmjet zhvillimit ekonomik e demokracisë; atë të ndikimit të zhvillimit ekonomik tek demokracia, qëndrueshmëria e saj apo gjasat e kalimit nga një regjim jodemokratik në një regjim demokratik. Sigurisht, që njohja e ndikimit të sistemit ekonomik ndaj atij politik është një burim i rëndësishëm informacioni për politkbërësit e aktorët e sistemit ekonomik në një vend të caktuar për të ndërtuar një marrëdhënie efikase e të qëndrueshme me njëri-tjetrin.

Por, gjithsesi marrëdhënien e mësipërme nuk kemi garanci të mjaftueshme për ta konsideruar shteruese dhe të plotë. E nevojshme në këtë kontekst është njohja edhe e perspektivës tjetër, asaj të ndikimit të demokracisë tek sistemi ekonomik e niveli i zhvillimit të këtij sistemi. Ky kah i marrëdhënies midis këtyre dy variablave është edhe në qendër të vëmendjes së ekonomisë politike. Theksi që i kushtohet kësaj marrëdhënieje buron nga logjika e përgjithshme se pavarësisht formatit demokratik apo jodemokratik është sistemi politik e institucionet përbërëse të tij që përcaktojnë mënyrën e rregullimit dhe adminstrimit të aktvitetit ekonomik të një vendi, veçori kjo e cila buron nga sovraniteti që sistemi politik zotëron brenda një entiteti shtetëror⁷⁰.

⁶⁸ Dahl, R., (2005), *Poliarkia: pjesëmarrja dhe opozita*, Pegi, Tiranë, fq. 10.

⁶⁹ Boix, *op.cit.*, fq. 14-15.

⁷⁰ Shënim: Për shkak të dy-kahshmërisë me anë të së cilës prezantohet marrëdhënia rritje ekonomike - demokraci, përqëndrimi në studimin e njërit kah apo kahut tjetër të kësaj marrëdhënieje është në varësi të natyrës së studimit të ndërmarrë. Për rrjedhojë, në një pjesë të studimeve e shohim demokracinë si variabël të varur e herë të tjera si variabël të pavarur.

Këtë ndikim rregullues të supozuar të formatit demokratik mund ta shohim të shfaqet në disa mënyra. Së pari, në një vend demokratik, qytetarët kanë mundësinë të ushtrojnë kontroll të vërtetë ndaj aktivitetit të politikanëve nëpërmjet zgjedhjeve. Kështu, gjatë procesit zgjedhor demokratik mund të ndëshkohen ata politikanë të cilët nuk kanë ushtruar pushtetin politik në përputhje me interesat e qytetarëve që i kanë zgjedhur. Së dyti, demokracia duke u mbështetur në shtresën e mesme, ndihmon në garantimin e lirive politike e ekonomike (dhe nje shoqëri civile e konsoliduar) duke çuar paralelisht edhe në nxitjen e krijimit të më shumë pasurie në një vend të caktuar, element ky i cili mbështetet edhe nga Lipset (1959,1960). Sipas këtij të fundit, ‘një shoqëri civile plotësisht operacionale, ka shumë gjasa që të jetë edhe pjesëmarrëse... organizatat civile ndikojnë institucionet politike për projekte të cilat prekin ato dhe anëtarët e tyre, dhe e transferojnë këtë informacion tek qytetaria... ndërsa sistemet totalitare nuk kanë shoqëri civile efektive’⁷¹. Së treti, anagzhimi efektiv social mundësohet edhe për shkak se regjimi demokratik mundëson garantimin e lirive politike e sociale dhe mbrojtjen e tyre.

Megjithatë, ndikimi i formatit demokratik në një vend të caktuar, e sidomos në sistemin ekonomik, mund të prodhojë një kundër-efekt të padëshiruar, madje çënues të zhvillimit të mëtejshëm ekonomik. Përfaqësues të këtij qëndrimi janë Huntington dhe Olson. Sipas të parit, efektet negative të demokracisë në zhvillimin ekonomik evidentohen në vende të cilat janë rishtazi demokratike dhe që nuk kanë një nivel të lartë të zhvillimit ekonomik. Pengesa kryesore që prodhojnë këto lloj demokracish janë shpenzimet e mëdha qeveritare. Rrjedhimisht, kjo do të reduktonte akumulimin e pasurisë dhe investimet. Ndërsa Olson, përfaqësues edhe i qëndrimit neoklasik të ekonomisë politike, përqendrohet në ndikimin e grupeve të interesave në vendet demokratike. Sipas tij, me kalimin e kohës pozitativat e grupeve të caktuara të interesit konsolidohen duke qenë më të favorizuar nga pushteti politik, e në të njëjtën kohë duke prodhuar inefficenca demokratike apo rënie të performancës demokratike. Madje, Sarkar arrin deri në përfundimin se në një vend më pak të zhvilluar, gjasat që partia që ka pushtetin të ndjekë politika që nuk e ndihmojnë zhvillimin ekonomik janë shumë të larta⁷². Elementi shpjegues i kësaj shtate sipas Sarkar është fakti se ‘në një vend më pak të zhvilluar, për një numër të madh individësh, politika përbën një pjesë thelbësore të strategjive të tyre për mbijetesë ekonomike, duke qënë se pjesa më e madhe e këtyre individëve janë të angazhuar në sektorin informal. Si rrjedhim, për të përmirësuar shanset e rizgjedhjes, partia që është në pushtet dhe që zotëron një organizim të mirë të brendshëm do të adoptojë politika anti-zhvillimore, duke maksimizuar madhësinë e sektorit informal’⁷³. Pra, mënyra se si organizohet pushteti politik, si dhe eksperiencia demokratike janë dy dimensionet të cilat mund të ndikojnë negativisht rritjen ekonomike sipas këtyre autorëve.

Përveç qëndrimeve të ndryshme të identifikuar më sipër mbi çështjen e ndikimeve pozitive apo negative të demokracisë mbi zhvillimin ekonomik të një vendi e më konkretisht mbi rritjen ekonomike, ditët e sotme, diskutimi kryesor përqendrohet në ndikimin e drejtpërdrejtë apo të tërthortë të demokracisë mbi rritjen ekonomike.

⁷¹ Lipset, M.S., (1960), ‘The social requisites of democracy revisited: 1993 Presidential Address’, *American Sociological Review*, Vol. 59(1):1-22, fq. 12-13.

⁷² Sarkar, A., (2010), ‘On the political economy of a backward region’, *Indian Growth and Development Review*, Vol. 3(2): 122-137, fq. 122.

⁷³ *ibid.*, fq. 123.

Kështu, përfaqësuesit e qëndrimit mbi marrëdhënien shkakësore ndërmjet demokracisë e rritjes ekonomike janë mbështetësit e teorisë së modernizimit. Këtë e dëshmon edhe Lipset sipas të cilit ‘faktorët e industrializimit, urbanizimit, pasurisë, dhe edukimit janë kaq shumë të ndërlidhur sa që formojnë një faktor të vetëm. Dhe faktorët e përfshirë nën zhvillimin ekonomik bartin me të korrelacionin politik të demokracisë’⁷⁴.

Nga ana tjetër, një pjesë e madhe e studiuesve, nëpërmjet përdorimit të modeleve të ndryshme ekonometrike arrijnë në përfundimin se demokracia nuk ka një ndikim të rëndësishëm të drejtpërdrejtë mbi rritjen ekonomike. Përkundrazi, ndikimi i demokracisë mbi këtë tregues të rëndësishëm të sistemit ekonomik vlerësohet më shumë nëpërmjet ndikimit të saj në mënyrë të tërthortë tek variabla të tjerë socialë dhe ekonomikë. Kështu, në modelin e tyre, Baum dhe Lake evidentojnë një ndikim pozitiv jo të drejtpërdrejtë të demokracisë mbi rritjen ekonomike nëpërmjet jetëgjatësisë dhe edukimit. Ata arrijnë në përfundimin se ndikimi i jetëgjatësisë mbi rritjen është domethënës në vendet e varfra, ndërsa arsimit (norma e rregjistrimit në arsimin të mesëm) ndikon pozitivisht rritjen në vendet jo të varfra⁷⁵. Në të njëjtën linjë, Helliwell, në studimin e marrëdhënies midis rritjes ekonomike dhe demokracisë arrin në përfundimin se ndikimi jo i drejtpërdrejtë pozitiv i demokracisë mbi rritjen ekonomike realizohet nëpërmjet ndikimit pozitiv që ka demokracia në investime dhe arsimim⁷⁶.

Edhe sipas Acemoglu *et al* (2008), hidhet poshtë ideja e ekzistencës së një marrëdhënieje shkakësore ndërmjet dy variablave kryesorë, por pavarësisht kësaj, ata sërishit konfirmojnë korrelacionin pozitiv së të ardhurave me demokracinë. Kjo sipas autorëve shpjegohet nga rrugët e ndryshme të zhvillimit ekonomik e politik që shtetet kanë ndjekur përgjatë kohës, të cilat kanë përfaqësuar pika kritike për ecurinë e mëtejshme ekonomike e politike të vendeve⁷⁷. Një vit më vonë, bazuar në të njëjtën logjikë, Acemoglu *et al* (2009), bëjnë një vlerësim kritik të hipotezës së modernizimit sipas së cilës niveli i të ardhurave është i lidhur në mënyrë shkakësore me demokracinë. Pra, tranzicionet apo kalimet nga apo tek demokracia shpjegohen me ndryshimin e nivelit të të ardhurave në një vend të caktuar. ‘Sipas tyre, qasja më reale që mund të bëjë vlerësimin e marrëdhënies ndërmjet demokracisë dhe nivelit së të ardhurave është përdorimi i hipotezës së rrethanave kritike, sipas së cilës ndryshimi institucional i cili ndikon si zhvillimin ekonomik dhe atë politik ndërmerret nga diferencat gjatë një rrethane historike kritike’⁷⁸.

Duke përmbledhur, trajtesa e deritanishme në lidhje me demokracinë, shfaqjen e saj, kushtet në të cilat shfaqet, mund të përvijohet nëpërmjet tre qasjeve shpjeguese: identifikimin e demokracisë me tiparet e strukturës politike (Eckstein, Verba, Dahl, Sarkar, etj), përqëndrimin tek faktorët socio-psikologjikë (Almond, Verba, Lerner, Baum

⁷⁴ Lipset, (1959), *op.cit.*, fq. 80.

⁷⁵ Baum, A. M. Lake, A. D., (2003), ‘The political economy of growth: Democracy and Human Capital’, *American Journal of Political Science*, Vol. 47(2): 333-347, fq. 345.

⁷⁶ Helliwell, F. J., (1992), ‘Empirical linkages between democracy and economic growth’, *Working Paper Nr. 4066*, Zyra Kombëtare e Kërkimit Ekonomik, fq. 1-28.

⁷⁷ Acemoglu, D. Johnson, S. Robinson, A. J. Yared, P., (2008), ‘Income and Democracy’, *American Economic Review*, Vol. 98(3):808-842, fq.836.

⁷⁸ *ibid.*, fq. 1045.

dhe Lake, etj) si dhe varësinë e demokracisë nga kushtet socio-ekonomike të një vendi (Lipset, Acemoglu *et al.*).

2.2.3 Perspektivat teorike (përmbledhje)

Nga pikëpamja teorike, pjesa më e madhe e studimeve mbi marrëdhënien e demokracisë me rritjen ekonomike, orientohet në dy drejtime apo perspektiva kryesore. Ato janë perspektiva e pajtueshmërisë dhe perspektiva e konfliktit. Përqaftimi i njërës perspektivë apo i tjetrës ka prodhuar edhe përfundime të ndryshme nga ana e studiuesve të ekonomisë politike në lidhje me këtë çështje. Njohja me to është e një rëndësie parësore duke qënë se këto perspektiva prodhojnë bazën logjike nga ku prodhohen supozimet kryesore të studimeve të ndërmarra.

Një vend të rëndësishëm në trajtimin dhe shpjegimin e këtyre perspektivave ka studimi i Huntington në lidhje me qëllimet e zhvillimit. Sipas tij, ka pesë qëllime kryesore të zhvillimit: rritja ekonomike, barazia, demokracia ose vendosja e saj, rendi politik e stabiliteti, dhe autonomia. Perspektiva apo qasja e pajtueshmërisë nënkupton se progresi i arritur në njërin prej qëllimeve të zhvillimit ishte i lidhur dhe nxiste përmbushjen e qëllimeve të tjera. Kjo, bazuar kryesisht në eksperiencën perëndimore ku zhvillimi ka përfshirë tendencën për përmbushjen e të pesë qëllimeve së bashku. Sipas Huntington, një rol të madh në sendërtimin e perspektivës së pajtueshmërisë kanë luajtur modeli liberal, modeli marksist dhe teoria e varësisë nëpërmjet fokusit të përbashkët që kishin këto teori në eliminimin e varfërisë e varësisë⁷⁹. Kështu, modeli liberal e vendosi theksin politikisht tek garantimi i lirive e të drejtave individuale, ndërsa ekonomisht tek tregu i lirë, prona private e konkurueshmëria. Eliminimi i konceptit të varësisë në kontekstin e këtij modeli lidhej me ndarjen ndërmjet sistemit politik dhe ekonomik, dhe pavarësimin të këtij të fundit nga ndërhyrja dhe rregullimi shtetëror. Ndërkohë, kjo mënyrë e të rregulluarit të ekonomisë së vendit do i jepte mundësinë për përfitueshmëri nga aktiviteti ekonomik të gjithë atyre që do të ndërvepronin si agjentë ekonomikë brenda këtij sistemi. Modeli marksist, bazuar në kritikën e mënyrës sesi ishin të organizuara marrëdhëniet e punës në sistemet kapitaliste të vendeve perëndimore, përqendrohej në marrëdhënien shfrytëzuese mes dy klasave të krijuara duke dhënë udhëzimet e nevojës së përmbysjes së kësaj marrëdhënieje kapitalistë-punëtorë. Teoria e varësisë, e popullarizuar në vitet 60', prezantonte marrëdhënien e varësisë të shteteve të varfra ndaj atyre të pasura, duke qënë se sipas supozimve të saj çdo rritje e pasurisë së shteteve të pasura realizohej në kurriz të shteteve më të dobëta.

Mirëpo, jo çdo zhvillim bën të mundur arritjen në mënyrë të menjëhershme të këtyre qëllimeve. Eksperienca empirike e studimet e mëtejshme në vitet 70' dëshmuuan për mungesën e një marrëdhënieje të plotë pozitive dhe të njëkohshme ndërmjet qëllimeve të zhvillimit. Kështu, jo domosdoshmërisht, një vend që shfaqte rritje ekonomike do të ishte demokraci, apo do të tentonte drejt demokracisë. Kjo logjikë i hapi rrugën perspektivës së konfliktit, ku mbështetësit e saj shihnin si të nevojshme përzgjedhjen ndërmjet qëllimeve

⁷⁹ Sipas përmbledhjes akademike, Universiteti i Princeton, i gjendshëm në: <www.princeton.edu/wwac/academic-review/files/.../2.7_Huntington.doc>, për: Huntington, S., (1987), 'Goals of Development', *Understanding Political Development*, Huntington dhe Weimer eds. fq. 1-3.

të zhvillimit.⁸⁰ Pamundësia e përmbushjes së plotë të tyre shpjegohej edhe me faktin se ekziston një tension dhe konflikt ndërmjet këtyre qëllimeve, çka bën të pamundur realizimin e tyre së bashku.

Të projektuara në një nivel më mikro, dhe pikërisht në marrëdhënien ndërmjet rritjes ekonomike dhe demokracisë, perspektiva e pajtueshmërisë dhe ajo e konfliktit dëshmojnë të njëjtën bazë logjike. Kështu, për studiuesit të cilët mbështeten tek perspektiva e pajtueshmërisë, rritja ekonomike dhe demokracia ecin në të njëjtin drejtim së bashku. Pra, demokracia ndihmon në rritjen ekonomike nëpërmjet një ndikimi pozitiv tek kjo e fundit. Ndërsa, perspektiva e konfliktit përqëndrohet në antagonizmin që përfaqësojnë këta dy variabla: pra, që ndikimi i demokracisë mbi rritjen pritet të jetë i kundërt. Nisur nga kjo bazë e përgjithshme, studiuesit që mbështesin këtë qëndrim, verifikojnë empirikisht pikërisht këtë lloj marrëdhënieje.

2.2.4 Stabiliteti politik dhe korrupsioni

Korrupsioni si fenomen është i lidhur ngushtësisht me qeverisjen e mirë dhe efëente. Rrjedhimisht, nisur nga natyra e këtij fenomeni dhe shumëdimensionaliteti i qeverisjes së mirë si koncept, korrupsioni është vendosur në fokus të studimeve dhe kërkimit shkencor jo vetëm nga politologët por edhe nga ekonomistët, veçanërisht pas viteve 1990. Kjo për shkak edhe të një ndryshimi në qëndrimin e komunitetit ndërkombëtar për të diskutuar çështjet e korrupsionit në një mënyrë të hapur dhe transparente⁸¹. I përkufizuar si abuzimi i postit publik për përfitime private⁸², korrupsioni mund të shkaktohet nga faktorë të ndryshëm dhe mund të rezultojë në një shumëllojshmëri pasojash. Sipas Mauro, disa prej shkaqeve të korrupsionit janë: kufizimet tregtare, subvencionet e qeverisë, kontrolli i çmimeve, nivele të ulëta në shërbimin civil, faktorët sociologjikë, etj⁸³. Ndërsa, përta përta pasojave, ndër më të rëndësishmet që Mauro përmend është vonesa në rritjen ekonomike⁸⁴.

Një nga diskutimet kryesore që zhvillohet ditët e sotme është nëse ekziston lidhje ndërmjet një regjimi demokratik dhe korrupsionit në një vend të caktuar. Pra, nëse formati demokratik rrit apo ul gjasat për praninë e korrupsionit. Kështu, pavarësisht gjerësisë konceptuale dhe formave të ndryshme me anë të së cilave shfaqet fenomeni i korrupsionit, i një rëndësie të veçantë është korrupsioni i karakterit publik, e më specifikisht ai politik. Dhe pikërisht, marrëdhënia që ka interesin kryesor hulumtues në një pjesë të madhe të studimeve është ajo ndërmjet demokracisë e korrupsionit politik. Një logjikë e thjeshtë na orienton tek ideja se një regjim i konsoliduar demokratik do të përballet me nivele të ulëta të korrupsionit, nisur nga niveli i lartë i llogaridhënies e

⁸⁰ *ibid.*, fq.1-3.

⁸¹ Mauro, P. (2007), 'World Bank Researchers and the Study of Corruption', *Journal of World Affairs*, Vol. 13(2):67-77, fq.2.

⁸² Johnston, M., (1998), 'Fighting systemic corruption: social foundations for institutional reform', *European Journal of Development Research*, Vol. 10(1): 85-104, fq. 89.

⁸³ Mauro, P. (1997), 'Why worry about corruption', International Monetary Fund, fq. 4-5/
<<http://www.imf.org/external/pubs/ft/issues6/issue6.pdf>>

⁸⁴ *ibid.*, fq.6-7.

përgjegjshmërisë që duhet të jetë prezent në demokraci. Thënë ndryshe, në një vend demokratik, qytetarët zotërojnë një mjet të rëndësishëm kontrolli ndaj politikanëve, siç është vota. Rrjedhimisht, politikanët priten që të jenë më pak të predispozuar në ndërmarrjen e praktikave korruptive në një vend demokratik, edhe pse edhe në këto vende janë gjithsesi jo plotësisht të distancuar prej tij. Pavarësisht studimeve të shumta teorike e empirike të fokusuara në këtë çështje, ende nuk ka një qëndrim unanim ndërmjet akademikëve për këtë marrëdhënie. Një pjesë pozicionohen në mbështetjen e logjikës së sipërpërmundur, ndërsa për të tjerët ekzistojnë po ashtu prova empirike e argumente teorike për të vërtetuar të kundërtën. Megjithatë, është thuarjse konsensuale ideja se në demokracitë e konsoliduara ka më pak korrupsion. Sigurisht, që në këtë përgjithësim nuk mund të përfshijmë demokracitë e reja apo ato regjime të cilat karakterizohen nga eksperiencia të shkurtra demokratike, dhe që shtrojnë si të nevojshme një analizë të mirëfilltë në lidhje me fenomenin e korrupsionit, nivelet e tij, si dhe ndikimet përkatëse në variabla të sistemit politik dhe atij ekonomik.

Rrjedhimisht, nga trajtesa e deritanishme e çështjeve të demokracisë, stabilitetit politik, dhe korrupsionit, si dhe e tipareve që i shoqërojnë ato, mund të mbërrijmë në deduksione të rëndësishme. Në këtë kontekst, do të pranohet se demokracia, e cila në sajë të mënyrës nëpërmjet së cilës ushtrohet, shpërndahet e organizohet pushteti ndihmon paralelisht edhe në stabilitetin politik të një vendi të caktuar. Nga ana tjetër, brenda këtij formati demokratik mund të supozohet se ndërvepron edhe logjika tjetër: demokraci, nivele më të ulëta të korrupsionit politik, stabilitet politik. Ndryshe, mungesa e stabilitetit politik që karakterizon një pjesë të demokracive të reja, për shkak të proceseve demokratizuese nëpër të cilat kalojnë ato, krijon hapësirat për të prodhuar edhe korrupsion. Këtë logjikë të përgjithshme mund ta zbërthejmë në disa dimensione kryesore të prodhuara nga studimet e deritanishme.

Së pari, një dimension studimi është marrëdhënia që ekziston ndërmjet stabilitetit politik dhe nivelit të korrupsionit në një vend të caktuar. Të shumta janë studimet që orientohen në këtë logjikë. Ndër to përmendim Persson, Tabellini dhe Trebbi të cilët e shohin stabilitetin politik si një element që rrit vlerën e krijimit të një reputacioni pozitiv duke çuar kështu në më pak korrupsion⁸⁵. Përqëndrimi i vëmendjes tek individët politikanë në vlerësimin e marrëdhënies midis korrupsionit dhe stabilitetit politik paraqitet edhe nga autorë të tjerë. Kështu, sipas Leite dhe Weidman, destabiliteti nënkupton faktin se zyrtarët e qeverisë nuk kanë mjaftueshmërisht pushtet politik për të ndërmarrë masa anti-korrupsion⁸⁶. Pra, për ta, një nga shkaqet e mungesës së stabilitetit politik janë praktikatat korruptive të cilat zaptojnë hapësirën e vendimmarrjes publike politike. Rrjedhimisht, lloji i regjimit politik dhe hapësirës ku zhvillohet aktiviteti politik do të jetë diferencues i niveleve si të stabilitetit politik dhe të korrupsionit. Kështu, për Nur-tegin dhe Czap, niveli i korrupsionit është më i ulët në demokracitë jostabël sesa në diktaturat e qëndrueshme⁸⁷. Në këtë linjë, këta autorë vlerësojnë se demokracitë e reja në ndryshim

⁸⁵ Persson, T. Tabellini, G. Trebbi, F., (2003) 'Electoral rules and corruption', *Journal of the European Economic Association*, Vol. 1: 958-989.

⁸⁶ Leite, C. dhe Weidman, J., (1999), 'Does mother nature corrupt? Natural resources, corruption and economic growth', *International Monetary Fund Working Paper*, WP/99/85, fq. 1-34.

⁸⁷ Nur-tegin, K. Czap, J. H., (2012), 'Corruption: Democracy, Autocracy, and Political Stability', *Economic Analysis & Policy*, Vol. 42 (1):51-66, fq 52.

nga diktaturat që kanë ekzistuar për periudha të konsiderueshme kohore prodhojnë më pak stabilitet politik sesa të dytat, një kosto kjo me të cilën përballen qytetarët e regjimeve të reja demokratike⁸⁸.

Megjithatë, autorë të tjerë si Akça, Ata, dhe Karaca shpjegimin e niveleve të ulëta të korrupsionit në vendet me stabilitet politik e lidhin me nivelin e të ardhurave të këtyre vendeve. Logjika tek e cila mbështet një nga rezultatet e studimit të tyre është se vendet me të ardhura të larta karakterizohen nga nivele të larta të stabilitetit politik, çka ul edhe praktikën korruptuese, ndërkohë që e kundërta ndodh me vendet me një nivel të ulët të ardhurash⁸⁹.

Së dyti, në qendër të studimeve të fundit është edhe marrëdhënia e korrupsionit me rritjen ekonomike. Kur studiohet marrëdhënia ndërmjet korrupsionit dhe rritjes ekonomike, pikëpamja e zakonshme e pranuar është ajo që e sheh korrupsionin si një ndikues të rëndësishëm në rritjen ekonomike të një vendi. Megjithatë, autorët ndryshojnë në rezultatet e tyre përse i përket natyrës së kësaj marrëdhënieje. Pra, nëse ka një ndikim pozitiv apo negativ të korrupsionit në rritjen ekonomike.

Kështu, nga njëra anë, prezantohet një grup autorësh të cilët nëpërmjet studimeve në grup-shtete arrijnë në konkluzionin se korrupsioni ul rritjen ekonomike në një vend të caktuar. Kjo është edhe pikëpamja tradicionale gjerësisht e pranuar nga studiuesit e kësaj çështjeje. Arsyet e këtij ndikimi negativ të korrupsionit në rritjen ekonomike autorët i shpjegojnë nëpërmjet rritjes së kostove të transaksioneve, ulje të investimeve, si dhe shpërdorim të burimeve të cilat nëse do të shfrytëzoheshin ashtu siç duhet, do të çonin në një qeverisje më efektive. Për shembull, Del Monte dhe Papagni marrin në studim fenomenin e korrupsionit që shfaqet nga blerjet e bëra nga zyrtarë të qeverisë. Ata vlerësojnë se ky lloj 'korrupsioni ka një ndikim direkt negativ në mundësitë afatgjata të rritjes ekonomike sepse qeveritë mund të ofrojnë më pak inpute aktiviteteve private ekonomike'⁹⁰. Kjo pikëpamje theksohet më tej nga Mauro (1995, 1997), i cili nëpërmjet studimit të parë të një karakteri ekonometrik arriti në përfundimin se korrupsioni ul rritjen ekonomike. Sipas tij 'një devijim standard përmirësim në indeksin e korrupsionit shkakton një rritje të investimeve prej pesë për qind të PBB-së, dhe një rritje prej 0.5 për qind të normës vjetore të rritjes të PBB-së'⁹¹. Më tej, Akçay nëpërmjet një analize empirike të 54 vendeve të zhvilluara dhe në zhvillim vlerëson se korrupsioni ka ndikim statistikisht të rëndësishëm dhe negativ mbi rritjen ekonomike⁹².

Megjithatë, ndikimi i korrupsionit nuk është i njëjtë në të gjitha vendet. Vihen re ndryshime kur merret në konsideratë dallimi ndërmjet vendeve të zhvilluara dhe vendeve në zhvillim (I), apo diferenca në llojin e formatit politik demokratik apo jo-demokratik (II).

⁸⁸ *ibid.*, fq. 53.

⁸⁹ Akça, H. Ata, Y. A. Karaca, C., (2012), 'Inflation and corruption relationship: evidence from panel data in developed and developing countries', *International Journal of Economics and Financial Issues*, Vol. 2(3): 281-291, fq.289.

⁹⁰ Del Monte, A. dhe Papagni, A. 'Public Expenditure, Corruption, and Economic Growth: The case of Italy', 1-24, fq.17

⁹¹ Mauro, P. (1995), 'Corruption and Growth', *Quarterly Journal of Economics*, Vol. 110(3): 681-712, fq. 704.

⁹² Akçay, S., 'Corruption and economic growth: A cross-national study', Ankara Üniversitesi SBF Dergisi, Vol. 57(1).

- (I) Kutan, Douglas dhe Judge në studimin e tyre të fokusuar në vendet e Lindjes së Mesme e Afrikës së Veriut (MENA) dhe Amerikës Latine shohin se ka dallime të dukshme dhe të rëndësishme në terma të ndikimit të korrupsionit tek rritja ekonomike në të dyja rajonet⁹³. Sipas tyre, ‘ndërkohë që korrupsioni ishte i lidhur me përmirësimin e zhvillimit ekonomik në vendet e MENA-s, ai nuk kishte lidhje të rëndësishme me rritjen ekonomike në vendet e Amerikës Latine gjatë të njëjtës periudhë të kampionit të marrë në konsideratë’⁹⁴. Në kuadrin e këtij dimensionit kërkimi, edhe për Koyuncu, Ozturkler dhe Yilmaz, një marrëdhënie statistikisht e rëndësishme dhe negative është gjetur midis privatizimit dhe korrupsionit në ekonomitë në tranzicion për tre indekse të ndryshme të korrupsionit⁹⁵. Një studim më i detajuar i tre kategorive të 97 vendeve (vende me të ardhura të ulëta, vende me të ardhura të larta, dhe vende me një nivel mesatar të ardhurash) në periudhën ndërmjet viteve 2002-2010 është realizuar edhe nga Akça, Ata, dhe Karaca. Përveç linjës kryesore të studimit të marrëdhënies ndërmjet inflacionit dhe korrupsionit në këto vende, autorët mbërrijnë në përfundimin se rritja e inflacionit ndikon në rritjen e korrupsionit, si dhe shohin një marrëdhënie pozitive (negative) ndërmjet rritjes ekonomike dhe korrupsionit në vendet me të ardhura të ulëta (larta)⁹⁶.
- (II) Drury, Krieckhaus, dhe Lusztig argumentojnë se edhe pse demokracia nuk ka ndikime të drejtpërdrejta në rritjen ekonomike të një vendi, ajo mund të ndikojë në mënyrë jo të drejtpërdrejtë nëpërmjet fenomenit të korrupsionit rritjen ekonomike. ‘Në studimin e mbi 100 vendeve në periudhën kohore 1982-1997, ata arrijnë në përfundimin se ndërkohë që korrupsioni në vendet demokratike nuk ka ndonjë ndikim të rëndësishëm, në vendet jo-demokratike rritja ekonomike çënohet nga fenomeni i korrupsionit’⁹⁷.

Në anën tjetër, edhe pikëpamja që korrupsioni mund të ketë një ndikim pozitiv në rritjen ekonomike është mbështetur nga shumë studiues të tjerë. Huntington ka theksuar rolin e korrupsionit në mbajtjen e sistemit politik dhe eliminimin e revolucioneve⁹⁸, një ide e pasuar edhe nga Friedrich i cili mbërrin tek ideja se korrupsioni është i dobishëm për rritjen ekonomike të vendit dhe rrjedhimisht e ndikon atë pozitivisht⁹⁹. Për më tepër, Swaleheen dhe Stansel duke përdorur një panel prej 60 vendesh, arrijnë në përfundimin se për vende me liri të ulët ekonomike (ku individët kanë zgjedhje ekonomike të

⁹³ Kutan, A. Douglas, Th. and Judge, W., ‘Does corruption hurt economic development?: Evidence from Middle Eastern, North African and Latin American countries’, 1-27, i gjendshëm në <<http://www.siu.edu/business/economicsandfinance/pdf/070102.pdf>>.

⁹⁴ *Ibid.*, pg.15.

⁹⁵ Koyuncu, C. Ozturkler, H. dhe Yilmaz, R., (2010), ‘Privatization and corruption in transition economies: a panel study’, *Journal of Economic Policy Reform*, Vol. 13(3): 277-284, fq. 277.

⁹⁶ Akça, Ata, Karaca, *op.cit.*, fq.289.

⁹⁷ Drury, C. A. Krieckhaus, J. Lusztig, M., (2006), ‘Corruption, democracy, and economic growth’, *International Political Science Review*, Vol. 27(2): 121-136, fq. 121.

⁹⁸ Huntington, *op.cit.*, fq.64.

⁹⁹ Friedrich, C.J., (1972), *The Pathology of Politics, Violence, Betrayal, Corruption, Secrecy and Propaganda*, Nju York: Harper and Row.

kufizuara), korrupsioni redukton rritjen ekonomike. Megjithatë, në vende me liri të lartë ekonomike, korrupsioni vlerësohet se çon në nxitjen dhe rritjen e rritjes ekonomike¹⁰⁰. Shaw, Katsaiti, dhe Jurgilas në rishikimin e studimit të Mauro (1995) mbi korrupsionin dhe rritjen ekonomike arrijnë në përfundimin se instrumentat e përdorur në vlerësimin e kësaj marrëdhënieje nuk janë të duhurit (përdorimi i instrumentit të Fraksionalizimit Etnolinguistik nga Mauro). Sipas tyre, përdorimi i CLR-së, instrumentit të Normës të Probabilitetit të Kushtëzuar (Conditional Likelihood Ratio), jo vetëm që është një identifikues i fortë, por edhe përlllogaritja e marrëdhënies ndërmjet korrupsionit dhe rritjes ekonomike nëpërmjet përdorimit të këtij instrumenti nuk mund të eliminojë mundësinë e të mos paturit të asnjë ndikimi nga korrupsionit tek rritja ekonomike apo investimet¹⁰¹.

Choi dhe Woo në pikëpamje të vlerësimit të marrëdhënies midis politikëbërjes (kryesisht qeverisë) dhe niveleve të korrupsionit, tregojnë se qeveri me një nivel të lartë korrupsioni paraqesin edhe më shumë sukses ekonomik sesa regjimet më pak të korruptuara në vendet në zhvillim. 'Performanca ekonomike e suksesshme tenton të zbehë ndikimin e korrupsionit në rezultatin zgjedhor (elektoral)'¹⁰². Kështu, në vendet në zhvillim, korrupsioni është një çështje përfitimesh në kuptimin që për qytetarët rritja ekonomike është më e rëndësishme si çështje sesa korrupsioni, kur ky i fundit është në nivele të konsiderueshme. Kjo na drejton tek idea se në një vend në zhvillim, një ekonomi e suksesshme mund ta kalojë në një plan të dytë vëmendjen e qytetarëve ndaj korrupsionit e sidomos në format e ndryshme të pjesëmarrjes politike. Për më tepër, përfitimi ekonomik që gëzojnë vende të ndryshme nga praktikat korruptive është më i prekshëm në ato vende të cilat karakterizohen nga burokraci e zgjeruar. Pritshmëria do të jetë se, në këto vende do të lehtësoheshin ndërveprimet ndërmjet aktorëve publikë dhe atyre privatë, përfshirë këtu edhe firmat e dobëta në treg¹⁰³.

Së treti, ajo që është e rëndësishme në këtë shqyrtim është fakti se korrupsioni dhe rritja shfaqen dhe zhvillohen nën një kornizë të përbashkët politike. Sistemi politik prodhon fenomenin e korrupsionit politik, dhe në të njëjtën kohë ndërmerr dhe është përgjegjës për fillimin e zbatimin e politikave ekonomike. Ebben dhe de Vaal theksojnë idenë se ndërveprimi midis sistemit politik dhe institucioneve të tjera është i rëndësishëm për marrëdhënien ndërmjet korrupsionit dhe rritjes ekonomike¹⁰⁴. Madje, Mo tregon se korrupsioni krijon destabilitet sociopolitik, dhe ky destabilitet duke prodhuar pasiguri, ul edhe produktivitetin dhe rritjen ekonomike¹⁰⁵. Për rrjedhojë, bazuar në këto implikime të mundshme të fenomenit të korrupsionit në sistemin social e atë ekonomik, dhe mundësisë

¹⁰⁰ Swaleheen, M. Stansel, D., (2007), 'Economic freedom, Corruption and growth', *Cato Journal*, Vol. 27(3): 343-358, fq. 343.

¹⁰¹ Shaw, P. Katsaiti, S. M. Jurgilas, M., (2011), 'Corruption and growth under weak identification', *Economic Inquiry*, Vol. 49(1): 264-275.

¹⁰² Choi, E and Woo, J. (2010), 'Political corruption, economic performance, and electoral outcomes: a cross-national analysis', *Contemporary Politics*, Vol. 16(3): fq.249-262, fq. 249.

¹⁰³ Drury, Kriekhaus, Lusztig, *op.cit.*, fq. 123.

¹⁰⁴ Ebben, de Vaal, A. (2009), "Institutions and the Relation between Corruption and Economic Growth", fq.27, akesuar në 10 Gusht 2012/< http://www.degit.ifw-kiel.de/papers/degit_14/c014_014.pdf/>

¹⁰⁵ Mo, *op.cit.*, fq. 79.

së prezencës së destabilitetit politik bëhet e nevojshme marrja në konsideratë e këtij elementi në studimin e grup-shteteve specifike të studimit tonë.

2.3 STABILITETI POLITIK DHE INSTITUCIONALIZIMI

Në marrëdhënien ndërmjet zhvillimit ekonomik dhe sistemit politik të prezantuar më sipër, rolin kryesor ndërmjetësues e luajnë institucionet. Kjo sepse, zhvillimi ekonomik e ai politik si dinamika të brendshme të procesit modernizues kanë të nevojshëm një kuadër institucional i cili të mundësojë shkëmbimet ndërmjet dy sistemeve të ndryshme. Në këtë kontekst, është e nevojshme paraqitja e disa prej logjikave kryesore të qasjes institucionale.

Këta elementë, së bashku me strukturën institucionale do të shohim se janë ngushtësisht të lidhur me stabilitetin apo destabilitetin e një shteti. Kështu, marrëdhënia mes institucioneve dhe shoqërisë (nisur edhe nga karakteri homogjen apo plural i shoqërisë) apo grupeve të veçanta të saj është në qendër të studimeve të perspektivës institucionale. Studiuesit i referohen rëndësisë që ka struktura institucionale brenda shteteve për të absorbuar qëndrimet politike, edhe pse këto të fundit mund të jenë të fraksionalizuara e të polarizuara. Rrjedhimisht, këtu shohim një implikim të rëndësishëm në lidhje me gjasat për stabilitet apo destabilitet në një vend të caktuar. Në terma të përgjithshëm do të konfirmim se, në ato vende ku qëndrimet e ndryshme arrijnë të akomodohen brenda strukturës institucionale kemi gjasat për stabilitet politik, dhe e anasjellta.

Ndërkaq, studimi i marrëdhënies midis stabilitetit politik dhe institucioneve është shfaqur në mënyrë më të theksuar veçanërisht duke filluar nga vitet 90', që si periudhë kohore përfaqësoi ndryshime të rëndësishme politike e ekonomike sidomos për Evropën Lindore. Kjo sepse, tashmë në nivelin ndërkombëtar mbizotëruan dy tendenca kryesore: së pari, nevoja e reduktimit të varfërisë nëpërmjet rritjes ekonomike të vendeve të varfra, e përligjur nga mendimi i përgjithshëm se rritja dhe zhvillimi janë thelbësorë në reduktimin e destabilitetit politik dhe konfliktit; së dyti, procesi i demokratizimit të Evropës Lindore i udhëhequr nga aksioma e përgjithshme se demokracitë e konsoliduara janë më stabile¹⁰⁶. Këtu ndahen edhe qëndrimet në lidhje me rolin e institucioneve si 'sisteme të mirëpërcaktuara dhe të ngulitura rregullash të cilat strukturojnë ndërveprimet sociale¹⁰⁷' në procesin e zhvillimit.

Një pjesë e autorëve e shohin të pjesshëm kontributin e institucioneve në zhvillim, e sidomos në ato vende të cilat prezantojnë vonesa zhvillimi. Kështu, sipas Leftwich, roli i institucioneve në demokraci 'rrallë promovon politikën e ndryshimit radikal në kontrollin, akumulimin, shpërndarjen ose përdorimin e pasurisë, i cili është shumë i rëndësishëm veçanërisht në shoqëritë me zhvillim të vonuar'¹⁰⁸. Në këtë kontekst, niveli i zhvillimit të një vendi vlerësohet si përcaktues në suksesin e formatit institucional. Por, edhe formati institucional, i varur nga niveli i zhvillimit është reflektim i këtij të fundit duke prodhuar në këtë mënyrë pamundësi në përmbushjen e funksioneve që identifikohen me institucionet.

¹⁰⁶ Leftwich, *op.cit.*, fq. 686.

¹⁰⁷ Hodgson, G. M., (2006), 'What are institutions?', *Journal of Economic Issues*, Vol. XL(1):1-24, fq.18.

¹⁰⁸ Leftwich, *op.cit.*, fq. 699.

Edhe nëse i referohemi Evropës Lindore pas viteve 90', një vlerësim fillestar do të ishte mungesa e një kuadri institucional të konsoliduar që t'i përgjigjet nevojave për rritje dhe zhvillim të shpejtë. Por, mbërritja tek një burokraci profesionale e vendosur në një makineri institucionale mirë-funksionuese dhe cilësore kërkon kohë¹⁰⁹. Raporti i Bankës Botërore pranon vështirësitë që lidhen me këtë aftësim të institucioneve për t'iu përgjigjur nevojave të kohës në mesin e viteve 90'. Më tej, në raportin e vitit 2002, Banka Botërore, konfirmon se 'aftësia e shtetit për të mundësuar institucione të cilat mbështesin rritjen dhe reduktimin e varfërisë, shpesh e konsideruar si mirëqeverisje, është thelbësore për zhvillimin¹¹⁰. Duke vazhduar në vitin 2013, Banka Botërore për vendet e karakterizuara nga konflikti, shprehet se dobësia e institucioneve apo edhe paqëndrueshmëria politike evidenton rëndësinë e stimulimit të kohezionit social nëpërmjet politikës së punësimit¹¹¹.

Nëse për Bankën Botërore aftësimi institucional kërkon kohë për të mundësuar mirëfunksionim të 'lojës politike', Rodrik *et al.*, në studimin e tyre të kontributit të institucioneve, gjeografisë, dhe tregëtisë në përcaktimin e niveleve të të ardhurave nëpër botë, identifikojnë cilësinë e institucioneve si kontribuesin kryesor, ndryshe nga tregëtia apo gjeografia të cilat rezultojnë të kenë një marrëdhënie të dobët me nivelin e të ardhurave¹¹². Duke vazhduar më tej Goldstone *et al.*, në vlerësimin e destabilitetit politik në nivel botëror mbërrijnë në përfundimin se janë pikërisht institucionet politike ato që përbëjnë elementin më të mirë parashikues të destabilitetit politik dhe jo elementë të tjerë si kushtet ekonomike, gjeografia apo demografia¹¹³.

Përbërja e shoqërisë, pra fakti nëse ajo është plurale apo homogjene, evidenton akoma më shumë rëndësinë e institucioneve në situata konfliktuale. Argumenti kryesor që përbashkëson një pjesë të autorëve është se shoqëritë heterogjene (plurale), të karakterizuara nga ndarje të forta politike, do të shfaqin karakteristika të mungesës së stabilitetit (Lipset, Almond, Powell and Mundt, Dahl, etj). Megjithatë, niveli i destabilitetit vërehet i ndryshëm për regjime të ndryshme politike. Kështu, është i njohur fakti se dy nga elementët që garantojnë në një nivel të konsiderueshëm stabilitetin politik në shoqëritë heterogjene janë konsocializmi i prezantuar nga Lijphart si një mundësi për bashkëjetesë paqësore në shtete shumë-kombëshe dhe korporativizmi si 'një set i veçantë politikash dhe rregullimesh institucionale për strukturimin e përfaqësimit të interesave'¹¹⁴. Sipas Keman, këta elementë janë në gjendje që 'në demokracitë plurale edhe në situata dhe gjendje të ndryshueshme ta çojnë më tej konsensusin atje ku konflikti

¹⁰⁹ Banka Botërore, (1997), op.cit., fq. 97.

¹¹⁰ *ibid.*, fq. 115.

¹¹¹ Banka Botërore., (2013), *World Development Report: Jobs*, Uashington DC, fq. 19.

¹¹² Rodrik, D. Subramanian, A. Trebbi, F., (2002), 'Institutions rule: the primacy of institutions over geography and integration in economic development', *NBER Working Paper*, Nr. 9305, fq. 1-43.

¹¹³ Goldstone, A. J. Bates, H. R. Epstein, L. D. Gurr, R. T. Lustik, B.M. Marshall, G. M. Ulfelder, J. Woodward, M., (2010), 'A global model for forecasting political instability', *American Journal of Political Science*, Vol. 54(1):190-208.

¹¹⁴ Stepan, A., (1978), *The state and society: Peru in comparative perspective*, Princeton University Press, Princeton, fq. 46.

duket i paevitueshëm¹¹⁵. Në pikëpamjen e tij dhe të një sërë autorësh përfaqësues të rrymës së institucionalizmit, nuk janë vetëm strukturat institucionale, procedurat e rregullat, ato të cilat përcaktojnë sjelljen e aktorëve të ndryshëm në një shoqëri. Kjo pikëpamje e trajtuar më shumë edhe nga Putnam, Steinmo, etj, paraqet varësinë e zhvillimit të institucioneve nga historia, ose më saktë nga rrugët e zhvillimit që vetë institucionet kanë ndjekur.

Jung dhe Sunde në studimin e stabilitetit të demokracisë nisen nga supozimi se shoqëria përbëhet nga grupe të ndryshme, të cilat nuk e kanë problem krijimin e koalicioneve, dhe madje interesat konfliktuale mund të akomodohen lehtësisht nëpërmjet angazhimit të grupeve në respektimin e marrëveshjeve. Ata e konsiderojnë problemin e formimit të koalicioneve në rrethana ku grupet e ndryshme të një shoqërie, për shkak të interesave të ndryshme që kanë në shpërndarjen e faktorëve të prodhimit, nuk angazhohen për mos eliminim të mundësisë për pjesëmarrje të grupeve të tjera në një koalicion qeverisës në të ardhmen¹¹⁶. Sipas tyre, mbajtja dhe shfaqja e demokracisë në shoqëri heterogjene ka një varësi të madhe nga korniza institucionale e cila të mund të garantojë besueshmërinë, dhe demokracia mund të shfaqet vetëm në një mjedis ekonomik të balancuar.

Edhe sipas Acemoglu (2006), 'institucionet jo efçente do të shfaqen dhe mbizotërojnë kur grupet të cilat preferojnë politikat ineffçente të prodhuara nga këto institucione janë mjaftueshmërisht të fuqishëm, dhe kur nuk mund të gjenden rregullime të tjera sociale që kompensojnë këto grupime të fuqishme të përfitojnë nga shpërndarje më efçente të burimeve'¹¹⁷. E njëjta logjikë mbështetet edhe nga Cervellati, Fortunato dhe Sunde, të cilët në trajtimin e demokracisë jo vetëm i referohen kuadrit institucional, por cilësisë së rendit ligjor si një variabël i pavaruar i lidhur ngushtësisht me demokratizimin. Teoria e tyre 'sugjeron se kushtet në të cilat realizohet procesi i demokratizimit janë më thelbësore për demokracinë e cila po shfaqet, sesa vetë tranzicioni'¹¹⁸.

Përveç rëndësisë së marrëdhënies midis kuadrit institucional dhe elementëve socialë, një implikim i rëndësishëm i studimeve të përqendruara në qasjen institucionale është edhe rëndësia që ka mjedisi (apo konteksti) ekonomik ku veprojnë institucionet. Sipas Williams *et al.*, 'proceset e rritjes varen në mënyrë vendimtare nga ndërtimi i marrëdhënies të institucionalizuara të besimit ndërmjet politikanëve dhe investitorëve, por edhe në krijimin e kontrollit dhe balancave për të kundërshtuar (mënjanuar) konfliktet e interesave'¹¹⁹. Këto marrëdhënie duhet të ndërtohen mbi ekzistencën e disa kushteve bazë që nxisin rritjen ekonomike në një vend të cakuar në tre drejtime kryesore: 'liria nga shpronësimi, investitorëve iu nevojitet besim që do të jenë në gjendje të ruajnë asetet e tyre, mirëfunksionim i tregjeve konkurruese, të mirë-rregulluar dhe ndërkombëtarisht të hapur, si dhe investim i përshtatshëm dhe siç duhet mbi të mira publike dhe gjysëm-

¹¹⁵ Keman, H., (1999), 'Political stability in divided societies: a rational-institutional explanation', *Australian Journal of Political Science*, Vol. 34(2): 249-268, fq. 250.

¹¹⁶ Jung, Sunde, *op.cit.*

¹¹⁷ Acemoglu, D., (2006), 'Modeling inefficient institutions', *Cambridge Collections Online*, Cambridge University Press, 341-380, fq. 342.

¹¹⁸ Cervellati, M. Fortunato, P. Sunde, U., (2007) *Violence during democratization and the quality of democracy*, fq 1; aksesuar më Shtator 2012, < <http://www2.dse.unibo.it/cervellati/pdf/violence.pdf>>

¹¹⁹ Williams, G. Duncan, A. Landell-Mills, P. Unsworth, S., (2011), 'Politics and growth', *Development Policy Review*, Vol. 29(s1): 29-55, fq.53.

publike¹²⁰. Pra, garantimi i përmbushjes dhe respektimit të këtyre kushteve kërkon si premisë fillestare një proces politik i cili të ndihmojë në institucionalizimin e marrëdhënieve midis aktorëve politikë, ekonomikë e socialë. Si përfundim, sukcesi i këtij ndërmjetësimi në procesin politik është i ndikuar nga struktura institucionale, sepse ‘institucionet politike të përcaktuara si një sistem rregullash formësojnë (ose të paktën në një pjesë) sjelljen strategjike të aktorëve politikë të pavaruar dhe lehtësojnë procesin e vendimmarrjes, duke nxitur përmirësimin e mirëqënies publike’¹²¹.

Pavarësisht se nga trajtesa e mësipërme përqendrohemi tek dy koncepte themelore siç janë demokracia dhe stabiliteti politik, ato kurrsesi nuk mund të konsiderohen si dy koncepte të barazvlefshme e reciprokisht të shkëmbyeshme me njëra-tjetrën. Stabilitetin politik e shohim si një fenomen prezent në formatin demokratik të organizimit politik (pavarësisht niveleve të ndryshme të shfaqjes së tij përgjatë kohës në vende të ndryshme), ndërsa demokracia si koncept është qartësisht e diferencuar nga stabiliteti politik duke krijuar premisat në varësi të niveleve ekzistuese të saj për stabilitet apo destabilitet politik. Duke iu referuar pikërisht kësaj mundësie ngatërrimi mes koncepteve Bollen specifikon përcaktimin e tij për demokracinë si ‘masën në të cilën pushteti politik i elitave minimizohet dhe ai i jo-elitave maksimizohet. Rrjedhimisht sipas autorit, mund të arrijmë në përfundimin se atje ku jo-elitat kanë pak kontroll mbi elitat, demokracia politike është e ulët, ndërsa kur elitat u japin llogari dhe u përgjigjen jo-elitave, demokracia politike është e lartë’¹²². Rrjedhimisht, presupozohet se ka një varësi të stabilitetit politik nga niveli i demokracisë në një vend të caktuar. Rëndësia e shpërndarjes së pushtetit politik është kyçe në rastet e vendeve me të kaluar autoritare. Për këtë, Richard dhe Anderson thekson se ‘ideja e përgjithshme që buron prej rasteve të suksesshme të demokratizimit në botën paskomuniste është se institucionet të cilat promovojnë shpërndarjen e pushtetit ekonomik dhe politik dhe përfshirjen e aktorëve të ndryshëm në proceset politikbërëse janë më efektive në lehtësimin e konsolidimit të demokracisë’¹²³.

2.3.1 Lloji i formës së qeverisjes dhe stabiliteti politik

Mirëpo, struktura institucionale, e sidomos mënyra sesi janë të organizuara pushtetet është e përcaktuar nga forma e qeverisjes së një vendi. Dy ndër elementët kryesorë që mund të përmendim në lidhje me formën e qeverisjes janë: iniciativat ligjvënëse mbeten tek qeveria, dhe mbijetesa e qeverisë është e varur nga mbështetja e mazhorancës në asamble (parlament)¹²⁴. Në këtë kuadër, formatit parlamentar, si rezultat i rregullimit të veçantë të marrëdhënieve midis hallkave të pushtetit dhe rolit të kreut të shtetit në këtë marrëdhënie, duhet t’i kushtohet rëndësia e duhur. Pra, mënyra se si prezantohet marrëdhënia ndërmjet këtyre dy hallkave të pushtetit shërben si një ndikues edhe i

¹²⁰ *ibid.*, fq. 2.

¹²¹ Keman, *op.cit.*, fq.256.

¹²² Bollen, A. K., (1990), ‘Political democracy: conceptual and measurement traps’, *Studies in Comparative International Development*, Vol. 25(1): 7-24, fq. 9.

¹²³ Richard, D. dhe Anderson, Jr. *Postcommunism and the theory of democracy*, cituar në Ekiert, G. Kubik, J. Vachudova, A. M., (2007), ‘Democracy in the post-communist world: an unending quest?’, *East European Politics and Societies*, Vol. 21(7): 7-30, fq. 14.

¹²⁴ Persson, T. Tabellini, G., (1999), ‘The size and scope of government: comparative politics with rational politicians’, *European Economic Review*, Vol. 43: 699-735, fq.719.

stabilitetit politik të një vendi. Ky ndikim padyshim që nuk mund të jetë një element shterues shpjegues i stabilitetit politik. Ndikimin kryesor mund ta shohim në pozicionin dhe rolin e legjislativit. Ky i fundit, nëpërmjet zotërimit të instrumentit të përfaqësimit prodhon legjitimitimin e regjimit politik si dhe legjitimitimin e mënyrës se si janë organizuar pushtetet në vend. Mundësimi i përfaqësimit të grupimeve, interesave dhe në tërësi, të diversitetit të shoqërisë ndihmon nga ana tjetër edhe në integrimin e shoqërisë dhe zbehjen në një mënyrë të dinamikave konfliktuale e destabilizuese. Në tërësi, ‘legjislaturat kanë gjasat të jenë stabil si institucione, çka iu mundëson atyre ndikimin tek dhe nga mjedisi politik’¹²⁵.

Megjithatë është e nevojshme që të vlerësohet mënyra se si legjislaturat ndikojnë apo kontribuojnë në nivelet e stabilitetit politik apo destabilitetit e shembjes së regjimit politik. Jo vetëm kaq, por legjislaturat veprojnë e funksionojnë në një kontekst të mirëpërcaktuar. Rrjedhimisht, e rëndësishme është edhe njohja e kushteve specifike nën të cilat parlamentet ndihmojnë në konsolidimin e stabilitetit politik. Një ndër studimet kryesore që ka patur në fokus të vet këto kushte në marrëdhënien ndërmjet mbështetjes politike dhe stabilitetit të regjimit politik nga njëra anë dhe legjislaturave nga ana tjetër është studimi i Mishler dhe Hildreth (1984), me një kampion prej 100 legjislaturash. Ata arrijnë në përfundimin se, ‘edhe pse legjislaturat mund të kontribuojnë në mënyrë thelbësore tek stabiliteti, atje ku janë burimet e duhura, nivelet e ulëta dhe të moderuara të tensionit social, dhe një tërësi institucionesh demokratike, aftësia e tyre (legjislaturave) për të promovuar stabilitetin ka gjasat të cenohet nga varfëria, frakturat sociale, ose nga mungesa e institucioneve dhe praktikave të tjera’¹²⁶.

2.3.2 Ndërveprimet ndërmjet aktorëve dhe institucioneve

Përveç vlerësimit të rolit të kuadrit institucional në përfaqësimin dhe akomodimin e proceseve sociale e ekonomike në sistemin politik, një çështje tjetër për tu konsideruar është edhe marrëdhënia ndërmjet aktorëve dhe institucioneve të sistemit politik në situata konfliktuale. Për këtë, nisemi edhe nga fakti se një nga karakteristikat veçuese të një regjimi demokratik është aftësia për të akomoduar qëndrimet, perceptimet dhe ndjenjat e qytetarëve brenda një kuadri institucional me elementë të theksuar të llogaridhënies. E kundërta ndodh me regjimet jodemokratike ku, mjedisi socio-politik i krijuar, nuk i jep mundësi dhe as e stimulon krijimin e opinionit publik dhe shprehjen e qëndrimeve të qytetarëve duke i atribuuar vetes detyrën e të formuluarit të interesave të shoqërisë dhe asaj çka është e duhur për këtë të fundit.

Mënyra se si është sendërtuar kjo marrëdhënie ndikon edhe në stabilitetin e përgjithshëm politik të një vendi. Sipas Keman, një shpjegues i stabilitetit relativ të rendit politik është i ashtuquajtur ‘*ekuilibër i shkaktuar nga struktura*’, i cili i referohet “ekzistencës së një rendi politik të institucionalizuar të shoqërisë, që është në gjendje të prodhojë një balancë ndërmjet konfliktit dhe konsensusit, ku ky i fundit është i vazhdueshëm dhe prodhon humbje minimale ndaj çdo individi ose grupi brenda një shoqërie’¹²⁷. E rëndësishme në

¹²⁵ Loewenberg, G. Patterson S. C., *Comparing Legislatures*, 1979, Boston: Little, Brown and Co, fq. 21.

¹²⁶ Mishler, W. Hildreth, A., (1984), ‘Legislatures and political stability: an explanatory analysis’, *The Journal of Politics*, Vol. 46(1): 25-59, fq 50.

¹²⁷ Keman, *op.cit.*, fq.253.

këtë kontekst është edhe përcaktimi i kuptimit të konfliktit. Në vlerësimin e konflikteve të armatosura për periudhën pas Luftës së Dytë Botërore deri në vitin 2001 dhe ngritjen e një baze të dhënash në lidhje me këtë element, Gleditsch *et al.* bazuar në përcaktimin e Universitetit të Upsalës përfshijnë në konceptin e konfliktit ekzistencën e ‘një lloj papërputhshmërie të qeverisë (lloji i sistemit politik, zëvendësimi i qeverisë qendrore, ose ndryshimi i përbërjes së saj), ose të territorit (një ndryshim nga një shtet tek tjetri në kontrollimin e territorit në një konflikt ndërshtetëror ose kërkesa për shkëputje apo autonomi në një konflikt të brendshëm)’¹²⁸.

Të njëjtin fokus ka patur edhe Shepsle dhe Weingast për ekuilibrin e shkaktuar nga struktura. Sipas tyre në përpjekjen për të vlerësuar stabilitetin e një sistemi, shitja e votave, formimi i koalicioneve, negocimi janë çështje të cilat gabimisht i vendosim në plan të parë. Këto elementë janë pasoja e argumentit që trajtojmë. Përkundrazi, sipas tij ‘janë pikërisht kufizimet institucionale të cilat promovojnë ekuilibrin e shkaktuar nga struktura’¹²⁹.

Keman argumenton se mënyra sesi akomodohen interesat e nevojat e ndryshme të aktorëve në demokracinë bashkëpëlqimore dhe atë korporative është e ndryshme. Në të parën, për shkak të fleksibilitetit të njohur formalisht, si dhe kompromiseve dhe negociemeve mbërrihet në gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme. Nga ana tjetër, në rastin e korporatizmit, hapësirat për të manovruar përcaktohen nga qeverisja e partisë, çka e bën më të vështirë mbërritjen drejt një konsensusi, sepse aktorët e përfshirë në proces mund vetëm të rendisin preferencat e tyre, por mbërritja tek një marrëveshje e përbashkët arrihet kur ajo është e pranueshme për të gjithë. Duke i konsideruar aktorët në lidhje me ‘nevojat’ e tyre urgjente, dhe institucionet si variabla ndërhyrës të cilët krijojnë hapësirën e manovrimit, ne mund të kuptojmë marrëdhënien paradoksale ndërmjet konflikteve sociale dhe zhvillimit të konsensusit përsa i përket fizibilitetit të zgjedhjes të politikave publike¹³⁰. Megjithatë, ky argumentim ka mangësitë e veta. Ai i referohet aktorëve të përfshirë në proces, qoftë kjo nëpërmjet ekzistencës së fleksibilitetit vendor apo nëpërmjet hapësirave të krijuara nga qeveria. Në funksion të përfundimit të një panorame më të thellë për këtë aspekt të stabilitetit demokratik, në konsideratë duhen marrë edhe ata aktorë të cilët janë përjashtuar nga të tilla procese ndërvepruese. Kështu, sipas Wright ‘demokracitë e reja me nivele të ulëta të konkurrencës fillestare politike kanë më shumë gjasa të dështojnë, sepse ata që janë përjashtuar në fillim të lojës politike kërkojnë të shkatërrojnë regjimin në të ardhmen’¹³¹. Ose, sipas pikëpamjes së Drazen, edhe në nivelin individual, individët të karakterizuar nga heterogjeniteti i interesave, dhe rrjedhimisht nëpërmjet shfaqjes së konfliktit të interesave janë ndikues në rezultatet e politikave¹³². Pra, me pak fjalë, stabiliteti i demokracive të reja është i ndikuar edhe nga

¹²⁸ Gleditsch, P. E. Wallenstein, P. Eriksson, M. Sollenberg, M. Strand, H., (2002), ‘Armed conflict 1946-2001: A new dataset’, *Journal of Peace Research*, Vol. 39(5), fq. 615-637, Sage Publications, fq. 619.

¹²⁹ Shepsle, A. K. Weingast, R. B., (1981), ‘Structure induced equilibrium and legislative choice’, *Public Choice*, Martinus Nijhoff Publishers, Hollandë, fq. 515.

¹³⁰ Keman, *op.cit.*, fq. 265.

¹³¹ Wright, J., (2008), ‘Political Competition and Democratic Stability in New Democracies’, *British Journal of Political Science*, Cambridge University Press, Vol. 38(2): 221-245, fq. 221.

¹³² Drazen, A., (2000), ‘How does politics affect economic outcomes? Insights from ‘New’ political economy’, *Essay on political economy*, fq 1-5, fq. 3.

hapësirat që këto vende iu ofrojnë grupeve të caktuara të cilat kanë potenciale kërcënuese për stabilitetin, dhe nga natyra njerëzore e cila e bën shpesh kërcënues rezultatin e politikave.

2.4 RISHIKIMI I LITERATURËS NË PËRKUFIZIMIN E STABILITETIT POLITIK

Dy nga studimet më të hershme që kanë hedhur dritë mbi stabilitetin politik si koncept janë ato të Hurwitz dhe Hibbs. Hurwitz vlerëson se pesë janë konceptimet më të zakonshme për stabilitetin politik: 'së pari, mungesa e dhunës; së dyti, kohëzgjatja e qeverisë; së treti, ekzistenca e një regjimi konstitucional legjitim; së katërti, mungesa e ndryshimit strukturor; dhe së fundi, një atribut social i shumëanshëm'¹³³. Katër, ndër pesë nga këto konceptime lidhen me karakteristika të brendshme të entitetit politik. Kështu, mungesa e dhunës, qeverisja e qëndrueshme, mungesa e ndryshimeve strukturore brenda formatit politik apo qëndrueshmëria e shoqërisë së organizuar politikisht, krijojnë premisat për ekzistencën e stabilitetit politik. Ndërsa, legjitimitetin dhe kushtetueshmërinë e regjimit mund t'i vlerësojmë si faktorin e jashtëm nën kontekstin e të cilit zhvillohen dinamikat e sipërpërmendura.

Siç mund ta shohim, ekzistenca e dhunës përbën një tipar dallues që vendoset në qendër të analizës së konceptit të stabilitetit, dhe më konkretisht dhuna politike e grupeve të ndryshme sociale. Megjithatë, shfaqja e një fenomeni të tillë bën të nevojshëm operacionalizimin dhe përkufizimin e tij. Kjo sepse, në konceptin e dhunës politike të masave apo grupeve të ndryshme mund të përfshihen situata dhe procese nga më të ndryshmet duke rritur rrjedhimisht edhe vështirësinë e analizës së objektit studimor.

Për vetë rëndësinë që ka çështja e dhunës politike, studime të ndryshme e vlerësojnë dhe e masin atë duke përdorur variabla të ndryshëm. Madje, ashtu si edhe në këtë studim, koncepti i dhunës merret në trajtesë ngushtësisht i lidhur me konfliktin dhe destabilitetin. Për shkak të shumëllojshmërisë nëpërmjet së cilës shfaqen formatet e dhunshme është e nevojshme njohja e kriterëve për identifikimin e saj. Nëse i referohemi Hibbs (1973), tre janë kriteret që duhen marrë në konsideratë kur vlerësohen fenomenet e dhunës politike¹³⁴: së pari, ngjarja në fjalë duhet të ketë karakter kundër sistemit. Ky kriter përjashton nga analiza lëvizjet apo ngjarjet e manifestuara të cilat kanë për qëllim shfaqjen e mbështetjes ndaj sistemit; së dyti, ngjarja apo ndodhia duhet të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë dhe me rëndësi politike ku rëndësia lidhet me ndikimin që ka ngjarja në pengimin apo pamundësimin e realizimit të objektivave të sistemit politik; së treti, karakteri i ngjarjes apo fenomenit duhet të jetë masiv dhe jo individual e i paorganizuar. Ndërsa, Bollen dhe Jones kanë përdorur një indeks të destabilitetit politik ekstrem të përbërë nga katër tregues kryesorë, të cilët janë gjithashtu të përqendruar në shfaqjet e dhunshme të politikës dhe shfaqjet e dhunshme ndaj saj, si: vrasjet, transferime jo të

¹³³ Hurwitz, L., (1973), 'Contemporary Approaches to Political Stability', *Comparative Politics*, Vol. 5(3): 449-463, fq. 449.

¹³⁴ Douglas, A. Hibbs, Jr., (1973), *Mass political violence: a cross-national causal analysis*, John Wiley & Sons, Nju Jork, fq. 7.

rregullta të ekzekutivit, sulme të armatosura, dhe vdekjet nga dhuna politike e brendshme¹³⁵.

Pra, nëse trajtojmë shfaqjet e shumta të dhunës brenda një sistemi të caktuar politik, marrja në konsideratë e tyre në marrëdhënien me stabilitetin politik është e varur nga dimensionet e numrit të personave të përfshirë në to, ndikimi që prodhohet tek sistemi politik nga ky lloj ndërveprimi i dhunshëm politik, si dhe nga natyra e këtyre ngjarjeve apo ndodhive kundër sistemit politik. Natyrisht, mënyrat e shfaqjes së formateve të dhunës politike në një shtet të caktuar janë të ndryshme, por gjithsesi ato konvergojnë në tre dimensionet kryesore të sipërpërmendura. Gjithsesi, zotërimi i këtyre karakteristikave nuk i bën të gjithë shfaqjet e dhunës të njëjta. Dhuna politike në një vend të caktuar mund të vlerësohet si produkt i gjashtë variablave të mëposhtme¹³⁶:

Protestat, të cilat përfshijnë demonstrata të dhunshme ose përplasje të një grupi të madh qytetarësh të shprehura nëpërmjet përdorimit të forcës fizike, dhe që zakonisht shprehet nëpërmjet dhunimit të pronës, plagosjes së njerëzve, apo përdorimin e mjeteve për kontrollin e protestës.

Ngjarjet me sulm të armatosur, të cilat shfaqen si akte dhune të organizuara nga/ose që përfshijnë grupe të armatosura me armë të çdo lloji.

Grevat politike, të cilat përfaqësohen nga çdo grevë e karakterit industrial, ose të punonjësve apo studentëve, kundër veprimeve, politikave qëndrimeve të qeverisë apo të liderëve të saj.

Vrasjet, ku përfshihet çdo vrasje apo tentativë vrasjeje e motivuar politikisht e një zyrtari të lartë apo politikani.

Vdekjet nga dhuna politike përfshijnë në këtë variabël numrin e të vrarëve në lidhje me dhunën e brendshme ndërmjet grupeve të shfaqur nëpërmjet sulmeve të dhunshme, protestave, demonstratave dhe fenomeneve të tilla të ngjashme.

Demonstratat antiqeveritare karakterizojnë bashkime të organizuara të një numri të madh njerëzish me qëllim protestën kundër qeverisë, veprimeve, politikave apo një ose disa liderëve të saj.

Duke ndjekur logjikën e Hibbs në variablat shpjegues të stabilitetit politik, Mishler dhe Hildreth përdorin ‘protestat, demonstratat antiqeveritare, dhe grevat e përgjithshme, si tregues të dimensionit të një proteste të përgjithshme; dy variablat vrasjet dhe luftimin guerilas të etiketuara më sipër si luftë e brendshme nga Hibbs; dhe dy variablat kriza qeveritare dhe spastrimet, ku këto të fundit nuk janë përfshirë nga Hibbs në kategorizimet e tij të dhunës politike’¹³⁷.

Në një mënyrë, këto vështrime të deritanishme të stabilitetit politik kanë në fokus të tyre regjimin politik dhe mënyrën sesi ai mban veten, qoftë kjo nëpërmjet shfaqjes së llojeve

¹³⁵ Bollen, A. Jones, T. S., (1982), ‘Political Instability and direct foreign investment: the motor vehicle industry, 1948-1965’, *Social forces*, Vol. 60(4): 1070-1088.

¹³⁶ Douglas, Hibbs, *op.cit.*, fq. 8.

¹³⁷ Mishler, Hildreth, *op.cit.*, fq. 36.

të ndryshme të dhunës, apo nëpërmjet mungesës së prezencës së formateve të dhunshme të organizimit politik. Pra, krijohet pritshmëria se, nëse kemi prani të njërit apo tjetrit lloj të dhunës, rrjedhimisht do të kemi edhe cenim të stabilitetit politik në vend. Në mënyrën se si e mban veten sistemi politik, Gurr i referohet qëndrueshmërisë së tipareve të autoritetit brenda një sistemi politik. Kështu, ai propozon një përkufizim tjetër duke e vlerësuar stabilitetin si vazhdueshmërinë dhe përshtatshmërinë e sistemit politik¹³⁸. Megjithatë, për arsye studimi është e nevojshme që të shihet edhe përkufizimi në lidhje me përcaktuesit e stabilitetit politik.

Po sipas të njëjtit autor, 'vazhdueshmëria është hapësira kohore gjatë së cilës një sistem politik qëndron pa ndryshime thelbësore në strukturën e tij të autoritetit, ndërsa përshtatshmëria lidhet me masën e kapacitetit të shfaqur të një sistemi politik për ndryshim inkremental në strukturën e autoritetit'¹³⁹. Në po të njëjtën linjë të mbajtjes së vetes nga ana e regjimit dhe sistemit politik, Bunce¹⁴⁰ e konsideron stabilitetin politik 'si kapacitetin e regjimit (ose i organizimit të pushtetit politik) dhe shtetit (ose një entiteti politik të përcaktuar në hapësirë dhe që zotëron monopolin e ushtrimit të pushtetit) për të mundësuar rendin politik'. Përcaktues për ruajtjen e rendit politik, Bunce prezanton elementët me anë të së cilëve identifikon këtë lloj rendi, si: rregulla konstante të lojës politike, të cilat janë të pranuar nga të gjithë dhe informojnë për sjelljen e të gjithëve; ekzistenca e një regjimi hegjemonik; qeveri që funksionon efektivisht, dhe kufij fizikë që janë të mirëpërcaktuar dhe të pakontestuar. Ndërsa, destabiliteti, përcaktohet nga nivele të larta të mungesës së rendit social; presione shkëputjeje; kundërshtime mbi formën e regjimit; nivele të larta të qarkullimit të qeverisë, dhe qeveri të cilat nuk mund të vendosin, ose edhe pse vendosin nuk mund të zbatojnë.

Nëse përqendrohemi tek sistemi politik, element përfaqësues i tij është edhe përbërja e qeverisë. Nëpërmjet funksioneve të saj ekzekutive të ndërmarrjes, zbatimit e monitorimit të politikave publike, qeveria ka rolin e saj në stabilitetin e vendit. Madje, një pjesë e studimeve që kanë në fokus të tyre stabilitetin politik dhe marrëdhënien e tij me elementë të tjerë kryesisht nga sistemi ekonomik, e vlerësojnë stabilitetin politik si stabilitet të qeverisë. Në këtë kontekst, në vlerësimin e marrëdhënies midis stabilitetit politik dhe seniorazhit, Cukierman *et al.*, përcaktojnë stabilitetin politik 'të përfaqësuar nga probabiliteti i humbjes së zyrës'¹⁴¹. Pra, sipas tyre, stabilitetin politik mund ta shohim thjeshtësisht të lidhur me probabilitetin e ndryshimit të qeverisë, pa marrë në konsideratë si ndryshime të qeverisë, ndryshimet në përbërjen e saj. Ngushtësisht të lidhur me qeverinë, por jo vetëm, e vlerësojnë edhe Taylor dhe Herman stabilitetin politik. Sipas tyre stabiliteti politik i përcaktuar si 'kohëzgjatja e qeverisë në ditë', vlerësohet i lidhur me përbërjen e sistemit partiak, përbërjen e qeverisë, si dhe rolin e opozitës në një vend të

¹³⁸ Gurr, R. T., (1974), 'Persistence and Change in Political Systems, 1800-1971', *American Political Science Review*, Vol. 68(4): 1482-1504, fq. 1484.

¹³⁹ *ibid.*, fq. 1484.

¹⁴⁰ Bunce, *op.cit.*, fq. 772-773.

¹⁴¹ Cukierman, A. Edwards, S. Tabellini, G., (1992), 'Seignorage and Political instability', *The American Economic Review*, Vol. 82(3): 537-555, fq. 542.

caktuar¹⁴². Ndërsa për Alesina *et al.*, (1996), destabiliteti politik përcaktohet si tendenca e ndryshimit të qeverisë në një vend nëpërmjet mjeteve kushtetuese apo jokushtetuese¹⁴³.

Sipas Olson, ekziston një marrëdhënie dikotomike ndërmjet stabilitetit politik dhe destabilitetit politik nga pikëpamja e rezultateve që këto gjendje prodhojnë brenda një shteti të caktuar. Në kuadrin e një logjike të zakonshme, është e kuptueshme se një shtet i stabilizuar politikisht do të jetë më i zhvilluar. Megjithatë, për Olson, në rrethana të caktuara, edhe destabiliteti politik mund të nxisë zhvillimin e një entiteti politik më shpejt se në rrethanat e një stabiliteti të përgjithshëm. Kjo, kur destabiliteti politik arrin nivele të tilla të cilat çojnë drejt përçarjes së koalicioneve të krijuara¹⁴⁴. Në rrethana të shkrirjes dhe shpërbërjes së koalicioneve që shpërndajnë pasurinë, pasuria mbrohet më lehtësisht duke rritur, sipas Olson edhe gjasat për një rritje më të shpejtë ekonomike.

Megjithatë, ekzistenca apo mungesa e stabilitetit politik lidhet edhe me kontekstin ku merr jetë fenomeni. Për çështjen që është marrë në studim, janë sistemi social e ekonomik ata të cilët përfaqësojnë kushtet fillestare nga ku stimulohet stabiliteti apo destabiliteti. Kjo do të thotë se i një rëndësie të madhe është edhe trajtimi i konceptit të stabilitetit politik nga një pikëpamje social-psikologjike. Kështu, Feierabends e trajton konceptin e destabilitetit politik në terma të elementëve socialë dhe psikologjikë duke e konsideruar atë si një rezultat përfundimtar të frustrimit dhe perceptimit të privimit nga të mira të caktuara¹⁴⁵. Ky përcaktim e lidh destabilitetin politik me një gjendje të rënduar psikologjike të shoqërisë e cila prodhohet nga mungesa e zotërimit apo aksesit ndaj të mirave apo shërbimeve publike. Frustrimi i prodhuar nga kjo gjendje sipas pikëpamjes social-psikologjike prodhon destabilitet politik.

Pra, në një mënyrë, stabiliteti si koncept është i lidhur ngushtësisht me kontekstin social të cilit i referohet, e padyshim edhe me dinamikat e brendshme të shoqërisë, mënyrës së ndërveprimit midis individëve e aktorëve të tjerë socialë, nivelit të integritetit të tyre me strukturat sociale, politike dhe ekonomike, etj. Nëpërmjet këtyre dinamikave dhe elementëve, individët krijojnë, ndërmjetësojnë dhe përfaqësojnë role të ndryshme, duke i dhënë kuptim strukturës së përgjithshme të politisë. Pra, nën një perspektivë të tillë të të parit të stabilitetit politik, analiza kalohet në një nivel më të përgjithshëm, e rrjedhimisht më të lidhur me individin. I parë nga ky këndvështrim, stabiliteti politik kuptohet më mirë ‘si një strukturë e sjelljes politike e fokusuar në marrëdhënien ndërmjet përfaqësimit institucional të roleve e strukturave dhe konstruksionit të tyre social në ndryshim të vazhdueshëm, ose si shkalla në të cilën formalja dhe informalja përputhen me njëra tjetrën’¹⁴⁶. Ky përkufizim i stabilitetit politik mund të përkthehet ndryshe ‘sa më e ngushtë korrespondenca ndërmjet formales dhe informales brenda një objekti politik, aq më e madhe rregullsia e saj dhe aq më të pakta përçarjet; pra stabiliteti perfekt është

¹⁴² Taylor, M., Herman, M.V., (1971), ‘Party systems and government stability’, *The American Political Science Review*, Vol. 65(1):28-37, fq. 29.

¹⁴³ Alesina, A. Ozler, S. Roubini, N. Swagel, P., (1996), ‘Political instability and economic growth’, *Journal of Economic Growth*, Vol. 1(2): 189-211, fq.3.

¹⁴⁴ Olson, M., (1982), *The Rise and Decline of Nations: Economic Growth, Stagflation, and Social Rigidities*, Nju Haven: Yale University Press.

¹⁴⁵ Feierabend, V. I. Feierabend, R. L., (1966), ‘Aggressive behaviours within polities, 1948-1962: A cross national study’, *Journal of Conflict Resolution*, Vol. 10(3):249-271.

¹⁴⁶ Margolis, J. E., (2010), ‘Civil Wars’, *Understanding political Stability and Instability*, Vol. 12 (3): 326-345, fq. 342.

korrelacioni i plotë; destabiliteti perfekt është mungesa totale e korrelacionit¹⁴⁷. Rrjedhimisht, konteksti vendor ku ndërveprojnë formalja e informalja është përcaktues në vlerësimet e mëtejshme të stabilitetit politik dhe tipeve të mundshme të shfaqjes së tij. Për akomodimin dhe bashkëveprimin ndërmjet formales dhe informales, sipas Margolis¹⁴⁸, shtetet fokusohen në katër dinamika kryesore stabilizuese: duke përdorur autoritetin, duke shfaqur aftësi ripërtëritëse dhe reformuese, nëpërmjet legjitimitetit, dhe nëpërmjet tendencave për t'u zëvendësuar. Dështimi i një shteti në njërin apo tjetrën nga këto dinamika bëhet përcaktues i llojeve kryesore të destabilitetit, të cilat Margolis i identifikon si më poshtë¹⁴⁹:

- Kriza e autoritetit, e cila i referohet paaftësisë së shtetit për të mbajtur rendin, e cila mund të shfaqet nëpërmjet formave si: grushtet e shtetit, konfliktet për shkëputje, luftrat civile, etj.
- Kriza e përshtatjes, e cila lidhet me paftësinë e shtetit për të rirregulluar formatin e marrëdhënieve me shoqërinë, e shprehur kryesisht në dështimin e shtetit e të politikave të tij.
- Kriza e legjitimitetit e cila i referohet perceptimit mospranues të qytetarëve, të cilët e shohin formatin qeverisës pa të drejta për të qeverisur, zakonisht të shprehur nëpërmjet: protestave, revolucioneve, e rebelimeve.

Kjo perspektivë e të parit të konceptit të stabilitetit na orienton drejt një lidhjeje të mundshme midis kohezionit social si dhe konceptit të stabilitetit politik. Kjo sepse, prezenca e konfliktit, dhunës, qëndrimeve të kundërta e jo të pajtueshme si shfaqje të destabilitetit politik, cenojnë kohezionin social. Koncepti i kohezionit social është një ndër më të diskutuarit në literaturën e shkencave sociale. Gjithsesi, ai ofron një vlerësim në nivelin makro të sistemit social duke ndihmuar në një analizë më të plotë edhe të stabilitetit politik.

Dy janë traditat kryesore që trajtojnë konceptin e kohezionit social. E para përfaqësohet nga një qasje sociale dhe social-psikologjike e vlerësimit të kohezionit, ndërsa qasja e dytë e sheh këtë koncept nga pikëpamja e qeverisjes dhe politikëbërjes. E përbashkëta e analizave social-psikologjike është se ato e vendosin konceptin e kohezionit social 'në thelb të çështjeve të rëndësishme si integrimi social, disintegrimi dhe stabiliteti'¹⁵⁰. Pra, i parë në nivel sistemi, kohezioni social shihet si një kontribuues në stabilitetin e sistemit dhe qëndrueshmërinë e tij. Nga ana tjetër, referenca tek kohezioni social, veçanërisht kohët e fundit, lidhet edhe me dinamikën e procesit të qeverisjes apo të ashtuquajturat 'qeverisjet e reja'. Të ndërgjegjshëm për ndryshimet sociale brenda shteteve, rritjes së kulturave e etnive, e bashkë me to edhe të krijimit të fraksioneve brenda sistemeve sociale, qeveritë shtetërore kanë parë të nevojshme ridimensionimin e mënyrës dhe drejtimit të qeverisjes. Ky ridimensionim e konsideron konceptin e kohezionit social si një përgjigje ndaj ndasive dhe përplasjeve sociale të shoqërive moderne. Si i tillë, i vendosur në qendër të axhendës së politikës, kohezionin e shohim të shfaqur nëpërmjet këtyre tre elementëve: 'së pari, promovimi i besimit ose 'solidaritetit' së bashku me politikat tradicionale ekonomike; së dyti, pranimi se procesi i pjesëmarrjes ka po aq

¹⁴⁷ *ibid.*, fq. 332.

¹⁴⁸ *ibid.*, fq. 16.

¹⁴⁹ Margolis, *op.cit.*, fq. 17-18.

¹⁵⁰ Chan, J., To, H. P. Chan, E., (2006), 'Reconsidering social cohesion: developing a definition and analytical framework for empirical research', *Social Indicators Research*, Vol. 75(2): 273-302, fq. 275.

rëndësi sa edhe rezultati; së treti, konsiderimi i një qasjeje më holistike ndaj hartimit dhe koordinimit të politikës publike'¹⁵¹. Në përpjekjen për të ofruar një përkufizim të plotë që të kapë çështjen e kohezionit social, Chan *et al.* e konsiderojnë atë (kohezionin social) si 'një gjendje e cila përfshin ndërveprimet horizontale dhe vertikale ndërmjet anëtarëve të shoqërisë të karakterizuara nga një bashkësi qëndrimesh dhe normash që përfshijnë besimin, ndjenjë e përkatësisë dhe gatishmërinë për të bashkëpunuar dhe ndihmuar, si dhe manifestimet e sjelljes së tyre'¹⁵².

Së fundmi, nëse do të tentonim të kryenim një vlerësim të përgjithshëm të koncepteve dhe mënyrave prej nga prezantohet dhe analizohet stabiliteti (destabiliteti) politik shohim se mbizotërojnë dy rryma apo këndvështrime të përgjithshme: e para i referohet trajtesës dhe prezantimit të stabilitetit politik apo mungesës së tij kryesisht nëpërmjet shfaqjeve të dhunshme sociale me orientim të dyanshëm nga sistemi politik drejt shoqërisë dhe anasjelltas (Hibbs, Bollen dhe Jones, Mishler dhe Hildreth, Douglas dhe Hibbs, etj), dhe këndvështrimi i dytë e identifikon këtë fenomen politik bazuar në karakteristika të veçanta të kuadrit institucional të sistemit politik, e mënyrës se si prodhohen produktet e tij (outputet) publike në terma të: legjitimitetit, përshtatshmërisë, aftësisë për të akomoduar përplasjen ndërmjet formales dhe informales, perceptimit në lidhje me të mirat publike të prodhuara nga sistemi politik, kohezionit social, si dhe të elementëve të brendshëm të formatimit të sistemit politik si: përbërja e koalicioneve, sistemi partiak, e rolin e opozitës, (Gurr, Bunce, Cukierman *et al.*, Taylor dhe Herman, Olson, Feirabands, etj).

Gjithashtu, duke u bazuar në trajtesën e deritanishme të përkufizimeve të stabilitetit politik vërejmë se, ashtu si shumë koncepte e fenomene të lëmit të sociale e politikës, ky koncept është e vështirë të kapet nëpërmjet një përkufizimi të vetëm në shumëllojshmërinë e formave nëpërmjet së cilave shfaqet. Të qenit një koncept abstrakt e kompleks rrit në të njëjtën kohë vështirësinë e operacionalizimit të tij nëpërmjet treguesve kuantifikues (trajtesa e të cilëve bazuar në kontributin studimor të shumë studiuesve do të vijojë më poshtë). Megjithatë, duke marrë në konsideratë hulumtimin e mësipërm dhe shumëllojshmërinë e elementëve që shpjegojnë këtë fenomen, ne tentojmë në prodhimin e një përkufizimi të tij, bazuar edhe në kontributin kryesor të Hurwitz¹⁵³ dhe të studiuesve të tjerë të trajtuar më sipër, duke e konsideruar stabilitetin politik si një fenomen apo shfaqje politike, e cila në kontekstin shtetëror nënkupton mungesën e dhunës, jetëgjatësinë e qeverisjes, mungesën e ndryshimeve strukturore, legjitimitetin dhe vendimarrjen efektive. Apo e kundërta, destabilitetin politik e shohim si një fenomen brenda një konteksti të caktuar social-shtetëror, ku përgjatë një periudhe të caktuar kohore prodhohen shfaqje të ndryshme të dhunës, të cilat mund të reflektohen në kabinetin qeveritar e më gjerë në strukturimin e sistemit politik të një vendi.

Natyrisht, në konceptin e stabilitetit apo destabilitetit politik prezantohen edhe dy tipare të tjera sic janë: ndryshueshmëria në kohë e ndryshueshmëria ndërmjet vendeve. Nivelet e stabilitetit politik ndryshojnë me kalimin e kohës në varësi të ndryshorëve të tjerë socialo-ekonomikë, e po kështu në vende të ndryshme në kohë të ndryshme evidentohen nivele të ndryshme të tij.

¹⁵¹ *ibid.*, fq. 279.

¹⁵² *ibid.*, fq.298.

¹⁵³ Hurwitz, *op.cit.*, fq. 461-463.

2.4.1 Treguesit dhe modelet në studimin e stabilitetit politik

Në gjuhën e teorisë së sistemeve, e cila shihet si një nga shpjegueset e realitetit shumëdimensional, ‘integrimi dhe vetëm integrimi i niveleve dhe sistemeve është e vetmja mënyrë që mund të shpjegojë socialen’¹⁵⁴. I ngritur mbi lloje të ndryshme nivelesh e nënsistemesh të tjera, sistemi, e rrjedhimisht edhe socialja, përbën njësinë bazë të zhvillimit të marrëdhënieve e proceseve, prej të cilave rezultojnë e gjenerohen ngjarje, fenomene, dukuri, procese e marrëdhënie të tjera. Analiza e secilit prej këtyre elementëve nuk mund të zhvillohet kurrsesi pa marrë në konsideratë kontekstin e marrëdhëniet shkak-pasojë prej së cilave prodhohen këto elementë. Paralelisht, kjo realizohet nga ana e studiuesve nëpërmjet aplikimit të qasjeve teorike e empirike.

Qasjet teorike, nën objektin studimor të këtij punimi ofrojnë bazën e trajtimit dhe analizës së çështjes së stabilitetit politik dhe marrëdhënieve të tij shkakësore me variabla të sistemit social e atij ekonomik. Megjithatë, përveç analizave të tilla të një karakteri përshkruar dhe horizontal, një kontribut të rëndësishëm në studime të fenomeneve si stabiliteti politik apo procese e elementë të tjerë përfaqësues të sistemit politik ofron edhe literatura empirike. Kjo e fundit, duke testuar marrëdhënien reale midis variablave, ndihmon në ofrimin e një perspektive vertikale e me thellësi studimore në plotësimin e shqyrtimit të çështjes.

Në këtë kontekst, të shumta janë studimet empirike për destabilitetin apo stabilitetin e sistemit politik. Megjithatë, pavarësisht shumësisë së modeleve empirike për këtë çështje, ka shumë pak dakortësi apo marrëveshje për matjen më të mirë të destabilitetit politik. Kjo, sepse studimet ndryshojnë në përkufizimin që marrin në konsideratë për destabilitetin politik, duke filluar nga përkufizimet më të ngushta të të parit të destabilitetit si ‘tendenca për ndryshimin e qeverisë’ (Alessina et al, 1996) e deri në konsiderimin e destabilitetit si një bashkësi treguesish të ndryshëm. Problemi kryesor me fokusimin tek një konceptim i ngushtë i destabilitetit politik qëndron edhe tek vështirësia e matjes së këtij fenomeni. Jo vetëm kaq, por edhe gjasat për një trajtim subjektiv në këtë rast rriten duke qënë se varet nga zgjedhja e studiuesit, perspektiva dhe dimensionin nga do të trajtohet koncepti. Nga ana tjetër, analiza e konceptit si një ndërthurje treguesish, shton nivelin e kompleksitetit të shqyrtimit, por në të njëjtën kohë prodhon edhe nivele më të larta objektiviteti.

Kështu, në një studim prej 18 vendesh të Amerikës Latine nga viti 1971 deri në vitin 2000, Blanco dhe Grier studiojnë përcaktuesit apo shkaqet e destabilitetit politik në këto vende. Ata marrin në konsideratë konceptin e destabilitetit si ‘një bashkim i nëntë treguesve të ndryshëm, si: vrasjet, grushtet e shtetit, krizat qeveritare, demonstratat kundër qeverisë, protestat, grevat, spastrimet, aktivitetin e gueriljeve dhe revolucionet’¹⁵⁵. Nëpërmjet modelit të tyre, autorët e sipërpërmendur arrijnë në disa rezultate të rëndësishme. Së pari, lloji i regjimit rezulton të jetë përcaktues i rëndësishëm në praninë apo jo të destabilitetit, ku vlerësohet se regjimet demokratike prodhojnë më pak destabilitet politik. Nga ana tjetër, po kështu pabarazia e të ardhurave, fraksionalizmi

¹⁵⁴ Duma, G., (2011), *Cikël leksionesh: Teoritë e kuptimit dhe adminsitrimin të sistemeve*, fq.10.

¹⁵⁵ Blanco, L. Grier, R., (2007), ‘Long live democracy: the determinants of political instability in Latin America’, *Journal of Development Studies*, Vol. 45(1): 76-95, fq. 77.

entik dhe rritja ekonomike, sipas modelit të Blanco dhe Grier prodhojnë ndikime jolineare në destabilitetin politik të një vendi¹⁵⁶.

Nga ana tjetër, Alessina *et al.*, në modelin e tyre empirik nëpërmjet një sistemi dy-ekuacionësh, përdorin një kampion më të madh prej 113 vendesh për periudhën 1950-1982, përgjatë së cilës vlerësojnë marrëdhënien ndërmjet rritjes ekonomike dhe destabilitetit politik. Analiza e tyre fillon duke marrë në konsideratë përcaktimin e destabilitetit politik si ‘tendenca për ndryshimin e ekzekutivit, nëpërmjet mjeteve ‘kushtetuese’ ose ‘jokushtetuese’¹⁵⁷.

Cukierman *et al.*, ndërtojnë një model matës të stabilitetit politik duke përdorur tre grupe variablash shpjegues. Ndër to, autorët përdorin një grup variablash ekonomike për matjen e performancës ekonomike të qeverisë, grupin e variablove politike në të cilin përfshihen elementë si: protestat, represionet e qeverisë, rregullimet në përbërjen e qeverisë të cilat nuk rezultojnë në ndryshim të saj, përpjekjet për ndryshimin e qeverisë, dhe periudha kohore e matur në vite prej së cilës ka ndodhur ndryshimi i qeverisë; si dhe grupin e tretë të variablove strukturorë, në të cilin përfshijnë demokracinë, PBB-në, zgjedhjet, dhe formën e qeverisjes¹⁵⁸.

Taylor dhe Herman (1971) në studimin e stabilitetit të qeverisë fokusohen në një kampion prej 196 shtetesh për periudhën nga paslufta deri në vitin 1969. Variablat e pavarur që këta autorë marrin në konsideratë për shpjegimin e niveleve të stabilitetit të qeverisë janë: sistemi partiak në parlament, përbërja e qeverisë (në kuptimin e partive politike që janë pjesë e saj), si dhe roli i opozitës në parlament, e parë kjo nga numri i partive politike që janë pjesë e opozitës (opozitë një apo shumë partiake). Në testimin e hipotezave në lidhje me varësinë e stabilitetit politik nga këto variabla Taylor dhe Herman arrijnë në përfundimin se: ‘ekziston një nivel i lartë lidhjeje ndërmjet stabilitetit qeveritar dhe nivelit të fraksionalizimit të sistemit partiak, qeveritë një partiake ishin në mënyrë të ndjeshme më stabël sesa qeveritë koalicionare, si dhe niveli i fraksionalizimit të opozitës apo numri i partive në përbërje të saj nuk kishin ndikim të ndjeshëm tek stabiliteti i qeverisë’¹⁵⁹.

Campos dhe Nugent në studimin e destabilitetit politik për 98 vende në zhvillim marrin në konsideratë dy nivele të destabilitetit politik për t’i përfshirë në model: destabilitetin politik të një ‘niveli të lartë’ dhe destabilitetin politik të moderuar. Në të parin, ata e operacionalizojnë konceptin nëpërmjet treguesve, si: numri i vrasjeve politike, revolucionet, dhe grushtet e suksesshme të shtetit, ndërsa destabilitetin e moderuar e vlerësojnë në terma të konkurueshmërisë dhe rregullimit të pjesëmarrjes politike, rregullimit, nivelit të hapjes së rekrutimeve në ekzekutiv, si dhe pavarësisë ligjore dhe operacionale të kreut të ekzekutivit¹⁶⁰.

¹⁵⁶ *ibid.*, fq. 77.

¹⁵⁷ Alesina, Ozler, Roubini, Swagel, *op.cit.*, fq. 3.

¹⁵⁸ Cukierman, Edwards, Tabellini, *op.cit.*, fq. 545-546.

¹⁵⁹ Taylor, Herman, *op.cit.*, fq. 37.

¹⁶⁰ Campos, F. N. Nugent, B. J., (2002), ‘Who is afraid of political instability’, *Journal of Development Economics*, Vol. 67: 157-172, fq. 159.

Goldstone *et al.*, (2010) kanë dhënë një kontribut të vyer në literaturën akademike në lidhje mundësinë e parashikimit të stabilitetit politik në rend botëror. Në analizën e tyre, koncepti i destabilitetit politik konsiderohet nga treguesi i ekzistencës së konfliktit dhe vlerësimit të ekspertëve në lidhje me një situatë të tillë¹⁶¹. Rrjedhimisht, për ta destabiliteti politik ekziston atje ku ka konflikt. Modeli i tyre zhvillohet nëpërmjet katër variablove të pavarur, si: lloji i regjimit i specifikuar si i tillë bazuar në tiparet e shfaqura në procesin e rekrutimit të ekzekutivit dhe konkurrueshmërisë së pjesëmarrjes politike, vdekshmëria foshnjore, treguesi i konfliktit të mundshëm rajonal si dhe nga diskriminimi politik ose ekonomik në nivel shtetëror. Si rrjedhojë, autorët ritheksojnë rëndësinë e institucioneve (karakteristikave të mirëspecifikuara të regjimit politik) më shumë se sa faktorëve ekonomikë në destabilitetin politik. Në këtë kontekst, Goldstone *et al.*, evidentojnë se ‘demokracitë e plota janë regjimet më stabël, ndërsa regjimet më të rrezikshme dhe jo stabël janë demokracitë e pjesshme të cilat karakterizohen nga kombinime të elementëve të demokracive dhe autokracive’¹⁶². Përcaktimi që këta autorë bëjnë në lidhje me kategorizimin e vendeve si plotësisht apo pjesërisht demokratike bazohet në tre tregues: masa në të cilën përzgjedhja e liderit politik është e hapur dhe konkurruese; shkalla në të cilën konkurrenca politike nuk është e dhunshme, nuk është e detyrueshme, dhe e pakufizuar; dhe niveli në të cilin pushteti ekzekutiv është i kufizuar nga institucione më të mëdha qeverisëse¹⁶³.

Duff dhe McCamant (1968) në përpjekjen për të vlerësuar stabilitetin e sistemit politik në vende të Amerikës Latine (19 të tilla, të marra në krahasim të vlerave me njëra-tjetrën), evidentojnë disa kritere të cilat iu atribuohen demokracive stabël. Si të tilla, ata identifikojnë: ekzistencën e niveleve më të larta të mirëqënies sesa mobilizimi social, normën e lartë të rritjes ekonomike, shpërndarjen e barabartë së të ardhurave, kapacitetin e lartë politik, si dhe partitë politike me veprimtari të gjerë e të institucionalizuar¹⁶⁴. Në vijim, autorët identifikojnë stabilitetin politik si një shprehje të:

$$\text{Stabiliteti i sistemit} = (4x_1 + 2x_2 + 3x_3 + 3x_4) / 12$$

Stabiliteti politik i sistemit shihet si një mesatare e deviacioneve standarde nga mesatarja e Amerikës Latine, ku më specifikisht x_1 është mirëqënia sociale minus mobilizimin social, x_2 është rritja e fundit ekonomike, x_3 është aftësia prodhuese e matur në përqindje të PBB-së të mbledhur nga taksat plus grantet dhe huatë e jashtme të matura në përqindje të PBB-së, ndërsa x_4 është aftësia shpërndarëse e matur si përqindje e PBB-së së shpenzuar në arsimin publik¹⁶⁵. Interesant në këtë vlerësim, ndryshe nga autorët e tjerë është fakti se stabiliteti politik i sistemit shpjegohet nëpërmjet elementëve si: rritja ekonomike, mirëqënia sociale, aftësia shpërndarëse, të cilat në studime të tjera, të para deri tani shihen si varaibla të pavarur ndikues në konceptin e stabilitetit politik. Në rastin

¹⁶¹ Goldstone, Bates, Epstein, Gurr, Lustik, Marshall, Ulfelder, Woodward, *op.cit.*, fq. 191.

¹⁶² Goldstone, J.A. Gurr, T.R. Marshall, M.G. Ulfelder, J., (2004), ‘It’s all about state structure: new findings on revolutionary, origins from global data’, *Homo Oeconomicus*, Vol. 21(3), fq. 429-455, fq.431.

¹⁶³ *ibid.*, fq.431.

¹⁶⁴ Duff, A. E. McCamant, F. J., (1968), ‘Measuring social and political requirements for system stability in Latin America’, *The American Political Science Review*, Vol. 62(4):1125-1143, fq. 1126.

¹⁶⁵ *ibid.*, fq. 1130.

konkret shihen më shumë si tregues dhe përcaktues të konceptit në fjalë. Këtë e prezanton më në detaj tabela e mëposhtme:

Tabela 2.3: Kriteret për/dhe shfaqjet e stabilitetit/destabilitetit të sistemit politik

Sistem stabël		
Kriteret	Shfaqjet	
Mirëqenia > Mobilizimi social. Normë e lartë e rritjes ekonomike. Shpërndarje e barabartë e të ardhurave. Kapacitete të larta politike. Parti politike të institucionalizuara me një bazë të gjerë.	<i>Demokracia</i> Vazhdojnë si demokraci	<i>Diktaturat</i> Jo rritje e shtrëngimit, me opsionin drejt evolucionit në sistem demokratik.
Sistem jo-stabël		
Kriteret	Shfaqjet	
Mirëqenia < Mobilizimi social. Normë e ulët e rritjes ekonomike. Shpërndarje e pabarabartë e të ardhurave. Kapacitete të ulëta politike. Parti politike të ngushta, të personalizuara.	Inflacion. Ndryshime në personel. Rritje e mbështetjes së zgjidhjeve ekstremiste. Dhunë e decentralizuar. Ndërrhyrje ushtarake. Luftë guerile. Revolucion social.	Inflacion. Rritje e nivelit të shtrëngimit. Dhunë e decentralizuar. Grusht shteti. Luftë guerile. Revolucion social.

Burimi: Duff, A. E. McCamant, F. J., (1968), 'Measuring social and political requirements for system stability in Latin America', fq. 1126.

Nga e gjithë kjo trajtesë e modeleve që kanë në qendër të tyre destabilitetin politik, pavarësisht treguesve të ndryshëm në përbërje të tyre, një tjetër çështje shtrohet për vlerësim. Cili është pozicioni i stabilitetit politik në marrëdhënie me elementë të tjerë të karakterit politik dhe ekonomik në një shtet të caktuar?

Kjo pjesë e studimeve, më shumë e shohin dhe vlerësojnë stabilitetin politik si një variabël të varur. 'Arsyeja është e thjeshtë: njerëzit inkurajohen të investojnë dhe të merren me tregëti kur janë të sigurt tek e ardhmja, dhe janë të pakta gjërat që duket se kanë më shumë gjasa për të vënë në pikëpyetje biznesin dhe besimin e konsumatorëve sesa një e ardhme me probleme politike dhe ndryshime të menjëhershme në rregullat e lojës ekonomike'¹⁶⁶.

Një përmbledhje të treguesve përbërës të stabilitetit politik me përshkrimet përkatëse të secilit prej tyre, ku dhe mbështetet pjesa më e madhe e literaturës në lidhje me destabilitetin politik ofrohet nga Cross-National Time-Series Data Archive (Arkiva e të Dhënave Ndër-Shtetërore në Seri). Tabela e mëposhtme ofron një paraqitje të këtyre treguesve të destabilitetit me përshkrimet përkatëse:

Tabela 2.4: Përshkrimi i treguesve të destabilitetit politik

Variabëli	Përcaktimi i Cross-National Time-Series Data Archive
Grusht shteti	'Numri i ndryshimeve jashtë-kushtetuese ose ndryshimeve të detyruara në elitën qeverisëse dhe/ose kontrolli i saj efektiv i strukturës së fuqisë së një vendi në një vit të caktuar.'
Krizë qeveritare	'çdo zhvillim i shpejtë situatë që kërcënon të rrëzojë

¹⁶⁶ Goldsmith, *op.cit.*, fq. 471.

	regjimin aktual- duke përjashtuar rastet e revoltave që kanë si synim këtë rrëzim'
Revolucion	'çdo ndryshim ilegal ose i detyruar në elitën drejtuese qeverisëse, çdo përpjekje për një ndryshim të tillë, ose çdo rebelim i armatosur i suksesshëm ose jo i suksesshëm qëllimi i të cilit është pavarësia nga qeveria qendrore.'
Demonstrata anti-qeveritare	'çdo mbledhje publike e paqshme e së paku 100 personave për qëllimin kryesor të paraqitjes ose prezantimit të kundërshtimit të tyre ndaj politikave të qeverisë ose autoritetit, duke përjashtuar demonstratat me natyrë të dukshme kundër të huajve.'
Rebelim (trazira)	'çdo demonstratë e dhunshme ose përplasje e më shumë se 100 personave duke përfshirë edhe përdorimin e forcës fizike.'
Grevë e përgjithshme	'çdo grevë e 1,000 ose më shumë punëtorëve të industrisë apo shërbimeve që përfshin më shumë se një punëdhënës dhe që i drejtohet politikave shtetërore qeverisëse ose autoritetit.'
Luftë guerilase	'çdo aktivitet i armatosur, sabotim, ose bombardime të realizuara nga banda të pavarura qytetarësh ose forca të parregullta dhe që ka qëllim rrëzimin e regjimit aktual.'
Spastrim	'çdo eliminim sistematik nëpërmjet burgosjes ose ekzekutimit të opozitës politike brenda rangjeve të regjimit ose të opozitës.'
Vrasje	'çdo vrasje politike e motivuar ose tentativë vrasje e një zyrtari qeveritar të lartë ose e një politikani.'

Burimi: Blanco dhe Grier, (2009), fq.80, (bazuar në Cross National Time Series Data).

2.4.2 Indekset për matjen e stabilitetit politik

Analiza e konceptit të stabilitetit politik, përveç paraqitjes së përkufizimit të këtij koncepti dhe treguesve me të cilët ai shihet i lidhur, bën të nevojshme prezantimin edhe të mënyrave të matjes së tij. Rrjedhimisht, përveç shumësisë së qasjeve, treguesve të përdorur e rrjedhimisht edhe përkufizimeve të stabilitetit politik, të shumtë janë edhe indekset për matjen e niveleve të tij të cilat gërshetojnë në mënyra të ndryshme tregues të ndryshëm. Për këtë, institucione të ndryshme ndërkombëtare si dhe projekte të tjera studimore, nëpërmjet vlerësimeve përgjatë kohës, kanë mundur prodhimin e indekseve të ndryshme prej nga ku ofrojnë të dhëna sasiore të niveleve të stabilitetit politik për një vend të vetëm, rajon, apo për pjesën më të madhe të vendeve të botës. Këto të dhëna shërbejnë edhe si bazë për analiza të tjera, sidomos të vlefshme për studimin e marrëdhënieve ndërmjet këtij fenomeni e variablave të tjerë me karakter social dhe ekonomik. Për këtë, Global Observatory vlerëson se 'indekset i shtohen dijes botërore dhe ofrojnë një lexim të thjeshtë të trendeve dhe ndryshimeve, që ndryshe do të kërkonin analizën e një sasi të madhe të dhënash'¹⁶⁷. Sidoqoftë, nisur nga burimet e ndryshme prej nga ku institutet e projektet marrin të dhënat, si dhe modelet e ndryshme përpunuese të tyre, edhe indekset e stabilitetit politik ndryshojnë nga njëra-tjetra për nga mënyra se si konceptohet indeksi, si dhe nga mënyra apo metodologjia e përdorur në studimin e tij. The Economist Intelligence Unit e konsideron indeksin e stabilitetit politik si tregues të 'niveletit të kërcënimit ndaj qeverisë nga protestat sociale'¹⁶⁸. Në të njëjtën linjë të rrezikut

¹⁶⁷ Global Observatory, *Catalogue of indices*, i gjendshëm në:
<<http://www.theglobalobservatory.org/indices.html#conflict>>

¹⁶⁸ The Economist Intelligence Unit, *Social Unrest*, i gjendshëm në:
<http://viewswire.eiu.com/site_info.asp?info_name=social_unrest_table&page=noads>

që ekziston ndaj qeverisë dhe qëndrueshmërisë së saj, Banka Botërore përcakton se indeksi i stabilitetit politik dhe i mungesës së dhunës mat 'perceptimet e mundësisë për destabilizim të qeverisë nëpërmjet mjeteve të dhunshme e jokushtetuese, duke përfshirë këtu dhunën e brendshme dhe terrorizmin'¹⁶⁹.

Nëse iu referohemi disa indekseve kryesore të stabilitetit politik do të evidentonim kryesisht kontributin e katalogut të indekseve të Global Observatory: Analysis on Global Issues (Analiza mbi Çështjet Botërore), Qendrës për Politikën Botërore (Center for Global Policy), si dhe Bankës Botërore (Worldwide Governance Indicators WGI, Treguesit Botërorë të Qeverisjes). I pari¹⁷⁰, realizon një përmbledhje të indekseve kryesore të destabilitetit politik brenda kategorisë së parë të konfliktit, brishtësisë dhe destabilitetit politik në të cilën përfshihen: Failed State Index (Indeksi i Dështimit të Shtetit) (The funds for Peace), Global Peace Index (Indeksi Botëror i Paqes) (Institute of Economics and Peace), Peace and Conflict Instability Ledger (Matësi i Destabilitetit i Paqes dhe Konfliktit) (University of Maryland), Political Instability Index (Indeksi i Destabilitetit Politik) (The Economist Intelligence Unit), State Fragility Index (Indeksi i Brishtësisë së Shtetit) (George Mason University), si dhe Country Indicators for Foreign Policy: Failed and Fragile States (Treguesit Shtetërorë për Politikën e Jashtme: Shtetet e Dështuara dhe të Brishta) (Carleton University, The Norman Paterson School of International Affairs). Nga ana tjetër, Qendra për Politikën Botërore¹⁷¹, ofron të dhëna të rëndësishme në bazë të studimeve kërkimore për çështje të politikës botërore, përfshirë këtu edhe të dhënat për destabilitetin politik, nëpërmjet tre dimensioneve kryesore: projektit Polity IV i cili fokusohet në karakteristikat e regjimeve, Indeksit të Brishtësisë së Shtetit (State Fragility Index), dhe projektit të Task Forcës së Destabilitetit Politik (Political Instability Task Force, PITF). Së fundi, Instituti i Bankës Botërore¹⁷² ofron vlerësime të stabilitetit politik për çdo vend prej vitit 1996, nëpërmjet Treguesve të Qeverisjes nëpër Botë (WGI, 1996-2012). Nëse do të realizonim një kategorizim të këtyre indekseve do të identifikonim dy orientime kryesore: së pari, indekse të stabilitetit/destabilitetit politik të cilat bazohen në të dhëna të regjistruara bazuar në ngjarjet, proceset, dhe fenomenet prej nga ku niset operacionalizimi i konceptit (pjesa më e madhe e katalogut të indekseve të Observatorit Botëror, Polity IV, PITF-ja, Indeksi i Brishtësisë së Shtetit, etj); dhe së dyti, indekse të cilat prodhojnë informacione në lidhje me po të njëjtin fenomen, por të ndërtuara mbi qëndrime, pritshmëri, opinione ekspertësh, etj (përfshirë këtu edhe indekset e World Governance Indicators, The Economist Intelligence Unit).

Tabela e mëposhtme ofron një përmbledhje të indekseve të stabilitetit politik, evidentim të mënyrës se si ndërtohen ata dhe konceptit specifik prej nga nisen në mbledhjen e të dhënave.

¹⁶⁹ Banka Botërore, *Political Stability*, i gjendshëm në:

<<http://info.worldbank.org/governance/wgi/pdf/pv.pdf>>

¹⁷⁰ Global Observatory, *Catalogue of indices*, i gjendshëm në:

<<http://www.theglobalobservatory.org/indices.html#conflict>>

¹⁷¹ Center for Global Policy, <<http://globalpolicy.gmu.edu/>>

¹⁷² The World Bank Group, (2012), *Worldwide Governance Indicators*, <<http://info.worldbank.org/governance/wgi/index.asp>>

Tabela 2.5: Përmbledhje e Indekseve të Stabilitetit Politik

Indeksi	Çfarë mat	Metodologjia	Konceptimi i Indeksit
Failed State Index ¹⁷³ (Indeksi i Dështimit të Shtetit)	Riskun e destabilitetit ose dhunës për 177 shtete.	Cilësore dhe sasiore (grumbullim të dhënash, raportesh, dokumentesh të përditshme dhe përpunim nëpërmjet softuerit CAST)	12 indikatorë socialë, ekonomikë e politikë si: presionet demografike, refugjatët, zhvillim i pabarabartë, varfëria dhe rënia ekonomike, legjitimiteti i shtetit, shërbimet publike, të drejtat e njeriut, aparati i sigurimit, elitat e fraksionalizuara, ndërhyrja e jashtme, ankesë në grup dhe konflikt human.
Peace and Conflict Instability Ledger ¹⁷⁴ (Matësi i Destabilitetit i Paqes dhe Konfliktit)	Riskun e destabilitetit ose të një konflikti të armatosur për 163 shtete.	Cilësore dhe sasiore (të dhëna nga ekspertët si dhe informacion statistikor)	5 indikatorë ku përfshihet: qëndrueshmëria institucionale, niveli i hapjes së ekonomisë, norma e vdekshmërisë foshnjore, militarizimi, siguria nga fqinjët.
Political Instability Index ¹⁷⁵ (Indeksi i Destabilitetit Politik)	Prekshmerinë e shtetit nga problemet sociale për 165 shtete	Përdorimi i modelit të prodhuar nga PITF.	Bashkim i dy indekseve: <i>indeksi i cënueshmërisë ekzistuese të shtetit</i> (pabarazia, historia e shtetit, korrupsioni, fragmentimi etnik, besimi në institucionet, statusi i minoriteteve, historia e destabilitetit politik, trazira nga forca punëtore, niveli i ofrimit social, shtetet fqinje, lloji i regjimit, lloji i regjimit dhe fraksionalizimi) dhe <i>problemet ekonomike</i> (rritja në të ardhurat, papunësia, niveli i të ardhurave për frymë).
Country Indicators for Foreign Policy: Failed and Fragile States ¹⁷⁶ (Treguesit Shtetërorë për Politikën e Jashtme:	Brishtësinë shtetërore (diferencën ndërmjet karakteristikave aktuale të shtetit nga	Analizë e të dhënave bazuar në nivelet: të dhëna strukturore, të dhëna të bazuara nga ngjarjet, anketime të	75 indikatorë të ndarë në gjashtë kategori kryesore: qeverisje, ekonomiks, siguri dhe krim, zhvillimi njerëzor, demografia, dhe

¹⁷³ The Fund for Peace, <<http://global.fundforpeace.org/>>

¹⁷⁴ Hewitt, J. J. Wilkenfeld, J. Gurr, R. T., *Peace and Conflict 2012*, Center for International Development and Conflict Management, <http://www.cidcm.umd.edu/pc/executive_summary/exec_sum_2012.pdf>

¹⁷⁵ The Economist Intelligence Unit, <http://viewswire.eiu.com/index.asp?layout=VWArticleVW3&article_id=874361472>

¹⁷⁶ Carment, D. Samy, Y., (2012), 'Assesing state failure: a country indicators for foreign policy report', *Country Indicators for Foreign Policy*, <<http://www4.carleton.ca/cifp/app/serve.php/1407.pdf>> ; <<http://www4.carleton.ca/cifp/>>

Shtetet e Dështuara dhe të Brishta)	gjendja e tyre ideale) për 197 vende.	ekspertëve dhe në terren.	mjedisi.
Political Instability Task Force ¹⁷⁷ , PITF (Task Forca e Destabilitetit Politik)	Prekshmërinë e shteteve nga shfaqja e destabilitetit politik e dështimit të shtetit të para nëpërmjet shfaqjes së lufrave revolucionare ose etnike, ndryshimeve të kundërta të regjimit, dhe genocidit.	Vlerësim rastesh i konsoliduar dhe kompleks i shteteve në baza vjetore.	Të dhëna vjetore mbi raste të luftës etnike, luftës revolucionare, ndryshimeve të kundërta të regjimit, dhe genocidit/politicitit, sipas indikatorëve vjetorë si: numri i rebelëve, zona e prekur, dhe numri i vdekjeve.
State Fragility Index ¹⁷⁸ (Indeksi i Brishtësisë së Shteteve)	Brishtësinë e shteteve në terma të: kapaciteteve shtetërore për të menaxhuar konfliktin, hartimin e zbatimin e politikave publike, aftësinë ripërtëritëse në mbajtjen e koherencës, kohezionit të sistemit e cilësinë e jetës, për 165 vende.	Caktimi i vlerave kufi për të mundësuar krahasimin e indikatorëve dhe indekseve përbërës.	Vlerësimi i dy inekseve përbërës: <i>efektiviteti dhe legjitimiteti</i> të përbërë secili nga kategoritë e indikatorëve të sigurisë, politikës, ekonomikë e socialë.
Stabiliteti Politik dhe Mungesa e Dhunës (Worldwide Governance Indicators, Banka Botërore) ¹⁷⁹	Perceptimin e gjasave të destabilitetit të qeverisë nëpërmjet mjeteve të dhunshme	Përdorimi i modelit të elementëve të pavëzhguar, për të prodhuar informacion kardinal ¹⁸⁰ .	Matës i përbërë nga tetë indikatorë të tjerë të prodhuar nga agjenci të ndryshme të fokusuara në: profilin e institucioneve, kushtet e biznesit dhe konkureshmërisë, riskun politik, normat e sigurisë së vendit dhe të dhënat e Economist Intelligence Unit në lidhje me stabilitetin politik.

Nëpërmjet kësaj sinteze mund të mbërrijmë edhe në një vlerësim paralel nëpërmjet kategorizimit të indekseve të stabilitetit politik dhe përkufizimit fillestar të marrë në konsideratë për këtë fenomen nga institucionet apo projektet që prodhojnë indekset.

¹⁷⁷ Center for Global Policy, <<http://globalpolicy.gmu.edu/political-instability-task-force-home/>>

¹⁷⁸ Marshall, G. M. Cole, R. B., *State Fragility Index and Matrix 2011*, Center for Global Policy, <http://www.systemicpeace.org/SFI/matrix2011c.pdf>

¹⁷⁹ The World Bank Group, (2012), *Worldwide Governance Indicators*, <<http://info.worldbank.org/governance/wgi/resources.htm>>

¹⁸⁰ Kaufman, D. Kraay, A. Mastruzzi, M., (2010), 'The worldwide governance indicators: methodology and analytical issues', *Policy Research Working Paper 5430*, Grupi i Kërkimit për Zhvillim i Bankës Botërore, fq.16.

Vëmë re se qasja kryesore që mbizotëron në ndërtimin e këtyre indekseve është të parit e konceptit të stabilitetit politik kryesisht nëpërmjet ekzistencës apo jo të shfaqjeve të dhunshme në një vend të caktuar. Kjo reflektohet nga treguesit kryesorë të përdorur në ndërtimin e indekseve nga institucionet apo projektet e ndryshme. State Fragility Index, PITF, Peace and Conflict Instability Ledger dhe Country Indicators for Foreign Policy: Failed and Fragile States, Stabiliteti Politik dhe Mungesa e Dhunës, në ndërtimin e indeksit të stabilitetit politik vlerësojnë sigurinë ndër treguesit kryesorë. Qasja tjetër mbizotëruese është ajo e përqëndrimit tek një konceptim i stabilitetit politik kryesisht i bazuar në karakteristikat e sistemit politik të një vendi në pikëpamje të legjitimitetit, institucioneve, elitave e elementë të tjerë brenda sistemit.

Një panoramë prezantuese të niveleve dhe trendeve të destabilitetit politik prej viteve 1960' në rajone të ndryshme (Afrika, Azia, Evropa Lindore, Hemisfera Perëndimore, Vende të veçanta) ofron edhe Databanks International në grafikun e mëposhtëm:




Figura 2.2: Destabiliteti politik nëpër botë

Burimi: Databanks International, 2007 (bazuar tek Aisen, A. Veiga, J.F., (2011))

Megjithatë, si karakteristikat që shfaq sistemi politik, ashtu edhe mënyrat e shfaqjes të dinamikave të tij, janë të kushtëzuara nga një kontekst më i gjerë: vetë formati shtetëror dhe regjimi politik. Për këtë, njohja e tendencave të dështimit apo suksesit të shtetit ka një lidhje të drejtpërdrejtë edhe me stabilitetin politik. Kuantifikimin e të dhënave në lidhje me dinamikën e vazhdueshmërisë apo ndryshimit të shtetit si dhe qëndrueshmërinë apo ndryshimin e regjimit i mundëson projekti Polity IV¹⁸¹, prej nga ku mund të fokusohemi në karakteristikat e regjimit e ato shtetërore në studimin e tendencave stabilizuese apo destabilizuese për rastin e Ballkanit Perëndimor përgjatë periudhës së marrë në studim.

¹⁸¹ Polity IV Project: Political Regime Characteristics and Transitions, 1800-2011, <<http://www.systemicpeace.org/polity/polity4.htm>>

KAPITULLI 3

STABILITETI POLITIK DHE RRIJJA EKONOMIKE

Përmbledhje

Në këtë kapitull të tretë, pas prezantimit dhe analizës që i është bërë konceptit të stabilitetit politik, përqendrohemi tek sistemi ekonomik. Kjo, me qëllimin kryesor për të trajtuar teorikisht logjikat e funksionimit të tij në raport me rritjen ekonomike si një element kyç i ecurisë ekonomike të një vendi. Jo vetëm kaq, por nëpërmjet analizës së rritjes ekonomike në tentojmë të identifikojmë rrugët e mënyrat e ndikimit të politikës, e më specifikisht faktorëve politikë tek ky element i rëndësishëm i sistemit ekonomik.

Kështu, ky kapitull është konceptuar të trajtojë teorinë ekonomike të rritjes, si terreni kryesor prej nga ku identifikohen qasjet e ndryshme ekonomike në lidhje me konceptin e rritjes ekonomike. Kjo, për të vijuar më pas me rishikimin e literaturës në marrëdhënien ndërmjet stabilitetit politik dhe rritjes ekonomike. Korniza teorike e marrëdhënies destabilitet politik-rritje ekonomike përqendrohet më pas në trajtimin edhe të modeleve që kanë në fokus të vet këtë marrëdhënie. Nisur nga një përpjekje për të strukturuar marrëdhënien ndërmjet faktorëve politikë e atyre ekonomikë të trajtuar gjerësisht nga literatura ekonomike e rritjes, ne identifikojmë disa dimensione kryesore: marrëdhënien ndërmjet variablit të varur rritje ekonomike përkundrejt stabilitetit politik, demokracisë, institucioneve e korrupsionit.

3.1 HYRJJE

Stabiliteti politik dhe rritja ekonomike, ashtu si procese e fenomene të tjera brenda entiteteve politike shtetërore, shfaqin trendet e tipareve të tyre hapësinore e kohore brenda një makroprocesi të përgjithshëm që është ai i zhvillimit. Për Hausmann *et al.*, zhvillimi është një koncept i gjerë i cili përfshin rritjen e kapaciteteve njerëzore në përgjithësi¹⁸². Pikërisht, brenda logjikës zhvillimore legjitimohen e justifikohen dinamika të rëndësishme të sistemit ekonomik, politik e social të një vendi të caktuar, të cilat shfaqen nëpërmjet elementëve të veçantë, siç është stabiliteti politik për sistemin politik dhe rritja ekonomike për sistemin ekonomik. Nisur nga kjo logjikë, është e nevojshme që të fokusohemi tek dinamika e zhvillimit ekonomik, për të identifikuar më pas pozicionin dhe rolin që bart rritja ekonomike në të.

Procesi i zhvillimit ekonomik karakterizohet nga tre elementë kryesorë, të cilat janë rritja e popullsisë, progresi teknologjik dhe akumulimi i kapitalit. Të dhënat empirike tregojnë se të tre këta faktorë zakonisht ecin së bashku¹⁸³. Sipas pikëpamjes së Kaldor¹⁸⁴ ritmi i zhvillimit në një vend të caktuar është rezultat i fuqisë së presionit sipërmarrës nga njëra anë, dhe elasticitetit të përgjigjes së rritjes së popullsisë, progresit teknik dhe akumulimit të kapitalit nga ana tjetër. Në tentativën për t'iu përgjigjur pyetjes se përse vende të ndryshme diferencohen nga ritmet e ndryshme të zhvillimit, autori thekson rëndësinë e arsimit të popullsisë rurale në vendet e pazhvilluara. Më specifikisht, ai shprehet: 'çelësi për një rritje të përshpejtuar në zonat e pazhvilluara të botës qendron tek ndryshimet thelbësore si në mënyrën e të menduarit e njohuritë teknike, dhe në aftësitë e popullsisë të tyre fshatare... Megjithatë, qasja më premtuese për mua duket se qendron tek përpjekja për të rritur nivelin e përgjithshëm të arsimit në zonat rurale'¹⁸⁵.

Pra, siç e shohim, një element shoqëruar i zhvillimit ekonomik është edhe rritja ekonomike. Madje, sipas Mobarak, zhvillimi ekonomik kërkon rritje ekonomike të qëndrueshme. Kjo sepse, sipas autorit, 'procesi i zhvillimit i lejon një shoqëri të përshtatet ndaj pasigurive të krijuara nga rrethana mjedisore në ndryshim, në një mënyrë të tillë që të vazhdojë të përmirësojë standardin e jetesës së anëtarëve të vet... Kështu, zhvillimi nuk është vetëm rezultat i ritmeve të larta ose pozitive të rritjes, por edhe i stabilitetit të saj'¹⁸⁶. Nga ana e saj rritja, dhe ecuria e procesit të zhvillimit ekonomik nevojit prezencën në një vend të një sërë faktorësh të tjerë më të cilët edhe empirikisht është evidentuar një korrelacion pozitiv. Si të tillë, Williams *et al.*, evidentojnë

¹⁸² Hausmann, R. Rodrik, D. Velasco, A., (2005), 'Growth diagnostics', fq.1-35/i gjendshëm në <<http://www.hks.harvard.edu/fs/drodrik/Research%20papers/barcelonafinalmarch2005.pdf>>

¹⁸³ Kaldor, N., (1980), *Essays on the economic stability and growth*, Holmes &Meier Publishers, Inc. Nju York, fq.233.

¹⁸⁴ *ibid.*, fq. 237.

¹⁸⁵ *ibid.*, fq. 241.

¹⁸⁶ Mobarak, M. A., (2005), 'Democracy, volatility and economic development', *The Review of Economics and Statistics*, Vol. 87(2): 348-361, fq.348.

besueshmërinë e investitorëve, tregun mirfunksionues, konkurrencial e të rregulluar siç duhet, si dhe investimin veçanërisht në infrastrukturë, kapital njërëzor dhe teknologji¹⁸⁷.

Sigurisht zhvillimi shfaq dinamika të ndryshme në vende e rajone të ndryshme. Dallimet në nivelet e zhvillimit për vende të ndryshme janë jo vetëm dëshmuar të stadeve të ndryshme të zhvillimit në të cilat ndodhen, por edhe të faktit se në trajtimin e zhvillimit dhe rritjes ekonomike që e shoqëron është e vështirë për të mbërritur në përgjithësime dhe rekomandime të përbashkëta. Ky argument gjen mbështetje nga diferencat e rezultateve të arritura në studime të shumta në fushën e ekonomisë politike, por edhe nën një logjikë psikologjiko-institucionale. Nga pikëpamja e ekonomisë politike, Williams *et al.*, identifikon se problemi në shumë prej vendeve në zhvillim është se ato janë në fazat e hershme të shtet-ndërtimit, dhe ku marrëdhëniet e institucionalizuara (marrëdhëniet e besimit ndërmjet politikanëve dhe investitorëve), dhe kontrolli e balancimi i pushtetit janë shpesh të dobëta¹⁸⁸. Ndërsa, nga pikëpamja e logjikës psikologjiko-institucionale Wight¹⁸⁹ fokusohet tek trajtimi i ideve dhe psikologjisë humane në evidentimin e stimujve të cilat nxisin rritjen ekonomike. Sipas tij, nuk ka një model perfekt ideal të rregullimit institucional-politik i cili të mund të nxisë rritjen ekonomike. Shembulli emblemantik tek i cili përqendrohet autori është ai i vendit afrikan të Botsuanës me ritme të larta zhvillimi. Ideja qëndron tek fakti se edhe nëse u referohemi ritmeve të rritjes ekonomike, ashtu edhe të ardhurave për frymë (renditjeve të ofruara nga Bakna Botërore), vende të ndryshme kanë rregullime të ndryshme institucionale, ashtu si tradita, ligje, nivel të lirive, e histori të ndryshme. Për këtë, nuk ka një përgjigje të vetme për stimujt e rritjes ekonomike në një vend. Ajo çka është e rëndësishme sipas autorit janë instiktet. Tre prej tyre janë në themel të natyrës njerëzore (insitkti për veten, për të tjerët, dhe kundër të tjerëve). Një shoqëri duhet të dijë të vendosë në funksionim dhe harmoni këto të fundit për të hedhur hapa zhvillimi.

Së fundmi, elementi që gjithmonë mbetet në qendër të vëmendjes përse i përket zhvillimit ekonomik është vetë shteti. Kjo sepse suksesi në zhvillimin e mëtejshëm ekonomik të një vendi është në varësi të politikave shtetërore të ndjekura. Nëse do t'u referoheshim vendeve në tranzicion, Tabellini (2004)¹⁹⁰, do të evidentonte si çelësin e zhvillimit ekonomik, stimujt e duhur nga ana e qeverisë për të ndërmarrë ato politika të cilat e nxisin vetë zhvillimin, e ku këta të fundit prodhohen nga përfitimet e liberalizimit politik dhe ekonomik. Për autorin, suksesi më i madh u ka takuar atyre shteteve të cilat si fillim kanë ndërmarrë politikat liberalizuese në aspektin ekonomik dhe më pas ka ndodhur liberalizimi politik. Më specifikisht, autori thekson se 'janë të shumta politikat që mund dhe duhet të ndërmarrin qeveritë në terma të ofrimit të të mirave publike, rregullimit të dështimeve të tregut, reduktimit të pabarazive në të ardhura dhe mundësi..., por diferenca reale për zhvillimin ekonomik të një vendi qëndron tek një infrastrukturë ligjore dhe institucionale e cila mbron të drejtat e pronësisë dhe garanton sundimin e ligjit'¹⁹¹. Pra,

¹⁸⁷ Williams, G. Duncan, A. Landell-Mills, P. Unsworth, S., (2008), 'Politics and growth: An analytical framework', *The Policy Practice Ltd*, fq.18.

¹⁸⁸ *ibid.*, fq. 13.

¹⁸⁹ Wight, B. J., (2011), 'Public Policy, Human Instincts, and Economic Growth', *The Independent Review*, Vol. 15(3): 351–365, ISSN 1086–1653.

¹⁹⁰ Tabellini, G., (2004), 'The role of the state in economic development', *CESIFO Working Paper*, Nr.1256, fq. 18.

¹⁹¹ *ibid.*, fq. 1.

zhvillimi ekonomik e mbështetja e tij nëpërmjet një rritjeje të qëndrueshme nënkupton përfshirjen e një sërë variablash të tjerë, të cilët në marrëdhënie të drejtpërdrejtë apo jo janë përcaktues të ritmeve e trendit që rritja paraqet në një vend të caktuar. Nën këtë perspektivë e paraqet edhe Mamoona dhe Murshed konceptin e zhvillimit. Sipas tyre ‘zhvillimi ekonomik është një fenomen kompleks i cili përfshin një shumësi përcaktorësh të një karakteri social, ekonomik, politik dhe shkencor’¹⁹². Është pikërisht studimi i këtij ndërveprimi që ndihmon në vlerësimin e dinamikave zhvillimore në vende të ndryshme si dhe nevojshmërinë për të riparë apo jo politika të caktuara.

3.2 TEORITË EKONOMIKE TË RRIJTJES

Nga një vështrim i përgjithshëm i marrëdhënies midis ekonomisë e politikës do të vlerësonim se, në një vend të caktuar, sistemi politik e ai ekonomik veprojnë e ndërveprojnë me njëri-tjetrin duke integruar elementë të rëndësishëm, të cilët i orientojnë zhvillimet e tyre të brendshme në drejtimet e synuara. Pra, pavarësisht logjikave të ndryshme vepruese së brendshmi, sistemet marrin e japin nga njëri-tjetri duke prodhuar rezultate sociale. Nga njëra anë, sistemi politik krijon kuadrin e përgjithshëm veprues të sistemit ekonomik, e nga ana tjetër sistemi ekonomik përgjigjet nëpërmjet produkteve të caktuara të karakterit ekonomik, të cilat në formën e një rrethi ciklik ndikojnë ecurinë e mëtejshme të politikës së një vendi. Pra, grup-faktorë të një karakteri social-politik ndërveprojnë (ndikojnë e ndikohen) me faktorë të një natyre ekonomike. Nëse i kanalizojmë këto ide në gjuhën teorive dhe fushave studimore të shkencës politike dhe të ekonomisë, shohim se ato janë shprehëse të një konvergjence ndërmjet dy drejtimeve kryesore të studimit në marrëdhënien ndërmjet sistemit politik dhe atij ekonomik: teoritë e rritjes dhe ekonomia politike. ‘Literatura e rritjes, së bashku me teoritë e saj të reja endogjene të rritjes analizon faktorët ekonomikë të tillë si: arsimi, infrastruktura, dhe shpenzimet qeveritare për të përcaktuar se cilët janë më shumë apo më pak të rëndësishëm për rritjen. Ndërsa, ekonomia politike argumenton se ekonomiksi vetë nuk mund të shpjegojë i vetëm variacionin e madh ndërmjet shteteve përsa i përket rritjes, dhe më në përgjithësi, rezultatet ekonomike dhe përzgjedhjen e politikave’¹⁹³.

Në këtë logjikë, një ndër këto marrëdhënie ndërvepruese është ajo ndërmjet stabilitetit politik dhe rritjes ekonomike, e cila nën supozimin e një ndikimi të mundshëm të stabilitetit politik tek rritja ekonomike konsiderohet ndryshe edhe si ‘politizimi i rritjes ekonomike’¹⁹⁴. Duke e vlerësuar në këtë mënyrë, parashikojmë një peshë të rëndësishme të stabilitetit politik tek një tregues kryesor ekonomik siç është rritja ekonomike. Thënë ndryshe, nga ndryshimet në nivelet e stabilitetit politik mund të presim presim ndryshime edhe në nivelet e rritjes ekonomike të një vendi në intervale të caktuara kohore.

¹⁹² Mamoona, Murshed, M. S., (2009), ‘Want economic growth with good quality institutions? Spend on education’, *Education Economics*, Vol. 17(4): 445-468, fq. 445.

¹⁹³ Alesina, A. Perotti, R., (1994), ‘The political economy of growth: a critical survey of the recent literature’, *The World Bank Economic Review*, Vol. 8(3): 351-371, fq. 351.

¹⁹⁴ Younis, M. Lin, X. X. Selvarathinam, S., (2008), ‘Political stability and economic growth’, *Amerian Journal of Applied Sciences*, Vol. 5(3): 203-208, fq.204.

Siç mund të vërehet, teoria e sistemeve dhe logjika me të cilën kjo e fundit identifikohet, nuk është e vetmja qasje e cila mbështet argumentin kryesor, atë të marrëdhënies së supozuar ndërmjet rritjes ekonomike dhe stabilitetit politik. Në fakt, këtë argument e shohim të zhvilluar edhe nën teoritë ekonomike. Tre janë drejtimet kryesore përgjatë së cilave është zhvilluar teoria e rritjes: teoria klasike e rritjes (Malthus), teoria neoklasike e rritjes (Solow), dhe teoria e re e rritjes (Romer, Lucas). Ato janë ngritur duke marrë elementë të caktuar nga njëra-tjetra, por edhe duke e zëvendësuar njëra-tjetrën. Por, si e shohin dhe e shpjegojnë këto teori rritjen dhe marrëdhënien midis këtyre variableve?

Në fokusin kryesor të teorisë neoklasike të rritjes është mënyra se si mund të arrihet një normë e qëndrueshme e rritjes ekonomike në marrëdhënie me tre elementë kyç, faktorët e prodhimit: puna, kapitali dhe teknologjia. Ndryshe nga teoria klasike, e cila nëpërmjet burimeve të kufizuara dhe rritjes së popullsisë shpjegon rritjen e PBB-së, dhe më pas rënien e saj si pasojë e këtyre dy faktorëve, teoria neoklasike mbron idenë e mbajtjes së PBB-së në nivele ekuilibri, duke reflektuar ndryshime në nivelet e punës dhe kapitalit si përgjigje ndaj ndryshimeve teknologjike. Është ecuria teknologjike e cila, sipas neoklasikëve bën të mundur përparimin e rritjes ekonomike. Një ndryshim thelbësor ky me klasikët sipas të cilëve rritja ekonomike do të ketë një fund, e mund të arrijë në nivelin e mbijetesës, për shkak të rritjes së popullsisë si rezultat i një rritjeje të mëparshme ekonomike, por në të njëjtën kohë edhe rritjeje të burimeve nga nevojat e një popullsie në rritje. Mirëpo, pamundësia për të vlerësuar nga pikëpamja sasiore diferencat në nivelet e rritjes vetëm nëpërmjet dallimeve që vende të ndryshëm kishin nga pikëpamja e kapitalit fizik dhe atij njërëzor, çuan drejt një drejtimi të ri në teorinë e rritjes: atë të teorisë së re të rritjes. Ajo çka e diferencon këtë teori të tretë nga teoritë e para është trajtimi i faktorëve si ndryshimi teknologjik dhe kapitali njerëzor si faktorë endogjenë në shpjegimin e niveleve të ndryshme dhe ritmeve të rritjes së produktivitetit në vende të ndryshme¹⁹⁵.

Të kuptuarin më në thellësi të rritjes ekonomike e ka mundësuar edhe ndërtimi i modeleve. Nëpërmjet tyre, teoricienët dhe ekonomistët kanë mundur ‘të shpjegojnë të dhënat, të parashikojnë të ardhmen me më shumë besueshmëri, si dhe të shohin ndikimin e mundshëm të vendimeve, qofshin këto individuale, apo politika kombëtare..., të shpjegojnë se përse rritja mund të ndryshojë nga vendi në vend dhe në kohë të ndryshme, si dhe përse, kjo e fundit na orienton drejt veprimeve të caktuara të politikave’¹⁹⁶. Gjithsesi, modelet ndryshojnë nga njëri-tjetri dhe në parashikimet e tyre, sepse në fund të fundit janë reflektime të perspektivave e qëndrimeve të ndryshme që ekonomistët kanë mbi konceptin e rritjes. Në këtë kontekst, ndarja kryesore që realizohet edhe në literaturën ekonomike të rritjes është ajo ndërmjet modeleve endogjene dhe modeleve ekzogjene të rritjes (modelet neoklasike të rritjes). Dallimi kryesor i cili i diferencon këto dy lloje modelesh është qëndrimi që mbajnë ndaj teknologjisë apo ndryshimit teknik. Modelet ekzogjene të rritjes supozojnë se rritja ndikohet nga faktorë të jashtëm siç është teknologjia. Pra, rritja në modelet ekzogjene përcaktohet së jashtëmi (nga ndryshimi teknologjik), ndërsa në modelet endogjene norma e qëndrueshme e rritjes përcaktohet së

¹⁹⁵ Martin, R. Sunley, P., (1998), ‘Slow convergence? The new endogenous growth theory and regional development’, *Economic Geography*, Vol. 74(3):201-227.

¹⁹⁶ Center for the Study of Complex Systems, *Economic growth*, (online course 8), fq. 83.

brendshmi¹⁹⁷, apo nga forca të brendshme të cilat në mënyrë eksplicite janë të parashtruara në model. Ka qenë modeli neoklasik i rritjes i Solow (1956), ai që i dha shtysë Teorisë së Re të Rritjes apo Teorisë Endogjene të Rritjes. ‘Kjo e fundit e vendos theksin tek roli kyç i faktorëve të investimeve në kapitalin njerëzor, njohurive, inovacionit dhe përmirësimit të performancës institucionale si kontribues në gjenerimin e eksternaliteteve pozitive, sinergjive, dhe rritjes së të ardhurave nga kapitali dhe puna’¹⁹⁸. Realiteti ekonomik i vendeve të ndryshme të botës, së bashku me të dhënat empirike dhe testimin e tyre nëpërmjet modeleve endogjene të rritjes i dhanë shtysë dhe mbështetje të mëtejshme kësaj kategorie modelesh.

Megjithatë, përdorimi i dinamikave thelbësisht ekonomike nga modelet endogjene të rritjes, në raste të caktuara, i bëri ato të paafta për të shpjeguar realitetet ekonomike të vendeve të ndryshme. Në këtë kontekst, duke ju referuar edhe karakteristikës shtetërore që përfaqësojnë ekonomitë e vendeve të ndryshme, marrja në konsideratë e një ndryshori tjetër, siç është dinamika politike mund ta rriste aftësinë shpjeguese të tyre. Kjo u shfaq nëpërmjet konceptit politiko-ekonomik të quajtur ‘politizimi neoklasik i rritjes ekonomike’¹⁹⁹. ‘Teoria e politizuar neoklasike e rritjes thekson se stoku i punës dhe kapitalit të disponueshëm për prodhim, si dhe efienca me të cilën faktorët input-e transformohen në output, varen thelbësisht nga mënyra se si politika, politikat publike dhe rregullimet institucionale ndikojnë në sigurinë e të ardhurave nga pronësia dhe të ardhurave private nga sipërmarrja, inovacioni, investimi dhe puna’²⁰⁰. Thënë ndryshe, kjo teori fokusohet në mënyrën se si politika dhe politikja ndikojnë sistemin ekonomik në një tregues të rëndësishëm të tij siç është rritja ekonomike. Pra, nuk përqendrohemi vetëm në studimin e variablave të izoluar në sistemet që i gjenerojnë ato, por, edhe në shkëmbimet e ndikimet e variablave tek njëri-tjetri. Nëpërmjet konceptit të politizimit të rritjes ekonomike ofrohet ndihmesë në studimin e rasteve të caktuara për tu fokusuar e thelluar në rezultate duke qënë se mund të importohen perspektiva shpjeguese (variabla) të cilat janë ekzogjene për sistemin ekonomik, por që ndikojnë produktet e tij (në këtë rast rritja ekonomike), vlerësime këto që nga Douglas dhe Hibbs (2001) konsiderohen ndryshe si kontribute metodologjike të teorisë së politizuar neoklasike të rritjes ekonomike²⁰¹. Metodologjike, sepse nëpërmjet kësaj teorie ofrohet mundësia e përfshirjes

¹⁹⁷ Ickes, *op.cit.*, fq.1.

¹⁹⁸ Williams, Duncan, Landell-Mills, Unsworth, *op.cit.*, fq. 10.

¹⁹⁹ Shënim: Përveç këtij konteksti, autorë të tjerë, në marrëdhënien e politikës me sferën ekonomike, përdorin në një tjetër kuptim përcaktimin ‘politizim i jetës ekonomike’. Kështu sipas Johnson *et al*, (1997), ‘Politizimi i jetës ekonomike mund të konsiderohet si përdorimi nga ana e politikanëve të së drejtave të kontrollit (si fuqitë rregulluese mbi firmat private, aftësia për të rregulluar dhe kufizuar hyrjen, etj) mbi bizneset’. Autorët tregojnë se politizimi i jetës ekonomike dhe rishpërndarja e burimeve (që rezulton prej politizimit) në sektorin informal kanë ndikime të thella si në strukturën, ashtu edhe në normën e rritjes ekonomike të një ekonomie në tranzicion. (*Burimi*: Johnson, S. Kaufman, D. Shleifer, A., (1997), ‘The unofficial economy in transition’, *Brookings Papers on Economic Activity*, Vol 2: 159-239). Në po të njëjtën linjë, politizimi i aktivitetit ekonomik si ushtrimi i kontrollit të të drejtave nga politikanët dhe burokratët tek firmat rithekskohet nga Johnson *et al* (1998). (*Burimi*: Johnson, S. Kaufman, D. Zoido-Lobaton, P., (1998), ‘Regulatory discretion and the unofficial economy’, *American Economic Review*, fq 1-10).

²⁰⁰ Douglas, A., Hibbs, Jr., (2001), ‘The politicization of growth theory’, *Kyklos*, Vol. 54: 257-278, fq. 13-14.

²⁰¹ *ibid.*, fq. 14.

së variablave të ndërmjetëm duke e zgjeruar shkallën e modelimit të studimit. Kështu, nga njëra anë mund të shohim ndikimin e faktorëve të prodhimit në produktin e përgjithshëm, dhe ndikimin e këtij të fundit nga politika e rregullimet institucionale të një vendi të caktuar. Skematikisht sipas Douglas dhe Hibbs, duke iu referuar edhe Hall e Jones (1999), si dhe Acemoglu, Jonson dhe Robinson (2000), modeli i studimeve të tilla do të paraqitet si më poshtë:

Politika, Politikat, Institucionet \Rightarrow *Faktorwt Inpute, Produktivitetet Marxhinal* \Rightarrow *Outputi*

Qasja për të përfshirë në modelet e rritjes ekonomike edhe variabla të karakterit politik, padyshim që rrit aftësinë shpjeguese të këtyre modeleve jo vetëm në paraqitjen e një kuadri më të plotë të gjendjes së ekonomisë, por edhe ndikimin e treguesve të veçantë politikë tek ajo. Kjo mënyrë e të vështruarit dhe analizuarit të produktivitetit dhe rritjes të një shoqërie të organizuar politikisht ka përfaqësuar edhe një ndryshim të ndjeshëm në mënyrën e të menduarit ekonomik si dhe të modelimit të rasteve të caktuara për tu studiuar. Kjo sepse, tashmë ‘rritja ekonomike dhe produktiviteti shihen të përcaktuara jo vetëm nga proceset endogjene të formimit të kapitalit, apo nga variacioni në sjelljen kursyese të qytetarëve, preferencat kohore të tyre e utiliteti, por edhe nga politika, politikat dhe institucionet’²⁰².

Dëshmi e kësaj rryme të re studimi në ekonomi, e sidomos pas viteve 90’, janë një sërë studimesh të cilat, e zbërthejnë politikën në variabla të ndryshëm, dhe tentojnë të shohin lidhjet e këtyre të fundit me rritjen ekonomike. Në këtë grup variablash, një pozicion qendror ka natyra e terrenit politik ku merr jetë aktiviteti ekonomik, apo ndryshe stabiliteti politik i vendit. Më poshtë do të ofrojmë një rishikim të përmbledhur të literaturës e cila teston, analizon e vlerëson marrëdhënien midis rritjes ekonomike e variablave shoqërues me stabilitetin ekonomik dhe tregues të tjerë politikë. Përveç konvergjencave në rezultatet e studimeve, kjo literaturë reflekton edhe logjikën e përgjithshme të teorisë neoklasike të rritjes ekonomike të politizuar, nëpërmjet përfshirjes në modele të variablave socio-politikë, përpos atyre të një karakteri ekonomik.

E thënë kjo nëpërmjet gjuhës së ekuacioneve, sipas Douglas dhe Hibbs, output-i për person mund të vlerësohet si vijon:

$$\ln(Q/L)_j = \alpha + \beta PI_j + Z_j \gamma + \varepsilon_j$$

ku, *PI* identifikon politikën, politikat publike dhe institucionet, ndërsa *Z* është vektor i variablave të tjerë kontrolli²⁰³. Siç mund ta shohim, output-i për person, është i përcaktuar nga variabla të karakterit ekonomik e politik, duke dëshmuar edhe një herë sipas autorëve, ndryshimin në mendësinë e përgjithshme të kërkimit e analizave ekonomike në marrjen parasysh në këto studime edhe të ndikimeve nga faktorët politikë.

Në teorinë e rritjes, një vend të rëndësishëm zë edhe analiza e vlerësimit i diferencave që ekzistojnë mes vendeve në lidhje me nivelin e output-it për frymë. Studiuesit dhe ekonomistët i shohin ndryshimet ndërmjet shteteve përsa i përket këtij elementi të lidhura


²⁰² *ibid.*, fq. 21.

²⁰³ Douglas, A., Hibbs, Jr., (2001), ‘The politicization of growth theory’, *Kyklos*, Vol 54: 257-278, fq. 19.


ngushtësisht me diferencat në kapitalin fizik dhe nivelin e arsimit të forcës punëtore. Megjithatë, përpos njohjes së rolit që kanë këta dy faktorë në output-in për frymë, Hall dhe Jones (1999), vlerësojnë se ky i fundit është më shumë i ndikuar nga infrastruktura sociale. Me infrastrukturë sociale ata nënkuptojnë institucionet dhe politikat e qeverisë që përcaktojnë mjedisin ekonomik në të cilin individët akumulojnë aftësitë e mjeshtëritë e tyre, dhe ku firmat akumulojnë kapitalin e prodhojnë output-in²⁰⁴. Sipas autorëve, diferencat në infrastrukturën sociale ndërmjet vendeve shkaktojnë diferenca të mëdha në akumulimin e kapitalit, nivelin e arsimit, dhe produktivitetin, dhe rrjedhimisht diferenca të mëdha në nivelin e të ardhurave²⁰⁵.

Në kuadrin e marrëdhënieve ndërmjet zhvillimit ekonomik, e më veçanërisht prodhimit kombëtar për frymë, McArthur dhe Sachs (2000) në rishikimin e rezultateve të Acemoglu, Johnson, dhe Robinson (2000), nëpërmjet shtrirjes së kampionit të vendeve të marra nën studim, arrijnë në përfundimin se nuk janë vetëm institucionet që ndikojnë zhvillimin ekonomik, por edhe variabla të tjerë të lidhura me gjeografinë si: shkalla e shfaqjes së malarisë e vdekshmëria foshnjore²⁰⁶.

Vlerësimin e rrugëve të mundshme të ndikimit të variablave të tjerë tek zhvillimi ekonomik, autorët e shprehin nëpërmjet skemave të mëposhtme të cilat paraqesin edhe argumentet e mbështetur:



Logjika: kushtet e pafavorshme gjeografike ulin produktivitetin bujqësor dhe shëndetin, duke penguar në mënyrë të drejtpërdrejtë zhvillimin. Kushtet e pafavorshme gjeografike gjithashtu promovojnë një shtet lakmitar duke çuar kështu në institucione lakmitare dhe zhvillim të dobët (Sipas McArthur dhe Sachs (2000) bazuar në Gallup, Sachs dhe Mellinger).



Logjika: Kushtet e pafavorshme gjeografike kanë një ndikim të drejtpërdrejtë mbi prodhimin, dhe një ndikim jo të drejtpërdrejtë nëpërmjet institucioneve, ku nga të dyja çohet drejt niveleve të ulëta të zhvillimit. Nga ana tjetër, nivelet e ulëta të zhvillimit rezultojnë në nivele të ulëta të inovacionit dhe ndryshim të ngadaltë teknologjik (Sipas McArthur dhe Sachs (2000), bazuar në Sachs (2000)).

Pra, pavarësisht se zhvillimi është një koncept i gjerë që përfshin disa dimensione të përgjithshme të aktivitetit ekonomik, tiparet e karakteristikat me të cilat shfaqet në vende të ndryshme janë të ndryshme. Në këtë kontekst, nëse do t'i referoheshim kategorisë së vendeve në zhvillim, një aspekt të rëndësishëm të ecurisë së tyre në terma të zhvillimit do të identifikonim rritjen ekonomike. Sigurisht, nga sa pamë më sipër, rritja nuk mund të vlerësohet e izoluar vetëm brenda sistemit ekonomik. Për të prodhuar rezultate të vlefshme të cilat ofrojnë edhe orientime për politikat në afatmesëm e afatgjatë, sidomos

²⁰⁴ Hall, E. R. Jones, I. C., (1999), 'Why do some countries produce so much more output per worker than others?', *The Quarterly Journal of Economics*, Vol 114(1): 83-116, fq.84.

²⁰⁵ *ibid.*, fq.114.

²⁰⁶ McArthur, W. J. Sachs, D.J., (2000), 'Institutions and geography: comment on Acemoglu, Johnson and Robinson (2000)', *NBER Working Paper Series*, Working Paper no. 8114, National Bureau of Economic Research, fq. 10.

të një vendi në tranzicion, nevojitet analizimi i realitetit në plotësi duke përfshirë edhe dinamikën politike të tij.

3.3 RISHIKIM I LITERATURËS NË MARRËDHËNIEN NDËRMJET STABILITETIT POLITIK DHE RITJES EKONOMIKE

Një pjesë e rëndësishme e kërkimit dhe hulumtimit makroekonomik (më specifiku, ekonomisë politike të rritjes) të kohëve të fundit ka qenë edhe analiza e pasojave të destabilitetit politik tek rritja ekonomike. Përqëndrimi në studimin e një marrëdhënieje të kësaj natyre nisët nga premisa e përgjithshme e ndikimit të mundshëm, madje shpesh herë dhe të anasjelltë të këtyre elementëve tek njëri-tjetri. Pavarësisht rëndësisë qendrore që ka stabiliteti politik për sistemin politik dhe rritja ekonomike për sistemin ekonomik, të dy këta variabla shihen pashmangshmërisht të ndërlidhur edhe me procese e fenomene të tjerë të sistemeve respektive. Kjo, padyshim e rrit vështirësinë e vlerësimit dhe analizimit të statusit të marrëdhënies së tyre në rajone apo vende të veçanta. Këtë e dëshmon edhe Youns *et al.*, sipas të cilëve në ekonomitë aziatike, ‘stabiliteti politik ndikon rritjen ekonomike jo vetëm në mënyrë të tërthortë nëpërmjet akumulimit të kapitalit, por edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë’²⁰⁷. E megjithatë, është i qëndrueshëm vlerësimi i pjesës më të madhe të ekonomistëve sipas të cilëve destabiliteti politik është i dëmshëm për performancën ekonomike.

Përse ndodh kështu? Sipas një logjike të thjeshtë, do të prisnim që një shtet i karakterizuar nga nivele të larta të destabilitetit politik të prezantonte edhe nivele të ulëta të rritjes ekonomike, apo në raste të caktuara edhe rënie të saj. Kjo sepse, destabiliteti politik do të rriste pasigurinë në vend, duke frenuar apo ndikuar edhe nivelin e investimeve (të huaja apo të brendshme) me një ndikim të drejtpërdrejtë në aktivitetin ekonomik dhe rritjen ekonomike. Për më tepër, ‘destabiliteti politik konsiderohet nga ekonomistët si një sëmundje e keqe e dëmshme për performancën ekonomike të një vendi, e cila rrit gjatë e kufizimit të horizonteve të vendimmarrjes së politikbërësve duke çuar kështu drejt politikave makroekonomike afatshkurtra nënoptimale, ndryshueshmërisë së shpeshtë të tyre, e duke ndikuar rrjedhimisht tek performanca ekonomike’²⁰⁸. Pra, nga njëra anë destabiliteti politik krijon pasiguri në lidhje me institucionet e politikbërësit duke ndryshuar edhe modelet e sjelljes së agjentëve privatë ekonomikë dhe të firmave, nga ana tjetër, minon marrëdhëniet ekonomike mes agjentëve të ndryshëm ekonomikë duke rrezikuar edhe funksionimin e tregut. Ndryshe, Aisen dhe Vega do të shpreheshin se ‘destabiliteti politik ka gjasa të kufizojë vizionin e politikbërësve duke i orientuar drejt politikave makroekonomike afatshkurtra jooptimale dhe ndryshueshmërsë të shpeshtë të tyre, duke prodhuar kështu paqëndrueshmëri e duke ndikuar negativisht tek performanca makroekonomike e vendit’²⁰⁹.

²⁰⁷ Younis, Lin, Selvarathinam, *op.cit.*, fq.208.

²⁰⁸ Samimi, Monfared, Moghaddasi, Azizi, *op.cit.*, fq. 18.

²⁰⁹ Aisen, A. Veiga, J.F., (2011), ‘How does political instability affect economic growth?’, *IMF Working Paper*, WP/11/12, Fondi Monetar Ndërkombëtar, 1-28, fq. 3.

Ndërkohë, do të prisnim që, një shtet plotësisht i stabilizuar politikisht të karakterizohej nga zhvillime të qëndrueshme me tendencë rritjeje edhe në sektorin ekonomik. Kjo sepse, stabiliteti i shfaqur nga sistemi politik krijon siguri dhe besim tek agjentët ekonomikë sidomos tek investitorët, duke qenë se prospektet për të ardhmen e ekonomisë vlerësohen si pozitive. Mirëpo, një tjetër rrethanë do të ishte ajo e vendeve në zhvillim, ku, shpesh nuk vërejmë një korrelacion të drejtpërdrejtë ose të plotë ndërmjet stabilitetit politik dhe zhvillimit ekonomik në përgjithësi. Arsyeja kryesore që qendron mbas kësaj është se ndërkohë që sistemi politik dhe ai ekonomik mundësojnë plotësimin e kërkesave të shoqërisë, në të njëjtën kohë rritet edhe niveli i pritshmërive. Rritja e pritshmërive shoqërohet me kërkesa të reja ndaj sistemit politik, të cilat shpesh mund të marrin formë të organizuar. Kjo, mund të ushtrojë presion drejt qeverisë dhe shpeshherë mund të krijojë situata të tensionuara socio-politike. Për rrjedhojë, janë këto situata të tensionuara, që duke marrë forma të ndryshme në shtete të ndryshme rrisin nivelet e destabilitetit politik të matur dhe të vlerësuar nga institutet e agjencitë ndërkombëtare.

Megjithatë, para testimit empirikisht të çështjes së destabilitetit politik dhe rritjes ekonomike, si dhe të variablave të tjerë ndërhyrës që bëhen pjesë e kësaj marrëdhënieje për rastin e vendeve të Ballkanit Perëndimor, parakërkohet ndërmarrja e disa hapave të tjerë për të plotësuar kornizën teorike të studimit. *Së pari*, nevojitet të shohim kontributin e studiuesve të fushës në lidhje me vlerësimin e marrëdhënies ndërmjet destabilitetit politik dhe rritjes ekonomike, si dhe të shohim modelet e përdorura prej tyre në testimin e marrëdhënies ndërmjet këtyre variablave. *Së dyti*, na duhet të vlerësojmë dhe të evidentojmë variablat e tjerë të karakterit social, politik e ekonomik që shihen të rëndësishëm në përfshirjen e tyre në model për rastin tonë studimor.

3.3.1 Korniza teorike e marrëdhënies destabilitet politik-rritje ekonomike: modelet kryesore

Marrëdhëniet, ndërveprimet e shkëmbimet që realizohen në elementë të veçantë ndërmjet sistemit social, politik e atij ekonomik karakterizohen nga dy tipare kyçe. Së pari, ato zhvillohen brenda një konteksti apo terreni të caktuar fizik dhe hapësinor, dhe së dyti, mund t'i vlerësojmë si pjesë mikro të një procesi më të përgjithshëm që për entitetet politike është *zhvillimi*. Kështu, në rastin konkret të këtij studimi, nisur nga fakti se zhvillimi politik dhe ai ekonomik përfshijnë si pjesë të tyre stabilitetin/destabilitetin politik dhe rritjen ekonomike, ne tentojmë të shohim korrelacionin e mundshëm të këtyre variablave me njëri-tjetrin duke marrë nxitje edhe nga tendenca në rritje e studimeve specifike në këtë fushë. Këtë e ligjëron më se miri Kaldor, sipas të cilit '... as akumulimi i kapitalit, dhe as rrjedha e inovacionit teknik, nuk mund të konsiderohen më si 'variabla të pavarur' po aq sa rritja e popullsisë - ata janë shfaqje të një procesi zhvillimi, por që nuk mund të shpjegojnë se *përse* zhvillimi ndodh aty ku ndodh dhe kur ndodh...' ²¹⁰. Një ndër kontributet e mëdha në këtë fushë është ai i Huntington tek *Political Order in Changing Societies*, ku autori vlerëson zhvillimin në raport me sistemin politik dhe proceset e tij të brendshme. Në këtë raport, Huntington argumenton tezën e një

²¹⁰ Kaldor, N., (1980), *Essays on the economic stability and growth*, Holmes & Meier Publishers, Inc. Nju Jork, fq.236.

marrëdhënieje jo të drejtë lineare ndërmjet zhvillimit dhe demokracisë, por ndërmjetësimin e saj nga rendi politik (stabiliteti politik) siç e quan vetë në një vend të caktuar²¹¹. Nëpërmjet kësaj teze kuptojmë se zhvillimi ekonomik i një vendi nuk mund të vlerësohet në raport të thjeshtë linear dhe të drejtpërdrejtë me demokracinë, por me procesin e demokratizimit i cili për vendet në tranzicion ka gjasa më të mëdha të karakterizohet nga destabilitet politik apo mungesë rendi. Ndryshe, Alesina dhe Perotti (1994), e strukturojnë argumentin e mësipërm të Huntington në lidhje me këtë marrëdhënie në këtë mënyrë: ‘Kur vendet e varfra përjetojnë periudha zhvillimi dhe rritjeje të shpejtë ekonomike, destabiliteti social mund të rritet, sepse gjenerohen kërkesa të reja, procesi i urbanizimit përshpjetohet, si dhe e gjithë shoqëria është nën trazira. Por, kjo nuk është e vërtetë për vendet e pasura, të cilat ndryshe nga ato të varfra, tashmë i kanë të ngritura institucionet e duhura për tu përballur me transformimet sociale dhe ekonomike’²¹². Skematikisht kjo marrëdhënie do të paraqitet si më poshtë:




Figura 3.1: Korrelacioni ndërmjet zhvillimit dhe demokracisë²¹³

Në një metaforë ekonomike të rritjes, Romer shprehet se ‘ritja ekonomike ndodh kurdo kur njerëzit i marrin burimet dhe i riorganizojnë ato në mënyra që janë më të vlefshme’²¹⁴. Nëse do e shihnim këtë aspekt të rritjes brenda kontekstit politik ku realizohet aktiviteti ekonomik, atëherë ekzistencën e stabilitetit politik do e shihnim si një element të nevojshëm. Pikërisht, në varësi të ekzistencës së një mjedisi politikisht stabil apo jostabil, Olson bën dhe vlerësimin e niveleve të rritjes ekonomike për vendet e pazhvilluara si: rritje e qëndrueshme e ulët, rritje e shpejtë, rënie e madhe e rritjes, apo përkeqësim gradual i rritjes²¹⁵. Pra, shohim se stabiliteti politik shihet si një parakusht i rëndësishëm për rritjen ekonomike. Këtë e theksojnë më tej Williams *et al.*, të cilët në studimin e tyre për politikën dhe rritjen ekonomike ofrojnë një kornizë analitike të

²¹¹ Huntington, S., (2006), *Political Order in Changing Societies*, Yale University, Londër.

²¹² Alesina, A. Perotti, R., (1994), ‘The political economy of growth: a critical survey of the recent literature’, *The World Bank Economic Review*, Vol. 8(3): 351-371, fq. 359.

²¹³ Chen, *op.cit.*, fq. 20.

²¹⁴ Romer, M. P., ‘*Economic Growth: The concise encyclopedia of economics*’, i disponueshëm në: <<http://www.econlib.org/library/Enc1/EconomicGrowth.html>>

²¹⁵ Goldsmith, *op.cit.*, fq. 473.

mënyrës se si proceset politike ndikojnë tek rritja ekonomike. Si rrjedhim, sipas tyre, ‘proceset politike iu japin formë rezultateve ekonomike e sociale, duke qenë se ato promovojnë efikasitetin dhe barazinë ekonomike, duke çuar kështu drejt rritjes ekonomike dhe reduktimit të varfërisë’²¹⁶. Në po të njëjtën linjë, kësaj here duke u përqendruar në vendet me ekonomi në tranzicion në periudhën prej viteve 1990’, Eschenbach dhe Hoekman vlerësojnë marrëdhënien ndërmjet politikave reformuese në sektorin e shërbimeve dhe rritjes ekonomike të këtyre vendeve. Kjo, nisur nga vlerësimet e dekadës së fundit në lidhje me trendin rritës të pjesës që zënë shërbimet në PBB-në që këto vende po paraqesin. Autorët, duke kontrolluar një numër variablash shpjegues të përdorura në literaturën e rritjes (investimet, kriza, inflacioni), gjejnë ‘një lidhje pozitive statistikisht të rëndësishme ndërmjet rritjes së PBB për frymë dhe masave të marra në politikën reformuese të sektorit publik. Mirëpo, vlerësimet e tyre mbërrijnë edhe në një ‘rreth vicioz’ ku rritja dhe reforma politike përforcojnë efikasitetin e reformës, e cila nga ana e saj stimulon rritjen’²¹⁷.

3.3.1.1 Rritja ekonomike dhe destabiliteti politik

Megjithatë, këto pohime nuk janë të mjaftueshme për të dalë në përfundime përsa i përket natyrës së marrëdhënies ndërmjet politikës dhe ekonomisë, e aq më tepër ndërmjet stabilitetit politik dhe rritjes ekonomike. Korniza studimore paraqitet komplekse, nisur nga shumësia e aspekteve prej nga ku vlerësohet edhe marrëdhënia specifike ndërmjet destabilitetit politik dhe rritjes ekonomike. Pikërisht, në tentativën për të kanalizuar prurjet studimore në lidhje me këtë çështje specifike, si më poshtë evidentojmë drejtimet kryesore të analizës së studiuësve të ndryshëm. Këta të fundit kanë analizuar marrëdhënien ndërmjet nëngrupe variablash kryesisht të përqendruar tek: destabiliteti politik dhe rritja ekonomike; demokracia dhe rritja; korrupsioni, demokracia e rritja ekonomike; demokracia, institucionet dhe rritja. Nëpërmjet përdorimit të një qasjeje sistematike të evidentimit të këtyre kontributeve studimore, ne tentojmë të ofrojmë një panoramë më të qartë të rezultateve si dhe të mënyrës sesi këto nën nivele studimore ndërlidhen me njëri-tjetrin.

Kështu, sipas një vlerësimi të një niveli më të përgjithshëm Brunetti dhe Weder, trajtojnë marrëdhënien ndërmjet sistemit politik dhe performancës ekonomike të një vendi. Ideja e punimit të tyre fokusohet tek çështja se marrëdhënia mes këtyre dy variablave nuk duhet të përqendrohet në llojin e regjimit politik, por tek (de)stabiliteti politik. Ky i fundit, i operacionalizuar si probabiliteti i rënies së qeverisë²¹⁸, rezulton të jetë një vlerësues më i mirë në marrëdhënien ndërmjet demokracisë dhe performancës ekonomike. E rimarrë në studimin e mëvonshëm nga Pitlik, performanca ekonomike vlerësohet tashmë në marrëdhënie me institucionet demokratike në prodhimin e reformave të tregut. Kështu, autori arrin në përfundimin se reformat e politikave ekonomike në periudha krizash nuk kanë nevojë për një qeverisje autoritare. Përkundrazi, ‘demokracitë jo vetëm zbatojnë politika ekonomike më liberale në përgjithësi, por edhe karakterizohen nga një nivel më i

²¹⁶ Williams, Duncan, Landell-Mills, Unsworth, *opocit.*, fq. 5.

²¹⁷ Eschenbach, F. Hoekman, B., (2006), ‘Services Policy Reform and Economic Growth in Transition Economies’, *Review of World Economics / Weltwirtschaftliches Archiv*, Vol. 142(4):746-764, fq. 759.

²¹⁸ Brunetti, A. Weder, B., (1995), ‘Political Sources of Growth: A Critical Note on Measurement’, *Public Choice*, Vol. 82(1/2):125-134, fq. 126.

lartë përgjigjshmërie në periudha krizash të rritjes ekonomike²¹⁹. Në fakt, periudhat e krizës përveç se përbëjnë një moment të vështirë për ekonominë e një vendi, shoqërohen edhe me një situatë pasigurie me të cilën përballen më së shumti investitorët privatë. Kështu, pavarësisht aplikimit të politikave ekonomike të një karakteri liberal, në raste të caktuara, ato mund të shoqërohen edhe me pasiguri e situata politikisht jo të qëndrueshme. Në këtë kontekst, Ali teston marrëdhënien që mund të ekzistojë ndërmjet destabilitetit politik, pasigurisë së politikave dhe rritjes ekonomike. Nga rezultatet e testuara empirikisht prej tij vihet re se ‘matësit e zakonshëm të destabilitetit politik si grushtet e shtetit, revolucionet, etj, nuk arrijnë të kapin ndikimin e politikave vazhdimisht të ndryshueshme tek perceptimet e agjentëve të rëndësishëm ekonomikë’²²⁰. Si rrjedhim, evidentohet se nuk është destabiliteti politik që ndikon në mënyrë domethënëse rritjen ekonomike, por destabiliteti i politikave i cili ka një ndikim më të madh dhe më të rëndësishëm.

Grushtet e shtetit dhe revolucionet konfirmohen edhe nga Jong-A-Pin si shpjegues jo të mirë të variacionit të rritjes ekonomike. Duke e vlerësuar destabilitetin politik si një fenomen katërdimensional (përfshirë këtu protestat civile, agresionin politikisht të motivuar, destabilitetin brenda regjimit politik, dhe destabilitetin e regjimit politik), autori teston empirikisht ndikimet e secilit prej këtyre dimensioneve tek rritja ekonomike afatgjatë. Autori evidenton se destabiliteti i regjimit politik dhe protestat civile janë të lidhura në mënyrë të rëndësishme me rritjen ekonomike afatgjatë dhe se modeli i cili përfshin këto katër dimensioneve të destabilitetit politik është një shpjegues më i mirë i ndryshimit të rritjes ekonomike sesa variabli i destabilitetit politik i parë vetëm si shuma e revolucioneve dhe grushteve të shtetit²²¹.

Marrëdhënia shkakësore ndërmjet destabilitetit politik dhe rritjes ekonomike konfirmohet edhe nga Zureiqat. Nëpërmjet përdorimit të modelit të regresionit linear të shumëfishtë, autori në testimin e kësaj marrëdhënieje në 25 shtete nga rajone të ndryshme për periudhën 1985-2002, konfirmon hipotezën sipas së cilës destabiliteti politik shkakton një rënie të rritjes ekonomike²²². Ajo që është interesante në këtë punim është vlerësimi i destabilitetit politik nisur nga të dhënat e nivelit të demokratizimit të Polity 2. Ndërkohë që, sipas Zureiqat rezultatet nuk konfirmojnë hipotezën sipas së cilës destabiliteti politik dhe rritja ekonomike janë endogjenë dhe përcaktues të njëri-tjetrit.

Aisen dhe Vega, në një studim të fundit të tyre e shohin këtë marrëdhënie në një kampion më të madh shtetesh (169 shtete) për periudhën 1960-2004. Në linjë me një pjesë të konsiderueshme të literaturës, në vlerësimin e destabilitetit politik nëpërmjet ndryshimeve të kabinetit, rezultatet e modelit të tyre empirik konfirmojnë sërish rezultatet e evidentuara më sipër nga të tjerë studiues. Sipas Aisen dhe Vega, destabiliteti politik ndikon negativisht në reduktimin e ndjeshëm të rritjes ekonomike. Sipas tyre, ‘qeveritë në

²¹⁹ Pitlik, H., (2008), ‘The Impact of Growth Performance and Political Regime Type on Economic Policy Liberalization’, *KYKLOS*, Vol. 61(2):258–278, fq. 275.

²²⁰ Ali, M. A., (2001), ‘Political Instability, Policy Uncertainty, and Economic Growth: An Empirical Investigation’, *Atlantic Economy Journal*, Vol. 29(1): 87-106, fq. 102.

²²¹ Jong-A-Pin, R., (2006), ‘On the measurement of political instability and its impact on economic growth’, fq.1-33, fq.22/ i disponueshëm në:
<<http://som.eldoc.ub.rug.nl/FILES/reports/themeC/2006/06C05/06C05.pdf>>

²²² Zureiqat, M. H., (2005), ‘Political Instability and Economic Performance: A Panel Data Analysis’, *Award Winning Economics Papers*, Paper 1. fq. 1-35, fq. 22.

vende politikisht të fragmentarizuara me nivele të larta të destabilitetit politik duhet të adresojnë shkaqet e tij kryesore dhe jo të zbusin ndikimet e tij në hartimin dhe zbatimin e politikave ekonomike, sepse vetëm në këtë rast shtetet mund të kenë politika ekonomike të qëndrueshme të cilat të mund të çojnë drejt ritmeve më të larta të rritjes ekonomike²²³.

Alesina *et al.*, propozojnë konsiderimin e destabilitetit politik si ‘gjasat e ndryshimit të qeverisë’, tashmë të parë jo si një variabël ndërmjetësues, por në një marrëdhënie të drejtpërdrejtë me rritjen ekonomike. Në vlerësimin e ndikimit të destabilitetit politik tek rritja ekonomike në një kampion prej 113 vendesh në periudhën ndërmjet viteve 1950-1982, Alesina *et al.*, mbërrijnë në përfundimin se destabiliteti politik redukton rritjen ekonomike. Sipas tyre, ‘ky rezultat është veçanërisht i fortë në rastin e ndryshimeve jokushtetuese të ekzekutivit, siç janë grushtet e shtetit, si dhe ndryshimet të cilat ndryshojnë përbërjen ideologjike të ekzekutivit²²⁴. Nga ana tjetër, sipas autorëve, ndikimi i rritjes ekonomike në destabilitetin politik të vendeve të marra në studim paraqitet më pak i qartë. Ndikimi më i madh i një rritjeje të ulët ekonomike vërehet për rëniet e qeverive për shkak të grushteve të shtetit, ndërsa për llojet e tjera të ndryshimit të qeverive Alesina *et al.*, nuk shohin një ndikim të qartë²²⁵.

Ashtu si Alesina *et al.*, edhe Ozler dhe Tabellini (1991), në studimin e marrëdhënies ndërmjet destabilitetit politik dhe borxheve të jashtme që një shtet krijon, e konsiderojnë destabilitetin politik si probabilitetin e humbjes së zyrës apo si tendencën e një ndryshimi të pashmangshëm të qeverisë²²⁶. Modeli i tyre kap dy tipare të rëndësishme të sistemit politik: jo vetëm destabilitetin politik, por edhe polarizimin politik. Këtë tipar të fundit ata e shohin si shkallën e mosmarrëveshjeve që ekzistojnë brenda sistemit politik në lidhje me përbërjen e të mirave publike. Autorët i referohen këtyre dy tipareve të sistemit politik, sepse në vlerësimin e tyre destabiliteti i lartë dhe shkalla e lartë e polarizimit çojnë drejt një preference për konsum për të tashmen sesa për të ardhmen nga ana e qeverisë.

3.3.1.2 Rritja ekonomike dhe demokracia

Studime të tjera vlerësojnë më tej çështjen e marrëdhënies ndërmjet rritjes ekonomike dhe demokracisë, si dhe rolit të institucioneve në ecurinë e sektorit ekonomik. Në fakt, rëndësinë e vlerësimit dhe testimit të këtyre variablave në marrëdhënie me njëra tjetrën e shtroi fenomeni i dekolonizimit i cili në vitet 60’ u shoqërua me shfaqjen e shteteve të reja në Afrikë dhe Azi. Qëndrimet e para në lidhje me këtë marrëdhënie i parashtruan Galenson dhe de Schweinitz. Sipas, tyre nuk mund të flitej për demokraci dhe rritje ekonomike në të njëjtën kohë. Kjo sepse, në vendet e varfra demokracia ndikon në rritjen e konsumit, duke cënuar nga ana tjetër investimet e si rrjedhim edhe rritjen ekonomike të vendit²²⁷.

²²³ Aisen, Veiga, *op.cit.*, fq. 25.

²²⁴ Alesina, Özler, Roubini, Swagel, *op.cit.*, fq. 205.

²²⁵ *ibid.*, fq. 190.

²²⁶ Ozler, S. Tabellini, G., (1991), ‘External debt and political instability’, *NBER Working Papers Series*, No. 3772, Zyra Kombëtare e Kërkimit Ekonomik, 1-27, fq. 1 -13.

²²⁷ Galenson, W., (1959), *Labor and Economic Development*. New York: John Wiley and

Ndryshe dëshmon Friedman (1962) tek 'Kapitalizmi dhe liria'. Sipas tij dy liritë kryesore, liria ekonomike dhe liria politike janë përforcuese dhe balancuese të njëra-tjetrës, dhe pikërisht ndikimi i demokracisë tek rritja mund të shihet nëpërmjet cilësisë së institucioneve ekonomike të ngritura. Apo ndryshe: 'lloji i organizimit ekonomik që siguron drejtpërsëdrejti liri ekonomike, konkretisht kapitalizmi konkurrues, nxit gjithashtu lirinë politike, pasi ai ndan pushtetin ekonomik nga pushteti politik, dhe në mënyrën e tij, lejon njërin që të balancojë tjetrin'²²⁸. Po të njëjtin argument mbështet edhe Barro për të cilin zhvillimi i të drejtave politike në një vend të caktuar ecën paralelisht me zhvillimet e sistemit ekonomik dhe standardin e jetesës së një vendi. Janë këta elementë të fundit që shndërrohen në përcaktues edhe të statusit të lirive politike të një vendi. Dhe në funksion të kësaj, nëse nevojitet të nxitet e mbështetet rritja tek vendet më pak të zhvilluara, atëherë sipas Barro, së pari duhet të institucionalizohen në këto vende liritë ekonomike (tregu i lirë, e drejta e pronës). Pra, nëse liria ekonomike mund të vendoset në një vend, atëherë do të nxitet rritja ekonomike, dhe rrjedhimisht vendi do të tentojë vetë të jetë më demokratik, pa iu imponuar kjo nga jashtë²²⁹.

Realiteti empirik prezanton edhe kundërshtues ndaj këtij qëndrimi duke konfirmuar edhe një herë rëndësinë që ka konteksti e mënyra sesi sendërtohen marrëdhëniet ndërmjet aktorëve politikë e agjentëve ekonomikë në një vend të caktuar. Kjo sepse, në disa raste, pavarësisht mungesës së mbrojtjes së duhur ligjore të së drejtave të pronësisë apo kontratave, në sajë të marrëdhënieve informale ndërmjet atyre që kanë pushtetin dhe agjentëve të tjerë ekonomikë të cilët vendosin të investojnë, vende të caktuara shfaqin rritje të nivelit të investimeve dhe rritjes ekonomike. Këtë konfirmon edhe Moore dhe Schmitz sipas së cilëve rasti i Kinës është dëshmuar i situatës, kur kemi një rritje të investimeve me një bazë më shumë marrëdhëniesh informale sesa marrëdhëniesh ligjore²³⁰.

Kështu, në analizimin e marrëdhënies ndërmjet rritjes ekonomike, demokracisë, dhe institucioneve, Polterovich dhe Popov trajtojnë dy hipoteza të ndërlidhura me njëra-tjetrën. Së pari, 'në vende ku ligji dhe rendi janë mjaftueshmërisht të fortë, demokratizimi stimulon rritjen ekonomike, ndërsa në vende me rend dhe ligje të dobëta demokratizimi e cënon rritjen; së dyti, autorët testojnë edhe faktin se kur demokratizimi ndodh në kushtet e ligjeve dhe rendit të dobët kemi zgjerimin e ekonomisë informale, përkeqësimit të cilësisë së qeverisjes dhe pakujdesisë në politikat makroekonomike'²³¹. Fenomenin e rendit, autorët e shohin të ndërlidhur me ligjin e për këtë e përkufizojnë rendin e ligjin në një shtet të caktuar si aftësinë e shtetit për të përforcuar rregullat dhe rregulloret bazuar jo në praktika arbitrare, por në rregulla ligjore të mirëpërcaktuara. Nëpërmjet përdorimit të modelit të regresionit linear, autorët arrijnë të vërtetojnë hipotezën e dytë, ku në bazë të rezultateve të testimit, shihet se në vende me 'një traditë të varfër të ligjit dhe rendit,

Sons; De Schweinitz, K., (1959), 'Industrialization, labor controls, and democracy', *Economic Development and Cultural Change*, Vol. 7(4): 385-404.

²²⁸ Friedman, M., (2005), *Kapitalizmi dhe liria*, Dita 2000, Tiranë, fq. 10.

²²⁹ Barro, J. R., (1996), 'Democracy and growth', *Journal of Economic Growth*, Vol. 1: 1-27, fq. 24.

²³⁰ Moore, M. Schmitz, H., (2008), 'Idealism, Realism and the Investment Climate in Developing Countries', *Working Paper*, Nr. 307, Instituti i Studimeve të Zhvillimit, Britani e Madhe, fq. 8.

²³¹ Polterovich, V. Popov, V., (2007), 'Democratization, quality of institutions, and economic growth', *TIGER Working Paper Series Nr. 102*, Transformation, Integration, and Globalization Economic Research, 1-46, fq. 1.

demokratizimi i shpejtë çënon kapacitetin institucional dhe cilësinë e politikës makroekonomike me ndikim edhe në rritjen ekonomike²³².

Në po të njëjtin drejtim mbërrijnë rezultatet e argumentit të ekonomisë politike të studiuar nga Plümpfer dhe Martin (2003) të përqendruar në marrëdhënien ndërmjet shpenzimeve qeveritare, demokracisë dhe rritjes ekonomike. Duke u përqendruar në marrëdhënien në formën *u* të përmbysur ndërmjet niveleve të demokracisë dhe rritjes ekonomike, autorët shohin se lloji i regjimit të një vendi ndikon në mënyrë përcaktuese instrumentet që qeveritë përdorin për të tërhequr mbështetjen politike. Kështu, sipas Plümpfer dhe Martin, sa më shumë demokratik të jetë një vend, aq më e mirë është cilësia e shpenzimeve qeveritare²³³. Në pikëpamje të drejtimit të shkakësisë, edhe për këta autorë nëpërmjet modelit të prodhuar argumentojnë se pjesëmarrja politike (nëpërmjet së cilës vlerësohet demokracia) ndikon në shpenzimet qeveritare (duke qenë se ky është instrumenti kryesor i qeverisë për të fituar mbështetjen politike), dhe këto të fundit ndikojnë në performancën ekonomike²³⁴.

I trajtuar nga një argument i karakterit financiar, edhe studimi i Dawson (2008) mbështet të njëjtën linjë rezultatesh. Kështu, duke përdorur të dhëna panel për 44 vende në zhvillim gjatë periudhës 1974-2001, ai trajton marrëdhënien ndërmjet zhvillimit financiar dhe rritjes ekonomike. Përfundimet e punimit të tij ritheksojnë faktin se në ato vende në zhvillim ku aplikohen politika të cilat promovojnë zhvillimin e sektorit financiar nëpërmjet rritjes së likuiditeteve, promovohet gjithashtu edhe rritja ekonomike²³⁵.

Një konceptim shumë të veçantë në lidhje me variablin demokraci e mënyrën e operacionalizimit të saj ofrohet edhe nga Gerring *et al.*, (2005), të cilët në vlerësimin e marrëdhënies së demokracisë me rritjen ekonomike nisen nga një perspektivë historike duke sugjeruar njohjen e variablit të demokracisë më shumë si një variabël *stoku* sesa si një variabël *niveli*²³⁶. Kjo sepse, nëse demokracia ndikon tek rritja ekonomike aktuale e një vendi, atëherë ky ndikim prodhohet jo vetëm nga statusi i demokracisë i periudhës kur vlerësohet rritja, por edhe nga historia e regjimit të vendit në fjalë. Thënë ndryshe ‘sa më gjatë të ketë qëndruar demokratik një shtet i caktuar, aq më i madh do të jetë kapitali i tij fizik, njerëzor, e politik dhe aq më e mirë do të jetë rritja ekonomike’²³⁷. Pra, për Gerring *et al.*, nuk është niveli aktual i demokratizimit të një vendi, treguesi i cili ndikon tek rritja ekonomike, por stoku i akumuluar nga koha e demokracisë. Nëpërmjet përdorimit të modelit të regresionit linear, autorët arrijnë në përfundimin se demokracia ndikon tek rritja ekonomike, dhe kjo marrëdhënie është më e fortë kur variabli i demokracisë konsiderohet si një koncept kumulativ dhe i përshkallëzuar.

²³² *ibid.*, fq.38.

²³³ Plümpfer, Th. Martin, W. C., (2003), ‘Democracy, Government Spending, and Economic Growth: A Political-Economic Explanation of the Barro-Effect’, *Public Choice*, Vol. 117(1/2): 27- 50, fq. 44.

²³⁴ *ibid.*, fq. 44.

²³⁵ Dawson, P. J., (2008), ‘Financial developmet and economic growth in developing countries’, *Progress in Development Studies*, Vol. 8(4): 325–331, fq. 325.

²³⁶ Gerring, J. Bond, P. Brandt, W. Moreno, C., (2005), ‘Democracy and Historical Growth A historical Perspective’, *World Politics*, Vol. 57(3): 323-367, fq. 324.

²³⁷ *ibid.*, fq. 324.

Në fakt, të fokusuar në një dimension më të ngushtë sesa vetë demokracia, siç është qeverisja e mirë, Kaufmann dhe Kraay (2002), tentojnë të shohin nivelin e korrelacionit dhe kahun e shkakësisë pikërisht ndërmjet këtij variabli dhe rritjes ekonomike. Qeverisja e mirë në këtë rast konceptohet si 'tërësia e institucioneve dhe traditave nëpërmjet të cilave ushtrohet autoriteti në një shtet të caktuar'²³⁸. Duke përdorur të dhënat e Bankës Botërore për treguesit e qeverisjes për 175 vende, gjetjet e autorëve konfirmojnë studimet e sipërpërmendura në lidhje me natyrën dhe kahun e marrëdhënies ndërmjet vetë qeverisjes së mirë dhe rritjes ekonomike. Rezultatet e tyre konfirmojnë ekzistencën e një korrelacioni të fortë dhe pozitiv me drejtim nga qeverisja e mirë tek rritja ekonomike. Ndërkohë, Kaufmann dhe Kraay testojnë edhe mundësinë e ekzistencës së një 'rrethi vicioz', nëse edhe vetë rritja ekonomike është shkaktare e qeverisjes së mirë. Vlerësimet e tyre rezultojnë në një përgjigje negative përsa i përket mundësisë së ndikimit të rritjes ekonomike tek qeverisja e mirë²³⁹.

Edhe për Mobarak, nuk duhet të përqendrohemi në marrëdhënien e drejtpërdrejtë ndërmjet demokracisë dhe rritjes ekonomike. Modeli i tij dy-ekuacionësh në rreth 80 shtete për një periudhë prej tre dekadash identifikon këtë radhë ndikimesh: ekzistenca e demokracisë dhe niveleve të larta të saj kanë një ndikim negativ tek paqëndrueshmëria e rritjes. Ndërsa paqëndrueshmëria në vetvete ul rritjen ekonomike²⁴⁰. Pra, në vend të vlerësimit të marrëdhënies së drejtpërdrejtë demokraci-ritje ekonomike, Mobarak prodhon një model ku identifikon një kanal komunikues dhe ndërlidhës ndërmjet këtyre dy variablave që është paqëndrueshmëria. Kështu, nëse këtë marrëdhënie do e projektonim në një plan krahasues ndërmjet vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim, do të shihnim se ajo merr rëndësi sidomos për grupin e fundit të shteteve. Kjo sepse, një pjesë e tyre jo vetëm janë nën procesin e demokratizimit, por edhe sepse rritja e tyre është karakterizuar nga periudha të njëpasnjëshme rritjeje e më pas rënijeje. Për këtë, paqëndrueshmëria pritet të ketë një ndikim negativ tek rritja, prishmëri kjo e cila konfirmohet edhe nga Mobarak në studimin e tij.

Ajo çka mund të evidentojmë nga prezantimi i studimeve të autorëve të mësipërm në lidhje me këtë marrëdhënie, janë dy linja kryesore qëndrimi; ajo e ndikimit pozitiv që ka demokracia tek rritja ekonomike dhe linja e një ndikimi frenues tek rritja. Qëndrimi i parë ligjërohet mbi bazën e efijencës shpërndarëse si një tipar i formatit demokratik, ndërsa qëndrimi i dytë nisët nga logjika e rritjes së konsumit nën demokraci, e cila rrjedhimisht ka edhe efekt ulës për investimet. Ndryshe, Przeworski²⁴¹ e shpjegon zinxhirin e arsytimit për të dy qëndrimet në këtë mënyrë: njerëzit e varfër dëshirojnë të konsumojnë menjëherë, kur punëtorët mund të organizohen, ata rrisin pagat, reduktojnë përfitimet, dhe ulin investimet, dhe kur qytetarët mund të votojnë qeveritë të shpërndajnë të ardhurat larg nga investimet, duke ulur investimet reduktohet rritja ekonomike. Nga pikëpamja e efijencës shpërndarëse, ideja qëndron tek fakti se demokracitë të shpërndajnë më mirë burimet e disponueshme të tyre në përdorime produktive, dhe duke qënë se në regjimet

²³⁸ Kaufmann, D. Kraay, A., (2002), 'Growth without governance', 5th Economia Panel Meeting, Universiteti i Harvardit, Banka Botërore, 1-60, fq. 6.

²³⁹ *ibid.*, fq. 1-60.

²⁴⁰ Mobarak, *op.cit.*, fq. 348.

²⁴¹ Przeworski, A., (2004), 'Democracy and economic development', në Edward D. Mansfield dhe Richard Sisson (eds.), *The Evolution of Political Knowledge*. Columbus: Ohio State University Press, 1-27, fq. 14.

autoritare drejtuesit nuk janë llogaridhënës ndaj elektoratit, ata nuk kanë stimuj për të maksimizuar prodhimin total por vetëm përfitimet e tyre. Ndërsa demokracitë, nëpërmjet mbrojtjes së të drejtave të pronësisë, e duke mundësuar shpërndarjen e informacionit, krijojnë një mjedis më pozitiv e të pranueshëm për investitorët.

3.3.1.3 Rritja ekonomike dhe institucionet

Një tjetër nivel studimor në pikëpamje të rritjes ekonomike dhe të marrëdhënies së saj me variabla të tjerë është edhe kuadri institucional. Për pasojë, një pjesë e konsiderueshme e literaturës së ekonomisë politike, përpos përfshirjes së variablit të destabilitetit politik, studion edhe ndikimin e mundshëm të institucioneve tek rritja. Institucionet nga njëra anë bëjnë të mundur rregullimin e aktivitetit ekonomik, e në varësi të natyrës së tyre, mund të lehtësojnë ose vështirësojnë transaksionet apo marrëdhëniet ekonomike mes agjentëve ekonomikë. Pikërisht, në lidhje me këtë pozicion të institucioneve mes sistemit social dhe atij ekonomik shprehet North, sipas të cilit ‘institucionet luajnë një rol shumë themelor në shoqëri: ato janë faktori kyç, përcaktues i performancës në afatgjatë të ekonomive’²⁴². Nga ky pohim mund të supozojmë se ekziston një marrëdhënie shkakësie me kah nga institucionet tek rritja ekonomike e cila është në qendër të shpjegimit të performancës ekonomike të vendeve të ndryshme. Dhe pikërisht, nëse u referohemi studimeve edhe të natyrës empirike, sidomos atyre të viteve të fundit, vëmë re konfirmimin, pavarësisht diferencave në mënyrën e testimi të marrëdhënies apo konceptimit të variablit në fjalë (institucioneve), e pohimit të mësipërm të North.

Kështu, Aron bazuar në rishikimin e literaturës në lidhje me rolin e institucioneve arrin në përfundimin se të dhënat empirike tregojnë ekzistencën e një lidhjeje ndërmjet cilësisë së institucioneve, investimeve dhe rritjes’. Kjo sepse, sipas autores, ‘korniza institucionale ndikon tek rritja për shkak se është pjesë e rëndësishme e sasisë së shpenzuar si në kostot e transaksioneve dhe në kostot e transformimit (në procesin e prodhimit)²⁴³. Dy elementë të rëndësishëm mund të identifikojmë në qëndrimin e Aron përsa i përket institucioneve dhe përfshirjes së tyre në modelet e rritjes apo të investimve: së pari, konsiderimin e variablit të institucioneve si një variabël që lidhet me apektin e cilësisë apo performancës²⁴⁴ së institucioneve formale apo informale e jo me karakteristikat apo atributet përshkruese të tyre, si dhe së dyti, mënyrën e përfshirjes së ndikimit të mundshëm të destabilitetit politik tek modelet e rritjes. Specifike në këtë aspekt është pikërisht konceptimi i destabilitetit politik si një kategori matëse institucionale e mëvetësuar, përveç kategorive të karakteristikave politike dhe atyre sociale²⁴⁵.

²⁴² North, D., (1990), *Institutions, Institutional Change, and Economic Performance*, Cambridge University Press, Nju Jork, fq. 107.

²⁴³ Aron, J., (2000), ‘Growth and Institutions: A Review of the Evidence’, *The World Bank Research Observer*, Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/ Banka Botërore, Vol. 15(1): 99–135, fq. 104.

²⁴⁴ Shënim: Përqëndrimi tek cilësia apo performanca e institucioneve formale dhe informale përfshirjen e elementëve të tillë si: liritë civile, të drejtat e pronësisë, respektimi i kontratave, etj.

²⁴⁵ *ibid.*, fq. 123.

Si politika dhe institucionet bëhen pjesë e Modelit të Rritjes të Solow?

Modeli i rritjes ekonomike i Solow bazohet në premisën që prodhimi (output-i) prodhohet duke përdorur një kombinim të punës (L) dhe kapitalit (K), nën të ardhura konstante, kështu që dyfishimi i inputeve rezulton në një dyfishim edhe të output-it. Sasia e output-it (y) përcaktohet gjithashtu nga efizienz (A) me të cilën përdoren kapitali dhe puna. Ndryshe, $y = Af(L,K)$

Me supozimin e mëtjshëm të tregjeve konkurruese, rrjedhimisht, norma e rritjes së ekonomisë është shuma e ponderuar e normave të rritjes të parametrin të efizienz, g_A (e quajtur edhe progresi teknik), të forcës punëtore g_L , dhe të stokut të kapitalit g_K . Ndryshe, $g_y = g_A + a_L g_L + a_K g_K$

Regresionet e rritjes për një grup shtetesh studiojnë përcaktuesit e rritjes duke e përdorur eksperiencën e çdo vendi si një pikë të dhënash. Zakonisht ka dy lloj regresionesh: a) ato që përlllogarisin ndryshimet në nivelin e prodhimit (output-it), duke përdorur ekuacionin e parë, dhe b) ato regresione që përlllogarisin ekuacionin e dytë.

Si mund të përfshihen diferencat shtetërore institucionale në këto regresione? Për të dyja kategoritë, cilësia e institucioneve mund të ndikojë progresin teknik... Regresionet të cilat e neglizhojnë rolin e efizienz fillestare teknike (nga institucionet) mund të mbitheksojnë rolin e investimeve tek rritja ekonomike. Në shumë vende në zhvillim ka pragje të niveleve të infrastrukturës, të drejtave të pronësisë, dhe arsimit (të gjitha prej të cilave janë të ndjeshme nga institucionet) që duhet të arrihen para se të realizohet prodhimi. Prania e këtyre pragjeve nënkupton se supozimi për të ardhura konstante mund të mos jetë i vlefshëm. Kështu, përfshirja e variabla insitucionalë specifike shtetërore mund të ndikojë përlllogaritjen e përgjigshmërisë së prodhimit ndaj kapitalit (fizik dhe human) në të dyja kategoritë e regresioneve.

Burimi: Aron, J., (2000), 'Growth and Institutions: A Review of the Evidence', The World Bank Research Observer, Banka Ndwrkombwtare pwr Rindwrtim dhe Zhvillim/Banka Botërore, Vol. 15(1): 99–135, fq. 102.

Cilësia e institucioneve dhe roli i akumulimit të kapitalit njerëzor janë dy variabla që trajtohen edhe nga Mamoona e Murshed në marrëdhënie me mirëqënien ekonomike në një vend të caktuar dhe më specifikisht në marrëdhënie me rritjen ekonomike. Në fakt, me cilësi të institucioneve autorët nënkuptojnë faktorët të cilët çojnë drejt qeverisjes së mirë, si: stabiliteti politik, llogaridhënia, shteti i së drejtës, cilësia burokratike, si dhe kontrolli i korrupsionit. Të parë në këtë këndvështrim, këto institucione testohen në krahasim me kapitalin njerëzor në lidhje me mënyrën e ndikimit të tyre tek rritja ekonomike. Kështu, autorët arrijnë në përfundimin se 'si zhvillimi i kapitalit njerëzor, ashtu edhe funksionimi insitucional janë po aq të rëndësishëm për mirëqënien ekonomike. Madje, zhvillimi i kapitalit njerëzor nëpërmjet arsimit, ndihmon në përmirësimin e funksionimit insitucional duke ndikuar kështu edhe tek rritja ekonomike e një vendi'²⁴⁶.

²⁴⁶ Mamoona, Murshed, *op.cit.*, fq. 462-463.

Ndryshe nga Aron dhe Mamoona e Murshed të cilët sugjerojnë matjen e variablit të institucioneve në një vend nisur nga performanca apo cilësia e tyre, Persson (2002) thekson më shumë aspektin strukturor të institucioneve në mënyrën se si ata më pas ndikojnë politikat publike. Kuadrin institucional të një vendi të caktuar, Persson e sheh si rrjedhojë të dy faktorëve të rëndësishëm: së pari, formatit qeverisës (presidencial apo parlamentar) dhe llojit të sistemit zgjedhor të aplikuar në një vend. Sipas tij, duke parë këta dy faktorë mund të mbërrimë edhe në vlerësimin e kornizës institucionale të një vendi dhe ndikimin e saj tek politikat publike. Kështu, nëpërmjet testimit të modeleve empirike të regresionit të shumëfishtë linear, autori evidenton se ‘empirikisht formatet presidenciale të qeverisjes janë të lidhura me qeveri më të vogla sesa format parlamentare, me përgjigje më pak të qëndrueshme dhe më të vogla ndaj shokut të së ardhurave, me një cikël post-zgjedhor më të fortë në shpenzimet dhe të ardhurat agregate, por me një cikël më të dobët në transfertat sociale; ndërkohë, që sistemet zgjedhore mazhoritare janë të lidhura me programe shpenzimesh më të vogla dhe me më pak korrupsion sesa sistemet proporcionale zgjedhore’²⁴⁷.

Në po të njëjtën linjë studimi, Henisz përqendrohet tek institucionet dhe rritja, por nga një perspektivë më të ngushtë të të parit të institucioneve, atë të institucioneve politike. Studimi i tij nuk ofron përgjigje përfundimtare në lidhje me natyrën e marrëdhënies ndërmjet institucioneve politike dhe rezultateve ekonomike, por risia e tij qëndron në faktin se mënyra nëpërmjet së cilës trajtohen institucionet politike është po aq e vlefshme në testimin e marrëdhënies me rritjen ekonomike sa edhe treguesit e përdorur më parë²⁴⁸. Në këtë këndvështrim, studimin e institucioneve politike, Henisz e sheh në kontekstin e sistemit zgjedhor që një vend aplikon, mundësisë së përdorimit të së drejtës së vetos nga degët e pavarura të qeverisë si dhe shpërndarjes së preferencave tek këto degë.

I fokusuar në vendet në zhvillim, edhe Mijiyawa teston empirikisht dhe evidenton rolin ndikues të institucioneve tek rritja ekonomike e qëndrueshme. Në fakt, ajo çka paraqet veçanti në këtë studim është ndarja në kategori e institucioneve dhe vlerësimit të secilit prej tyre në marrëdhënie me rritjen ekonomike të qëndrueshme. Për këtë, autori dallon ndërmjet institucioneve demokratike, atyre të të drejtave të pronësisë private, dhe institucioneve ekonomike rregullatore. Duke identifikuar ‘institucionet e mira’ si ato institucione që u garantojnë investitorëve privatë koso relativisht më të ulëta për investimet e tyre, dhe që garantojnë përfitimin e produktit të investimit të investitorëve privatë’²⁴⁹, Mijiyawa nga rezultatet e testimit empirik evidenton se në indeksin e përbërë politiko-ekonomik të institucioneve, të gjitha kategoritë e tyre ndikojnë tek rritja ekonomike, por me një rol më të rëndësishëm të institucioneve rregullatore pikërisht tek ky variabël. Nëse do t’i referohemi një skeme të marrëdhënies së shkakësisë ndërmjet institucioneve për të mbërritur tek rritja e qëndrueshme ekonomike, shohim si më poshtë²⁵⁰:

²⁴⁷ Persson, T., (2002), ‘Do Political Institutions Shape Economic Policy?’, *Econometrica*, Vol. 70(3): 883-905, fq. 903.

²⁴⁸ Henisz, J. W., (2000), ‘The institutional environment for economic growth’, *Economics and Politics*, Vol. 12(1): 1-31, fq. 26-27.

²⁴⁹ Mijiyawa, G. A., (2008), ‘Sustained Economic Growth: Do Institutions Matter, and Which One Prevails?’, *Cato Journal*, Vol. 28(3): 385-420, fq. 386.

²⁵⁰ *ibid.*, fq. 396.

Institucione “të mira” → Rritje e Investimeve Private → Rritje e Faktorit të Përgjithshëm të Prodhimit → Përfitueshmëri Ekonomike Konkuruuese → Rritje e Qëndrueshme Ekonomike

Duke u përqendruar tek ekonomitë në tranzicion, marrëdhënien ndërmjet institucioneve dhe rritjes ekonomike e trajtojnë edhe Beck dhe Laeven. Autorët tenojnë të zhvillojnë një logjikë të mënyrës se si janë ngritur e zhvilluar institucionet në vendet post-komuniste e ndikimit që ka patur kuadri institucional tek rritja ekonomike e këtyre vendeve. Duke u nisur nga një trajtim i ekonomisë politike, Beck dhe Laeven shpjegojnë se variacioni i paraqitur mes këtyre vendeve në aspektin e ngritjes dhe ndërtimit të institucioneve shpjegohet nga varësia që vende të caktuara kanë nga burimet natyrore si dhe nga kohëzgjatja e eksperiencës demokratike. Në fakt, autorët dalin në përfundimin se këta dy faktorë janë shkaktarë të vonimit të ndërtimit të institucioneve të tregut e një sistemi politik më të hapur. Nga ana tjetër, në dekadën e parë të tranzicionit, autorët tregojnë se institucionet janë një variabël i rëndësishëm në shpjegimin e zhvillimit ekonomik dhe rritjes në këto vende²⁵¹.

Varësinë nga burimet natyrore në marrëdhënie me stabilitetin politik e trajton edhe Dunning, por nga një perspektivë tjetër. Nisur nga presmisa kryesore se elitat politike në vendet që janë të varura nga burimet natyrore duhet të vendosin të zgjedhin ndërmjet përfitimeve të diversifikimit ekonomik por dhe konkurrencës politike që ky i fundit mund të prodhojë në një vend të caktuar, nëpërmjet evidentimit të shembujve konkretë autori sfidon pjesën më të madhe të literaturës së kësaj fushe. Kjo sepse, nëse në përgjithësi vlerësohen gjasat e prodhimit të destabilitetit politik, për ato vende të cilat kanë varësi nga burimet natyrore dhe të cilat shfaqin performancë ekonomike të dobët, Dunning nëpërmjet aplikimit të një modeli dinamik argumenton të kundërtën. ‘Varësia nga burimet është rezultat i vendimmarrjes strategjike të elitës politike për të kufizuar sfidimin e pushtetit nga kundërshtarët e tyre politikë. Për këtë arsye, tkurrja ekonomike nuk shkakton ndryshime regjimi apo destabilitet politik, sepse pikërisht promovimi i varësisë tek burimet natyrore bllokoi cenimin e pushtetit në fuqi’²⁵².

3.3.1.4 Rritja ekonomike dhe korrupsioni

I konceptuar në një pjesë të mirë të literaturës së sipërpërmendur si një element me të cilin identifikohet apo cenohet qeverisja e mirë dhe cilësia e institucioneve, korrupsioni zë një vend të veçantë në literaturën e ekonomisë politike përse i përket ndikimit të tij të mundshëm tek rritja ekonomike e një vendi të caktuar. Kështu, Mauro, për testimin e marrëdhënies ndërmjet korrupsionit dhe rritjes ekonomike krijon një indeks bazuar në të dhënat e Business International duke i grupuar ato në dy grupe kryesore pjesë e indeksit, si: efikasitet burokratike dhe stabilitet politik. Përfundimet e studimit të tij mbërrijnë tek

²⁵¹ Beck, Th. Laeven, L., (2005), ‘Institution building and growth in transition economies’, World Bank, 1-56, fq. 1.

²⁵² Dunning, Th., (2005), ‘Resource dependence, economic performance, and political instability’, *The Journal of Conflict Resolution*, Vol. 49(4): 451-482, fq.474-475.

ideja se ‘korrupsioni ul investimet private, duke ulur kështu rritjen ekonomike. Marrëdhënia negative ndërmjet korrupsionit dhe investimeve, si dhe rritjes, është domethënëse, jo vetëm në një kuptim statistikor, por edhe në një kuptim ekonomik’²⁵³. Po kështu, autorë të tjerë si Minassian vlerësojnë se, nëse një vend identifikohet me nivele të larta të korrupsionit, atëherë ky vend nuk mund të presë përmirësime tek treguesit e tij makroekonomike, nëse këto nivele të korrupsionit janë të qëndrueshme. Kështu, duke qënë se ‘korrupsioni shihet si një hallkë e cila e cenon zhvillimin, çdo avancim ekonomik do të jetë në varësi të zgjidhjes së suksesshme të këtij problemi’²⁵⁴.

Kontributet e mësipërme kërkimore, në fakt konfirmojnë tezën e pjesës më të madhe të literaturës së kësaj çështjeje se korrupsioni ka një ndikim të drejtpërdrejtë dhe negativ tek rritja ekonomike.

Duke e parë këtë marrëdhënie nga këndvështrimi edhe i ndikimit të mundshëm të demokracisë tek rritja, Drury *et al.*, në studimin e ndërmarrë në 100 vende për peridudhën kohore 1982-1997, vënë re se dimensionin e llojit të formatit politik luan një rol përcaktues. Kështu, sipas tyre, në vendet të cilat janë demokraci shihet se korrupsioni nuk ka ndonjë ndikim të drejtpërdrejtë tek rritja ekonomike, ndërsa në vende të tjera jodemokratike duket se rritja ekonomike preket duke përsuar rënie nga korrupsioni²⁵⁵. Pra, autorët e shohin ndikimin e korrupsionit nisur nga një marrëdhënie më komplekse, dhe për këtë ata argumentojnë se ‘ndikimi negativ i korrupsionit ndërmjetësohet nga procesi politik në të cilin ndodh korrupsioni, dhe demokracia e zbeh ose e redukton këtë ndikim negativ’²⁵⁶.

Pra, ashtu siç mund të vëmë re, studimet e ndryshme empirike të përqendruara në marrëdhënien ndërmjet politikës e performancës ekonomike të shteteve nuk mbërrijnë në rezultate sistematike të së njëjtës linjë. Nga njëra anë, ekziston një grup studimesh të cilat e konsiderojnë atë si variabël të varur dhe shohin variacionin e tij në marrëdhënie me variabla të tjerë të karakterit social e ekonomik (kjo kryesisht një qasje studimore e ndërmarrë nga politologët). Nga ana tjetër, stabiliteti politik shihet edhe si variabël i pavarur kryesisht nga shkenca ekonomike për të parë ndikimin në marrëdhënien e tij me variabla të tjerë të karakterit ekonomik, si rritja ekonomike (ku përqendrohet edhe logjika e përgjithshme e këtij punimi). Përsa i përket testimin dhe vlerësimin të stabilitetit politik si një variabël i pavarur mbërrihet në rezultate të ndryshme. Nga njëra anë evidentohen studime të cilat arrijnë në rezultatet e një ndikimi direkt negativ të stabilitetit politik tek rritja ekonomike, ndërsa nga ana tjetër, të tjera studime nxjerrin në pah një marrëdhënie jo të drejtpërdrejtë negative të stabilitetit politik tek rritja ekonomike. I parë në kontekstin e të qenit një fenomen pjesë e sistemit politik, destabiliteti politik vlerësohet edhe në kontekstin e formatit politik e llojit të tij në ndikimin tek rritja ekonomike.

²⁵³ Mauro, *op.cit.*, fq. 686.

²⁵⁴ Minassian, G., (2002), ‘The economic environment in Albania, Bulgaria, Macedonia FYR, and Greece: A cross country study’, *Eastern European Economics*, Vol. 40(4): 45-82, fq. 62.

²⁵⁵ Drury, C. A. Kriekhaus, J. Lusztig, M., (2006), ‘Corruption, Democracy, and Economic growth’, *International Political Science Review / Revue Internationale de Science Politique*, Vol. 27(2): 121-136, fq. 121.

²⁵⁶ Drury, C. A. Kriekhaus, J. Lusztig, M., (2006), ‘Corruption, Democracy, and Economic growth’, *International Political Science Review / Revue Internationale de Science Politique*, Vol. 27(2): 121-136, fq. 133.

Duke përmbledhur, mund të konfirmojmë se shumësia e studimeve sasiore e cilësore rithekson edhe një herë rëndësinë që merr për ekonominë politike të rritjes vlerësimi i marrëdhënies *destabilitet-rritje*, si një shtyllë e rëndësishme prej nga ku marrin zanafillën politikat ekonomike të një vendi. Ajo që mund të vëmë re nga parashtrimi i mësipërm është se në testimin e kësaj marrëdhënieje, qëndrimet e studiuesve ndahen nga mënyra sesi përkufizohet destabiliteti politik, kur ky i fundit testohet empirikisht në modelet përkatëse. Nga ana tjetër, çështje e diskutuar është edhe kahu i shkakësisë. Pra, fakti nëse është destabiliteti politik ai i cili ndikon në ritmet e rritjes ekonomike, apo është kjo e fundit që ndikon në rritjen apo uljen e niveleve të destabilitetit politik në një vend të caktuar. Nëse i referohemi çështjes së parë, vëmë re se dy janë drejtimet kryesore të operacionalizimit të konceptit të destabilitetit politik: një pjesë e studiuesve e shohin atë nga pikëpamja e treguesve të cilët dëshmojnë për prezencën e dhunës, pra tregues socio-politikë, të tillë si: protestat, grushtet e shtetit, revolucionet, etj., ndërsa një pjesë tjetër nga pikëpamja e qëndrueshmërisë së pushtetit ekzekutiv, pra ndryshueshmëria e përbërjes së qeverisë dhe probabiliteti i rënies së saj (autorë të tillë si Alesina dhe Pertotti (1994); Cukierman *et al.*, (1992); Alesina *et al.*, (1996), etj. Përsa i përket kahut të marrëdhënies dhe nivelit të ndikimit të variablave tek njëri-tjetri, autorë si Ali, Pitlik, Jong-A-Pin, Aisen dhe Vega, Zureiqat, Alesina *et al.* (1996), etj., evidentojnë një marrëdhënie negative ndërmjet destabilitetit politik dhe rritjes ekonomike me kah nga variabëli politik i destabilitetit tek rritja ekonomike, apo në tërësi performanca ekonomike e një sistemi ekonomik.

Në vlerësimin e marrëdhënies *demokraci-rritje* ekonomike vëmë re se rezultatet nuk janë përfundimtare në lidhje me llojin (pozitiv apo negativ) të ndikimit të demokracisë tek rritja ekonomike. Disa autorë evidentojnë një ndikim pozitiv të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë të demokracisë tek rritja (Friedman, Barro, Polterovich e Popov, Plümper dhe Marin, Gerring *et al.*, Kaufman e Kraay, Mobarak, etj); dhe të tjerë studiues dalin në përfundime të një ndikimi negativ të demokracisë tek rritja ekonomike (Galenson, de Schweintiz, Moore e Smitz, etj). Një ndikim negativ i demokracisë tek rritja ekonomike ligjërohet nga logjika e prezencës së një shumësie grupesh në një shtet të caktuar, të cilat në kushtet e lirisë për të vepruar e për të përmbushur interesat e tyre politike shpesh të kundërta mund të prodhojnë bllokime të procesit të vendimmarrjes, pikërisht në sajë të aksesit që kanë në sferën politike. Kjo si rezultat prodhon ndikime negative tek rritja. Nga ana tjetër, në një kontekst demokratik ku garantohen zgjedhje të lira si dhe liritë politike dhe ekonomike do të presim që fryma e sipërmarrjes dhe aktiviteti ekonomik të çonte drejt rritjes ekonomike. Është pikërisht ky drejtim i të parit të marrëdhënies ndërmjet rritjes ekonomike dhe demokracisë që mund të shihet si ‘inkurajues në kuadrin e proceseve të demokratizimit që ka përfshirë Evropën Lindore përgjatë dekadës së fundit’²⁵⁷. Më konkretisht, për rastin e Shqipërisë e cila është pjesë e këtyre proceseve, vlerësimi i marrëdhënies në fjalë bart një rëndësi të veçantë.

Në pikëpamje të marrëdhënies së *institucioneve dhe rritjes ekonomike*, literatura bazë kryesisht evidenton një marrëdhënie pozitive të ndikimit të institucioneve tek rritja ekonomike. Studiues që konfirmojnë këtë linjë të përgjithshme rezultatesh janë: North,

²⁵⁷ Alesina, A. Perotti, R., (1994), ‘The political economy of growth: a critical survey of the recent literature’, *The World Bank Economic Review*, Vol. 8(3): 351-371, fq. 355.

Aron, Mamoon e Murshed, Mijiyana, Beck e Laeven, etj. Ajo që vëmë re janë mënyrat e ndryshme, në varësi të natyrës së studimit, sesi janë konceptualizuar insitucionet për tu testuar më pas me rritjen ekonomike e me variabla të tjerë ndërhyrës. Operacionalizimin e konceptit dhe indekset që përdoren në matjen e tij mund t'i shohim kryesisht në dy dimensione kryesore. Nga njëra anë, një pjesë e studiuesve përqendrohen tek aspekti cilësor dhe i performancës së institucioneve (përfshirë këtu specializimin burokratik, sundimin e ligjit dhe së drejtës, kontrollin e korrupsionit në administratë, etj); ndërsa nga ana tjetër vlerësohet aspekti strukturor i tyre ngushtësisht i lidhur me formatin qeverisës dhe llojin e sistemit zgjedhor.

E lidhur ngushtësisht me marrëdhënien institucione-rritje është ndërhyrja edhe e variablit të *korupsionit*. I parë si një variabël me një ndikim negativ tek rritja ekonomike (autorë si Mauro, Drury, Minassian, etj), vlerësimi i korrupsionit realizohet kryesisht brenda llojit të regjimit politik. Pra, nëse kemi të bëjmë me demokraci të konsoliduara, demokraci në tranzicion, apo regjime jodemokratike. Më pas, nivelet përkatëse të korrupsionit të evidentuara sipas renditjeve të caktuara të agjencive dhe institucioneve ndërkombëtare testohen në modelet empirike në marrëdhënie me rritjen ekonomike e ndikimin e tij tek ky variabël i fundit.

3.3.1.5 Modelet kryesore

Studimet e prezantuara më sipër dëshmuajn jo vetëm për shumëllojshmërinë e analizave të ndërmarra në studimin e marrëdhënieve ndërmjet variablave të veçantë të sistemit ekonomik dhe atij politik, por edhe për rrugët e ndryshme të ndjekura nga studiuesit për të mbërritur në rezultate specifike. Pikërisht, për të parë më në detaj këtë element të fundit, shohim të nevojshëm edhe prezantimin e disa prej modeleve kryesore të përdorura nga studiuesit në testimin empirik të këtyre marrëdhënieve.

*Modeli i Alesina et al*²⁵⁸. (1996)

Në studimin e marrëdhënies ndërmjet stabilitetit politik dhe rritjes ekonomike, Alesina *et al.*, nisen nga përcaktimi i stabilitetit politik si tendenca për ndryshimin e qeverisë, e karakterizuar nga variabla politike dhe ekonomike. Autorët e adresojnë problemin e endogjenitetit ndërmjet performancës ekonomike dhe stabilitetit politik nëpërmjet përdorimit të një sistemi dy-ekuacionësh, ku, si norma vjetore e rritjes ekonomike, ashtu edhe tendenca për ndryshimin e qeverisë vlerësohen veçmasi si variabla të pavarur. Kështu, sistemin bazë dy-ekuacionësh autorët e prezantojnë në formën e mëposhtme:

Prob(GCHANGE)

$$= \Phi(Y_c GROWTH + \alpha_{c1} EXADJ_{-1} + \alpha_{c2} GCHANGE_{-1} + \beta_{c0} + \beta_{c1} GROWTH_{-1} + \beta_{c2} WGROWTH_{-1} + \beta_{c3} LATIN + \beta_{c4} AFRICA)$$

$$GROWTH = Y_y GCHANGE + \alpha_{y1} EDUC + \beta_{y0} + \beta_{y1} GROWTH_{-1} + \beta_{y2} WGROWTH_{-1} + \beta_{y3} LATIN + \beta_{y4} AFRICA + u_y$$

²⁵⁸ Alesina, A. Ozler, S. Roubini, N. Swagel, P., (1996), 'Political instability and economic growth', *Journal of Economic Growth*, Vol. 1(2): 189-211, fq. 198-199.

Në specifikimin e modelit, Alesina *et al.*, përta i përket ekuacionit të parë klasifikojnë variablat e pavarur në tre kategori kryesore: 1) treguesit e problemeve, shqetësimeve politike, të tilla si rregullimet e kohëve të fundit të ekzekutivit, si dhe përpjekjet e kohëve të fundit për të rrëzuar qeverinë; 2) variablat strukturorë të cilat lidhen me dallimet ndërmjet vendeve të marra në konsideratë, si psh. përkatësia në një zonë të caktuar gjeografike, apo të qenit demokraci; dhe, 3) performanca ekonomike e kohëve të fundit e vlerësuar kjo nëpërmjet normës së rritjes ekonomike. Kështu, ekuacioni kryesor i ndryshimit të qeverisë përfshin normën aktuale të rritjes (GROWTH), rritjen e një viti të mëparshëm (GROWTH(-1)), dhe normën e rritjes botërore të një viti më parë (WGROWTH(-1)), variablat rajonalë dami si (LATIN) dhe (AFRICA), variablin e treguesit të ndryshimit të qeverisë së një viti më parë (GCHANGE(-1)), si dhe rregullimet (ndryshimet apo përshtatjet) e ekzekutivit të një viti më parë (EXADJ(-1)).

Ndërsa, në ekuacionin bazë të vlerësimit të rritjes ekonomike, autorët përfshijnë variablat si: tendencën e ndryshimit të qeverisë (GCHANGE), shkallën e regjistrimit në arsimin bazë (EDUC), variablat dami për vendet e Amerikës Latine dhe Afrikës, përkatësisht (LATIN) dhe (AFRICA), si dhe dy variabla të cilët vlerësojnë variacionin e rritjes përkatësisht norma e një viti më parë e rritjes (GROWTH(-1)), dhe norma e botërore e rritjes e një viti më parë (WGROWTH(-1)). Të dhënat e përfshira në testimin e këtyre marrëdhënieve përfshijnë një grup prej 113 vendesh për periudhën ndërmjet viteve 1950-1982.

Modeli Feng²⁵⁹ (1997)

Yi Feng, në studimin e ndërveprimeve ndërmjet demokracisë, stabilitetit politik dhe rritjes ekonomike, identifikon sistemin e mëposhtëm të ekuacioneve simultane si bazën metodologjike të testimit empirik:

$$\begin{aligned} P_1 &= \lambda_{P1}P_{2,3} + Y_{P1}G + \xi_{P1}D + \alpha_{P1}X_{P1} + \varepsilon_1 \\ P_2 &= \lambda_{P2}P_{1,3} + Y_{P2}G + \xi_{P2}D + \alpha_{P2}X_{P2} + \varepsilon_2 \\ P_3 &= \lambda_{P3}P_{1,2} + Y_{P3}G + \xi_{P3}D + \alpha_{P3}X_{P3} + \varepsilon_3 \end{aligned}$$

ku, P_1 = probabiliteti i një ndryshimi jo të rregullt të qeverisë, P_2 = probabiliteti i ndryshimeve të mëdha të rregullta të qeverisë, P_3 = probabiliteti i ndryshimeve të vogla të rregullta të qeverisë, G = norma vjetore e rritjes ekonomike për frymë, D = shkalla e demokracisë, X = variablat e paracaktuar, dhe termat e gabimit ε , ϕ , μ . Ashtu si modeli i Alesina *et al.*, edhe Feng, metodologjikisht mbështetet në përdorimin e një sistemi ekuacionesh, por duke përdorur metodën e katrorëve më të vegjël me tre nivele (3SLS). Arsyeja kryesore e përdorimit të kësaj metode është eliminimi i njëanshmërisë dhe gabimeve në matje për shkak të endogjenitetit që variablat në këto marrëdhënie përfaqësojnë. Testimin empirik nëpërmjet kësaj metode, autori e aplikon në marrjen në konsideratë të një grupi prej 96 vendesh për periudhën 1960-1980.

²⁵⁹ Feng, Y., (1997), 'Democracy, Political Stability and Economic Growth', *British Journal of Political Science*, Vol. 27(3): 391-418, fq. 398-400.

Modeli i Pitlik²⁶⁰ (2008)

Pitlik, në studimin e tij fokusohet tek performanca ekonomike dhe institucionet politike si dhe ndërveprimi i ndikimeve të tyre tek liberalizimi i politikës ekonomike në një kampion të gjerë shtetesh të zhvilluara dhe në zhvillim. Autori përdor modelin e regresionit linear me shumë variabla. Kështu, modeli bazë që autori prezanton është:

$$\Delta efw_{i,t} = \beta_1 efw_{i,t-1} + \beta_2 gw_{i,t-1} + \beta_3 pol_{i,t-1} + \beta_4 (gw_{i,t-1} \cdot pol_{i,t-1}) + \beta_5 X_{i,t-1} + u_{i,t}$$

ku i është indeksi i vendit, t përfaqëson periudha kohore pesë-vjeçare, efw përfaqëson rezultatin e lirisë ekonomike, gw është një prej variablave institucionale që përfaqëson shtrëngesat e demokracisë (*polfree*, *polity*) dhe X është një vektor i variablave të kontrollit. Ndërsa termi $u_{i,t}$ përbëhet nga tre elementë: termi i gabimit, efektet e përcaktuara kohore, dhe efektet e përcaktuara të njësisë. Për të eliminuar problemin e endogjenitetit, dhe shkakësisë së dyanshme që variablat e pavarur mund të kenë me variabëlën e varur, autori, ashtu siç mund ta shohim nga ekuacioni kryesor i modelit përdor variabla shpjegues (të pavarur) të një periudhe më parë. Për ta mbajtur modelin e qëndrueshëm, Pitlik shton si variabla kontrolli tek modeli bazë edhe log e PBB-së reale për frymë si dhe log e nivelit të hapjes së tregëtisë (e parë kjo si shuma e importeve dhe eksporteve tek PBB-ja, në përqindje).

Modeli i Zureiqat²⁶¹ (2005)

Në punimin e tij Zureiqat teston: së pari, ndikimin e destabilitetit politik tek rritja ekonomike dhe më konkretisht nëse destabiliteti shkakton një rënie të rritjes ekonomike; dhe, së dyti, nëse këta dy variabla (destabiliteti politik dhe rritja ekonomike) janë bashkërisht të korreluar dhe endogjenë kundrejt njëri-tjetrit. Në studimin empirik të këtyre dy tezave kryesore, autori përdor një model një ekuacional regresioni linear të shumëfishtë, si dhe një model dy-ekuacionësh simultanë po nëpërmjet regresionit linear të shumëfishtë.

Në modelin e parë, për të studiuar faktin nëse destabiliteti politik çon në një rënie të rritjes ekonomike, Zureiqat niset nga logjika e konsiderimit të rritjes ekonomike si një funksion jo vetëm i kapitalit njerëzor, kapitalit fizik, e teknologjisë, por edhe i destabilitetit politik.

Ndryshe,

$$\mathbf{Rritja\ ekonomike}_{it} = f(\mathbf{Kapitali\ njerëzor}_{it}, \mathbf{Kapitali\ fizik}_{it}, \mathbf{Teknologjia}_{it}, \mathbf{Destabiliteti\ Politik}_{it})$$

Logjika e thjeshtë e cila prodhohet nga ky ekuacion sipas autorit është se të paturit e më shumë kapitali njerëzor, kapitali fizik dhe teknologji çon në një rritje të rritjes ekonomike, ndërsa destabiliteti politik ka tendencën që me prezencën e tij në një vend të caktuar në një kohë të caktuar të çojë në ulje të rritjes ekonomike. Kështu, si matës të stabilitetit politik, autori përdor vlerësimin e Polity2 për këtë tregues, ndërsa për faktorët

²⁶⁰ Pitlik, *op.cit.*, fq. 265-267.

²⁶¹ Zureiqat, *op. cit.*, fq. 10-20.

jo-ekonomikë që mund të kenë një ndikim tek destabiliteti politik përdoret vlerësimi i lirisë së përgjithshme për një vend i matur nga Freedom House.

Duke integruar këta elementë, modeli konceptual që përdor autori në studimin e marrëdhënies stabilitet politik-rritje ekonomike është si më poshtë:

$$GDP_PER_CAP_{it} = \beta_0 + \beta_1 POP_GROWTH_{it} + \beta_2 ENG_USE_{it} + \beta_3 TV_PER_1K_{it} + \beta_4 POLITY2_{it}$$

ku si variabël i varur shërben PBB për frymë, ndërsa POP_GROËTH është variabël i varur i përqindjes së rritjes të popullsisë në një vend i për një periudhë të caktuar t . Po kështu, variabël tjetër i pavarur i përfshirë në regresion është përdorimi i energjisë për frymë (ENG_USE) në një vend në një kohë të caktuar, dhe dy variablat e tjerë të pavaur janë numri i aparateve televizive për 1000 banorë (TV_PER_1K), dhe vlerësimi i Polity 2 për demokracinë (POLITY2).

Ndërsa, modelin tjetër dy-ekuacionësh simultan autori e prezanton në formën e mëposhtme.

$$GDP_{PERCAP_{it}} = \alpha_1 + \alpha_2 POP_{GROWTH_{it}} + \alpha_3 ENG_{USE_{it}} + \alpha_4 TV_{PER_{1K_{it}}} + \alpha_5 POLITY2_{it}$$

$$POLITY2 = \alpha_6 + \alpha_7 GDP_PER_CAP_{it} + \alpha_8 FREEDOM_{it}$$

Metoda që ai përdor në regresionin e këtij sistemi ekuacionësh është metoda e katrorëve më të vegjël (OLS) dhe metoda e katrorëve më të vegjël me dy shkallë (TSLS).

Modeli i Aisen dhe Vega²⁶²

Aisen dhe Vega në modelin e tyre empirik tentojnë të testojnë faktin nëse destabiliteti politik ndikon në rritjen ekonomike të një vendi, si dhe kanalet e mundshme të një ndikimi të tillë në kuadrin e normës së produktivitetit të rritjes, dhe akumulimit të kapitalit fizik dhe njerëzor. Për këtë, autorët marrin në konsideratë një kampion prej 169 shtetesh, me të dhëna të grupuara në periudha 5-vjeçare ndërmjet 1960-2004 në një model linear me të dhëna paneli. Si pjesë e modelit përfshihen edhe variabla si: demokracia, liria ekonomike e homogjeniteti entik. Kështu, strukturimi i modelit bazë të tyre në testimin e hipotezës sipas së cilës destabiliteti politik dhe variabla të tjerë politikë dhe institucionale ndikojnë rritjen ekonomike përfshin këta variabla shpjegues (të pavarur): PBB-ja fillestare për frymë (log), *investimet* (si përqindje e PBB-së), *regjistrimi në shkollën fillore*, *rritja e numrit të popullsisë*, *hapja e tregëtisë*, si dhe *ndryshimet e qeverive* (si numri i herëve në një vit përgjatë së cilit është ndryshuar kryeministri ose 50% e kabinetit). Ky variabël shërben për modelin si përafruesi (proxy) i destabilitetit politik. Për të marrë në konsideratë ndikimet e stabilitetit makroekonomik tek rritja ekonomike, modelit bazë i shtohen edhe *norma e inflacionit* së bashku me variablin e

²⁶² Aisen, Veiga, *op.cit.*, fq. 4-8.

qeverisë (si përqindje e PBB-së, pra pritjet që një qeveri e madhe ezauron burimet për sektorin privat si dhe është e dëmshme për rritjen ekonomike).

Modeli i zgjeruar përveç këtyre dy grupimeve të variablave, atyre bazë dhe variablave të cilat marrin në konsideratë ndikimin e stabilitetit makroekonomik, përfshin edhe një grup variablash institucionalë, si: *indeksi i lirisë ekonomike*, *indeksi i homogjenitetit etnik*, ndërsa për demokracinë merret në model përafresi i saj, ekuivalent me vlerësimin e Polity IV.

Kështu, modeli empirik kryesor prej nga ku niset testimi i marrëdhënieve hipotetike mes variablave, paraqitet nga autorët si më poshtë:

$$\ln Y_{it} - \ln Y_{i,t-1} = \gamma \ln Y_{i,t-1} + \beta' X_{it} + \delta PT_{i,t} + \lambda' W_{it} + v_i + \mu_t + \varepsilon_{it}$$

$$i = 1, \dots, N \quad t = 1, \dots, T_i$$

ku, Y_{it} përfaqëson PBB-në për frymë të një vendi i në fund të periudhës t , X_{it} është një vektor i përcaktuesve ekonomikë të rritjes ekonomike, PT_{it} është variabli përafresi i destabilitetit politik, dhe W_{it} është një vektor i përcaktuesve politikë dhe institucionalë të rritjes ekonomike, v_i paraqet ndikimet specifike për vendet, μ_t përfaqëson ndikimet specifike të periudhës, dhe ε_{it} është termi i gabimit.

Modeli i Campos dhe Nugent²⁶³

Nëpërmjet studimit të një grupi prej 98 shtetesh, për periudhën 1960-1995 (duke e ndarë atë në periudha 5-vjeçare), autorët tentojnë të studiojnë empirikisht marrëdhënien ndërmjet destabilitetit politik dhe rritjes ekonomike. Në modelin e tyre, Campos dhe Nugent, për të patur një kapje të plotë të fenomenit të destabilitetit politik së bashku me treguesit nëpërmjet së cilëve ai operacionalizohet, prodhojnë dy matës të destabilitetit politik. Matësi i parë i referohet ‘kufirit të sipërm’ të këtij fenomeni ku përfshihen konceptimet e tij nëpërmjet shfaqjeve të dhunshme, dhe më konkretisht autorët përdorin: numrin e vrasjeve politike për milion banorë, revolucionet, si dhe grushtet e shtetit të cilat kanë rezultuar të suksesshme. Ndërsa, tek matësi i dytë i destabilitetit politik, i quajtur ‘kufiri i poshtëm’ përfshijnë: konkurueshmërinë dhe rregullimin e pjesëmarrjes politike, pavarësinë e veprimit të kreut të ekzekutivit, si dhe konkurueshmërinë, rregullimin, dhe shkallën e hapjes së rekrutimit në ekzekutiv.

Kështu, në modelin e tyre Campos dhe Nugent testojnë specifikisht marrëdhënien ndërmjet matësit të parë të destabilitetit politik kundrejt rritjes ekonomike për kategoritë e veçanta të vendeve të ndara të grupuara sipas përkatësisë gjeografike, dhe më pas ndikimin e mundshëm të matësit të dytë të destabilitetit politik tek rritja ekonomike e këtyre vendeve. Testimi i këtyre dy marrëdhënieve kryesore realizohet nëpërmjet testit Granger, pra nën kornizën e shkakësisë Granger, të cilën autorët e përdorin për shkak të vlefshmërisë që ofron në testimin e periudhave me intervale 5-vjeçare, dhe për shkak të dobishmërisë së bashkësisë së informacionit që përdoret²⁶⁴. Kjo sepse rezultatet e testit

²⁶³ Campos, Nugent, *op.cit.*, fq. 159-163.

²⁶⁴ Shënim: ‘Testi Granger varet nga supozimi se shkakun bart informacion unik për efektin (ndikimin), në kuptimin që është i padisponueshëm në ndonjë vend tjetër. Nëse dy variablat në testin Granger ndikohen nga një i tretë, nëse ky i fundit nuk konsiderohet, testi mund të jetë i padobishëm’. (Shih Campos, F. N.

Granger janë të pandikuara nga përfshirja e variablave të tjerë të cilët mund të luanin një rol shkatërrues për testin e vlefshmërinë e rezultateve të tij.

Modeli Barro (1996)

Modeli i Barro-s përqendrohet në studimin e marrëdhënies ndërmjet rritjes ekonomike dhe demokracisë në një panel prej 100 shtetesh për periudhën 1960-1990. Variablat e varur në modelin e regresionit të Barro (1996) janë norma e rritjes së PBB-së reale për frymë përkatësisht në periudhat 1965-1975, 1975-1985, 1985-1990. Modeli i regresionit linear i përdorur nga Barro përfshin në grupin e variablave shpjegues ato që ai i quan variablat e gjendjes dhe variablat e zgjedhjes apo mjedisorë. Në grupimin e parë përfshin shkollimin dhe shëndetësinë si matës të kapitalit njerëzor, si dhe nivelin fillestar të PBB-së. Ndërsa grupi i dytë i variablave të pavarur përfshin shkallën e fertilitetit, shpenzimet qeveritare për konsum dhe arsimim, një indeks të mbajtjes së sundimit të ligjit, shkallën e investimeve bruto tek PBB-ja, dhe ndryshimin në terma të tregëtisë, dhe variabli i demokracisë i përfshirë në model nëpërmjet indeksit Gastil të demokracisë.

Nga ana tjetër, Barro teston edhe ndikimin që tregues të karakterit ekonomik dhe politik mund të kenë tek demokracia. Në një model të parë, ai përshin si variabla të mundshëm shpjegues janë tregues të PBB-së, normës së vdekshmërisë foshnjore, dhe tregues të ecurisë në shkollim. Ndërsa si variabla të varur janë mesataret e indekseve të demokracisë për tre periudha 10-vjeçare. Duke u bazuar tek Lipset (1959), dhe Kyoung-Ryung e Torres (1993), Barro merr në konsideratë edhe marrëdhënien e mundshme të përcaktuesve të tjerë të demokracisë, si: pabarazinë e të ardhurave (koeficienti Gini), normën e papunësisë, log të popullsisë dhe pritshmërisë së jetëgjatësisë, si dhe një indeks të fraksionalizimit etnolingistik. Teknika që përdoret në regresionet e testuar është teknika e variablave instrumentalë. Kjo, për të eliminuar mundësinë e një korrelacioni ndërmjet termave të gabimit në ekuacionet e rritjes ekonomike për periudhat e ndryshme të mara në konsideratë.

Modeli Polterovich dhe Popov²⁶⁵

Polterovich dhe Popov përqendrohen në një nivel studimi më të gjerë, atij të marrëdhënies ndërmjet demokracisë dhe rritjes ekonomike. Në modelin e tyre empirik, demokracia ndahet nga ligji dhe rendi (ky i fundit si variabël i veçuar). Në këtë mënyrë, testohen hipotezat e ndikimit pozitiv të mundshëm të demokracisë në një vend, nëse ligji dhe rendi janë të fortë (dhe e anasjellta), si dhe ndikimi i ekonomisë informale në rastin e demokratizimit nën një kontekst të dobët rendi dhe ligji tek cilësia e qeverisjes dhe politikave makroekonomike.

Nugent, B. J., (2002), 'Who is afraid of political instability', *Journal of Development Economics*, Vol. 67: 157-172, fq. 163)

²⁶⁵ Polterovich, Popov, *op.cit.*, fq.13-25.

Kjo mundësohet nga ana e autorëve nëpërmjet përdorimit të modelit të regresionit të shumëfishtë linear për secilën nga çështjet e parashtruara në një grup shtetesh në periudhën ndërmjet viteve 1970-1999. Kështu, variabëli i varur që testohet është PBB-ja për frymë, ndërsa në regresion si variabla të varur hyjnë grupi i variablave të kontrollit si dhe variabli i demokracisë (D) dhe ligjit dhe rendit (RL). Në grupin e variablave të kontrollit autorët përfshijnë (importet neto të naftës si një % e totalit të importeve gjatë periudhës (1960-1999), densiteti i popullsisë, klima e investimeve, inflacioni, etj). Ndërsa në rastin e grupit të dytë të hipotezave, variabli i varur është në varësi të fokusimit të veçantë për çështje sepcifike që autori merr në konsideratë (ekonomia hije dhe demokratizimi, rendi dhe ligji dhe demokratizimi, korrupsioni dhe demokratizimi, klima e investimeve dhe demokratizimi, efektiviteti i qeverisjes dhe demokratizimi, etj)

Modeli Kaufmann dhe Kraay²⁶⁶

Kaufmann dhe Kraay studiojnë marrëdhënien ndërmjet rritjes ekonomike (të ardhurat për frymë) në raport me qeverisjen si faktor politik. Në testimin empirik të kësaj marrëdhënieje merret në konsideratë një kampion prej 175 shtetesh për periudhën 2000-2001. Strategjia empirike e tyre përfshin vlerësimin e ndikimit të niveleve më të mira të qeverisjes tek rritja ekonomike e një vendi, si dhe ndikimin që prodhohet nga e kundërta e kësaj marrëdhënieje, nëse një korrelacion i tillë vërtet mbështetet nga të dhënat epirike. Kjo sepse, autorët sugjerojnë mungesën e një rrethi vicioz në të cilin të ardhurat më të larta të çojnë drejt përmirësimeve të mëtejshme në qeverisje.

Modeli empirik i tyre përfshin përdorimin e regresioneve që përdorin variabla instrumentale. Kështu, autorët testojnë modelin e mëposhtëm:

$$y_j = \alpha + \beta \cdot g_j + e_j$$

$$g_j = \mu + \gamma \cdot y_j + \delta \cdot x_j + v_j$$

$$y_j^* = y_j + w_j$$

$$g_j^* = g_j + u_j$$

ku në dy ekuacionet e para të ardhurat për frymë shihen të varura nga qeverisja dhe faktorë të tjerë të jashtëm (e), dhe qeverisja shihet e varur nga të ardhurat për frymë, variabla të tjerë të vëzhguar (x), si dhe nga faktorë të tjerë jashtë modelit (v).

Modeli Mamoon dhe Murshed²⁶⁷

Mamoon dhe Murshed testojnë marrëdhënien ndërmjet rritjes ekonomike dhe cilësisë së institucioneve. Më specifikisht, ata shohin rolin e akumulimit të kapitalit njerëzor të matur nga numri i viteve të shkollimit dhe kapacitetit institucional tek prosperiteti. Në testimin empirik të këtyre marrëdhënieve autorët nisen nga ekuacioni i përgjithshëm i formës:

²⁶⁶ Kaufmann, Kraay, *op.cit.*, fq. 15-17.

²⁶⁷ Mamoon, Murshed, *op.cit.*, fq. 451-453.

$$\log y_i = x + \beta N_i + \chi TP_i + YHK_i + \eta PK_i + \varepsilon_i$$

ku si variabël i varur identifikohet rritja ekonomike nëpërmjet të ardhurave për frymë, ndërsa variablat e tjerë N_i , TP_i , HK_i , PK_i , janë përkatësisht matësit e institucioneve, integritit, kapitalit njerëzor, dhe kapitalit fizik. Në fazën e parë të testimit empirik të modelit të regresionit, duke përdorur variablat instrumentale, autorët vlerësojnë vlerat e parashikuara të institucioneve, politikës së tregëtisë, dhe kapitalit human duke i regresuar këta si variabla të varur nën një set instrumentesh. Sistemi i ekuacioneve i përfshirë në këtë mënyrë është :

$$\begin{aligned} N_i &= \lambda_{1i} + \phi_1 ENG_i + v_1 EUR_i + \tau_1 FR_i + w_i TLEX + \rho_1 PTR + \theta_1 GEO_i + \varepsilon_{Ni} \\ TP_i &= \lambda_{2i} + \phi_2 ENG_i + v_2 EUR_i + \tau_2 FR_i + w_2 TLEX + \rho_2 PTR + \theta_1 GEO_i + \varepsilon_{Ni} \\ HK_i &= \lambda_{3i} + \phi_3 ENG_i + v_3 EUR_i + \tau_3 FR_i + w_3 TLEX + \rho_3 PTR + \theta_3 GEO_i + \varepsilon_{Ni} \end{aligned}$$

ku si variabla të pavarur (apo instrumente) shërbejnë popullsi që flasin gjuhën angleze dhe gjuhë evropiane, shpenzimi publik në arsim, si dhe raporti publik - mësues i fillorës. Në fazën e dytë të testimit të modelit vlerat e parashikuara të variablave të mësipërm përfshihen në ekuacionin e parë të modelit.

Tabela e mëposhtme prezanton në mënyrë të përmbledhur këto modele.

Tabela 3.1: Përmbledhje e studimeve empirike mbi marrëdhënien rritje-destabilitet politik

Autori(ët)	Viti	Variabël i varur	Modeli	Matësi i (de)stabilitetit politik
Alesina, Ozler, Roubini, Sægel	1996	Rritja ekonomike dhe prob. i ndryshimit të qeverisë	Modeli i regresionit linear të shumëfishtë me dy ekuacione	Përcaktimi i destabilitetit politik si tendenca për ndryshimin e qeverisë.
Feng	1997	Norma vjetore e rritjes ekonomike për frymë dhe tre llojet e destabilitetit politik (brenda, dhe jashtë regjimit) të para si ndryshime të qeverisë.	Modeli i regresionit nëpërmjet një sistemi ekuacionesh të njëkohshme duke përdorur metodën e katrorëve më të vegjël me tre nivele (3SLS).	Përcaktimi i destabilitetit politik si ndryshime jo të rregullta të qeverisë (ndryshime në nivelin e regjimit), ndryshime të mëdha të qeverisë (brenda regjimit), dhe ndryshime të vogla të qeverisë (brenda regjimit).
Pitlik	2008	Rezultati i lirisë ekonomike	Modeli i regresionit linear të shumëfishtë	N.a
Zureiqat	2005	PBB për frymë dhe destabiliteti politik (POLITY2)	Modeli i regresionit linear të shumëfishtë nëpërmjet përdorimit	Si matës të stabilitetit politik, autori përdor vlerësimin e Polity2.

			të një sistemi të njëkohshëm ekuacionesh (përdorimi i metodës së katrorëve më të vegjël (OLS), dhe metoda e katrorëve më të vegjël me dy shkallë (TSLS)	
Aisen dhe Vega	2011	PBB për frymë	Modeli i regresionit logit të shumëfishtë	Ndryshimet e qeverive (si numri i herëve në një vit përgjatë së cilit është ndryshuar kryeministri ose 50% e kabinetit).
Campos dhe Nugent	2002	PBB për frymë	Korniza e shkakësisë Granger në modelin e regresionit	Përdorimi i dy matësve të destabilitetit politik: 'kufirit të sipërm' të këtij fenomeni ku përfshihen konceptimet e tij nëpërmjet shfaqjeve të dhunshme, dhe 'kufiri i poshtëm' përfshijnë: konkureshmërinë dhe rregullimin e pjesëmarrjes politike, etj.
Barro	1996	Norma e rritjes së PBB-së reale për frymë dhe demokracia	Modeli i regresionit me ekuacione të shumëfishtë duke përdorur teknikën e variablave instrumentale	N. a (përdoret variabli i demokracisë i vlerësuar nëpërmjet indeksit Gastil të demokracisë).
Polterovich dhe Popov	2007	PBB për frymë	Modelit të regresionit të shumëfishtë linear	N. a
Kaufmann dhe Kraay	2002	PBB për frymë dhe qeverisja	Modeli i regresionit linear të shumëfishtë dhe të thjeshtë me dy ekuacione nëpërmjet përdorimit të variablave instrumentale.	N.a
Mamoon dhe Murshed	2009	PBB për frymë	Modeli logit i regresionit nëpërmjet përdorimit të variablave instrumentale.	N.a

KAPITULLI 4

MARRËDHËNIA DESTABILITET POLITIK-RRITJE EKONOMIKE

Rasti i Ballkanit Perëndimor: një vështrim i përgjithshëm

Përmbledhje

Pas trajtimit të aspekteve teorike të boshtit kryesor të studimit, së bashku me legjitimimin teorik të tyre, në këtë kapitull synojmë të projektojmë këto aspekte në një terren konkret, atë të Ballkanit Perëndimor.

Trajtesa e kësaj kategorie vendësh realizohet nëpërmjet prezantimit fillimisht të trendeve të zhvillimeve ekonomike e politike të tyre. Më pas vijohet me ilustrimin e vijueshmërisë së faktorëve ekonomikë e politikë përgjatë kohës dhe ecurisë që vende të veçanta kanë patur në raport me këta faktorë. Të dhënat e përdorura për të ilustruar këto zhvillime u referohen agjensive e institucioneve ndërkombëtare të specializuara në matjen e treguesve specifikë si të sistemit ekonomik, ashtu edhe të atij politik.

Së fundi, vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe rastit të Shqipërisë ku duke u mbështetur në treguesit e stabilitetit politik që janë pjesë organike e këtij koncepti, është realizuar një analizë e përgjithshme e ecurisë së tyre në dimensionin kohor. Në të njëjtën linjë është vijuar edhe me prezantimin e analizën edhe të treguesve të natyrës ekonomike.

4.1 HYRJE

Vendet paskomuniste të Evropës Lindore dhe Juglindore përbëjnë një kategori vendesh sa unike në karakteristikat e veta, aq edhe të dallueshme në elementë të veçantë të karakterit social, ekonomik e politik. Pavarësisht kësaj, ky grup shtetesh apo edhe shtete të veçanta të tij kanë qenë në qendër të studimeve pas vitetve 90', kryesisht me fokus tek ndryshimet që këto vende pësuan në llojin e regjimit si dhe në strukturën e organizimit të aktivitetit ekonomik. Në fakt, sipas Bunce, logjika dominuese e këtyre zhvillimeve ka qenë ajo e 'variacionit' përkundrejt logjikës së 'uniformitetit'. Variacionin²⁶⁸, autorja e sheh jo vetëm në aspektin e karakteristikave sociale e fizike që dallonin nga njëri shtet në tjetrin që prej fillimeve të tranzicionit, por; së pari, në aksin e formës së regjimit, ku sipas saj mund të identifikohen regjime nga ato plotësisht demokratike, pjesërisht demokratike e deri në regjimet pjesërisht autoritare apo plotësisht autoritare, dhe së dyti në aksin e shkallës së plotësisë së regjimit të vendosur (shtrirja institucionale, identitete të përbashkëta, elitë politike në të njëjtën linjë me konturet ideologjike të politisë, etj). Bunce thekson se 'dallimet vihen re nga Hungaria, ku çështja e regjimit të vendosur është e përmbyllur, tek Bosnia, ish-Jugosllavia, Shqipëria, ku ka disa regjime që vazhdojnë të konkurojnë për dominim'²⁶⁹. Megjithatë, sipas autores, përveç ekzistencës së dallueshmërisë së karakteristikave që çdo shtet prezanton, ka edhe një marrëdhënie të veçantë ndërmjet llojit të regjimit e stabilitetit politik, dhe reformave ekonomike e performancës ekonomike që prezantohet në këtë grup vendesh. Kështu, stabiliteti lidhet me ekzistencën e një demokracie të plotë ose autoritarizmi të plotë, ndërsa performanca ekonomike lidhet ose me realizim të plotë të reformave ekonomike, ose me mungesë të plotë të tyre. Për këtë, në një studim të realizuar me një grup prej 24 ekonomish në tranzicion, Eschenbach dhe Hoekman, arritën në rezultatin se masat e marra nga këto vende përsa i përket reformës në politikën e shërbimeve ishin variabla të rëndësishëm shpjegues të performancës ekonomike të këtyre ekonomive në tranzicion. Pra, reforma e politikës së sektorit të shërbimeve ishte një ndikues i rëndësishëm i rritjes së performancës ekonomike për vende të cilat i ishin nënshtruar procesit të tranzicionit politik e atij ekonomik²⁷⁰.

4.2 VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR: TRENDET POLITIKO-EKONOMIKE

Më specifikisht, nëse u referohemi karakteristikave të ekonomive të vendeve të cilat iu nënshtruan procesit të tranzicionit, dhe më konkretisht vendet e Ballkanit²⁷¹, identifikojmë se qëllimi kryesor i tyre ka qenë transformimi i plotë i ekonomive dhe hapja e tyre ndaj tregut të lirë. Madje, nëse do të tenonim të strukturonim zhvillimet e sektorit ekonomik në periudha më specifike në këtë grup vendesh, do të evidentonim tre

²⁶⁸ Bunce, *op.cit.*, fq. 760.

²⁶⁹ *ibid.*, fq. 760.

²⁷⁰ Eschenbach, Hoekman, *op.cit.*, fq. 746-747

²⁷¹ Shënim: Duke marrë në konsideratë natyrën e zhvillimeve politike dhe ekonomike, trendin e këtyre zhvillimeve si dhe prospektet e përbashkëta të së njëjtës linjë së jashtmi në fokusin evropian, trajtesa krahasimore e tipareve të këtyre zhvillimeve prezanton vendet e Ballkanit Perëndimor.

të tilla. Periudha e parë përkon me periudhën e ndryshimeve të karakterit politik, kryesisht ndryshimit të formës së regjimit, periudhë në të cilën sektori ekonomik u përball me sfida të shumta. Ashtu si në sistemin politik, sistemi ekonomik i këtyre vendeve iu nënshtua ndryshimeve thelbësore të mënyrës së organizimit e funksionimit. Bozic-Miljkovic²⁷² i konsideron zhvillimet e viteve 90' të vendeve të këtij rajoni si përcaktuese të zhvillimeve të mëtejshme qofshin ato ekonomike apo politike. Përveç kësaj, sipas studiueses, problematikat e karakterit politik si: destabiliteti politik, mungesa e një shoqërie civile të organizuar, mungesa e sundimit të ligjit dhe shtetit të së drejtës prodhuan një realitet të vështirë e pengues për zhvillimet ekonomike. Në një periudhë të mëvonshme, pas ndryshimeve politike e ekonomike të cilat përfaqësuan kalime të rëndësishme nga një format organizimi tek tjetri (kryesisht në vitet 2000'), vendet e Ballkanit filluan të shfaqin tregues makroekonomikë në rritje, e ndër to më kryesorja ishte rritja ekonomike të qëndrueshme. Kështu, rritja mesatare e PBB-së për rajonin e vendeve të Ballkanit Perëndimor përlllogaritej rreth 5.7%, dhe kjo sipas Penev²⁷³ i detyrohej një modeli rritjeje të përcaktuar nga dy elementë kryesorë: (i) kapitalit të lirë ndërkombëtar dhe kredive të indeksuara në monedha ndërkombëtare, dhe (ii) liberalizimit të tregëtisë së jashtme dhe tregjeve financiarë.

Tabela 4.1: Ballkani Perëndimor, treguesit makroekonomikë 2011, 2012 (vlerësime)

	Shqipëria		Bosnjë Hercegovina		Kroacia		Maqedonia		Mali i Zi		Serbia	
	2011	2012	2011	2012	2011	2012	2011	2012	2011	2012	2011	2012
PBB (ndryshimi në %)	3	0.5	1.2	0	0	-1.1	3.1	0.9	2.4	0.2	1.6	-0.5
Papunësia (%)	13.3	15	27.6	27.6	13.6	14.1	31.2	31.2	-	-	24.4	25.5
Inflacioni (%)	3.9	3.5	3.7	2.2	2.2	2.9	3.9	2	3.1	2	11.2	5.9
Borxhi i jashtëm (si % e PBB-së)	58.9	63.7	40.3	43.6	47.5	52.7	27.1	46.8	43.3	46.7	50	63.6

Burimi: World Economic Outlook, Prill 2012

Pra, në përgjithësi, ajo që mund të vëmë re përgjatë kësaj periudhe është fakti se, kjo magnitudë e zhvillimeve makroekonomike u prodhua si rezultat i 'adoptimit të politikave të tregut të hapur, mbështetjes së sektorit privat dhe zhvillimit të mëtejshëm të tij, intensifikimit të marrëdhënieve ekonomike me vende të tjera të botës, si dhe marrjes së masave për nxitjen e konkureshmërisë së këtyre vendeve'²⁷⁴. Së fundmi, periudha e tretë e zhvillimeve ekonomike të rajonit do të përkonte me krizën financiare e cila u shfaq në

²⁷² Bozic-Miljkovic, I., (2007), 'Westren Balkans in the process of European Integration-Economic networking and the region's development', *Facta Universitatis: Economics and Organization*, Vol. 4(1): 79-90, fq. 80.

²⁷³ Penev, *op.cit.*, fq. 18.

²⁷⁴ Karasavoglou, G. A., (2011), *Economies of the Balkan and Eastern Europe Countries in the Changed World*, Cambridge Scholars Publishing, Britani e Madhe, fq. 9.

gjysmën e dytë të vitit 2007, dhe që e shfaqti ndikimin e saj në ekonominë e vendeve të Ballkanit e sidomos ato të Ballkanit Perëndimor vetëm rreth fundit të vitit 2008. Ajo u shoqërua me një dobësim të aktivitetit ekonomik, e ngadalësim të mëtejshëm të rritjes ekonomike të këtyre vendeve, dhe regjistrimet e rritjes ekonomike pozitive filluan vetëm pas vitit 2011.

Natyrisht, ndikimet e krizës ekonomike, për këtë kategori vendesh u ndjenë jo vetëm së brendshmi por edhe së jashtmi e sidomos në kontekstin evropian. Nëse do të tentonim t'i kategorizonim ndikimet negative të rajonit të Ballkanit kundrejt kontinentit evropian, sipas Lessenskit²⁷⁵ do të evidentonim këto problematika: së pari, BE vendosi axhendën e zgjerimit në prapavijë, duke mos e parë përgjatë kësaj periudhe krize si një prioritet të menjëhershëm; së dyti, përpjekjet e këtyre vendeve për t'i bërë ballë krizës, i riorientuan burimet e tyre nga nevojshmëria e reformave për anëtarësim në luftën ndaj krizës ekonomike; dhe, së treti, u riorientua edhe qëndrimi i BE-së përkundrejt çështjes së anëtarësimit në aspektin e përqëndrimit sidomos në politikën ekonomike dhe financiare të vendeve që synojnë anëtarësimin.

Sidoqoftë, çdo shtet, në varësi të mënyrës së organizimit ekonomik para periudhës tranzicionale dhe potencialit të aktivitetit ekonomik diferencohet nga shtetet e tjera të këtij rajoni në terma të investimeve të huaja, PBB-së për frymë, klimës së biznesit, etj. Tabela e mëposhtme ofron një paraqitje të ritmeve të rritjes ekonomike përgjatë periudhës së para dhe pas krizës ekonomike për një pjesë të vendeve të Ballkanit së bashku me projeksionet për ritmet e rritjes në afatshkurtër për vitet e ardhshme.

<i>Periudha kohore</i>	<i>2001-2003</i>	<i>2004-2006</i>	<i>2007</i>	<i>2008</i>	<i>2009</i>	<i>2010</i>	<i>2011</i>	<i>2012</i>
Shqipëria	6	5.6	6	7.7	3.6	3.3	3	0.5
Bosnjë Hercegovina	4.3	5.6	6.8	6	-2.8	0.7	1.3	0
Maqedonia	-0.3	4.1	5.9	4.8	-1	1.9	3.1	1
Mali i Zi	1.8	5.7	10.7	7.5	-5.7	2.5	2.4	0.2
Serbia	4	7	6.9	5.5	-3.5	1	1.6	-0.5
Kosova*	n.a.	3.3	6.3	6.9	2.9	3.9	5	3.8
Ballkani Perëndimor	3.2	5.6	7.3	6.4	-1.1	2.2	2.7	0.8

Burimi: FMN, World Economic Outlook, Tetor 2010, Prill 2012, Korrik 2012, Tetor 2012, dhe databaza e EBRD

²⁷⁵ Lessenski, M., (2010), 'How are the Balkans weathering the storm of the economic crisis: comparing the implications across countries in the regional and European context', *The Western Balkans: between the economic crisis and the European perspective*, Instituti për Studime Rajonale dhe Ndërkombëtare, Sofje, fq. 6-7.

Tabela 4.3: Rritja reale e PBB-së për disa vende të Ballkanit Perëndimor

	Projektimi i 2012-ës	2012 aktuale	2012 e përlogaritur	Projektimi i 2013-ës	Projektimi i 2014-ës
Shqipëria	0.8	1.6	2.2	1.8	2
Bosnjë Hercegovina	0	-0.7	-1.1	0.5	2
Kosova	3.6	2.3	1.1	3.1	4.3
Maqedonia	0	-0.3	0.4	1.4	2.5
Mali i Zi	0.2	-0.6	-0.2	1.2	1.5
Serbia	-2	-1.7	-1.9	2	2.7

Burimi: Banka Botërore, 2012

Një tërësi karakteristikash e tiparesh zhvillimi identifikojmë edhe nga pikëpamja politike për këtë kategori vendesh. Ndryshimi i regjimit politik së bashku me nevojshmërinë për të riformtuar strukturën institucionale në përshtatje dhe paralel me ecurinë e procesit të demokratizimit ka qënë i përcaktuar, ashtu si edhe për aktivitetin ekonomik, nga dy faktorë kryesorë: të brendshëm dhe të jashtëm. Së brendshmi, elitat politike kanë luajtur një rol të rëndësishëm në realizimin apo çuarjen më tej të reformave politike për të prodhuar rezultatet e synuara politike. Ndërsa së jashtëmi, faktori ndërkombëtar ka qënë gjithashtu përcaktues në drejtimin dhe statusin e këtyre ndryshimeve. Një rol të rëndësishëm në këtë aspekt ka patur edhe BE. Kështu, për Anastasakis, ‘përgjatë viteve 1990, kushtet politike të vendosura nga Bashkimi Evropian u shndërruan në një strategji të fuqishme të transformimit paskomunist që kishte për qëllim ndryshimin e politikave dhe konvergjencën e vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore me normat dhe praktikat e BE-së’²⁷⁶. Kështu, pavarësisht ndërveprimit të këtyre dinamikave në sistemet politike të vendeve paskomuniste, statusi dhe ecuria zhvillimeve politike në aspekte të veçanta ka qënë e ndryshme për vende të ndryshme. Megjithatë, sidomos për vendet e Ballkanit Perëndimor, paraqiten probleme dhe vështirësi të shumtë në shkallën e demokratizimit, çështjen e korrupsionit, kuadrin institucional, etj. Këtë e konfirmon edhe indeksi i Freedom House për vendet e këtij rajoni në elementë specifikë, si: niveli i demokratizimit, sundimi i ligjit, korrupsioni, liria, etj²⁷⁷.

Kështu, tabela e grafiku i mëposhtëm paraqesin aspekte të performacës demokratike për vende të veçanta si dhe një panoramë krahasuese të mënyrës sesi këto aspekte të veçanta të procesit të demokratizimit janë regjistruar në një dimension kohor vitet e fundit:

Tabela 4.4: Ritmet e ndryshimeve ndërmjet viteve 2008-2012

	Kroacia	Serbia	Mali i Zi	Maqedonia	Shqipëria	Bosnjë Hercegovina	Kosova
Procesi	=	=	=	↑	↓↓	↓	↓↓

²⁷⁶ Anastasakis, O., (2008), ‘The EU’s political conditionality in the Western Balkans: towards a more pragmatic approach’, *Southeast European and Black Sea Studies*, Vol. 8: 365–377, fq.365

²⁷⁷ Indeksi i Freedom House/ <<http://www.freedomhouse.org/report-types/freedom-world>>

zgjedhor							
Media pavarur	↓	↓	↓↓		↓	↓	↓
Shoqëria Civile	↑	↑↑	=	=	=	=	=
Qeverisja demokratike shtetërore	↓	↑	=	↓	↓↓↓	↓↓	↓↓
Qeverisja demokratike vendore	=	↑	=	=	↓↓↓	=	↑↑
Kuadri gjyqësor dhe pavarësia e tij	=	=	↑	↓	↓↓	↓	↑
Korrupsioni	↑↑	↑	=	↑	↓	↓	↓

Burimi: Freedom House, 2009, 2013; (Pinna²⁷⁸, 2013)
 Shënim: ↑ tregon 0.25 përmirësim; = status quo; ↓0.25 rënie




Figura 4.1: Performanca demokratike e Ballkanit Perëndimor sipas kategorisë

Burimi: Freedom House, 2013

Shënim: Trendet në një lakore të vetme për vende të veçanta të Ballkanit Perëndimor të cilat përfshijnë: procesin zgjedhor, median e pavarur, shoqërinë civile, qeverisjen demokratike shtetërore, qeverisjen demokratike vendore, kuadrin gjyqësor dhe pavarësinë e tij, si dhe korrupsionin.

Të gjithë treguesit e mësipërm, përmbledhen në atë që për Freedom House përbën nivelin e demokracisë për një vend të caktuar. Ajo që mund të vëmë re nga grafiku, është se pavarësisht specifikave në terma të zhvillimit demokratik që paraqet çdo shtet, së bashku, vendet e Ballkanit Perëndimor shfaqin thujtë të njëjtën ecure ose profil zhvillimi demokratik në secilin prej treguesve të mësipërm. Natyrisht, dallimet në ecurinë e këtyre vendeve përkundrejt përmirësimit të treguesve të mësipërm, reflektohen në kategorizimin që Freedom House përdor për statusin e demokracisë. Kështu, për vitin 2013, Kroacia, Serbia, Mali i Zi, dhe Maqedonia vlerësohen si demokraci gjysëm të konsoliduara, Kosova vlerësohet në kategorinë e regjimeve autoritare gjysëm të

²⁷⁸ Pinna, A., (2013)/ < <http://www.freedomhouse.org>>

konsoliduara, ndërsa Shqipëria dhe Bosnjë-Hercegovina shihen si qeverisje tranzicionale dhe regjime hibride.

Një çështje problematike për të gjitha vendet e rajonit përgjatë procesit të demokratizimit paraqet edhe prezenca e korrupsionit. Freedom House e vlerëson këtë të fundit si tregues, pjesë e indeksit të demokratizimit, ndërsa një vlerësim edhe më të detajuar ofron Transparency International me Indeksën e Perceptimit të Korrupsionit. Siç mund të shihet nga tabela e mëposhtme, prezenca e korrupsionit i ka pozicionuar ndër vite vendet e paskomuniste të Ballkanit Perëndimor midis vendit të 70-të dhe të 100-të nga 177 vende që merren nën vlerësim.

Tabela 4.5: Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit, Transparency International

Ballkani Perëndimor	Renditja			
	2004	2009	2011	2012
Shqipëria	108	95	95	113
Bosnjë- Hercegovina	82	99	91	72
Kroacia	67	66	37	62
Maqedonia	97	71	69	69
Kosova	-	-	112	105
Mali i Zi	-	69	66	75
Serbia	97	83	86	80

Burimi: Transparency International²⁷⁹, 2013

Në kuadrin e ndryshimeve politike të këtyre vendeve, përveç formatit të regjimit politik të vendosur, një rol të rëndësishëm luan edhe kuadri institucional. Më specifikisht, duke u fokusuar në vende si Shqipëria, Maqedonia, Bullgaria, etj, Minassian²⁸⁰, në analizimin e mjedisit ekonomik të tyre evidenton domsdoshmërinë e ngritjes së institucioneve cilësore. Kjo, sepse sipas autorit këto të fundit kanë një korrelacion të drejtpërdrejtë me mundësinë e një vendi për të gjeneruar rritje ekonomike. Rritja, rrjedhimisht çënohet nëse ka një prezencë të një cilësie të ulët të institucioneve, gjë e cila përkthehet drejtpërsëdrejti në rritjen e kostove të transaksioneve ekonomike duke i drejtuar aktivitetet ekonomike në drejtimin e gabuar. Ndryshe, zhvillimi për Minassian është i përcaktuar nga 'shpejtësia e zbatimit të reformave strukturore nga njëra anë, dhe nga ngritja e institucioneve moderne ekonomike, politike, dhe sociale nga ana tjetër'²⁸¹. Zhvillimi dhe ngritja e institucioneve demokratike është prodhuar jo vetëm si një nevojshmëri e brendshme, por edhe si një kërkesë e faktorit të jashtëm, sidomos atij evropian. Kjo sepse, ngritja e institucioneve të qëndrueshme të cilat garantojnë demokracinë, sundimin e ligjit, si dhe të drejtat e njeriut

²⁷⁹ Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit, (2013), Transparency International
<<http://www.transparency.org/cpi2013/results?>>

²⁸⁰ Minassian, *op.cit.*, fq. 58-63.

²⁸¹ *ibid.*, fq. 49.

është në qendër të edhe të kritereve politike të Bashkimit Evropian për vende të cilat synojnë anëtarësimin në këtë organizatë.

Për më tepër, përbalja me krizën ekonomike e vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe rimëkëmbja e ngadalshme e tyre nga kriza, e ka vendosur në qendër të vëmendjes rëndësinë e mjedisit institucional për çdo vend. Ky mjedis, përfaqësohet nga një tërësi insitucionesh të cilat duhet të mundësojnë mbarëvajtjen e sistemit politik e atij ekonomik. Në trajtesën e mësipërme, këto institucione i kemi parë si një bashkësi rregulluese formale dhe joformale e cila përshin: cilësinë e procesit të privatizimit, liberalizimin e çmimeve, liberalizimin e tregëtisë së jashtme, sistemi ligjor, korrupsioni, etj. Megjithatë, në varësi të natyrës së studimit, studiues të ndryshëm, u referohen elementëve të ndryshëm të analizës së kuadrit institucional dhe cilësisë së tij për vende apo rajone të caktuara.

Nëse i referohemi vlerësimit të kuadrit institucional nën procesin e tranzicionit demokratik për vendet e Ballkanit Perëndimor, si një bashkësi shetesh me dinamika të ngjashme zhvillimi politik dhe ekonomik, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (ERBD), paraqet situatën e mëposhtme të treguesve të përdorur në vlerësimin e progresit institucional në një vend të caktuar. Vlerësimi i secilit prej treguesve bëhet sipas një shkalle nga 1 deri 4+, ku 1 korrespondon me mungesën e plotë të përpjekjeve për tranzicion nga ekonomia e planifikuar, dhe 4+ korrespondon me përmbushjen apo arritjen e standardeve të një ekonomie tregu.

Tabela 4.6: Kuadri institucional për vende të Ballkanit Perëndimor sipas treguesve të tranzicionit të ERBD

	Pjesa e sektorit privat në PBB	Privatizimi i ndërmarrjeve të mëdha	Privatizimi i ndërmarrjeve të vogla	Menaxhimi i përgjithshëm dhe riorganizimi strukturor i kompanive	Tregtia e jashtme	Politika e konkurrencës	Reforma bankare dhe liberalizimi i normave të interesit	Reforma e përgjithshme në infrastrukturë
Shqipëria	75	4-	4	2+	4+	2	3	2
Bosnjë-Hercegovina	60	3	3	2	4	2	3	2+
Maqedonia	70	3+	4	3-	4+	2+	3	3-
Mali i Zi	65	3	4-	2	4	2	3	2+
Serbia	60	3.2	3.8	2.3	4	2.3	3.2	2.3

Burimi: Raporti i Tranzicionit i ERBD, 2009

Ajo që mund të vëmë re nga vlerësimi i treguesve për secilin vend është progresi i arritur në liberalizimin e tregëtisë së jashtme dhe reformën bankare. Ndërsa për treguesit e tjerë statusi i arritjeve është më i diferencuar, por me ecuri të përgjithshme në segmente të përbashkët për këtë kategori vendesh. Trendi që ka ndjekur reforma institucionale që prej

dekadës së parë të tranzicionit demokratik për këtë kategori vendesh dhe vende të tjera të cilat iu nënshtruan tranzicionit ekonomik prezantohet në grafikun e mëposhtëm të ERBD-së. Natyrisht, ai është një dëshmues i mënyrës se si kanë evoluar këto reforma për të mbërritur në vlerësimet e kohëve të fundit të prezantuara më sipër.




Figura 4.2: Ecuria e reformës institucionale në ekonomitë e tranzicionit, 1991-2002²⁸²
Burimi: ERBD, 2002

Një element kyç për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomive të këtyre vendeve është edhe konkurrueshmëria. Kjo e fundit, e vlerësuar në Raportin Botëror të Konkurrueshmërisë (GCR) (2012-2013) nga një total prej 144 shtetesh, paraqet një situatë jo shumë të favorshme e pozitive për vendet e Ballkanit Perëndimor. Në kuadrin e këtij raporti konkurrueshmëria shihet si ‘tërësia e institucioneve, politikave, dhe faktorëve që përcaktojnë nivelin e produktivitetit të një vendi’²⁸³. Kështu, ndër vendet e këtij rajoni me renditjen më të mirë paraqitet Mali i Zi (vendi i 72-të), ndërsa Shqipëria dhe Serbia paraqiten me renditje më poshtë sesa mesatarja e rajonit. Tabela e mëposhtme ofron një panoramë më të qartë të pozicionimit të secilit prej shteteve përkundrejt treguesve përbërës të Indeksit të Konkurrueshmërisë Botërore.

Tabela 4.7: Shtyllat e Konkurrueshmërisë Botërore të WEF (Forumi Ekonomik Botëror), renditjet 2012-2013

Vendet	Shqipëria	Bosnjë Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Serbia	Ballkani Perëndimor

²⁸² Shënim: Kjo reformë i referohet indeksit të përdorur nga ERBD për ekonomitë në tranzicion, dhe ku ky indeks është një shumatore e disa treguesve kryesorë të analizuar dhe kuantifikuar, si: politika e konkurrencës, reforma e ndërmarrjeve, reforma e sektorit bankar, dhe reforma në institucionet jo-bankare financiare. Segmenti i vlerave të indeksit është [0,4], ku nivelet më të ulëta tregojë reforma më të reduktuara e të ngushta institucionale nga ana e vendeve në tranzicion.

²⁸³ Schwab, K. Sala-i-Martin, X., (2012), *The Global Competitiveness Report 2012-2013*, Forumi Ekonomik Botëror (WEF), Gjenevë, fq. 4.

Indeksi Botëror i Konkurrueshmërisë		89	88	80	72	95	85
1	Kërkesat bazë	87	81	71	74	95	82
2	Përmirësuesit e efikasitetit	92	97	84	74	88	87
3	Faktorët e inovacionit	113	99	110	69	124	103

Burimi: Forumi Botëror Ekonomik (WEF): Raporti Botëror i Konkurrueshmërisë

Shënim: Renditja bëhet për 144 vende, ku sa më e ulët renditja aq më mirë.

Në përputhje edhe me teorinë ekonomike, GCR-ja²⁸⁴, i ndan ekonomitë në tre faza zhvillimi: ekonomi të orientuara në faktorët e prodhimit (konkurrueshmëria rritet nëpërmjet funksionimit të institucioneve, një mjedisi makroekonomik stabil, një infrastrukturë të zhvilluar dhe një forcë pune të shëndetshme); ekonomi të orientuara nga efikasiteti (konkurrueshmëria rritet si pasojë e arsimit të lartë dhe trajnimit, mirëfunksionim i tregut të punës dhe atij financiar, e një treg i madh i brendshëm ose i jashtëm), dhe etapa e tretë përfundimtare e zhvillimit korrespondon me ekonomitë e orientuara tek inovacioni (konkurrueshmëria rritet nëpërmjet përqendrimit tek teknologjia dhe inovacioni, e rrjedhimisht sofistikimi i biznesit). Sipas këtij raporti ekonomitë e vendeve të rajonit të Ballkanit Perëndimor janë në etapën e dytë të zhvillimit ekonomik e cila korrespondon me ekonominë e orientuar drejt efikasitetit, por që për të rritur konkurrueshmërinë, politikat ekonomike duhet të fokusohen tek shtyllat e sipërpërmendura.

Natyrisht, vlerësimi i aspektit ekonomik institucional nuk është i mjaftueshëm për një panoramë të përgjithshme të këtyre zhvillimeve institucionale për vendet e Ballkanit Perëndimor. Për këtë, më poshtë paraqesim edhe statusin e zhvillimeve të fundit të fokusuar më shumë brenda qasjes së qeverisjes të ofruar nga Worldwide Governance Indicators (2013). Këta të fundit, vlerësojnë ecurinë e dimensioneve të veçanta të qeverisjes për 215 ekonomi të ndryshme përgjatë kohës në bazë një-vjeçare. Këto dimensionet janë: stabiliteti politik dhe mungesa e dhunës, efektiviteti i qeverisjes, cilësia e reformave rregulluese, sundimi i ligjit, kontrolli i korrupsionit, dhe kundërshtimi e llogaridhënia²⁸⁵.

Tabela 4.8: Treguesit e qeverisjes për vitin 2013 për vendet e Ballkanit Perëndimor (Kaufman *et al.*, 2013)

Treguesit/Vendet	Kundërshtimi e llogaridhënia	Stabiliteti politik dhe mungesa e dhunës	Efektiviteti i qeverisjes	Cilësia e reformave rregulluese	Sundimi i ligjit	Kontrolli i korrupsionit
Shqipëria	-0.11	-0.16	-0.28	0.17	-0.57	-0.72
Bosnjë-Hercegovina	-0.14	-0.54	-0.47	-0.06	-0.23	-0.3
Maqedonia	0.00	-0.44	-0.07	0.35	-0.24	0.02
Mali i Zi	0.23	0.56	0.13	0.01	0.00	-0.1
Serbia	0.17	-0.22	-0.11	-0.08	-0.39	-0.31

²⁸⁴ *ibid.*, fq. 5-8.

²⁸⁵ Banka Botërore, *Worldwide Governance Indicators*:
<<http://info.worldbank.org/governance/wgi/index.aspx#home>>

Mesatarja	0.03	-0.16	-0.16	0.078	0.286	0.282
------------------	------	-------	-------	-------	-------	-------

Burimi: BB, Worldwide Governance Indicators, 2013

Shkalla e vlerësimit të secilit prej dimensioneve të qeverisjes sipas Worldwide Governance Indicators varion nga -2.5 në 2.5, ku vlerat më të larta korrespondojnë në rezultate më të mira të qeverisjes, dhe e anasjellta për vlerat më të ulta. Nëse do i referohemi përmbledhjes së të dhënave për vendet e parashtruara në tabelë, vëmë re se Mali i Zi është i vetmi vend për vitin 2012 që ka vlerësime pozitive në të gjitha dimensionet e qeverisjes, përveç çështjes së kontrollit të korrupsionit. Problematike për të gjitha vendet e tjera mbeten dimensionet e stabilitetit politik dhe i mungesës së dhunës, efektiviteti i qeverisjes, si dhe kontrolli i korrupsionit.

Më konkretisht, nisur edhe nga fokusi ynë studimor, nëse shohim nga pikëpamja krahasuese çështjen e stabilitetit politik, vëmë re se ajo është problematike për të gjitha vendet e këtij rajoni.

Tabela 4.9: Të dhëna krahasimore mbi vendet e Ballkanit Perëndimor në lidhje me stabilitetin politik e mungesën e dhunës, Worldwide Governance Indicators (BB)

Treguesi	Vendi	Viti	Vlerësimi i dimensionit të qeverisjes	Renditja
Stabiliteti Politik dhe Mungesa e Dhunës	Shqipëria	2002	-0.39	30.77
		2007	-0.20	37.98
		2012	-0.16	39.81
	Bosnjë-Hercegovina	2002	-0.25	38.46
		2007	-0.60	25.96
		2012	-0.54	28.91
	Kosova	2002	n/a	n/a
		2007	n/a	n/a
		2012	-1.15	15.17
	Maqedonia	2002	-1.12	17.31
		2007	-0.43	30.29
		2012	-0.44	33.18
	Mali i Zi	2002	n/a	n/a
		2007	0.15	48.08
		2012	0.56	63.98
	Serbia	2002	-0.60	26.44
		2007	-0.61	25.48
		2012	-0.22	38.86

Burimi: BB, Worldwide Governance Indicators²⁸⁶, 2013
(<http://info.worldbank.org/governance/ëgi/index.aspx#reports>)

Ashtu siç mund të shohim, përgjatë më shumë se një dekade (dekadës së fundit), destabiliteti politik ka vazhduar të jetë një çështje problematike për këtë kategori vendesh. Vetëm Mali i Zi ka regjistruar vlera pozitive, edhe pse këto të fundit janë larg të konsideruarit si rezultate të mira të këtij dimensionit të qeverisjeje. Ndërsa, pjesa tjetër e

²⁸⁶ Shënim: Vlerësimi i dimensionit të qeverisjes, tregon statusin e treguesit për një vend në një shkallë nga -2.5-2.5, ku vlera më të larta tregojnë rezultate më të mira qeverisjeje. Ndërsa, renditja tregon renditjen e një vendi në krahasim me të gjitha vendet e tjera, dhe ku 0 tregon renditjen më të ulët ndërsa 100 renditjen më të lartë.

vendeve të këtij rajoni identifikohet me vlera negative përkundrejt çështjes së stabilitetit politik dhe mungesës së dhunës, ku një situatë më e rënduar paraqitet për Maqedoninë. Përsa i përket renditjes krahasimore të këtyre vendeve në raport me të gjithë ekonomitë e tjera (215 të tilla) të botës, pozicionimi vazhdon të jetë jo i mirë. Më konkretisht, ato ndodhen ndërmjet pozicionit të 30-të dhe 40-të, çka dëshmon për rezultate të ulëta e problematike të qeverisjes në këtë dimension.

Kështu, nëpërmjet treguesve e indekseve të mësipërm, mund të shohim se mjedisi institucional për vendet e Ballkanit Perëndimor është larg të qenit një mjedis i mirërregulluar dhe eficient. Mungesa e një mjedisi të tillë të mirërregulluar dhe funksional përbën pengesë edhe për mbarëvajtjen e aktivitetit politik e atij ekonomik. Ndryshe, Minassian, rëndësinë e një organizimi të mirë institucional e sheh si një domosdoshmëri për një mjedis ekonomik konstruktiv. Kjo sepse, sipas tij 'cilësia e dobët institucionale krijon kosto të larta transaksioni të cilat i çorinetojnë sinjalet e tregut dhe i drejtojnë aktivitetet ekonomike në drejtim të gabuar'²⁸⁷. Megjithatë, ajo çka shërben si stimul dhe përmirësues i mundëshëm i situatës aktuale përsa u përket si institucioneve ekonomike e atyre politike, është perspektiva e anëtarësimit të ardhshëm të këtyre vendeve në Bashkimin Evropian. Kjo sepse, pritet që anëtarësimi brenda kësaj organizate të ofrojë një mjedis ekonomik-politik stabil e përmirësim të ndjeshëm të kuadrit ligjor e institucional në këto vende. Natyrisht, në tranzicionin ekonomik të vendeve paskomuniste një rol të rëndësishëm ka patur edhe institucioni i FMN-së. Ky i fundit, u krijua nga vendet perëndimore 'si një mekanizëm apo mjeti kryesor për orientimin e ndihmës drejt vendeve të cilat kishin dalë nga gërmadhat e perandorisë sovjetike, si dhe ishte përgjegjës për krijimin e një strategjie ndërveprimi me këto vende'²⁸⁸. Si i tillë, përgjatë periudhës së tranzicionit, sipas Stone, FMN ka luajtur një rol të rëndësishëm në marrëdhënien ndërmjet fuqisë, interesave, e politikëbërjes dhe ushtron ndikim mbi politikat kombëtare të këtyre vendeve.

Në përmbledhje, mund të shohim se dinamika e jashtme dhe ajo e brendshme, jo gjithmonë kanë qenë të ndërlidhura e paralele me njëra-tjetrën, dhe sipas Bieber një problem që qëndron evident për vendet e Ballkanit Perëndimor është gjendja e demokracisë²⁸⁹. Kështu, shohim se, nga sa identifikua më sipër, procesi i demokratizimit në vendet e Ballkanit Perëndimor është ende i ngadaltë dhe progresi drejt konsolidimit të këtyre demokracive jo i mjaftueshëm. Nëse, do të tentonim të identifikonim arritjet dhe statusin e zhvillimeve përkundrejt secilës fazë që procesi i demokratizimit përfshin, atëherë do të përftohej një panoramë e tillë: në vitet 90', të cilat përkuan me etapën e ndryshimit të regjimit, vështirësitë me të cilat u përballën vendet e këtij rajoni janë të dukshme në terma si të treguesve makroekonomikë, ashtu edhe atyre politikë; institucionalizimi i demokracisë përkoji me një periudhë stabilizimi dhe përmirësimi të ndjeshëm të këtyre elementëve, gjë që u reflektua më shumë në përmirësimin e situatës makroekonomike, ashtu siç dëshmojnë edhe treguesit e evidentuar më sipër; së fundmi, ajo çka mund të konfirmojmë në lidhje me etapën e tretë

²⁸⁷ Minassian, *op.cit*, fq.63.

²⁸⁸ Stone, W. R., (2002), *Lending credibility: The International Monetary Fund and the Post-Communist Transition*, Princeton University Press, fq. 3-4.

²⁸⁹ Bieber, F., (2013), 'The Western Balkans are dead-long live the Balkans: Democratization and the limits of the EU', *Unfinished Business: The Western Balkans and the International Community*, 1-10, fq. 5.

teorike, atë të konsolidimit të demokracisë, është se statusi i zhvillimeve të etapës së dytë, ka qënë përcaktues edhe për vijimësinë e konsolidimit të demokracisë. Kështu, pavarësisht trendeve rritëse në disa dimensione të qeverisjes dhe të sferës ekonomike përgjatë etapës së institucionalizimit të demokracisë, ritmi i këtyre zhvillimeve për një pjesë të mirë të vendeve të këtij rajoni nuk ka qënë i mjaftueshëm për të mundësuar kalimin drejt etapës përmbyllëse të procesit të tranzicionit demokratik. Ndryshe Serbos do të konfirmonte se ‘pavarësisht arritjeve të vazhdueshme dhe përpjekjeve të bëra nga vendet e Ballkanit Perëndimor në rrugën e tyre drejt integritit në BE, ato vazhdojnë të hasin në probleme të ndryshme që i përkasin sferës ekonomike, politike, institucionale, si: ‘pasiguri kushtetuese, sindroma e “shtetit të dobët”, një mjedis i varfër biznesi, dhe normë e lartë e papunësisë dhe varfërisë’²⁹⁰.

4.3 RASTI I SHQIPËRISË²⁹¹

Pavarësisht ngjashmërisë që prezantojnë vendet paskomuniste në disa dinamika zhvillimi ekonomik e politik, ato gjithsesi diferencohen nga njëra-tjetra. Nuk mund të flasim për uniformitet zhvillimesh ekonomike dhe politike për shkak të karakteristikave të ndryshme sociale, fizike, e politike që paraqesin shoqëritë e tyre jo vetëm përgjatë periudhës së tranzicionit, por me të cilat janë identifikuar edhe në periudhën e ndryshimeve të formatit të regjimit politik apo proceseve shtet-formuese. Kështu, ndryshimet në përbërjen sociale, stratifikimin e shoqërisë, kulturën politike, pozicionin gjeografik, mënyrën e organizimit të pushtetit politik, ushtrimit të autoritetit brenda kufijve shtetërorë, etj., bëjnë që etiketimi për zhvillimet e tranzicionit demokratik për vendet paskomuniste, madje më specifikisht edhe për vendet e Ballkanit Perëndimor të jetë ai i një heterogjeniteti zhvillimor.

Nëse i referohemi rastit të Shqipërisë paskomuniste, koncepti i parë që na duhet të sqarojmë është etiketimi ‘paskomunist’ që vendosim. Ky i fundit, sipas Shala i referohet një etiketimi i cili përshkruan ‘kushtet e një shoqërie, eksperimenti transformues soco-politik e ekonomik i së cilës, përgjatë 1945-1990 ishte i përqëndruar ekskluzivisht në komunizmin Marksist duke theksuar një aspekt mbi gjithë të tjerët: kolektivizimin, dhe ku ky i fundit u mbështet në zbatimin e pronësisë publike të burimeve prodhuese nëpërmjet kontrollit të përqëndruar, si dhe suprimimit të shoqërisë duke tentuar për të eliminuar diversitetin dhe shndërruar shoqërinë në barazitare’²⁹². Kështu, nevojshmëria e ndryshimeve në fillim të viteve 90’ për këtë vend, ashtu si dhe për vende të tjera të Evropës Lindore, lidhej me dy procese kryesore, njëri politik e tjetri ekonomik. I pari i referohet kalimit nga formati jodemokratik i totalitarizmit drejt demokracisë, dhe i dyti, kalimit nga një mënyrë e centralizuar e organizimit të aktivitetit ekonomik tek ekonomia

²⁹⁰ Serbos, S., (2008), ‘European integration and South Eastern Europe: Prospects and challenges for the Western Balkans’, *UNISCI Discussion Papers*, 18, 95-112, fq. 95.

²⁹¹ Shtojca 3 përmban një përmbledhje sintetike të zhvillimeve në kontekstin e treguesve të stabilitetit politik përgjatë periudhës pas ndryshimit të regjimit.

²⁹² Shala, A., (1997), ‘Social and political change in post-communist Albania, the 1990’s’, Institute of Social Studies, Graduate School of Development Studies, fq. 23.

e tregut. Si përfundim, dy procese të ndërlidhura me njëri-tjetrin brenda një konteksti të caktuar kohor të quajtur proces tranzicioni.

Tashmë, pas dy dekadash e gjysëm prej etapës së parë të tranzicionit demokratik, asaj të ndryshimit të regjimit politik, vërejmë se, nga një vështrim i përgjithshëm i proceseve demokratizuese, sistemi politik është përballur me sfida të shumta. Sipas Bideleux dhe Jeffries, nëse në vendet e tjera si: Mali i Zi, Bullgaria, Rumania apo Serbia, strukturat dhe rrjetet e pushtetit të trashëguara nga e kaluara komuniste u ruajtën edhe pas ndryshimeve të regjimit, në Shqipëri, të gjithë këto struktura të së kaluarës komuniste u shkatërruan, dhe pikërisht për këtë arsye ‘përpyekja e vazhdueshme për të vendosur demokracinë liberale është penguar nga një mungesë e theksuar e pushtetit të strukturave të caktuara dhe lidhjeve sociale të çdo lloji’²⁹³.

Në fakt, konstatimi i Bideleux dhe Jeffries na drejton tek çështja sesi është menaxhuar vetë tranzicioni, apo strategjia bazë që është përdorur për të mundësuar akomodimin e ndryshimeve në strukturën e tregut dhe formatin qeverisës. Dy perspektiva shpjeguese marrin rëndësi në këtë drejtim: politika e reformës në ekonomi dhe qasja institucionale.

Politika e reformës tenton të identifikojë mënyrën e shpërndarjes së kostove dhe përfitimeve në reformat ekonomike të ndjekura nga vendet paskomuniste përgjatë procesit të tranzicionit. Shpërndarja e kostove dhe përfitimeve brenda një vendi paskomunist në kuadër të reformave për të kaluar tranzicionin është edhe elementi kyç që ndihmon në analizimin e përzgjedhjes specifike të njëres apo tjetres reformë, në interpretimin e kohëzgjatjes së tyre, si dhe mbështetjes së votuesve për një subjekt politik apo një tjetër, për këtë kategori vendesh.

Shqipëria, ashtu si pjesa tjetër e vendeve paskomuniste, sipas Stone²⁹⁴ u përball me dy mundësi kryesore veprimi: nga njëra anë, ndjekja e shembullit të Kinës, për reforma graduale të cilat patën sukses në sektorin ekonomik, dhe nga ana tjetër, ndjekja e modelit neoliberal të politikave në vendet e Amerikës Latine të cilat u shoqëruan me kosto të mëdha si dhe destabilitet politik. Në fakt, duke parë këto dy modele, për të mundësuar suksesshëm tranzicionin në funksion të një strategjie të mesme flet Przeworski. Ai bazohet tek ideja se reformat, së pari do të kenë kostot përkatëse në një vend të caktuar dhe vetëm më vonë do të shfaqen përfitimet prej tyre. E thënë ndryshe, reformat ekonomike në vendet paskomuniste, në afatshkurtër, pritet të prodhojnë kosto sociale e ekonomike për shoqërinë, për të mundësuar më pas kalimin drejt një ekonomie të lirë tregu. Kostot lidhen me papunësinë e lartë, inflacionin e lartë, rritjen e çmimeve, etj, ndërsa përfitimet pritet të prodhohen si rezultat i masave (reformave) të njëpasnjëshme gjatë një periudhe afatshkurtër për të përfituar në afatgjatë. Problemi qëndror në këtë aspekt është se politikani sheh për zgjedhjet e radhës e për pasojat afatshkurta të përkthyer në kosto sociale të këtyre reformave. Rrjedhimisht, politikbërësve iu duhet të përballen me faktin se si do të akomodojnë pakënaqësitë që lidhen me reformat në afatshkurtër për të justifikuar përfitimet e së ardhmes.

Pikërisht, këtë sfidë me të cilën përballen politikbërësit e tranzicionit në vendet paskomuniste, Przeworski, tek *Demokracia dhe Tregu*, ndryshe e trajton si ‘përshkrimi i “luginës së tranzicionit” për tu ngjitur në “kodrat e larta” të një ekonomie të reformuar’²⁹⁵.

²⁹³ Bideleux, Jeffries, *op.cit.*, fq.72.

²⁹⁴ Stone, *op.cit.*, fq. 5.

²⁹⁵ Przeworski, (1991), *op.cit.*, fq. 138.

Grafikisht, kjo situatë shpjegohet nga Przeworski nëpërmjet ‘kurbës J’ e cila identifikon rënien e vështirësitë e reformave në afatshkurtër për të përfituar nga rezultatet e reformave në mënyrë graduale në afatgjatë.

Çështja kryesore që shtrohet është se si kanë vijuar dinamikat e politikës së reformës ekonomike në vendet paskomuniste dhe sfidat reale me të cilat janë përballur ato. Pra, nëse procesi ka prodhuar kosto, nga cilët aktorë janë prodhuar këto kosto, si dhe a kanë prodhuar pengesa reale në zbatimin e reformave këta aktorë. Sipas, Hellman²⁹⁶, reformat ekonomike kanë prodhuar kosto në të gjitha vendet paskomuniste, edhe në rastet më të suksesshme të tranzicionit, si: inflacion të lartë, papunësi e lartë, rënie e të ardhurave reale, rënie e shërbimeve publike, si dhe pasiguri në rritje. Duke u përqendruar tek inflacioni dhe vlerësimi i tij në marrëdhënie me ‘kurbën J’, Stone thekson se vendet paskomuniste me inflacion më të lartë patën rritje më të ngadaltë, ose rënie më të shpejtë, dhe ishin njëerëzitet e varfër ata që vuajtën më shumë nga inflacioni, duke prodhuar në këtë mënyrë edhe rritje të pabarazisë së të ardhurave²⁹⁷. Kostot e fillimit të tranzicionit i kanë orientuar qëndrimet e politkberësve ndaj humbësve potencialë në dy drejtime: qeveritë ose janë izoluar nga presioni elektoral dhe kanë ndërmarrë reforma të pjesshme duke rezultuar në progres të ulët reformash, ose kanë qenë më të ndjeshme ndaj kërcënimit të humbësve dhe kanë ndërmarrë reforma gjithpërfshirëse. Megjithatë, sipas Hellman ajo çka përbën tiparin e veçantë të këtyre zhvillimeve ishte se ‘në kontrast me dinamikat e reformës ekonomike dhe “kurbës J”, humbësit, në tranzicionet paskomuniste nuk kanë përbërë pengesën kryesore politike ndaj reformave. Ato janë përballur me një tërësi sfidash nga një burim i papritur: aktorët (si bankierët, menaxherët e kompanive shtetërore të cilët u kthyen në pronarë të tyre, sipërmarrësit e rinj, etj) të cilët gëzonin përfitime të mëdha nga shtrembërimet e një reforme të pjesshme tregu dhe luftuan për garantimin e fitimeve të tyre nga disbalancimet e reformave të pjesshme²⁹⁸.

Pra, ndryshe nga supozimet bazë të “kurbës J”, e cila bazohet tek fakti se reformat ekonomike prodhojnë kosto në afatshkurtër, dhe përfitimet i prodhojnë në afatgjatë, në tranzicionin paskomunist, reformat prodhuan në afatshkurtër përfitime për një grup të vogël, dhe kosto të shpërndara për të gjithë ekonominë.

Logjika e strategjisë së tranzicionit, e sugjeruar nga Przeworski përbën njërin aspekt të prodhimit të një baze legjitimimi të reformave ekonomike paskomuniste. Natyrisht, një rol të rëndësishëm në këtë aspekt luan edhe qasja e zgjedhjes institucionale nëpërmjet disa këndvështrimeve specifike të saj. Rëndësia e kësaj qasjeje lidhet me faktin se, për të kuptuar ecurinë e proceseve transitore në vendet paskomuniste, nevojitet të njihen pikërisht këto dinamika të cilat mund të jenë të ndryshme për vende të ndryshme, por që përligjin ekzistencën e një kuadri të caktuar institucional në një vend specifik. Si të tilla, duke përmbledhur edhe bazën teorike të pjesës së parë, identifikojmë pikëpamjen kulturore, ekonomike, politike e sociale. Secila prej këtyre dinamikave ofron një logjikë shpjeguese e justifikuese të ekzistencës së një kuadri të caktuar institucional për vende të

²⁹⁶ Hellman, S. J., (1998), ‘Winners take all: the politics of partial reform in post-communist transitions’, *World Politics*, Vol. 50(2): 203-234, fq. 16.

²⁹⁷ Stone, W. R., (2002), *Lending credibility: The International Monetary Fund and the Post-Communist Transition*, Princeton University Press, fq. 12.

²⁹⁸ Hellman, *op.cit.*, fq. 16-17.

caktuara. Kështu, *pikëpamja kulturore*, me përfaqësues Almond e Verba (1963) thekson se institucionet në një vend të caktuar janë produkt i kulturës specifike të atij vendi. Pra, ekziston një varësi nga rruga e zhvillimit që kanë ndjekur institucionet deri në momentin aktual zhvillimor të tyre. Në kontekstin e kësaj pikëpamjeje do të thoshim se për Shqipërinë, ashtu si edhe për një pjesë të konsiderueshme të vendeve paskomuniste, e kaluara komuniste me indoktrinimin marksist-leninist ka ndikuar në përvijimin e kuadrit institucional me tendencë përqendrimi pushteti. Ndërsa, *pikëpamja ekonomike*, e trajtuar më sipër nëpërmjet Przeworskit, e bazon kuadrin institucional në funksion të reformës ekonomike të ndjekur. Pra, sipas qëndrimit që humbësit nga reforma ekonomike mbajnë përkundrejt sistemit politik e institucioneve të veta, sistemi politik ose do të tentojë të akomodojë kundërshtimet nëpërmjet hapjes ndaj këtyre grupimeve, ose izolohet duke prodhuar institucione më të centralizuara. Nga *pikëpamja sociale*, sigurisht do të merrnim në konsideratë përbërjen e shoqërisë dhe prezencën në të apo jo të entive të ndryshme. Rrjedhimisht, prania e grupimeve të ndryshme do të prodhonte dy përgjigje të mundshme ndaj mënyrës së sendërtimit të kuadrit institucional në një vend: ose ndërtimit të institucioneve të cilat të ofronin mundësinë e aksesit të këtyre grupimeve, ose mbylljes së tyre e dominimit nga grupimi etnik më i madh. Në statusin aktual të zhvillimeve të Shqipërisë paskomuniste, mund të themi se formati institucional ka prodhuar mundësi për përfaqësimin dhe përfshirjen e grupimeve të tjera etnike. Së fundmi, *politikisht*, zgjedhjen e institucioneve të caktuara në vendet paskomuniste Frye²⁹⁹ e shpjegon me mënyrën e ndërtimit të sistemit partiak, nëse ky i fundit krijon mundësinë e atyre që quhen bllokime të procesit politik nga parti të tjera më të vogla, apo nëse sistemi është i orientuar drejt bipartitizmit. Historia politike e Shqipërisë pluraliste dëshmon për tendencat e kalimit të sistemit partiak drejt pluripartitizmit me dy parti kryesore që mbajnë peshën kryesore. Në fakt, dekadën e fundit, kanë qenë partitë e vogla ato të cilat kanë luajtur rolin qendror në vijueshmërinë e qeverisjes brenda një koalicioni partiak apo një tjetri.

Pra, ajo çka përbën interes studimor në kontekstin e kuadrit institucional për vendet paskomuniste, e rrjedhimisht për Shqipërinë, është struktura institucionale e prodhuar nga tranzicioni dhe shpjegimi i kësaj të fundit. Frye, e finalizon këtë logjikë duke argumentuar se ekziston një marrëdhënie e ngushtë ndërmjet institucioneve ekzistuese, pasigurisë, dhe zgjedhjes institucionale. Kur pasiguria në vend (u referohemi vendeve në procesin e tranzicionit demokratik) është e ulët, aktorët politikë mund të përdorin institucionet ekzistuese për të përkthyer pushtetin e tyre aktual politik në rezultate të favorshme institucionale, ndërsa me shfaqjen e pasigurisë ulet aftësia e aktorëve politikë të fuqishëm për të përkthyer pozicionin e tyre të privilegjuar në një set të ri institucionesh³⁰⁰.

Specifikisht, nga pikëpamja e indekseve dhe treguesve të veçantë që agjenci e institucione të tjera ndërkombëtare prodhojnë më poshtë prezantojmë në panoramë të vijueshmërisë së disa prej elementëve të sistemit politik për rastin e Shqipërisë.

²⁹⁹ Frye, T., (1997), 'A politics of institutional choice: post-communist presidencies', *Comparative Political Studies*, Vol. 30: 523-552, fq. 530-531.

³⁰⁰ Frye, T., (1997), 'A politics of institutional choice: post-communist presidencies', *Comparative Political Studies*, Vol. 30: 523-552, fq. 546-547.

Një ndër këta tregues është ai i dimensioneve të qeverisjes të prodhuar nga Banka Botërore në bazë vjetore të identifikuar si Worldwide Governance Indicators.

Tabela 4.10: Treguesit e qeverisjes për Shqipërinë përgjatë dekadës së fundit, trendi 2002, 2007, 2012

Treguesi	Vendi	Viti	Vlerësimi i dimensionit të qeverisjes	Renditja
Kundërshtimi dhe llogaridhënia	Shqipëria	2002	-0.04	47.60
		2007	0.09	51.44
		2012	0.01	50.24
Stabiliteti politik dhe mungesa e dhunës	Shqipëria	2002	-0.39	30.77
		2007	-0.20	37.98
		2012	-0.16	39.81
Efektiviteti i qeverisë	Shqipëria	2002	-0.57	32.68
		2007	-0.38	42.23
		2012	-0.28	44.98
Cilësia rregulluese	Shqipëria	2002	-0.25	43.63
		2007	0.07	55.83
		2012	0.17	56.46
Sundimi i ligjit	Shqipëria	2002	-0.92	21.05
		2007	-0.70	27.75
		2012	-0.57	35.07
Kontrolli i korrupsionit	Shqipëria	2002	-0.86	25.85
		2007	-0.66	29.61
		2012	-0.72	26.79

Burimi: Worldwide Governance Indicators, Shqipëria, Banka Botërore, 2013
(<http://info.ëorlbank.org/governance/ëgi/index.aspx#reports>)

Siç mund ta shohim, vlerësimet për të gjitha dimensionet e qeverisjes për Shqipërinë janë nën nivelin mesatar. Më problematike, dhe me nivele më të ulëta paraqiten dimensionet e stabilitetit politik, sundimit të ligjit dhe kontrollit të korrupsionit, çështje të cilat më sipër teorikisht duke iu referuar literaturës akademike i kemi parë ngushtësisht të lidhura me problematikën që ato prodhojnë edhe për reformën ekonomike. Më konkretisht, trendin që ka pësuar stabiliteti politik i vendit e shohim si më poshtë.




Figura 4.3: Shqipëria 1996-2012, treguesi i agreguar: stabiliteti politik dhe mungesa e dhunës³⁰¹
 Burimi: *Worldwide Governance Indicators, 2013*

Nëse bëjmë krahasimin prej fillimit të periudhës së marrë në konsideratë deri në vitin 2012, rritja, në kuptimin e përmirësimit të situatës në këtë tregues të qeverisjes është prej 10%, edhe pse vitet e fundit ajo ka shënuar një trend zbritës por të qëndrueshëm në krahasim me fillimet e dekadës së fundit.

Ndërkohë, nëse i referohemi më konkretisht vlerësimit dhe renditjes përkatëse të vendit përgjatë dekadës së fundit në lidhje me çështjen e korrupsionit, problematika vazhdon të mbetet e qëndrueshme. Këtë e dëshmon Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit (CPI) në vlerësimin që ofron për korrupsionin në rastin e Shqipërisë, por edhe në renditjen e përgjithshme në krahasim me vendet e tjera. Tabela e mëposhtme përmbledh të dhënat e raporteve të CPI ndër vite për dekadën e fundit në këtë vend.

Tabela 4.11: Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit për Shqipërinë, 1999-2012³⁰²

Viti	Shqipëria	
	Vlerësimi	Renditja
1999	2.2	84/99
2000	-	-
2001	-	-
2002	2.5	81/102
2003	2.5	92/133
2004	2.5	108/146
2005	2.4	126/159
2006	2.6	111/163
2007	2.9	105/179
2008	3.4	85/180
2009	3.2	95/180
2010	3.3	87/178
2011	3.1	95/183
2012	3.3	113/176
2013	3.1	116/177

Burimi: Të dhëna të prodhuara nga *Transparency International*³⁰³

Për të ofruar një analizë dhe pozicionim më të qartë të problematikës së korrupsionit brenda llojit të regjimit e mënyrës se si është strukturuar pushteti në këtë vend, na ndihmon klasifikimi që bën Mungiu-Pippidi në lidhje me marrëdhënien korrupsion-regjim. Sipas autores, tre janë llojet e regjimit në lidhje me çështjen e korrupsionit:

³⁰¹ Worldwide Governance Indicators, *Country Data Report for Albania, 1996-2012*, Banka Botërore.

³⁰² Shënim: CPI mudnëson vlerësimin e perceptimit të korrupsionit publik në shtetet ku realizohet ky vlerësim, nëpërmjet agregimit të të dhënave nga përgjigjet e anketimeve të realizuara në nivel biznesi dhe ekspertësh. Në kuadër të këtij indeksi, vlerësimi maksimal për një shtet është 10, çka korrespondon me mungesë perceptimi për ekzistencën e korrupsionit, ndërsa renditja tregon renditjen e një shteti në krahasim me grupin e shteteve të marra nën vlerësim ndër vite dhe ku vendi i renditur i pari tregon faktin se ky shtet është më pak i korruptuari ndër shtetet e tjera.

³⁰³ Corruption Perception Index, Transparency International/
 <<http://www.transparency.org/research/cpi/overview>>

patrimonializmi, partikularizmi konkurencial, universalizmi, ku secili prej tyre identifikohet me karakteristika të veçanta. Ndryshe, llojet e regjimeve dhe tiparet e tyre do të identifikoheshin në këtë mënyrë.

Tabela 4.12: Një tipologji e korrupsionit³⁰⁴

Regjimi	Shpërndarja e pushtetit	“Pronësia” e shtetit	Shpërndarja e të mirave publike	Pranueshmëria sociale e korrupsionit	Ndarja private/publike
Patrimonializëm	Monopol	Një ose pak pronarë	E padrejtë por e parashikueshme	E moderuar	Jo
Partikularizmi konkurencial	E pabarabartë dhe problematike	E kundërshtuar	E padrejtë dhe e paparashikueshme	E ulët	E dobët
Universalizmi	Relativisht e barabartë	Autonom	E drejtë dhe e parashikueshme	Shumë e ulët	E ndarë qartazi

Dhe pikërisht, duke iu referuar këtyre karakteristikave që çdo rregjim prezanton, me një referencë tek realiteti shqiptar dhe rezultatet që ky vend ka regjistruar nga vlerësimi i CPI-së, Shqipërinë do e poziciononim në kategorinë e dytë të regjimit. Ndryshe, grafikisht kjo situatë do të paraqitej si në grafikun e mëposhtëm:




Figura 4.4: Korrupsioni dhe regjimi në Shqipëri³⁰⁵

Paralelisht, edhe sistemi ekonomik ka shfaqur tiparet e veta së bashku me vështirësitë e proceseve tranzitore nga një model organizimi ekonomik në një tjetër. Në fillimet e viteve 90’, Shqipëria, nga të dhënat e Bankës Botërore kishte të ardhurat për frymë rreth

³⁰⁴ Mungiu-Pippidi, A., (2006), ‘Corruption: diagnosis and treatment’, *Journal of Democracy*, Vol. 17(3): 86-99, fq. 94.

³⁰⁵ Skardziute, A., (2010), ‘Corruption in Albania’, *Civil Society Against Corruption*, Hertie School of Governance, fq. 9.

600 dollarë,³⁰⁶ një mesatare kjo ndër më të ulëtat në Evropë. Po kështu, periudha paskomuniste u shoqërua edhe me nivele të larta të papunësisë, ku sipas FMN-së, fundi i vitit 1992 shënoi një normë papunësie prej 26.5%, e cila për këtë periudhë vetëm në vitet 1990 dhe 1991 ka patur nivele një-shifrore, ndërkohë që prej vitit 1992 e në vijim janë regjistruar vetëm nivele dy-shifrore, por me një trend në zbritje (viti 2013 me një normë papunësie prej 13.0%)³⁰⁷. Po kështu, edhe aspekte të tjera të sistemit ekonomik ndikuan në mënyrën se si u prezantua ai përgjatë proceseve demokratizuese, si: rritja e sektorit privat, zhvillimi i sektorit të ndërtimit, rritja e investimeve të huaja të drejtpërdrejta, rritja e PBB-së, etj. Gjithashtu, tipike për Shqipërinë e kësaj periudhe ishte edhe aftësia e saj, ndryshe nga vende të tjera paskomuniste, për të menaxhuar hiperinflacionin i cili në fillimet e viteve 90' arriti në 226%.

Disa nga treguesit kryesorë makroekonomikë për Shqipërinë ofrohen në tabelën përmbledhëse të mëposhtme. Nëpërmjet saj mund të vlerësohet trendi i përgjithshëm që kanë pësuar përgjatë periudhës së demokratizimit tregues të rëndësishëm të sektorit të saj ekonomik.

	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Rritja reale e PBB-së (në %)	5.7	5.4	5.9	7.7 ¹	3.3 ²	3.5
PBB (me çmime aktuale, në milionë lekë)	814,797	882,209	967,670	1,088,132	1,143,610	1,177,000
Numri i të punësuarve (në mijë)	932.0	935.1	939.0	974.1	899.3	916.9
Përqindja e papunësisë	14.2	13.8	13.2	12.7	13.7	13.49
Përqindja e inflacionit (fund v/v)	2.0	2.5	3.1	2.2	3.7	3.5
Balanca buxhetore (me grantet, në % të PBB-së)	(3.5)	(3.3)	(3.5)	(5.5)	(7.0)	(3.1)
Borxhi publik (në % të PBB-së)	57.4	56.2	53.5	54.8	59.7	58.52
Borxhi i jashtëm (në % të PBB-së)	17.2	16.6	15.3	18.0	23.4	25.19
Llogaria aktuale (pa transfertat zyrtare, në % të PBB-së)	(10.0)	(7.3)	(11.4)	(15.8)	(15.5)	(11.9)
Kursi mesatar i këmbimit, Lekë/USD	99.9	98.1	90.4	83.9	95.0	103.9
Kursi mesatar i këmbimit, Lekë/Euro	124.2	123.1	123.6	122.8	132.1	137.8
Agregati M3 (mesatare vjetore)	15.6	11.6	15.8	12.3	6.0	10.6

Figura 4.5: Disa nga treguesit themelorë makroekonomikë për Shqipërinë
Burimi³⁰⁸: Banka e Shqipërisë, INSTAT, Ministria e Financave, FMN, CIA

Ndërkohë që, nëse i referohemi më specifikisht nivelit të PBB-së përgjatë periudhës së demokratizimit, madje duke përfshirë edhe periudhën e fundit të regjimit komunist në Shqipëri, grafiku i prodhuar nga Economy Watch paraqet këtë situatë:

³⁰⁶ Banka Botërore, *PBB për frymë!* <<http://data.worldbank.org/indicator/NY.GDP.PCAP.CD?page=4>>

³⁰⁷ Fondi Monetar Ndërkombëtar/ http://www.quandl.com/IMF-International-Monetary-Fund/MAP_WEO_UNEMP_ALB-World-Economic-Outlook-Unemployment-Rate-Albania.

³⁰⁸ I disponueshëm në: <http://aida.gov.al/?page_id=1286&lang=al>




Figura 4.6: PBB në miliard dollarë për Shqipërinë përgjatë tre dekadave të fundit
 Burimi: Economy Watch; bazuar në të dhënat e FMN, BB, Internet World Statistics, OECD.

Nëpërmjet tij mund të shohim trendin rritës që paraqet përgjatë viteve PBB-ja e Shqipërisë, si dhe prospektin për vitet e ardhshme nën të njëjtin trend. Ky trend me luhatjet e veta, sidomos në vitet 1990-1992 dhe 1996-1998, shihet edhe për PBB-në për banorë në po të njëjtën periudhë, edhe pse në periudhën ndërmjet viteve 1980-1990 ritmi i rritjes është ndjeshëm më i vogël.




Figura 4.7: PBB për banorë, 1980-2013
 Burimi: FMN³⁰⁹

Ndryshe, Minassian kur i referohet një vështrimi të përgjithshëm të mjedisit ekonomik në Shqipëri, e sidomos në dekadën e parë të proceseve transitore, evidenton karakteristikat e mëposhtme për periudhën ndërmjet viteve 1998-2002³¹⁰:

- Prezencë të stabilitetit financiar, i cili konsiderohet si një parakusht për zhvillimin e qendrueshëm në të ardhmen.
- Aktivitetet ekonomike kanë dëshmuar një rritje të shpejtë e të dukshme në ciklin e biznesit.

³⁰⁹ Të dhëna të disponueshme në: < www.fmn-ekonomia-shqiptare-pergjate-tre-dekadave-t46471.0.html >

³¹⁰ Minassian, G., (2002), 'The economic environment in Albania, Bulgaria, Macedonia FYR, and Greece: A cross country study', *Eastern European Economics*, Vol 40(4): 45-82, fq. 78.

- Evidentohet një vonesë në terma të ndërtimit të institucioneve politike dhe ekonomike, gjë e cila e bën performancën e administratës më pak transparente dhe të paparashikueshme.
- Përpjekje për lehtësimin e barrës fiskale për investitorët me qëllim krijimin e një mjedisi të favorshëm.
- Veprimtari mbështetëse e pozitive e FMN-së, e cila nga ana tjetër i ka bërë elitat makroekonomike të varura nga mbikëqyrja e këtij institucioni.

Ajo që mund të vlerësojmë së jashtmi nga kjo paraqitje e thjeshtë e shfaqjeve të përgjithshme paskomuniste të sistemit politik dhe atij ekonomik, është se këto tipare kanë ecur paralelisht me njëra-tjetrën. Paraqitja e përmbledhjes së vendeve të Ballkanit Perëndimor, si dhe e rastit të Shqipërisë prezantoi një paraqitje përshkruese të mënyrës sesi kanë evoluar përgjatë tranzicionit politik dhe ekonomik elementë të rëndësishëm të dy këtyre sistemeve. Kështu, nga kjo paraqitje pamë se, tranzicioni demokratik shqiptar dhe ai i vendeve të Ballkanit Perëndimor është përballur me problematika të ndryshme, nga ku përmendim demokratizimin e sistemit, reformën institucionale, korrupsionin dhe prezencën e destabilitetit politik me të cilin janë shoqëruar këto fenomene përgjatë dy dekadave të fundit. Vlerësimet nëpërmjet indekseve të ndryshme të këtyre fenomeneve nga institucione e organizma ndërkombëtarë paraqesin trende pozitive zhvillimi por me ritme të ulëta, çka ligjëron edhe pozicionimin e Shqipërisë ndërkombëtarisht si një demokraci jo e plotë apo hibride. Jo vetëm kaq, por edhe treguesit makroekonomikë paraqesin luhatjet e tyre përgjatë periudhës së tranzicionit ekonomik duke e pozicionuar ndërkombëtarisht këto vende në kategorinë e vendeve në zhvillim e sipër. Ndër këta tregues, për arsye studimore, ne jemi fokusuar tek rritja ekonomike dhe zhvillimet që ka pësuar ajo me kalimin e kohës paralelisht edhe me ngjarjet e një karakteri politik.

Kjo situatë e përgjithshme përshkruese konfirmon pjesën më të madhe të argumenteve teorikë në lidhje me marrëdhënien stabilitet-rritje, por nuk është e mjaftueshme për të konfirmuar natyrën e kësaj marrëdhënieje dhe fortësinë e saj përgjatë periudhës pas viteve 90' për vendet e Ballkanit Perëndimor. Vlerësimet e karakterit përshkrues si dhe renditjet e prodhuara nga agjenci të ndryshme ndërkombëtare për aspekte të vecanta të sistemit politik e ekonomik për këto vende dëshmojnë për statuse specifike të ndryshme zhvillimore, por në terma makro të krahasueshme e të përafërta me njëra tjetrën. Natyrisht, që zhvillimet e kësaj natyre dhe të këtyre ritmeve na drejtojnë për tek nevoja e një vlerësimi më në thellësi të këtyre aspekteve zhvillimore. Për këtë, ne propozojmë një testim empirik të këtyre variablave (kapitulli në vijim) për të mbërritur në përfundime më të qëndrueshme rreth kësaj analize për këtë grup shtetesh.

E gjithë analiza, shihet në kuadrin e ekonomisë politike dhe logjikave që kjo e fundit parashtron. Kjo sepse, ekonomia politike na ofron një instrument të rëndësishëm studimi të marrëdhënies midis variablave politikë, socialë e ekonomike mes njëri-tjetrit. Si një disiplinë e tillë, duke patur në qendër të vëmendjes mënyrën sesi faktorët politikë ndikojnë rezultatet ekonomike, edhe ditët e sotme, ekonomia e re politike 'duke përdorur mjetet teknike dhe formale të analizës moderne ekonomike tenton të shohë rëndësinë e politikës për ekonominë dhe studimin e vendimarrjes politike në vetvete'³¹¹. Duke u mbështetur në këtë terren studimor, ne tentojmë të konfirmojmë hipotezat bazë të

³¹¹ Drazen, *op.cit.*, fq. 1.

studimit për këtë marrëdhënie të supozuar ndikuese të varaiblave të veçanta të karakterit politik në raport me ato të karakterit ekonomik.

4.3.1 Përmbledhje e zhvillimeve politike në Shqipëri pas ndryshimit të regjimit politik

Për të parë tendencat politike stabilizuese apo destabilizuese që kanë shoqëruar procesin politik, e për të mbërritur më pas tek ndikimi i tyre në sistemin ekonomik është i nevojshëm referimi tek faktet empirike që ka prodhuar ky proces. Këto fakte evidentohen nëpërmjet vëzhgimit të treguesve të stabilitetit politik. Për këtë arsye, më poshtë, ne tentojmë të ofrojmë një përmbledhje duke evidentuar këta elementë përkatësisht për rastin e Shqipërisë përgjatë periudhës pas-komuniste.

I) Ndryshimet e qeverive

Ndryshimet e qeverive në kuadrin e këtij studimi përkufizohen si ndryshime të përbërjes së qeverive të së njëjtit orientim politik apo ndryshim i këtij orientimi nëpërmjet konstituimit të ekzekutivit nga kampi opozitar. Të parat ndër këto ndryshime shënohen në vitin 1991, nëpërmjet mbajtjes së zgjedhjeve të para pluraliste pas rreth 50 vjetësh. Në parlamentin e përbërë nga 250 deputetë, pjesa më e madhe e vendeve u fitua nga PPSH dhe aleatet e saj, ndërsa 75 prej vendeve u fituan nga Partia Demokratike. Në vijim, zgjedhjet e vitit 1992 përkuan edhe me ndryshimin e përbërjes së qeverisë, duke qënë se mazhoranca e vendeve në parlament u fitua nga Partia Demokratike. Ndërsa, në zgjedhjet e vitit 1996, sërish u rikonfirmua qeverisja e kësaj partie. Vetëm një vit më pas, në 1997-ën, për shkak të akuzave për mungesën e transparencës së zgjedhjeve të mëparshme, si dhe dështimit e rrëzimit të skemave piramidale, dorëheqja nga qeverisja e PD-së, solli një përbërje të re të ekzekutivit jo vetëm në aspektin e ndryshimit të përbërjes së tij, por edhe në orientimin politik të saj. Megjithatë, lëvizjet e protestat sociale të kulmuara edhe me vrasjen e politikanit Azem Hajdari, u reflektuan me ndryshime në përbërjen e qeverisë në vitin 1998, kryesimi i së cilës u zëvendësua pas dorëheqjes së Fatos Nanos me kryeministrin e ri Pandeli Majko. Një vit më vonë, në tetor të vitit 1999 ndryshoi sërish drejtimi i ekzekutivit të majtë në Shqipëri nga P.Majko tek I.Meta, kryeministri i ri për shkak të dorëheqjes së kryeministrit të mëparshëm. Në zgjedhjet e ardhshme të korrikut të vitit 2001, u rikonfirmua orientimi i majtë i ekzekutivit shqiptar duke qënë se këto zgjedhje u fituan nga Partia Socialiste nën një madndat i dytë qeverisës³¹². Në vijim, viti 2005 dhe 2009 i zgjedhjeve të përgjithshme prodhuan ekzekutivë të djathtë të Partisë Demokratike së bashku me partitë e tjera koalicionare. Në zgjedhjet e fundit të qershorit 2013, në kushtet e një rotacioni politik, shumica parlamentare kaloi drejt koalicionit të majtë duke risjellë në pushtet Partinë Socialiste me aleatët e saj koalicionarë.

II) Qeveri të përkohshme

³¹² Albania Timeline, i gjendshëm në: <<http://news.bbc.co.uk>>

Realiteti politik i Shqipërisë post-komuniste, përveç ndryshimeve të shpeshta të qeverive është karakterizuar edhe nga qeveri me natyrë të përkohshme të cilat janë krijuar në përgjigje të ngjarjeve me potencial të theksuar destabiliteti me origjinë nga sistemi politik, ekonomik e ai social i vendit. Të parën ndër këto zhvillime e shohim në vitin 1991, kur qeveria e prodhuar nga zgjedhjet e po këtij viti, ku fituese ishte Partia Komuniste e aleatet e saj, nuk arritën të menaxhonin situatën post-zgjedhore. Dy janë qeveritë e përkohshme të prodhuara në harkun kohor të një viti në këtë moment. Së pari, në funksion të menaxhimit të grevës së përgjithshme të punëtorëve, u krijua qeveria e stabilitetit në periudhën qershor – dhjetor 1991. Së dyti, për shkak të konfliktit të vazhduar midis palëve politike (Partia Komuniste nga njëra anë dhe Partia Demokratike nga ana tjetër), si dhe vrasja e disa protestuesve të opozitës prodhuan qeverinë e dytë me karakter të përkohshëm, të njohur si ‘qeveri teknike’ e kryesuar nga Vilson Ahmeti. Kohëzgjatja e saj ishte nga dhjetori i vitit 1991 deri në prill të vitit pasardhës kur edhe u mbajtën zgjedhjet e përgjithshme për konstituimin e institucioneve përfaqësuese, e nga ku rrjedhimisht u prodhua një qeveri e re.

Fillimet e mandatit të dytë qeverisës të Partisë Demokratike pas zgjedhjeve të vitit 1996, u shoqëruan me rritje të tensionit social e problemeve të ruajtjes së rendit. Kështu, problemet në lidhje me transparencën e zgjedhjeve parlamentare, dështimi i skemave financiare piramidale në vend, së bashku me rritjen e pakënaqësisë e tensionit social të theksuar edhe nëpërmjet sulmeve dhe hapjes së depove të armëve çuan në dorëheqjen e qeverisë dhe marrjen e drejtimit të vendit nga Partia Socialiste. E treta qeveri e parakohshme krijohet në këtë moment (mars - korrik 1997) nën drejtimin e Bashkim Finos me qëllimin thelbësor të vendosjes stabilitetit qeverisës dhe përgatitjes së vendit për zgjedhjet e parakohshme, e konsideruar si ‘qeveria e pajtimit kombëtar’³¹³. Krijimi i tre qeverive të përkohshme në harkun kohor të gjashtë viteve të para të pluralizmit politik e për më tepër me qëllimin primar të ruajtjes së stabilitetit ose të rivendosjes së tij, dëshmon për vështirësitë e theksuara me të cilat është përballur sistemi politik nën procesin demokratizues. Në të njëjtën kohë, prezenca e qeverive të përkohshme në këtë hark kohor është një tregues i rëndësishëm i qëndrueshmërisë së sistemit politik të sapokrijuar, gjë që është reflektuar edhe në sistemin ekonomik e atë social në tërësi.

III) Protesta kundër qeverisë

Një nga treguesit nëpërmjet të cilit vlerësohet stabiliteti politik i një vendi të caktuar, e prezantuar kjo edhe nga rishikimi i mësipërm i literaturës, është qëndrimi i shoqërisë ndaj sistemit politik e produkteve të saj. Për këtë, si një premisë fillestare do të na shërbente pohimi se prezenca e protestave kundër qeverisë dëshmon për tendenca politikisht destabilizuese në një vend të caktuar. Kjo, padyshim edhe në varësi të harkut kohor kur ndodhin si dhe të shpeshtësisë së shfaqjes së tyre. Nëse i referohemi rastit specifik të Shqipërisë, prezenca e protestave kundër qeverisë është e konsiderueshme përgjatë periudhës post-komuniste. Kështu, problemet e vështirësitë ekonomike të qytetarëve edhe pas zgjedhjeve të para pluraliste të vitit 1991, kulmuan me protesta e demonstrata të cilat

³¹³ Këshilli i Ministrave, Republika e Shqipërisë, (2013), i gjendshëm në:
<<http://www.km.gov.al/?fq=brenda&gj=gj1&kid=59>>

çuan edhe në dorëheqjen e qeverisë Nano të konsitituar pas zgjedhjeve të këtij viti. Në vijim, protesta të fuqishme anti-qeveritare u shfaqën sërishmi në vitin 1997 të motivuara nga dështimi i skemave të financimit piramidial të cilat u shoqëruan edhe me dorëheqjen e qeverisë. Një vit më pas, në vitin 1998 vrasja e deputetit Azem Hajdari nxiti shfaqjen e protestave të dhunshme anti-qeveritare. Reagimi kryesor ndaj tyre ishte dorëheqja e kreut të ekzekutivit të atëhershëm Nano dhe emërimi si kryeministër i Pandeli Majkos.

Prezenca e protestave dhe demonstratave kundër qeverisë, kryesisht si reflektim i pakënaqësisë të qytetarëve nga performanca qeverisëse në përmirësimin e kushteve dhe standardeve të jetesës ka qënë një element që ka vazhduar të ekzistojë në realitetin shqiptar edhe pas një dekade procesesh tranzitore. Kështu, në vitin 2004, protesta të tjera anti-qeveritare nën drejtimin e opozitës së atëhershme u shfaqën si një reagim i zhgënjimit qytetar nga qeveria e iniciativat e saj në pamundësi për rritjen e mirëqënies së përgjithshme. Siç mund ta shohim, stimujt që kanë prodhuar reagime në formë protestash ndaj qeverisë në realitetin post-komunist të këtij vendi kanë qënë të ndryshme. Jo vetëm pakënaqësia ndaj performancës qeverisëse, por edhe ngërçet e sistemit ekonomik, ngjarje të polarizuara sociale, si dhe kundërshtimi ndaj rezultatit përfundimtar zgjedhor kanë qënë ndër logjikat kryesore të përforcimit të lëvizjeve protestuese. Pikërisht, refuzimi i rezultatit të zgjedhjeve të përgjithshme për shkak të pretendimit të parregullsisë së realizimit të tyre ishte motivimi kryesor i protestave që u shfaqën në vitin 2009. Dy vite më vonë, në vitin 2011 u shfaqën të tjera protesta anti-qeveritare me një karakter të dhunshëm. Këto të fundit të motivuara si protesta kundër korrupsionit qeverisës dhe kundërshtimit të rezultatit qeverisës të vitit 2009 u shoqëruan edhe me katër të vdekur.

IV) Sistemi partiak

Partitë politike dhe përfaqësimi i tyre parlamentar është një tjetër aspekt për tu marrë në konsideratë në kuadrin e qeverisjes së një vendi dhe ndikimeve të tij në sistemin politik. ‘Rënia e komunizmit në Evropën Lindore dhe veçanërisht protestat e studentëve shqiptarë, i dhanë jetë një sistemi shumë-partiak në Shqipëri, i cili rriti pritshmëritë e qytetarëve shqiptarë si një ndër mekanizmat kryesorë për të kaluar problemet e prodhuara nga 50 vjet komunizëm’³¹⁴. Megjithatë sistemi partiak në Shqipëri ka shfaqur karakteristika të veçanta mandat pas mandati qeverisës të cilat kanë plotësuar fizionominë e tij të përgjithshme në mënyrën sesi shfaqet sot. Nëse bëjmë një analizë në retrospektivë të këtyre tipareve, momenti i parë të cilit i referohemi janë zgjedhjet e para pluraliste të vitit 1991. Në këto zgjedhje, pjesa më e madhe e vendeve në parlament u fituan nga PPSH (67.9% të votave), ndërsa PD fitoi në rang kombëtar 30.1% të votave, dhe në fund nga PBDNJ (Partia e Bashkimit për të Drejtat e Njeriut) e cila fitoi 2% të votave³¹⁵. Në një panoramë të përgjithshme, në këto zgjedhje të para pluraliste shohim prezencën kryesisht të një sistemi dy-partiak, por në të njëjtën kohë me tendenca drejt përvijimit të një sistemi më shumë se dy partiak në vend, duke marrë parasysh edhe garimin e partive të tjera (si: Partia Republikane, Partia Socialdemokrate, Aleanca

³¹⁴ Xhaferaj, E., (2011), ‘Party-system and social cleavages: the case of the post-communist Albanian elections’, *PECOB’s Papers Series*, Vol 10, Itali, fq.7/ i gjendshëm në <www.pecob.eu>

³¹⁵ Lewis, G. P., (2000), *Political Parties in Post-Communist Eastern Europe*, Taylor & Francis e-Library, fq. 65.

Demokratike e Shqipërisë, etj) të cilat në zgjedhjet në vijim do të ishin një faktor i rëndësishëm.

Në zgjedhjet e përgjithshme të një viti më pas, të tjera parti hynë në skenën politike post-zgjedhore si rezultat i përqindjes së rritur të votave të fituara. Kështu, në zgjedhjet e vitit 1992, Partia Republikane dhe ajo Socialdemokrate fituan përkatësisht nga 3.1% dhe 4.4% të votave, ndërsa partitë kryesore Partia Demokratike dhe ajo Socialiste nga 62.1% dhe 25.7% të votave, si dhe me një rritje prej 0.9% të votave të fituara gjatë këtyre zgjedhjeve u prezantua PBDNJ (2.9 % të votave)³¹⁶. Ajo që mund të vihet re në këtë konfigurim të shpërndarjes së votave është prezenca e pesë partive politike në legjislativ, çka dëshmon edhe tendencën e sistemit partiak drejt një sistemi shumëpartiak. Ndërsa, në zgjedhjet e vitit 1996, përveç partive të tjera të përfaqësuara në legjislativ ashtu si në vitin 1992, u shfaq edhe Partia e Frontit Kombëtar e cila fitoi 5% të votave. Kjo u shoqërua edhe me një rënie të përqindjes së votave për Partinë Socialdemokrate (nën 2% të votave)³¹⁷. Nga përqindjet përkatëse që fituan partitë politike në zgjedhjet e parakohshme të vitit 1997 shohim se numri i tyre në parlament arriti në shtatë duke shtuar edhe partinë politike të Aleancës Demokratike të Shqipërisë. Pra, një tendencë drejt pluripartizmit apo një sistemi shumëpartiak.

Nisur konfigurimi i numrit të partive politike në legjislativ nga zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2001, mund të themi se u shfaq me fizionominë e plotë një sistem shumëpartiak. Nga aplikimi i sistemit zgjedhor miks³¹⁸ Partia Socialiste fitoi 41% të votave (përkatësisht 73 vende në parlament), koalicioni Bashkimi për Fitoren i kyresuar nga Partia Demokratike fitoi 36.8% të votave (përkatësisht 46 vende në parlament). Gjatë këtyre zgjedhjeve u konfirmua edhe prezenca e partive të tjera të vogla politike si: Partia e Re Demokratike e cila fitoi 5.2% të votave (6 vende në parlament), Partia Socialdemokrate 3.6% të votave, PBDNJ 2.6% të votave, Partia Agrare dhe Aleanca Demokratike respektivisht nga 2.5% të votave, si dhe dy vende në parlament u fituan nga deputetë të pavarur³¹⁹. Ndërkohë në vitin 2005, nëntë parti politike fituan mandate për në parlament, duke dëshmuar kështu një rritje të numrit të partive politike. Kështu, në këto zgjedhje gjetën përfaqësimin në parlament përveç partive politike kryesore edhe partitë e tjera politike duke konfirmuar prezencën e një sistemi shumë-partiak në Shqipëri. Kështu, Partia Demokratike fitoi gjithsej 56 mandate, Partia Socialiste 42 mandate, Partia Republikane 11 mandate, Partia Socialdemokrate 7 mandate, Lëvizja Socialiste për Integrim 5 mandate, e me radhë edhe parti të tjera të vogla të cilat të grupuara brenda dy koalicioneve kryesore të së majtës dhe së djathtës gjetën përfaqësimin në parlament, si: PDR, PAA, AD, PBDNJ, PDK, PDSSH, BLD, dhe një deputet i pavarur³²⁰.

³¹⁶ Lewis, *op.cit.*, fq.65.

³¹⁷ International Republican Institute (IRI), (1996), *IRI Observation Report on the Albanian Parliamentary Elections of May 1996*, i gjendshëm online në:
<<http://www.iri.org/sites/default/files/Albania's%201996%20Parliamentary%20Elections.pdf>>

³¹⁸ Shënim: nëpërmjet këtij sistemi zgjedhor në parlamentin e përbërë nga 140 deputetë, 100 prej tyre zgjidheshin nga sistemi mazhoritar, dhe 40 prej tyre nga sistemi proporcional.

³¹⁹ *Albania's Parliamentary Elections 2001*, (2001), Balkans Briefing, International Crisis Group, fq. 5.

³²⁰ Manual, (2007), *Legjislatura XVII (2005-2009)*, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Tiranë, fq. 12.

Në vazhdimësi, në vitin 2009, konfigurimi i sistemit partiak të prezantuar në parlament pësoi ndryshime të ndjeshme, për shkak të ndryshimeve kushtetuese në llojin e sistemit zgjedhor. Kalimi në një sistem zgjedhor proporcional rajonal ndikoi drejtpërsëdrejti në përfaqësimin e partive politike të vogla duke ulur ndjeshëm mundësitë e tyre për mandate parlamentare. Këto ndryshime, nga ana tjetër ndikuan edhe në konfigurimin partiak të legjislativit, tendencën kryesore të së cilit mund ta shohim drejt kufizimit të hapësirave të partive të vogla dhe favorizimit të partive të mëdha. Kështu, nëse iu referohemi rezultateve konkrete zgjedhore të vitit 2009, shohim se pesë janë partitë politike të përfaqësuara në legjislaturë gjatë këtij mandati përkatësisht Partia Demokratike (40.18% të votave), Partia Socialiste (40.85% të votave), Lëvizja Socialiste për Integrim (4.85% të votave), Partia Republikane (2.11% të votave), dhe Partia për Drejtësi dhe Integrim (0.95% të votave)³²¹.

³²¹ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, <http://www.cec.org.al/images/stories/zgjedhje-per-kuvend/2009/rez_vend.pdf>

PJESA II

PËRQASJA PRAKTIKE:

VLERËSIMI DHE TESTIMI EMPIRIK

Prezantimi i kornizës teorike dhe argumenteve të zhvilluara prej saj në lidhje me marrëdhënien ndërmjet destabilitetit politik në kuadrin e proceseve demokratizuese dhe rritjes ekonomike, si një tregues përfaqësues i performancës së sistemit ekonomik, ka të nevojshëm edhe vlerësimin empirik të marrëdhënieve në të cilat përfshihen variablat e përmendur.

Qasjet teorike të prezantuara në kapitujt paraardhës së bashku me argumentet që këto qasje parashirojnë, si dhe kontributi specifik i studiuesve të përqëndruar në të dy llojet e studimeve (cilësore dhe sasore) prodhuan logjikat kryesore brenda të cilave zhvillohen marrëdhëniet sistem politik-sistem ekonomik, si dhe mënyra se si këto të fundit legjitimohen në një grup të caktuar shtetesh. Në këtë kuadër, kjo pjesë i shërben paraqitjes, shpjegimit, dhe shtrimit të çështjeve nën lupën e dimensionit empirik duke u përqëndruar në kontekstin e Ballkanit Perëndimor pas viteve 90’.

Po kështu, përveç aspektit metodologjik, kjo pjesë praktike e punimit përfshin edhe prezantimin e rezultateve konkrete në lidhje me vlerësimin empirik si dhe diskutimin e analizën e tyre për disa vende të Ballkanit Perëndimor.

KAPITULLI 5

METODOLOGJIA

Përmbledhje

Në vijim të parashtrimit teorik të kapitujve të mësipërm, në këtë kapitull synohet të paraqiten elementët kryesorë që përbëjnë testimin empirik. Kështu, kapitulli vijon me përvijimin e hipotezave të cilat nevojiten të testohen empirikisht në studim. Në funksion të kësaj, në këtë kapitull metodologjik, studimi vijon me prezantimin e të dhënave të përdorura për të mundësuar testimin empirik si dhe llojin e këtyre të dhënave, me përcaktimin dhe përkufizimin e variablave që do të përfshihen në testimin empirik, me modelin që shërben si mjet për të mundësuar këtë analizë empirike, si dhe diskutimin e tij.

Kështu, nëpërmjet zhvillimit dhe trajtesës së këtyre elementëve të rëndësishëm, synojmë që të ofrojmë përfundime në lidhje me analizën metodologjike e cila, në funksion të rezultateve të përftuara nga testimi empirik do t'i nënshtrohet analizës dhe diskutimit të tyre, si pjesë e kapitullit pasardhës.

5.1 HYRJE

‘Rënia e murit të Berlinit në vitin 1989 u cilësua nga shumë si një moment kyç në evolucionin e sistemeve politike, duke u përcaktuar si pika kulmore e ‘valës së tretë’ të demokratizimit, element i cili është cilësuar nga Fukuyama si ‘fundi i historisë’³²². Ditët e sotme, i gjithë ky proces i ndërmarrë në fillimet e viteve 90’ përballet me analiza e diskutime të shumta. Një ndër çështjet kryesore që shtrohet në këtë kontekst është ajo e marrëdhënieve ndërmjet këtyre zhvillimeve politike dhe atyre ekonomike përgjatë kësaj kohe. Më konkretisht, do të evidentonim nevojën për të njohur natyrën e kësaj marrëdhënieje dhe elementëve specifikë që sistemi ekonomik dhe ai politik mbartin (të tilla si destabiliteti politik, demokracia, kuadri institucional, korrupsioni, rritja ekonomike, investimet, shpenzimet qeveritare) shkallën e ndikimit të tyre tek njëri-tjetri, specifikat shtetërore të këtyre marrëdhënieve, etj., për të mbërritur më pas në rezultate konkrete e orientime politikash.

Të gjithë këta elementë nuk do të ishin të trajtuar plotësisht nëse nuk do të mbështeteshin në një testim empirik sasior. Kuadri teorik i prezantuar më sipër, së bashku me argumentet, analizën, dhe vlerësimin që ofron për këtë çështje legjitimohet vetëm nëpërmjet testimit konkret të këtyre tematikave specifike. Kështu, rezultatet empirike mund të mbështesin apo hedhin poshtë kuadrin teorik, si dhe ndryshojnë në varësi të vendit apo vendeve që merren nën studim.

Metodologjikisht, testimi empirik i këtij punimi, i përqendruar në rastin e disa vendeve të Ballkanit Perëndimor pas viteve 90’ synon të hedhë dritë mbi disa aspekte të rëndësishme:

- Të dhënat e grumbulluara.
- Variablat e përfshirë për studimin e aspekteve të veçanta të marrëdhënies rritje ekonomike-destabilitet politik në kuadrin e proceseve demokratizuese e shtetformuese të Ballkanit Perëndimor.
- Modelin e përdorur në vlerësimin e marrëdhënies ndërmjet variablave (ekzogjenë dhe atyre endogjenë).

Në funksion të këtyre elementëve, kapitulli vijon nëpërmjet trajtimit të kësaj strukture pjesësh: fillimisht prezantohet konteksti i kërkimit empirik; më pas vijohet me prezantimin e pyetjes kryesore kërkimore dhe pyetjeve të veçanta kërkimore që derivojnë prej saj; në vazhdim, kapitulli përqendrohet në prezantimin e të dhënave të përfshira në studim, natyrës së tyre si dhe burimeve të cilave iu është referuar studimi; më pas, pjesa tjetër e kapitullit vijon me paraqitjen e modelit empirik, përkufizimin dhe shpjegimin e tij, variablat e varur dhe të pavarur të përfshira në model, si dhe supozimet e tij. Nëpërmjet kësaj trajtese, kapitulli mundëson lidhjen me pjesën pasuese e cila përqendrohet në prezantimin, analizimin, si dhe diskutimin e tyre.

³²² *Transition Report 2013*, (2013), European Bank for Reconstruction and Development (ERBD), fq. 23.

5.2 KONTEKSTI I KËRKIMIT

Proceset e tranzicionit demokratik në fillimet e viteve 90', të cilat u identifikuan si pjesë e 'valës së tretë' të demokratizimit çuan në përqëndrimin e kërkimit shkencor në elementë të veçantë si: ndryshimet tranzitore politike dhe ekonomike, proceset shtet-formuese, konceptin e zhvillimit demokratik, konsensusin dhe paskonsensusin e Uashingtonit, etj. Në kontekstin e këtyre zhvillimeve, dy elementë shndërrohen në përcaktues: stabiliteti politik nga njëra anë dhe rritja ekonomike nga ana tjetër. Pra, ecuria e zhvillimeve si të karakterit politik, ashtu edhe të karakterit ekonomik ka një konvergjencë tek këta elementë të cilët, sidomos për vendet që i janë nënshtruar procesit të tranzicionit demokratik e atij shtet-formues, marrin një rëndësi të veçantë.

Kontributet e kërkimit shkencor të përqendruar në studimin e këtyre elementëve i shohim të dimensionuara në përpjekjet për të operacionalizuar dhe përkufizuar fenomenin e destabilitetit politik si dhe për të testuar marrëdhënien ndërmjet këtij fenomeni dhe rritjes ekonomike. Në *linjën e parë* të studimeve, mund të identifikojmë kontributin e Hurwitz (1973), Hibbs (1973), Bollen dhe Jones (1982), Mishler dhe Hildreth (1984), etj., të cilët kanë në fokus të tyre regjimin politik dhe mënyrën sesi ai mban veten, qoftë kjo nëpërmjet shfaqjes së llojeve të ndryshme të dhunës (protestat antiqeveritare, grushtet e shtetit, ngjarjet me sulm të armatosur, vrasjet apo vdekjet nga dhuna politike, etj) apo nëpërmjet mungesës së prezencës së formateve të dhunshme të organizimit politik. Në një këndvështrim tjetër, autorë të tjerë si Gurr (1974), Bunce (1999) përqendrohen tek aftësia përshtatëse dhe rregulluese e regjimit politik apo sistemit politik. Më specifikisht, Cukierman, Edwards, dhe Tabellini (1992); Alesina dhe Perotti (1994); Alesina, Ozler, Roubini, Swagel (1996); Brunetti dhe Weder (1995); Taylor dhe Herman (1971), e shohin stabilitetin politik apo prezencën e destabilitetit politik nisur nga përbërja e ekzekutivit, ndryshueshmëria apo kohëzgjatja e tij. Të tjerë autorë, si Feierabends (1966), Margolis (2010), Chan (2006), etj e shohin atë të lidhur me kontekstin social dhe me elementë specifike të karakterit social apo psikologjik të tij.

Linja e dytë përqendrohet tek marrëdhënia ndërmjet këtij fenomeni të karakterit politik së bashku me elementë të tjerë të lidhur me të, në raport me rritjen ekonomike në kuadër të performancës ekonomike të shteteve. Nga vlerësimi i marrëdhënies destabilitet-rritje, studimet fokusohen në kahun e marrëdhënies dhe në nivelin e ndikimit të këtyre variablave tek njëri-tjetri. Autorë si Ali, Pitlik, Jong-A-Pin, Aisen dhe Vega, Zureiqat, Alesina *et al.* (1996), etj evidentojnë një marrëdhënie negative ndërmjet destabilitetit politik dhe rritjes ekonomike me kah nga destabiliteti tek rritja. Autorë të tjerë evidentojnë një ndikim pozitiv të drejtpërdrejtë ose jo të demokracisë tek rritja (Friedman, Barro, Polterovich e Popov, Plümper dhe Marin, Gerring *et al.*, Kaufman e Kraay, Mobarak, etj); dhe të tjerë studiues dalin në përfundime të një ndikimi negativ të demokracisë tek rritja ekonomike (Galenson, de Schweintiz, Moore e Smitz, etj). Në pikëpamje të marrëdhënies së institucioneve dhe rritjes ekonomike, literatura bazë kryesisht evidenton një marrëdhënie pozitive të ndikimit të institucioneve tek rritja ekonomike. Studiues që konfirmojnë këtë linjë të përgjithshme rezultatesh janë: North, Aron, Mamoona e Murshed, Mijiyana, Beck e Laeven, etj.

Kështu, përqëndrimi i studimit tonë tek mënyra se si fenomene specifike të karakterit politik ndikojnë në tregues të caktuar makroekonomikë, siç është rritja ekonomike, lidhet ngushtë me një disiplinë relativisht të re studimore e cila është ngritur si e tillë në sajë të kontributit të ekonomistëve dhe politologëve. Ajo është ekonomia politike apo ekonomiksi politik, siç shihet të përmendet në literaturë nga autorë të ndryshëm, e cila ndërthur perspektivat e tre disiplinave të tjera studimore, si: shkolla e vjetër e zgjedhjes publike, teoria e ekuilibrit e politikës makroekonomike, dhe shkolla e zgjedhjes racionale në shkencat politike³²³. Më specifikisht, duke qënë se fokusohemi tek rritja ekonomike, studimi zhvillohet në kontekstin e një fushe më specifike brenda ekonomisë politike, që është ekonomia politike e rritjes. Ajo çka është e një rëndësie studimore në këtë aspekt, është fakti se nëpërmjet logjikave vepruese të kësaj fushe, studiuesi nuk izolohet në studimin e aspekteve të veçanta të një apo disa variablave të së njëjtës natyrë duke e përjashtuar kështu studimin nga ndikimi i mundshëm i faktorëve të tjerë. Përkundrazi, për të ofruar një analizë më të shëndoshë e më të plotë të një apo disa marrëdhënieve, bëhet e domosdoshme marrja në konsideratë e komunikimit mes variablave të natyrave të ndryshme (ekonomike, politike e sociale).

Në kornizën e logjikave të ekonomisë politike të rritjes, studiuesit përqendrohen në testimin empirik të marrëdhënieve të veçanta në grupe shtetesh, zakonisht duke kategorizuar këto të fundit në kuadrin e kontinenteve. Disponueshmëria e të dhënave në lidhje me shtete të veçanta bëhet përcaktuese në disa raste edhe e grupit të shteteve të përzgjedhura në studim duke mos mundësuar një kapje të plotë të dinamikave në zona të veçanta.

Zhvillimet në Evropën Lindore dhe Juglindore në kuadër të proceseve demokratizuese shtrojnë nevojën e trajtimit të aspekteve politiko-ekonomike të këtyre zhvillimeve edhe në kuadrin e logjikave të ekonomisë politike të rritjes. Nëse ju referohemi studimeve të ndërmarra brenda kësaj minifushe specifike studimore, pjesës më të madhe të tyre u mungon dimensionin empirik i testimit të marrëdhënieve brenda këtij grupi specifik shtetesh. Madje, kjo prirje është më e theksuar nëse përqendrohemi në një shtet të veçantë ku përpjekjet hulumtuese kryesisht fokusohen tek analizat cilësore dhe përshkruese pa testuar empirikisht korpusin e elementëve politiko-ekonomikë e marrëdhëniet e tyre me njëri-tjetrin dhe shkallën e ndikimit tek njëri-tjetri.

Të ndërjegjshëm për rëndësinë që përfaqëson në ecurinë e proceseve demokratizuese marrëdhënia destabilitet politik-rritje ekonomike, në tentojmë që brenda këtyre dinamikave zhvillimore të fokusohemi tek një grup-shtetesh të Ballkanit Perëndimor, për të hulumtuar, testuar e vlerësuar raportin (de)stabilitet politik-rritje ekonomike. Natyrisht, Ballkani Perëndimor, ashtu si vende të tjera të Evropës Lindore e Juglindore u bë pjesë e ndryshimeve të karakterit politik e ekonomik si dhe e proceseve shtet-formuese. Mënyra se si u realizuan këto ndryshime, aktorët e përfshirë në to, rezultatet e prodhuara brenda kontekstit shtetëror, sigurisht që prezantojnë specifikat e veta në raport me shtete të tjera të këtij rajoni. Kjo, për arsye edhe të ndryshimeve në përbërjen sociale, stratifikimin e shoqërisë, kulturën politike, pozicionin gjeografik, mënyrën e organizimit të pushtetit politik, ushtrimit të autoritetit brenda kufijve shtetërorë, etj.

³²³ Persson, T., (2002), 'Do Political Institutions Shape Economic Policy?', *Econometrica*, Vol. 70(3): 883-905, fq. 883.

Duke marrë parasysh zhvillimet politike dhe ekonomike brenda së cilave synohet të testohen dinamikat politikisht stabilizuese ose destabilizuese, rëndësinë që paraqesin ndryshimet politike të regjimit për të studiuar më pas më në detaj vijimësinë e fenomeneve të brendshme të proceseve demokratizuese, periudhën e mjaftueshme kohore (pas viteve 90') për të testuar marrëdhënien mes variableve, kapjen më të plotë të specifikave të tranzicionit dhe ecurisë shtet-formuese të disa vendeve në raportin midis sistemit politik dhe atij ekonomik, ne tentojmë të ndërtojmë një model të përqendruar në një grup specifik shtetesh siç është Ballkani Perëndimor.

Dhe, nëse i referohemi më konkretisht shteteve të veçanta, si rasti i Shqipërisë, sipas Bideleux dhe Jeffries, nëse në vendet e tjera si: Mali i Zi, Bullgaria, Rumania apo Serbia, strukturat dhe rrjetet e pushtetit të trashëguara nga e kaluara komuniste u ruajtën edhe pas ndryshimeve të regjimit, në Shqipëri, të gjithë këto struktura të së kaluarës komuniste u shkatërruan, dhe pikërisht për këtë arsye 'përprjekja e vazhdueshme për të vendosur demokracinë liberale është penguar nga një mungesë e theksuar e pushtetit të strukturave të caktuara dhe lidhjeve sociale të çdo lloji'³²⁴. Edhe konstatimi i Bideleux dhe Jeffries na drejton tek çështja sesi është menaxhuar vetë tranzicioni, dhe padyshim roli që elementë të veçantë si qëndrueshmëria e qeverisjes apo ecuria e zhvillimit ekonomik kanë patur në akomodimin e ndryshimeve në lidhje me strukturën e tregut dhe formatin qeverisës.

Konteksti i mësipërm studimor është legjitimues edhe i arsyeve të përqendrimit të studimit në periudhën pas viteve 90', prej të cilave më specifikisht do të identifikojmë: së pari, nevojën për të mundësuar vlefshmërinë e analizës teorike për periudhën e marrë në konsideratë, si dhe supozimet e përfundimet që kjo e fundit mundëson; së dyti, nevojën për të testuar në mënyrë më të plotë e më në thellësi një periudhë të rëndësishme kohore për Ballkanin Perëndimor, jo vetëm nga pikëpamja e dinamikave të stabilitetit (destabilitetit) që shoqëruan kalime nga një regjim politik në një tjetër në disa vende, ose edhe ndërmarrje të proceseve shtet-formuese në disa të tjera, por edhe për të vlerësuar ndërveprimin e këtij variabli me një tregues të rëndësishëm makroekonomik siç është rritja ekonomike; së treti, për të garantuar qëndrueshmërinë e variablave të përfshirë të model në pikëpamje të vlefshmërisë dhe uniformitetit të kuptimit që prezanton secili prej tyre.

5.3 PYETJA KËRKIMORE DHE HIPOTEZAT E STUDIMIT

Proceset demokratizuese tranzitore e ato shtet-formuese në Ballkanin Perëndimor, si pjesë e një makro-procesi i cili përfshiu edhe vende të tjera të Evropës Lindore dhe Juglindore, së bashku me ndryshimet që këto procese prodhuan në sistemin ekonomik dhe atë politik të vendit u përcaktuan në një masë të konsiderueshme edhe nga konteksti vendor. Pavarësisht dinamikave të përgjithshme të cilat shihen si një emërues i përbashkët i ndryshimeve ekonomiko-politike në këto vende, konteksti vendor shërbeu si një përcaktor i rëndësishëm i tipareve specifike të cilat diferencuan këto zhvillime nga njëri vend në tjetrin. Në këtë kontekst, marrë në konsideratë edhe analizën teorike të

³²⁴ Bideleux, R. Jeffries, I., (2007), *The Balkans: A post-communist history*, Routledge, Londwr & Nju Jork, fq.72.

kapitullit të mëparshëm si dhe treguesit e veçantë vlerësues të këtyre ndryshimeve, lind nevoja e studimit në thellësi të elementëve jo vetëm në funksion të evidentimit të dinamikave zhvillimore për fenomene të veçanta të sistemit politik e atij ekonomik, por edhe për të parë trendin e këtyre zhvillimeve si dhe dallueshmërinë e ngjashmëritë që mund të paraqiten krahasimisht me vendet e tjera të së njëjtës kategori.

Kështu, në kuadrin e këtij konteksti kërkimor, pyetje të rëndësishme shtrojnë nevojshmërinë për t'iu dhënë përgjigje dhe për tu testuar. Në kuadrin e këtij studimi, marrë në konsideratë edhe kompleksitetin dhe shumëllojshmërinë e aspekteve demokratizuese e shtet-formuese, ne përqendrohemi tek një marrëdhënie specifike që është e rëndësishme për të dy këto procese. Ajo është marrëdhënia ndërmjet destabilitetit politik dhe rritjes ekonomike. E shtruar në formën e një pyetjeje kërkimore, ajo do të paraqitet si më poshtë:

Cila është marrëdhënia ndërmjet destabilitetit politik dhe rritjes ekonomike në vende të Ballkanin Perëndimor pas viteve 90'?

Pyetja kryesore e mësipërme parashtron nevojën për të konsideruar në veçanti elementë si:

- Operacionalizimin e konceptit të destabilitetit politik
- Nevojën e vlerësimit të komunikueshmërisë ndërmjet sistemit politik dhe atij ekonomik, dhe më specifikisht duke u bazuar tek elementë ngushtësisht të lidhur me variablin destabilitet politik brenda sistemit politik, dhe variablit rritje ekonomike brenda sistemit ekonomik.
- Elementë të veçantë që ndërhyjnë në marrëdhënien destabilitet politik-rritje ekonomike (niveli i demokratizimit, shpenzimet qeveritare, korrupsioni, arsimimi, etj)
- Identifikimi i natyrës (e drejtpërdrejtë apo/dhe e tërthortë) të ndikimit ndërmjet variablave e shkalla e përcaktueshmërisë.

Në zbërthimin në pjesë më specifike të kësaj pyetjeje përkundrejt edhe nevojës për të zbërthyer elementët e sipërpërmendur, do të veçonim derivimin e pyetjeve të tjera si:

- A çon destabiliteti politik drejt forcimit të rritjes ekonomike apo drejt rënies së saj?
- Cili është niveli i këtij ndikimi?
- A ndikon niveli i demokratizimit rritjen ekonomike?
- Cila është marrëdhënia ndërmjet destabilitetit politik dhe demokratizimit në raport me rritjen ekonomike?
- A ka ndikim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të grup-variablave politikë tek variabli i varur?
- Cili është roli i korrupsionit në këtë marrëdhënie?
- A ndikojnë niveli i shkollimit, shpenzimet qeveritare e investimet këto raporte?

Për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve në kuadrin e vlerësimit empirik të raportit destabilitet politik-rritje ekonomike për Ballkanin Perëndimor, një element tjetër i rëndësishëm i studimit është edhe identifikimi i të dhënave të cilat do t'i shërbejnë këtij qëllimi.

5.4 TË DHËNAT E PËRFSHIRA NË STUDIM

‘Të gjithë të dhënat janë pasojë e një personi që bën pyetjet mbi diçka tjetër’.
(Jacob, 1984, fq. 43)

Sipas Guajarati-t, ‘suksesi i çdo analize ekonometrike varet në mënyrë thelbësore nga disponueshmëria e të dhënave’³²⁵. Të dhënat e përdorura në këtë studim në funksion të dhënies përgjigje të pyetjes kryesore janë të dhënat sasiore dytësore. Pra, të dhëna të prodhuara nga institucione e organizma ndërkombëtarë të cilët janë të specializuar në mbledhjen e krijimin e bazave të të dhënave për grupe shtetesh, dhe që kanë zakonisht me një mbulim botëror të fenomeneve të veçanta të cilat i masin përgjatë kohës.

Përdorimi i kësaj kategorie të dhënash bëhet nisur nga karakteri dhe natyra e variablave të cilët testohen në kuadrin e këtij studimi. Nisur nga kjo, për variabla si destabiliteti politik, rritja ekonomike, demokratizimi, korrupsioni, etj, të cilat janë në qendër të këtij studimi, mbledhja e të dhënave sasiore parësore paraqet problematika e vështirësi të shumta.

Mospërdorimi i të dhënave sasiore parësore legjitimohet nga disa arsye kryesore: *së pari*, nëse do të ndërmerrnim mbledhjen e informacionit të këtij lloji të dhënash do të hasnim në problemin e mënyrës së mbledhjes së këtyre të dhënave, duke qënë se variablat janë kompleksë, me përmbajtje shumëdimensionale dhe vështirësisht të operacionalizueshëm për tu adresuar nëpërmjet një pyetësi; *së dyti*, të dhënat parësore gjithmonë përballen me problemin e cilësisë, faktit se sa realisht ato reflektojnë një fenomen në një vend të caktuar; *së treti*, edhe sasia e këtyre të dhënave të përftuara nëpërmjet një pyetësi do të ishte më e kufizuar duke prodhuar baza të dhënash të reduktuara në krahasim me të dhënat sasiore dytësore; *së katërti*, duke qënë se studimi i referohet testimi të marrëdhënies ndërmjet variablave nën një shtrirje kohore për një grup shtetesh, të dhënat sasiore parësore do të ofronin vetëm një fragment kohor të periudhës kur do të mblihdeshin, e nuk do të ishin të një karakteri të vazhdueshëm ashtu siç kërkohet nga studimi; *së pesti*, të dhënat parësore paraqesin probleme edhe në lidhje me besueshmërinë dhe plotësinë, ku shkalla e gabimit në mbledhjen e tyre është më e lartë.

Nisur nga ky grup arsyesh kryesore, ne përqëndrohemi në këtë studim në të dhënat sasiore dytësore të cilat:

- Ofrojnë vlerfshmëri dhe besueshmëri më të madhe në lidhje me matjen e fenomeneve specifike;
- Ofrojnë informacion në lidhje me segmente kohore të cilat kapin të shkuarën e të tashmen, duke mundësuar kështu identifikimin e trendeve;
- Ofrojnë një bazë tashmë të testuar e të përdorur informacioni nga studiues të tjerë në lidhje me tematika të ngjashme, çka rrit vlerën e tyre;
- Ofrojnë mundësinë e ndërmarrjes së një shumëllojshmërie analizash.³²⁶

³²⁵ Gujarati, N. D., (2004), *Basic Econometrics*, Fourth edition, The McGraw-Hill Companies, fq. 25.

³²⁶ Smith, E., (2008), *Using Secondary Data in Educational and Social Research*, McGraw-Hill, Open University Press, Angli, fq. 5

Ndryshe, Maylor & Blackmon (2005) e paraqesin analizën e avantazheve dhe disavantazheve së të dhënave dytësore sasiore si më poshtë:

Tabela 5.1: Analiza dytësore në perspektivë³²⁷

	Avantazhet	Disavantazhet
Përpyekja	Kursimi i kohës dhe mjeteve financiare në mbledhjen e të dhënave. Lejimi i më shumë kohe për analizën e të dhënave.	Nevojë për tu familjarizuar me të dhënat. Nevojë për të menaxhuar baza të mëdha dhe komplekse të dhënash. Mund të jete të kushtueshme.
Analiza	Akses në të dhëna të një cilësie të lartë. Krahasim i nëngrupeve apo nënbashkesive të të dhënave brenda kampionit të të dhënave. Krahasim i nëngrupeve apo nënbashkesive të të dhënave me vende të tjera. Mundësi për të analizuar të dhënat horizontalisht në kohe.	Mungesë kontrolli ndaj cilësisë së të dhënave. Kufizim tek të dhënat tashmë të mbledhura. Nuk mund t'ju pergjigjen pyetjes kërkimore.
Kontributi	Rinterpretim i të dhënave origjinale. Bazë të dhënash plotësisht e shfrytëzueshme.	Mund te shihen si të dhëna të mbledhura jo rigorozisht. Nuk çojnë në aftësim në kërkim sa metodat e drejtpërdrejta.

Burimi: Maylor & Blackmon (2005)

Në kuadrin e këtij punimi, dy janë grupet kryesore të variablave për të cilat është e nevojshme identifikimi i të dhënave sasiore dytësore: grup-variablat ekonomikë dhe grup-variablat politikë. Bazuar në vlerësimin e burimeve të ndryshme nga ku prodhohen këto të dhëna, literatura ekzistuese mbi treguesit e destabilitetit politik në pjesën më të madhe të rasteve përqendrohet në burimet e mëposhtme (në një pjesë prej tyre apo tek të gjitha në varësi të natyrës së studimit):

- *Banks Cross National Time Series Archive* (Arkiva Banks e të Dhënave në Seri Ndërmjet Shteteve)
- *International Country Risk Guide* (Udhëzuesi Ndërkombëtar i Riskut të Shteteve)
- *Polity IV* (Politi IV)
- *International Peace Research Institute Oslo* (PRIO) (Instituti Ndërkombëtar i Kërkimeve mbi Paqen i Oslos)
- *Database of Political Institutions* of the World Bank (DPI) (Baza e të Dhënave e Institucioneve Politike të Bankës Botërore)
- *State Failure Task Force* (SFTF) (Task Forca e Dështimit të Shteteve)

³²⁷ Maylor, H. Blackmon, K., (2005), *Research Business and Management*, Palgrave Macmillan, Londwr.

Ndërsa, në lidhje me burimet kryesore të të dhënave të një karakteri ekonomik, ndër to mund të përmendim konsultimin e bazave të të dhënave si:

- *Penn World Table Version 6.2 – (PWT)* (Tabela Botërore Penn, Versioni 6.2)
- *World Bank's World Development Indicators (WDI)* (Treguesit Botërorë të Zhvillimit të Bankës Botërore)
- *Global Development Network Growth Database (GDN)* (Baza e të Dhënave e Rrjetit Botëror të Zhvillimit mbi Rritjen)
- *International Monetary Fund's International Financial Statistics (IFS)* (Statistikat Ndërkombëtare Financiare të Fondit Monetar Ndërkombëtar).

Megjithatë, edhe të dhënat dytësore në varësi të natyrës së studimit dhe mënyrës se si përdoren kategorizohen në tre grupime kryesore: të dhënat në seri kohore, të dhënat e kryqëzuara, dhe të dhënat të kombinuara nga dy kategoritë e mëparshme të të dhënave (ndryshe, pooled data). Mbështetur në natyrën e këtij studimi, si dhe në logjikën e marrëdhënieve të mundshme ndërmjet variablave të prezantuar edhe nga burimet teorike të literaturës, në rastin e studimit empirik të përqendruar në Ballkanin Perëndimor³²⁸, ne përdorim të dhëna panel. Vetë të dhënat panel (panel data) ‘janë të dhëna tek të cilat e njëjta njësi e kryqëzuar vëzhgohet në raport me kohën.’³²⁹. Ndërsa, për të dhënat e serive kohore (time series data), mund të themi se ‘një seri kohore është një bashkësi vëzhgimesh mbi vlerat që merr një variabël në kohë të ndryshme’³³⁰.

Pra, nëpërmjet përdorimit të të dhënave panel vlerësohen dy dimensione të rëndësishme në kuadrin e kësaj fushe studimi: dimensionin kohor dhe dimensionin vendor. Dimensionin kohor e shohim të prezantuar nëpërmjet të dhënave vjetore për variablat e përfshirë në dy modelet. Ndërsa, dimensionin vendor u referohet shteteve si njësi bazë e vëzhgimit të trendeve që prezantojnë variablat e ndryshëm brenda tyre në një hark kohor të caktuar.

Më konkretisht, për grup-variablat e karakterit socio-politik të dhënat dytësore të përfuara u janë referuar konsultimit të burimeve të mëposhtme:

World Bank Governance Indicators (Treguesit e Qeverisjes Botërore të Bankës Botërore) – treguesi i destabilitetit politik
Corruption Perception Index (Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit) – treguesi i nivelit të korrupsionit
Polity IV - treguesi i nivelit të demokratizimit

³²⁸ Shënim: Ky grup shtetesh në kontekstin e testimit empirik përfshin: Shqipërinë, Bosnjë-Hercegovinën, Kroacinë, dhe Maqedoninë. Fokusimi për testimin empirik tek këto katër shtete shpjegohet në historikun e procesit të shtet-formimit në Ballkanin Perëndimor, që për shtete si Kosova e Mali i Zi ka qenë i vonë në kohë duke prodhuar kështu mungesa të konsiderueshme të dhënash. Për më tepër, disponueshmëria e të dhënave për rastin e Serbisë është e kufizuar në përdorim për shkak të përfshirjes në treguesit ekonomikë e politikë edhe të Kosovës para pavarësisë së saj. Gjithsesi, duke u fokusuar tek katër shtetet e sipërpërmendura, dhe në dinamikën e zhvillimit të tyre, të cilat siç e pamë nga analiza e të gjithë shteteve të Ballkanit Perëndimor janë në të njëjtat linja edhe me tre shtetet e tjera, ne tentojmë të identifikojmë disa logjika të përgjithshme të cilat gjejnë terren ligjërimit edhe tek Serbia, Kosova e Mali i Zi.

³²⁹ Gujarati, N. D., (2004), *Basic Econometrics*, Fourth edition, The McGraw-Hill Companies, fq. 28.

³³⁰ *ibid*, fq. 27.

Ndërsa për variablat e karakterit ekonomik, burimet kryesore të të dhënave të konsultuara janë: Banka Botërore dhe Economic Freedom Composite Index (Indeksi i Përbërë i Lirisë Ekonomike)

5.5 MODELI EMPIRIK

Modeli empirik në këtë studim synon të vlerësojë dhe të testojë empirikisht marrëdhëniet ndërmjet destabilitetit politik e variablave të tjerë ekonomiko-politikë, në raport me rritjen ekonomike të vendeve përgjatë kësaj periudhe.

Si i tillë, modeli empirik është i një rëndësie të veçantë. Kjo, jo vetëm në atë që modeli përfaqëson, por edhe në produktin që mundëson. Ndryshe, Intriligator e konsideron modelin si një ‘përfaqësim të thjeshtëzuar të një fenomeni aktual, i cili përfaqësohet nga modeli për ta shpjeguar, parashikuar dhe kontrolluar, qëllime këto që përputhen edhe me tre qëllimet e ekonometrisë: analizën strukturore, parashikimin, dhe vlerësimin e politikës’³³¹. Pikërisht, për të mundësuar realizimin e plotë të këtij sistemi tre-shkallësh qëllimesh në marrëdhënien ndër-sisteme që synojmë të studiojmë, është e rëndësishme edhe një analizë paraprake e modeleve të përshtatshme për fenomenin nën studim si dhe problematikat me të cilat shoqërohen ato, para prezantimit të modelit të përzgjedhur.

Një kontribut të konsiderueshëm në kuadër të vlerësimit të përshtatshmërisë së modeleve ekonometrike dhe problemeve të matjes që mund të shfaqen në studimin e fenomeneve që përfshijnë rritjen ekonomike dhe variabla të karakterit politik (kryesisht aspektet demokratizuese dhe destabilitetin politik), ka dhënë de Haan e Strum (2005), dhe de Haan (2007). Sipas de Haan (2007), në marrëdhënien ndërmjet elementëve të veçantë të sistemit politik me zhvillimin ekonomik, kërkimet e deritanishme shfaqin disa probleme në mënyrën e ndërmarrjes së studimit dhe testimit të marrëdhënieve në fjalë. Këto problematika shfaqen në disa dimensione kryesore: së pari, specifikimi i modelit dhe ndjeshmëria e rezultateve përkundrejt tij; së dyti, heterogjeniteti i kampionit të marrë nën studim, matja (operacionalizimi në funksion të matjes) e variablave politikë, si dhe mënyra se si është trajtuar dimensionin kohor³³².

Kështu, në funksion të përzgjedhjes së një modeli të duhur ekonometrik, i cili të kapë karakteristikat kohore e vendore të variablave me njëri-tjetrin, shohim të nevojshme të parashtrijmë secilin prej këtyre elementëve problematikë të cilët shpesh ndikojnë rezultatet e studimit:

- Specifikimi i modelit lidhet me një nga problemet tek i cili është fokusuar pjesa më e madhe e analizave të modeleve ekonometrike në shumë fusha kërkimi. Sipas Strum dhe de Haan (2005) pasiguria në përzgjedhjen e modelit lidhet me vështirësinë se ‘modele të ndryshme mund të duken të gjitha të arsyeshme për tu

³³¹ Intriligator, D. M., (1983), *Handbook of Econometrics*, Vllimi I, North-Holland Publishing Company, fq. 182-183.

³³² de Haan, J., (2007), ‘Political institutions and economic growth reconsidered’, *Public Choice*, Vol. 131:281-292, Springer Science+Business Media, fq.281.

përdorur duke marrë parasysh të dhënat, por që këto modele bartin edhe përfundime të ndryshme në lidhje me parametrat që na interesojnë të vlerësojmë³³³. Kjo lidhet ngushtësisht me një çështje problematike brenda kuadrit teorik ekonomik. ‘Teoria ekonomike nuk ofron orientim dhe drejtim në mënyrë të mjaftueshme për përzgjedhjen e specifikimit të duhur të një modeli empirik të rritjes sepse teoritë e rritjes janë ‘open-ended’ (të hapura, të pakufizuara), dmth., vlefshmëria e një teorie shkakësore të rritjes, nuk nënkupton edhe falsitetin e teorisë tjetër³³⁴. Duke qenë se studimi ynë përqendrohet në një rast specifik siç është ai i Ballkanit Perëndimor, kjo lloj problematike zbehet ndjeshëm për shkak të trajtimit të një trendi të vetëm zhvillimor në aspektin politik dhe atë ekonomik³³⁵.

- Nga ana tjetër, problematike në një studim të karakterit ekonometrik paraqet edhe mënyra e përzgjedhjes së kampionit, heterogjeniteti i tij, si dhe mundësia e prezencës në kampion të të dhënave të cilat nuk i përgjigjen marrëdhënies së përgjithshme ndërmjet variablave, por devijojnë nga grupi tjetër i të dhënave (outliers). Autorë të shumtë e lidhin këtë çështje me natyrën e të dhënave, burimin e tyre si dhe besueshmërinë e të dhënave të përzgjedhura për studim. Në këtë këndvështrim, vëzhgimi ynë në këtë studim përqendrohet tek rasti i një grupi specifik shtetesh, gjë e cila nga ana tjetër ul ndjeshëm heterogjenitetin e kampionit dhe të të dhënave. Studimi i marrëdhënieve të këtij karakteri në një kampion të gjerë shtetesh, të cilat nga ana e tyre paraqesin karakteristika të veçanta në terma të zhvillimit ekonomik, rrjedhimisht do të ndikonte edhe në gjasat e prezencës së vëzhgimeve që nuk ndjekin trendin e të dhënave të tjera. Kështu, duke mos patur heterogjenitet të madh në të dhëna, si dhe referimi ndaj bazave të besueshme së të dhënave lehtëson modelin tonë në këtë dimension problemesh matjeje.
- Një nga sfidat që paraqesin variablat politikë, e sidomos destabiliteti politik në fokus të këtij studimi është vështirësia në matje. Duke qenë se janë variabla të cilat nuk mund të vlerësohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, dhe për më tepër përfaqësohen nga një shumësi dimensionesh, vështirësia dhe problemi kryesor që identifikohet është matja e duhur e tyre. Për këtë, ekzistojnë burime të shumta të cilat masin dimensione të ndryshme të fenomeneve politike (për shembull për variabla të tillë si demokracia, destabiliteti politik, korrupsioni, etj). Një pjesë e konsiderueshme e studiuesve përqendrohen vetëm në një burim të dhënash duke e vënë në rrezik kapjen e plotë së të gjithë dimensioneve të variablave përkatës. Kjo zgjedhje shpesh bëhet edhe përcaktuese e rezultateve të studimit, dhe e koeficientëve të variablave të pavarur në regresion.

³³³ Strum, J-E. de Haan, J., (2005), ‘Determinants of long-term growth: new results applying robust estimation and extreme bounds’, *Research Paper Series*, Nr.12, Thurgauer Wirtschaftsinstitut, fq. 2.

³³⁴ de Haan, J., (2007), ‘Political institutions and economic growth reconsidered’, *Public Choice*, Vol. 131:281-292, Springer Science+Business Media, fq. 283.

³³⁵ Shënim: Literatura sugjeron që në rastet e studimeve me grupe të mëdha shtetesh, të cilat gjithashtu karakterizohen nga shumëllojshmëria e trendeve të rritjes ekonomike përgjatë dekadave, të përdoret EBA (Extreme Bounds Analysis). EBA-ja konsiston në verifikimin sesa të ndjeshëm janë koeficientët e çdo variabli përkundrejt shtimit të variablave të tjerë shpejgues në regresionin bazë.

5.5.1 Përzgjedhja e modelit

Modelet ekonomike që janë prodhuar nga literatura më e fundit në studimin e marrëdhënies midis rritjes ekonomike e variablave të karakterit politik (me fokusimin tek destabiliteti politik) janë të shumtë. Kjo, e nxitur edhe nga zhvillimi e ndërtimi i bazave së të dhënave të cilat mbulojnë jo vetëm një hark kohor të gjerë, por edhe të dhëna statistikore për një numër të madh (N) vendesh. Këto modele i shohim të testojnë marrëdhënien midis rritjes ekonomike e variablave të tjerë politikë e ekonomikë në një grup (N) shtetesh për një periudhë kohore t .

Guajarati (2004), duke iu referuar Hendry dhe Richard³³⁶ identifikon disa kritere kryesore, të cilat nevojitet të mbahen parasysh në përzgjedhjen e modelit në funksion të analizës empirike. Ndër të tilla identifikohen:

1. Modeli duhet të pranojë të dhënat; pra, parashikimet e bëra nga modeli duhet të jenë të mundshme logjikisht.
2. Modeli duhet të jetë në përputhje me teorinë; pra, ai duhet të ketë kuptim në pikëpamje të logjikave ekonomike.
3. Modeli duhet të ketë në formulimin e tij regresorë ose variabla shpjegues, të cilat nuk duhet të jenë të korreluara me termin e gabimit.
4. Modeli duhet të paraqesi qëndrueshmëri të parametrave; që do të thotë se vlerat e parametrave duhet të jenë stabël në mënyrë që të mundësojnë parashikimin.
5. Modeli duhet të shfaqë lidhje logjike me të dhënat; pra, nëse modeli i regresionit është i përshtatshëm, atëherë mbetjet (residuals) nga ky model duhet të jenë plotësisht të rastësishëm (zhurmë e bardhë). Nëse nuk ndodh kështu, atëherë ka gabim në specifikimin e modelit.
6. Së fundmi, modeli duhet të jetë edhe përfshirës. Pra, ai duhet të përfshijë edhe modelet rivale në kuptimin që të jetë në gjendje të shpjegojë rezultatet e tyre.

Përqëndrimi tek të tillë elementë, sigurisht ndihmon në përzgjedhjen e modelit të duhur të regresionit. Pavarësisht kësaj, pjesa më e madhe e problematikave me të cilat lidhet përzgjedhja e tij (të konsideruara si gabime të specifikimit), sipas Guajaratit janë: heqja e variablave(it) të rëndësishëm nga modeli, shtimi i variablave(it) të panevojshëm, vendosja e formës së gabuar funksionale, e gabimet në matje³³⁷.

³³⁶ Gujarati, N. D., (2004), *Basic Econometrics*, Fourth edition, The McGraw-Hill Companies, fq. 508 (mbwshtetur nw: D. F. Hendry and J. F. Richard, 'The Econometric Analysis of Economic Time Series', *International Statistical Review*, vol. 51, 1983, pp. 3–33).

³³⁷ Gujarati, N. D., (2004), *Basic Econometrics*, Fourth edition, The McGraw-Hill Companies, fq. 509.

5.5.2 Hipotezat e studimit

Në këtë etapë të përvijimit të metodologjisë identifikojmë hipotezat e studimit të cilat adresohen nga modeli përkatës ekonometrik (i prezantuar në vijim) për tu testuar empirikisht për rastin e disa vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Hipotezat e studimit ne i ndajmë në dy nivele kryesore: hipoteza kryesore, e cila ka për qëllim të prezantojë natyrën e marrëdhënieve të karakterit të përgjithshëm ndërmjet variablave të përfshirë në studim; si dhe hipotezat e thjeshta, të cilat derivojnë nga hipoteza e përgjithshme si një operacionalizim i saj për të parë më në thellësi e specifikisht raportin e çdo variabli që bëhet pjesë e ekuacioneve të regresionit të modelit.

Si të tilla, hipoteza të përgjithshme të studimit evidentojmë:

Hipoteza 1: Performanca e sistemit ekonomik në terma të rritjes ekonomike për rastin e grup-shteteve të Ballkanit Perëndimor ndikohet edhe nga faktorë të karakterit politik.

Ndërsa, hipotezat e thjeshta të cilat zbërthejnë logjikat e përgjithshme të dy hipotezave të mësipërme i identifikojmë si më poshtë:

H11: Demokracia e ndikon pozitivisht rritjen ekonomike.

H12: Destabiliteti politik ndikon negativisht rritjen ekonomike.

H13: Korrupsioni ndikon negativisht rritjen ekonomike.

H14: Liria ekonomike ndikon pozitivisht rritjen ekonomike.

H15: Shpenzimet qeveritare ndikojnë pozitivisht rritjen ekonomike.

H16: Niveli i shkollimit të popullsisë ndikon pozitivisht rritjen ekonomike.

H17: Investimet ndikojnë pozitivisht rritjen ekonomike.

H18: Destabiliteti politik nëpërmjet ndikimit tek faktorët ekonomikë, ndikon edhe në mënyrë të tërthortë rritjen ekonomike të vendit.

5.5.3 Përkufizimi, shpjegimi i modelit

Modeli

Modeli që përdorim është mbështetur në kontributin e studimit të Abeyasinghe i vlerësuar në kuadrin e *Honors Projects*³³⁸ duke e përshtatur për rastin e disa vendeve të Ballkanit Perëndimor. Ai synon të vlerësojë jo vetëm marrëdhënien e destabilitetit politik përkundrejt rritjes ekonomike, por edhe rolin e variablave të tjerë në këtë marrëdhënie. Për më tepër, duke u mbështetur edhe tek teoria ekonomike, ne synojmë të masim jo vetëm ndikimin e drejtpërdrejtë të variablave politikë, por edhe ndikimin e tërthortë të tyre tek rritja nëpërmjet ndikimit tek variabla të tjerë ekonomikë. Nëpërmjet përdorimit të regresionit linear të shumëfishtë paraqiten këto ekuacione:

$$\text{PBB}(f) = \alpha_1 + \beta_2(\text{Democ}) + \beta_3(\text{StabPol}) + \beta_4(\text{LEcon}) + \beta_5(\text{Korrups}) \quad (1)$$

ku, variablat e pavarur të karakterit politik janë stabiliteti politik, demokracia, liria ekonomike dhe korrupsioni.

Modelit bazë të thjeshtë të mësipërm i shtohen edhe një grup-variablash ekonomikë, duke e plotësuar modelin në formën e tij të përgjithshme si më poshtë:

$$\text{R}(\text{rritja})\text{PBB}(f) = \alpha_2 + \beta_{11}(\text{Democ}) + \beta_{12}(\text{StabPol}) + \beta_{13}(\text{LEcon}) + \beta_{14}(\text{Korrups}) + \beta_{15}(\text{I}) + \beta_{16}(\text{InPBB}) + \beta_{17}(\text{RP}) + \beta_{18}(\text{Edu}) + \beta_{19}(\text{GE}) \quad (2)$$

Për të parë se si ndikojnë variablat politikë tek variablat ndërhyrës të karakterit ekonomik përdorim edhe katër ekuacionet ndihmëse:

$$\text{I} = \alpha_3 + \beta_{31}(\text{Democ}) + \beta_{32}(\text{StabPol}) + \beta_{33}(\text{LEcon}) + \beta_{34}(\text{Korrups}) \quad (3)$$

$$\text{Edu} = \alpha_4 + \beta_{41}(\text{Democ}) + \beta_{42}(\text{StabPol}) + \beta_{43}(\text{LEcon}) + \beta_{44}(\text{Korrups}) \quad (4)$$

$$\text{GE} = \alpha_5 + \beta_{51}(\text{Democ}) + \beta_{52}(\text{StabPol}) + \beta_{53}(\text{LEcon}) + \beta_{54}(\text{Korrups}) \quad (5)$$

$$\begin{aligned} (\Delta\text{RPBB}(f)/\Delta\text{StabPol})^{339} &= (\delta\text{RPBB}(f)/\delta\text{StabPol}) + (\delta\text{RPBB}(f)/\delta\text{I}) * \\ &(\delta\text{I}/\delta\text{StabPol}) + (\delta\text{RPBB}(f)/\delta\text{Edu}) * (\delta\text{Edu}/\delta\text{StabPol}) + \\ &(\delta\text{RPBB}(f)/\delta\text{GE}) * (\delta\text{GE}/\delta\text{StabPol}) \end{aligned} \quad (6)$$

Pjesa e parë e anës së majtë të ekuacionit të fundit shpreh ndikimin e drejtpërdrejtë të destabilitetit politik tek rritja ekonomike, ndërsa pjesët e tjera tregojnë ndikimin e

³³⁸ Abeyasinghe, R., (2004), 'Democracy, political stability, and developing country growth: theory and evidence', *Honors Projects*, Nr. 17, Illinois Wesleyan University, fq. 1-32.

³³⁹ Shënim: Ky ekuacion i fundit ndihmës në funksion të modelit të përgjithshëm synon të vlerësojë ndikimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të destabilitetit politik tek rritja ekonomike. Për këtë arsye është marrë derivati i të gjithë modelit përkundrejt destabilitetit politik.

tërthortë të këtij variabli tek variablat e karakterit ekonomik (investimet, shkollimi, shpenzimet qeveritare), totali i të cilave presim të prodhojë ndikimin e drejtpërdrejtë të destabilitetit politik tek rritja ekonomike.

5.5.4 Variablat: variablat e varur dhe të pavarur

Kur tentojmë të vlerësojmë sistemin ekonomik të një vendi, e më specifikuisht fuqinë ekonomike të tij, të shumtë janë treguesit që mund të përdorim. Studiues të ndryshëm, në varësi të interesit të studimit përqendrohen në tregues si: tregëtia e jashtme, PBB-ja, kuota e FMN-së akorduar një vendi të veçantë, etj. Pavarësisht, plotësisë së informacionit që ofron kuota e FMN-së në lidhje me fuqinë ekonomike të një vendi e për më tepër, elementin e krahasueshmërisë në raport me vende të tjera, nisur nga specifika e marrëdhënieve që do të marrim nën studim, elementi kryesor tek i cili fokusohemi është rritja ekonomike e vlerësuar nëpërmjet PBB-së, variabël ky të cilin e shohim në pozicionin e variablit të varur në ekuacionet e mësipërme.

Përveç adresimit të çështjes së endogjenitetit, një tjetër çështje që meriton vëmendje është mënyra e operacionalizimit të variablit të destabilitetit politik. Ashtu siç e kemi theksuar më sipër, problemi kryesor që lidhet me këtë fenomen është shumësia e dimensioneve nëpërmjet së cilave shfaqet. Për këtë arsye, literatura ekonomike empirike që mbështetet në kampione të zgjeruara shtetesh, sugjeron ndërmarrjen e analizës faktoriale për të prodhuar matricën e dimensioneve të rëndësishme të destabilitetit politik nga grupimi i indekseve ndërkombëtarisht të përdorura për matjen e tij në shtete të ndryshme. Mirëpo, problemi kryesor që mund të identifikojmë në të tilla raste është fakti se shfaqjet e ndryshme të destabilitetit politik ndikohen nga karakteristikat rajonale të vendeve si dhe ato shtetërore për shtete të veçanta. Kështu, ‘ndryshimet e qeverive, nuk konsiderohen si shenja të destabilitetit politik në disa rajone, ndërsa grushtet e shtetit janë virtualisht jo-ekzistente në shtete të tjera’³⁴⁰. Edhe për rastin tonë studimor, specifikat shtetërore e rajonale përjashtojnë nevojën për të marrë në konsideratë matës të destabilitetit politik të cilat marrin në konsideratë dimensionet e caktuara të destabilitetit politik si: grushtet e shtetit, puçet ushtarake, etj.

Më konkretisht variablat e përfshirë në ekuacionet e regresioneve të modelit të paraqitur më sipër, shkurtimet e tyre si dhe përshkrimi për secilin prej tyre paraqitet në tabelën përmbledhëse të mëposhtme:

Tabela 5.2: Përmbledhje e variablave të modelit të regresionit

VARIABLI	PËRSHKRIMI
RPBB	Rritja e PBB-së: % e normës vjetore të rritjes së PBB.
StabPol	Destabiliteti politik si perceptimet e gjasave që ka një vend për destabilizimin e qeverisë ose

³⁴⁰ Zureiqat, M. H., (2005), ‘Political Instability and Economic Performance: A Panel Data Analysis’, *Award Winning Economics Papers*, Nr.1, fq. 22.

	rrëzimin e saj nëpërmjet mjeteve jokushtetuese ose të dhunshme, duke përfshirë këtu dhunën e motivuar politikisht dhe terrorizmin.
Democ	Niveli i demokracisë në vend sipas Polity IV.
Lecon	Niveli i lirisë ekonomike i matur si i tillë bazuar në lirinë e tregëtisë, biznesit, investimeve, dhe të drejtat e autorit.
Korrups	Nivelet e korrupsionit për një vend tregojnë perceptimin në lidhje me nivelin e korrupsionit në sektorin publik.
RP	Rritja e popullsisë: është norma eksponenciale e rritjes e popullsisë (vjetore %) e shprehur në përqindje.
I	Investimet e huaja të drejtpërdrejta janë fluksi neto i investimeve.
Edu	Norma e rregjistrimit në nivelin e studimeve universitare pavarësisht moshës e shprehur si përqindje e totalit të popullsisë.
GE	Shpenzimet e përgjithshme qeveritare përfshijnë të gjitha shpenzimet qeveritare aktuale për blerjen e të mirave dhe shpenzimeve .

5.5.5 Supozimet e studimit

Testimi i marrëdhënieve empirike mbështetet në supozimet e mëposhtme:

1. Duke u bazuar tek analiza e fenomenit të destabilitetit politik për një rajon si Ballkani Perëndimor, ne supozojmë se indekset e përdorura në vlerësimin e tij përgjatë kohës kapin shfaqjen e plotë të këtij fenomeni për këto vende.
2. Mbështetur në faktin se vendet e marra në konsideratë kanë qenë të përfshira nga dinamikat e proceseve demokratizuese, ne supozojmë se edhe elementë të tjerë të karakterit politik kanë patur ndikimin e tyre në performancën ekonomike.
3. Ne supozojmë se modeli i regresionit linear të shumëfishtë (është i vlefshëm) në testimin e marrëdhënieve ndërmjet variablave.
4. Ne supozojmë se të dhënat sasiore dytësore të ecurisë së variablave përgjatë kohës ofrojnë një përfaqësim real të statusit të këtyre variablave për Ballkanin Perëndimor.
5. Ne supozojmë se destabiliteti politik mund të ulë rritjen ekonomike.
6. Ne supozojmë se demokracia dhe destabiliteti politik mund të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë rritjen ekonomike.

KAPITULLI 6

ANALIZA E REZULTATEVE DHE DISKUTIMI I TYRE

Përmbledhje

Një element i rëndësishëm i aspektit praktik të këtij punimi është edhe analiza e diskutimi i rezultateve. Argumentet teorike që prezantuar fillimisht ofruan kontekstin brenda së cilave zhvillohen marrëdhëniet kryesore ndërmjet sistemit politik e atij ekonomik, e specifikisht ndërmjet destabilitetit politik dhe rritjes ekonomike. Nëpërmjet tyre, u mbërrit në evidentimin e modelit bazë i cili i shërben linjës praktike të këtij punimi, e konkretisht testimit empirik të marrëdhënieve në fjalë.

Për këtë, në këtë kapitull ne vijojmë me trajtimin e gjetjeve të testimit empirik për rastin e një grup shtetesh të Ballkanit Perëndimor. Analiza e rezultateve të prodhuara nga përpunimi i të dhënave nëpërmjet softuerit STATA ndahet në tre nivele kryesore: *së pari*, bëhet paraqitja e statistikave përshkruese si dhe analiza e tyre; *së dyti*, zhvillohet analiza e regresionit linear për vërtetimin e hipotezave të thjeshta të modelit të regresionit të marrë në konsideratë nga ky studim, për të përfunduar më pas (*së treti*) me një analizë të një niveli më të përgjithshëm të hipotezës kryesore të studimit.

Nga ana tjetër, përveç analizës së rezultateve nga përpunimi i të dhënave, paralelisht realizohet edhe diskutimi në lidhje me statusin empirik të gjetjeve (rezultateve) për variabla të ndryshëm, duke mundësuar ballafaqimin e tyre me argumentet teorike e qëndrimet e qasjeve studimore të marra në konsideratë (qasja moderniste, qasja demokratizuese, ekonomia politike e rritjes) për kategorinë e vendeve të marra në studim.

6.1 HYRJJE

Shqipëria, Bosnjë Hercegovina, Maqedonia e Kroacia, si pjesë e Ballkanit Perëndimor pavarësisht ndryshimeve në aspekte të veçanta, prezantojnë konvergjenca në trendet e tyre të përgjithshme zhvillimore si në aspektin ekonomik, ashtu edhe në atë politik. Ndër të tilla aspekte, Penev³⁴¹ përmend zhvillimet makroekonomike së bashku me sektorin e jashtëm e atë financiar, mjedisin e biznesit, konkurrueshmërinë në të, si dhe reformën rregullatore duke përfshirë këtu kapacitetet institucionale, transparencën në procesin legjislativ, praktikat korruptive, etj.

Një ndihmesë të madhe në vlerësimin e statusit të këtyre elementëve përgjatë viteve e japin institucionet, agjensitë ndërkombëtare e anketimet ndërkombëtare nëpërmjet matjeve, analizave e raporteve vjetore që ato prodhojnë të mbështetura në baza të pasura të dhënash. Si të tilla, përmendim: *Banks Cross National Time Series Archive* (Arkiva Banks e të Dhënave në Seri Ndërmjet Shteteve), *International Country Risk Guide* (Udhëzuesi Ndërkombëtar i Riskut të Shteteve), *Polity IV* (Politi IV), *International Peace Research Institute Oslo* (PRIO) (Instituti Ndërkombëtar i Kërkimeve mbi Paqen i Oslos), *Database of Political Institutions of the World Bank* (DPI) (Baza e të Dhënave të Institucioneve Politike të Bankës Botërore), *State Failure Task Force* (SFTF) (Task Forca e Dështimit të Shteteve), *World Bank's Development Indicators* (WDI) (Treguesit Botërorë të Zhvillimit të Bankës Botërore), *Global Development Network Growth Database* (GDN) (Baza e të Dhënave e Rrjetit Botëror të Zhvillimit mbi Rritjen), *International Monetary Fund's International Financial Statistics* (IFS) (Statistikat Ndërkombëtare Financiare të Fondit Monetar Ndërkombëtar), etj.

Mirëpo, për të parë më në detaj e më në thellësi marrëdhënien ndërmjet elementëve të veçantë të sektorit ekonomik e sistemit politik na ndihmon analiza e rezultateve të testimit empirik dhe diskutimi që gjeneron secila gjetje.

Kështu, qëllimi i këtij kapitulli është të prezantojë rezultatet e studimit si nga pikëpamja e të dhënave përshkruese, ashtu edhe nga pikëpamja e verifikimit të hipotezave të ngritura. Për këtë, më poshtë prezantohen rezultatet konkrete së bashku me paraqitjen grafike të marrëdhënieve ndërmjet variablave të ndryshëm si dhe diskutimet përkatëse. Natyrisht, këto të fundit hedhin dritë edhe mbi nevojën e ndërmarrjes së të tjera studimeve të cilat të mund të fokusohen pikërisht në këtë ndërthurje ndërmjet faktorëve ekonomikë e atyre politikë.

6.2 ANALIZA E STATISTIKAVE PËRSHKRUESE TË MODELIT

Kapitujt e mëparshëm përveç përqëndrimit në argumentet teorike, parashtruan gjithashtu edhe një paraqitje të përgjithshme të mënyrës se si vendet e Ballkanit Perëndimor performonin në lidhje me proceset tranzitore demokratike e ato ekonomike. Përveç

³⁴¹ Penev, S., (2012), *Economic and European perspectives for the Western Balkan countries*, Westminster Foundation of Democracy, Western Balkans Parliamentary network of committees for economy, finance and budget, Faculty of Economics and Business, Sarajevë, Institute of Economic Sciences, Beograd.

përqendrimit në elementë të veçantë në kuadrin krahasimor ndërmjet këtyre vendeve, për vetë natyrën e studimit shohim me vend përqëndrimin edhe në aspektet specifike të zhvillimit politik e ekonomik për rastin e Shqipërisë. Në përmbushje edhe të objektivave që ky studim ka paravendosur, nëpërmjet kësaj trajtесе tentohet të mundësohet edhe një qasje krahasuese ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor.

Për këtë arsye, kjo pjesë e studimit përqëndrohet në paraqitjen grafike të ecurisë së variablave të studimit në raport me kohën dhe me variabla të tjerë pjesë e modelit. Terreni teorik i teorive politike në lidhje me çështjet e demokracisë dhe ai i teorive ekonomike në lidhje me zhvillimin ekonomik dhe rritjen, si dhe hulumtimi empirik paraprak në lidhje me statusin e variablave në kohë gjejnë mbështetje edhe nga pjesa praktike e studimit.

Kështu, duke u mbështetur tek baza e të dhënave të studimit, më poshtë prezantohen të ilustruara grafikisht disa aspekte të zhvillimit ekonomik e politik të grup shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe Shqipërisë:

- Rritja e PBB-së dhe investimet

Në aspektin e variablit kryesor të varur, rritjes ekonomike, shohim këtë panoramë për Shqipërinë, Bosnjë Hercegovinën, Kroacinë e Maqedoninë në pikëpamje të ecurisë së këtij variabli në periudhën pas viteve 90’:




Figura 6.1: Trendi i ecurisë së rritjes ekonomike për grup-shtetet e Ballkanit Perëndimor

Siç mund ta shohim, thajse tek të gjitha këto shtete rritja e PBB-së ndjek të njëjtin trend, duke reflektuar edhe ndikimet që faktorë të jashtëm, siç ishte kriza ekonomike financiare kanë patur mbi këto shtete. Ndikimi i krizës prodhoi një rënie të rritjes së PBB-së (viti 2009-2010), e shoqëruar kjo më pas me një ngadalësim të ritmeve të rritjes. Përveç kësaj, ritmet e rritjes padyshim kanë reflektuar edhe gjendjen ekonomiko-politike shtetërore. Këtë e shohim qartazi në rastin e Shqipërisë, ku si pasojë e ngjarjeve destabilizuese të vitit 1997, edhe rritja e PBB-së ka rënie të konsiderueshme. Po kështu, situatë analoge është ajo e Bosnjë Hercegovinës, ku prej vitit 1996 ku ritmet e rritjes ishin shumë të larta,

filloi rënia e e cila që prej vitit 1998 vijoi thuajse në të njëjtin nivel me shtetet e tjera të këtij grupi shtetesh.

Nga ana tjetër, një variabël ngushtësisht i lidhur me PBB-në janë edhe investimet. Të para në lupën e dimensionit kohor (grafiku i mëposhtëm), investimet ashtu si rritja e PBB-së shfaqin të njëjtat trende të përgjithshme të ecurisë së tyre kohore për grup shtetet e Ballkanit Perëndimor. Në raste specifike, siç është rasti i Maqedonisë për periudhën e viteve 2000-2002, edhe pse trendi i ecurisë së investimeve në vend është i njëjtë me vendet e tjera të marra nën studim, magnituda e rritjes është më e lartë. Gjithashtu, specifik është edhe rasti i Shqipërisë për periudhën e viteve 2009-2010, vite që përkojnë me krizën ekonomike, e cila në ndryshim nga tre vendet e tjera e mban ritmin e investimeve në nivele krahasimisht më të larta.




Figura 6.2: Investimet për grup-shtetet e Ballkanit Perëndimor për periudhën 1996-2012

- Liria ekonomike

Siç mund ta shohim të ilustruar edhe grafikisht, liria ekonomike (referuar EFI-së) e parë si niveli i lirisë ekonomike bazuar në lirinë e tregëtisë, biznesit, investimeve, dhe të drejtat e autorit ka po ashtu të njëjtën vijueshmëri për periudhën kohore të marrë në konsideratë nga ky studim. Vlerësimet vjetore në lidhje me të janë në segmente shumë të afërta vlerash nga njëri shtet tek tjetri, me përjashtim të Bosnjë Hercegovinës e cila ka një vlerësim krahasimisht më të ulët në lidhje me lirinë ekonomike sidomos në fillim të periudhës. Megjithatë, duke filluar nga viti 2006, ecuria e sistemit ekonomik në pikëpamje të frymës së përgjithshme e hapësirave e lehtësive që u krijojnë agjentëve ekonomikë për sipërmarrje ekonomike, edhe për Bosnjë Hercegovinën arrin nivelet e shteteve të tjera.




Figura 6.3: Ecuria e vlerësimit të lirisë ekonomike sipas Indeksit të Lirisë Ekonomike (EFI), 1996-2012

- Shpenzimet qeveritare

Një tjetër variabël ndërhyrës në modelin kryesor është edhe variabli i shpenzimeve qeveritare. Ecuria e tij përgjatë viteve 1996-2012 luhatet në segmentin ndërmjet vlerave 18%-24% të PBB-së për pjesën më të madhe të shteteve. Përjashtim bën rasti i Shqipërisë, ku edhe pse mbizotëron një trend pa shumë luhajtje në pikëpamje të shpenzimeve qeveritare, këto të fundit janë dukshëm në nivele më të ulëta sesa ato të Maqedonisë, Kroacisë e Bosnjë Hercegovinës.




Figura 6.4: Shpenzimet qeveritare për periudhën 1996-2012 për grup shtetet e Ballkanit Perëndimor

- Demokratizimi

Natyrshëm, lind nevoja për të parë nga afër edhe performancën e sistemit politik të këtyre vendeve nga pikëpamja e faktorëve politikë që ndikojnë në të. Nëse u referohemi të dhënave të prodhuara nga Polity IV, dhe i paraqesim ato grafikisht për Shqipërinë,

Maqedoninë, Kroacinë e Bosnjë Hercegovinën, ecuria e tyre në raport me kohën paraqitet si vijon:




Figura 6.5: Ecuria e demokratizimit për grup shtetet e Ballkanit Perëndimor për periudhën 1996-2012

Vihet re qartë se ecuria e këtij variabli ka shfaqur për të gjitha shtetet një ecuri konstante pavarësisht vlerësimit në boshtin e demokratizimit. Përjashtim nga ky trend i përgjithshëm përbën Kroacia e cila shihet të ketë një rënie në vlerësimin në lidhje me procesin demokratizues në periudhën ndërmjet viteve 1998-2000. Megjithatë, zhvillimet e mëtejshme demokratike për këtë vend kanë një ecuri të qartë e thuajse në të njëjtat nivele nga ato prej së cilave fillonte vlerësimi në vitet 1996. Pavarësisht ecurisë konstante të zhvillimeve në të njëjtën linjë edhe me Shqipërinë, Kroacinë e Maqedoninë, Bosnjë Hercegovina paraqet vlerësime dukshëm negative në lidhje me zhvillimin dhe konsolidimin e demokracisë (-62).

- Liritë politike dhe të drejtat civile

Në pikëpamje të grup faktorëve politikë, nëse do të veçonim liritë politike e të drejtat civile, dhe më konkretisht mesataren e tyre për secilin vend, shohim se ky variabël ka një ecuri të qëndrueshme për pjesën më të madhe të vendeve deri në vitet 1999-2000 e më pas fillon një trend rritje³⁴² për të gjitha shtetet. Dhe, nëse shohim më specifikisht këtë rritje në vlerësim, vëmë re se nëse segmenti ku varionin vlerat në fillim të periudhës studimore ka qënë [3.5; 5], në fund të periudhës së marrë në konsideratë ky segment kalon në vlerat [1.5;3], ku vlerësimin maksimal ndër këto shtete në fund të periudhës e ka Kroacia. Si më poshtë, paraqiten rezultatet e përpunuara grafiki:

³⁴² Shënim: Interpretimi i vlerësimeve që prodhon Freedom House për liritë politike e të drejtat civile parashikon një vlerësim maksimal me 1, dhe minimal me 7. Për këtë arsye, pavarësisht se kurbat e ecurisë së këtij variabli paraqesin grafikisht një rënie, në terma të interpretimit kjo rënie në vetvete është rritje sipas vlerësimit të Freedom House.




Figura 6.6 : Liritë politike dhe të dretjtat civile, 1996-2012 (mesatarja e lirive politike e të drejtave civile, Freedom House)

Ndërsa, tabela e mëposhtme paraqet keto vlera konkrete të mesatarizuara në total me të dy kategoritë e lirive.

Tabela 6.1: Liritë politike dhe të dretjtat civile, 1996-2012 (mesatarja e lirive politike e të drejtave civile, Freedom House)

Vitet/Shtetet	Shqipëria	Bosnjë Hercegovina	Kroacia	Maqedonia
1996	4	5	4	3.5
1997	4	5	4	3.5
1998	4.5	5	4	3
1999	4.5	5	4	3
2000	4.5	4.5	2.5	3.5
2001	3.5	4.5	2	4
2002	3	4	2	3
2003	3	4	2	3
2004	3	3.5	2	3
2005	3	3.5	2	3
2006	3	3	2	3
2007	3	3.5	2	3
2008	3	3.5	2	3
2009	3	3.5	1.5	3
2010	3	3.5	1.5	3
2011	3	3.5	1.5	3
2012	3	3	1.5	3

Rasti specifik i Shqipërisë

- Investimet dhe rritja e PBB-së

Në aspektin ekonomik, ndër variablat kyç që përfshijmë në analizë janë investimet e rritja e Produktit të Brendshëm Bruto. Nëse shohim ecurinë e tyre në raport me kohën dhe me njëri-tjetrin vëmë re tipare interesante për rastin specifik të Shqipërisë.




Figura 6.7: Investimet dhe rritja e PBB-së në Shqipëri për periudhën 1996-2012

Kështu, investimet shohim të prezantojnë në totalin e periudhës kohore rritje, e cila për vitin 2012 mbërrin në shifrën 12%. Brenda këtij harku kohor totali i investimeve ka pësuar rëniet e rritjet e veta të cilat minimumin e kanë arritur në vitin 1999 me rreth 0.7%, ndërsa maksimumin në vitin 2009. Paralelisht me ecurinë e investimeve, rritja ekonomike karakterizohet thuajse nga të njëjtat trende zhvillimore. Kështu, rënia e pësuar në vitet '97-'99' tek investimet, padyshim reflektohet edhe tek rritja ekonomike., dhe në të njëjtën linjë kjo projektohet edhe për vitet 2000-2006. Po kështu, nga viti 2008-2012 rritja e rënja e rritjes ekonomike reflekton brenda kornizave të përgjithshme edhe ritmet e ecurisë së investimeve.

- Liria ekonomike




Figura 6.8: Liria ekonomike në Shqipëri për periudhën 1996-2012

Nga ana tjetër, liria ekonomike e parë si një element kyç në vlerësimet e përgjithshme për ecurinë dhe performancën e sistemit ekonomik në totalin e vet ka pësuar rritje në

vlerësimin e saj përgjatë periudhës kohore 1996-2012. Maksimumin e saj e shohim të arritur ndërmjet viteve 2009-2010 me një rënie të lehtë për periudhën 2011-2012.

- Demokratizimi

Analiza dhe përmbledhja e literaturës në lidhje me procesin e demokratizimit në Shqipëri, ashtu siç është theksuar më sipër, e sheh procesin e kalimit nga një regjim jodemokratik në një regjim demokratik si një proces ende të papërfunduar. Pra, si një proces tranzicioni në të cilin nuk është mbërritur ende në etapën përfundimtare të tij: atë të konsolidimit. Kjo, ka bërë që për pjesën më të madhe të studiuesve, Shqipëria të pozicionohet në kategorinë e vendeve me demokraci ‘hibride’, ‘malinje’, apo ‘të papërfunduar’. Më konkretisht, në lidhje me nivelin e demokratizimit apo vlerësimin e tendencave demokratike në vend bën Polity IV (Politi IV). Politi është një bazë të dhënash shumë e pasur, e ndërmarrë si projekt nga Qendra për Paqen Sistemike (Center for Systemic Peace), version më i fundit i së cilës është versioni i katërt (version i marrë në konsideratë në këtë studim). Vlerësimet e kuantifikuara në pikëzime konkrete për shtetet në këtë bazë të dhënash lëvizin në segmentin nga -10 (monarki e trashëguar) në 10 (demokraci e konsoliduar). Skema që përdor Politi ‘përbëhet nga gjashtë elementë kyç të cilët vlerësojnë karakteristika si formimi i ekzekutivit, kufizimet në autoritetin ekzekutiv, konkurrenca politike, si dhe cilësitë e institucionalizuara të autoritetit qeverisës’³⁴³.

Kështu, për rastin e Shqipërisë, si më poshtë ofrohet e paraqitur grafikisht ecuria në kohë e elementëve demokratikë e atyre autokratikë bazuar në të dhënat e kësaj baze botërore të dhënash:




Figura 6.9: Ecuria e demokratizimit në Shqipëri për periudhën 1996-2012³⁴⁴

Siç mund të vëmë re, ecuria e tendencave demokratike përkundrajt atyre autokratike prodhon një rezultante (politia), e cila përgjatë kohës sipas bazës së të dhënave të prodhuar nga Polity IV, ka pësuar rritje të konsiderueshme. Kështu, në një hark kohor prej 15 vitesh vlerësimi për politinë ka kaluar nga zero në nëntë, duke ecur paralelisht në të njëjtat vlera me nivelin e demokratizimit prej vitit 2002. Ky vlerësim është dëshmuar i

³⁴³ <http://www.systemicpeace.org/polityproject.html>

³⁴⁴ Shënim: Tabelat e grafikët e kësaj pjese praktike të punimit janë të ndërtuara e përpunuara nga autori bazuar në bazën e të dhënave sasiore të përfutuara për variablat e marra në analizë nga institucionet e agjencitë ndërkombëtare.

ecurisë pozitive dhe në rritje të proceseve demokratike në vend, të cilat nuk arrijnë të kenë vlerësimin maksimal nga kjo bazë të dhënash.

- Stabiliteti politik

Nga ana tjetër, nën kornizën e këtyre zhvillimeve të karakterit politik prezantohen edhe tendencat politikisht stabilizuese apo destabilizuese të vendit. Këto të fundit, referuar Indeksit të Destabilitetit Politik ilustrohen grafikisht përgjatë kohës si më poshtë:




Figura 6.10: Ecuria e Indeksit të Destabilitetit Politik për Shqipërinë

Kuantifikimi i një fenomeni kompleks siç është ai i destabilitetit politik dhe paraqitja e tij e mësipërme u mundësua nga të dhëna të përftuara nga Banka Botërore në lidhje me vlerësimet që ky institucion zhvillon vit pas viti botërisht. Ky indeks reflekton ‘perceptimet e gjasave që ka një vend për destabilizimin e qeverisë ose rrëzimin e saj nëpërmjet mjeteve jokushtetuese ose të dhunshme, duke përfshirë këtu dhunën e motivuar politikisht dhe terrorizmin’ (BB). Vlerat me të cilat BB identifikon ecurinë e tendencave stabilizuese e destabilizuese në vende të ndryshme pozicionohen ndërmjet vlerave -2.5 dhe 2.5, ku vlerat më të larta tregojnë vlerësime më të mira për qeverisjen e një vendi. Siç mund ta shohim, për rastin e Shqipërisë vlerësimi i destabilitetit politik për periudhën kohore të marrë në konsideratë lëviz në vlera negative me një përmirësim të ndjeshëm në vitet 2008-2009, por me një rikthim në vlerat më të ulëta (-0.72) në vitin 2012.

- Korrupsioni

Në po të njëjtën linjë, paraqesim si më poshtë edhe një element tjetër, të cilin literatura e pas viteve 90’ e konsideron si një variabël të rëndësishëm ndikues në zhvillimin ekonomik të vendit. Ai është Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit, i cili i matur nga treguesit e Bankës Botërore në lidhje me qeverisjen, rendit vendet bazuar në faktin se sa i korruptuar është sektori publik sipas perceptimit në këto vende. Vlerësimi i kuantifikuar për një vend në lidhje me nivelin e korrupsionit sipas këtij indeksi tregon perceptimin në lidhje me nivelin e korrupsionit në sektorin publik ku vlerat më të larta tregojnë vlerësime më të mira për qeverisjen e një vendi. Në ecurinë e tij përgjatë segmentit kohor 1996-2012, vëmë re përmirësime në lidhje me perceptimin në lidhje me këtë fenomen edhe pse vlerësimi është negativ përgjatë gjithë kohës.




Figura 6.11: Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit për Shqipërinë 1996-2012

- Të drejtat politike dhe liritë civile

Nga pikëpamja e të drejtave politike e lirive civile, si një tregues i rëndësishëm i demokratizimit të një vendi, Freedom House prodhon vlerësime konkrete edhe për Shqipërinë. Të drejtat politike, në kuadrin e anketimit vjetor që Freedom House kryen, konsiderohen ato të drejta të cilat u mundësojnë njerëzve të marrin pjesë lirisht në procesin politik, duke përfshirë këtu të drejtën për të votuar lirisht ndërmjet disa alternativave, konkurrencën për poste publike, etj. Ndërsa, liritë civile përfshijnë lirinë e shprehjes dhe besimit, sundimin e ligjit, si dhe autonominë personale pa ndërhyrje nga ana e shtetit. Dhe pikërisht në lidhje me këto të drejta segmentimi i vlerave që marrin shtetet përkatësisht për të dy kategoritë e të drejtave është në shkallën nga 1 në 7; ku një vlerësim prej 1 tregon shkallën më të lartë të lirive, dhe një vlerësim prej 7 dëshmon për nivelin më të ulët të lirive për një vend.³⁴⁵ Grafikisht shohim se në rastin e Shqipërisë, në total kemi një rritje në nivelin e këtyre të drejtave përgjatë kohës dhe pse në dhjetëvjeçarin e fundit këto të drejta nuk kanë pësuar rritje të mëtejshme duke ngelur në nivelin 3. Gjithsesi ky është një nivel mesatar i statusit të këtyre të drejtave. Kjo, nga ana tjetër, konfirmon edhe një herë edhe kategorizimin e Shqipërisë si një vend me demokraci jo të konsoliduar apo të pjesshme. Ndryshe, sipas terminologjisë që përdor Freedom House, rasti i Shqipërisë përfshihet në kategorinë e vendeve pjesërisht të lira.

³⁴⁵ <https://freedomhouse.org/report/freedom-world-2012/methodology#.VWzMRc-qqko>




Figura 6.12: Liritë civile dhe të drejtat politike në Shqipëri sipas Freedom House

Përveç trajtimit dhe evidentimit të mësipërm të marrëdhënieve dhe ecurisë midis variablave për shtetet e për rastin konkret të Shqipërisë, e rëndësishme është të shohim vlerësimin konkret të tyre në raport me rritjen ekonomike dhe marrëdhëniet reale të ndërtruara në raport me të. Për këtë, më poshtë vijohet me prezantimin e gjetjeve nga testimi i të dhënave.

6.3 ANALIZA E REGRESIONIT PËR VËRTETIMIN E HIPOTEZAVE TË MODELIT DHE DISKUTIMI I TYRE

Paraqitja grafike e ecurisë së variablave në kohë e në raport me njëri-tjetrin për grupin e shteteve të marra në konsideratë në këtë punim nevojit gjithashtu edhe diskutimin e trajtimit e disa momente të veçanta e specifike të cilat u vunë re përgjatë pjesës së paraqitjes së të dhënave të karakterit përshkues. Natyrisht, ashtu siç e kemi theksuar edhe më sipër në trendet e ecurisë së variablave nën studim, rol luan jo vetëm konteksti i jashtëm, por edhe ai i brendshëm vendor. Kjo do të thotë se pavarësisht elementëve që përbashkësojnë tërësinë e shteteve gjeografikisht të identifikuar si Ballkani Perëndimor së jashtmi rol luan edhe konteksti vendor me përpjekjet e brendshme për demokratizim, si dhe politikat e ndryshme ekonomike për të garantuar rritjen.

Nën këtë logjikë mund të shohim disa momente që nevojitin trajtesë e diskutim të veçantë:

Së pari, nëse i referohemi variablit të rritjes ekonomike për grupin e shteteve të marra në studim, shteti i cili paraqet një devijancë fillestare në raport me trendin e përgjithshëm të ecurisë së këtij variabli është Bosnjë Hercegovina. Nëse i referohemi figurës 2.11 e cila paraqet grafikisht kurbat e rritjes së PBB-së për shtetet nën studim, vëmë re se që në fillim të periudhës, e më konkretisht në vitin 1996 rritja për këtë shtet ka qenë dukshëm më e lartë. Mirëpo nga vlerat mbi 80 % e rritjes në vitin 1996, në harkun kohor të tre viteve u mbërrit në një rritje prej vetëm afro 10% në vitin 1999. Kjo mund të shpjegohet nga një tërësi faktorësh të cilat mund t'i grupojmë në dy grupe: faktorë të jashtëm e të brendshëm. Ndër faktorët e jashtëm të cilat mendohet se kanë ndikuar në ecurinë e rritjes ekonomike është destabiliteti politik në rajon, e më konkretisht momenti kyç i kësaj situatë në këtë periudhë ka qenë lufta në Kosovë. Brenda këtij grupi faktorësh ndikim ka luajtur rënia e niveleve të mbështetjes ekonomike pas periudhës së luftës, kriza

ekonomike në botë, si dhe kushtet jo të favorshme klimaterike të cilat kanë ndikuar prodhimin bujqësor³⁴⁶. Ndërkohë, së brendshmi pjesa më e madhe e studiuesve evidenton faktorët të tillë si ecuria e ngadaltë e reformave si dhe vullnetin e klasës politike për të zbatuar ato, elemente të cilat kanë reflektuar këtë ndryshim në ecurinë e rritjes ekonomike.

Së dyti, një element tjetër interesant është ai i cili lidhet me ecurinë e variablit të investimeve. Dy momente të veçanta të cilat mund të identifikojmë për diskutim nëse i referohemi grafikut të ecurisë së këtij variabli i referohen Maqedonisë dhe Shqipërisë. Kështu, dukshëm mund të identifikohet rritja krahasimisht më e madhe e investimeve për shtetin maqedonas për periudhën ndërmjet viteve 2000-2002. Kjo natyrisht mund të trajtohet nisur nga logjika e përpjekjes së vendit në procesin tranzitor drejt një ekonomie të hapur së brendshmi, si dhe së jashtmi nga anëtarësimi i këtij shteti në OBT si dhe procesi i tij i integritimit në BE. Në pikëpamje të faktorit të brendshëm, elementë të cilët njihen ndërkombëtarisht për suksesin e fluksit të investimeve në vend janë sistemi i thjeshtë dhe i favorshëm i taksave, si dhe një administratë funksionale në dogana³⁴⁷. Angazhimi i këtij shteti në këtë periudhë pikërisht për përmirësimin e lehtësisë së të bërit biznes si dhe për përmirësimin e kuadrit ligjor, në këtë kontekst kanë dhënë rezultatet të cilat dëshmojnë për diferencën e konsiderueshme të investimeve në vend në raport me shtetet e tjera për periudhën e viteve 2000-2002.

Së treti, nëse i referohemi variablit të demokratizimit, edhe pse vëmë re ecuri stabël përgjatë kohës të shteteve të marra në konsideratë, përjashtim bën rasti i Kroacisë. E konsideruar si një nga shtetet më të zhvilluara të rajonit, tashmë anëtare e BE, Kroacia në ecurinë e indeksit të demokratizimit shihet se ka një devijancë të theksuar në raport me shtetet e tjera me një vlerësim negativ në rënie në vitin 1999. Këtë vlerësim mund ta shpjegojmë me ecurinë e zhvillimeve politike për Kroacinë në këtë periudhë kohore. Qeveria e Tuxhmanit në këtë periudhë kishte filluar të humbiste besimin e qytetarëve për shkak të disa marrëveshjeve privatizimi që ishin realizuar në vend në fillim të viteve 90' të cilat ishin jobindëse e të dyshimta. Jo vetëm kaq, por më pas edhe vdekja e kreut të qeverisë Tuxhman, çoi vendin drejt zgjedhjeve të reja. Nëse do të tentonim të projektonim ndikimin e këtyre zhvillimeve në sektorin ekonomik, do të prisnim që edhe ecuria e rritjes për Kroacinë në këtë vit të kishte një rënie të konsiderueshme. Në fakt nëse i referohemi paraqitjes grafike të ecurisë së rritjes së PBB-së për vendet e Ballkanit Perëndimor, në vitin 1999 Kroacia është shteti me rritjen më të vogël e më konkretisht pa rritje të PBBsë (0%), vit ky i cili konsiderohet si periudha e një recensionit apo depresionit ekonomik për vendin.

Pra, vëmë re se në momente të veçanta, për shkak të gërshetimit të faktorëve të jashtëm e të brendshëm, vendet e marra në konsideratë paraqesin devijanca të izoluara në raport me trendin e ecurisë së variablave në total për të gjitha shtetet. Në diskutimin e këtyre momenteve të veçanta, pamë gjithashtu se zhvillimet e caktuara në një aspekt të veçantë janë reflektuar edhe tek ecuria e variablit qendror, rritja e PBB-së. Megjithatë, se si ka

³⁴⁶ Stojanov, D., *Hungary and Bosnia Herzegovina: A Success and a failure of transition*, Working Papers, Nr. 149, Institute for World Economics, Hungarian Academy of Sciences, Budapest, 2004, fq 16-18.

³⁴⁷ Kombet e Bashkuara, *Investment Policy Review: The Former Yugoslav Republic of Macedonia*, Konferenca e Kombeve të Bashkuara mbi Tregëtinë dhe Zhvillimin, Nju Jork, 2012.

qenë kjo ecuri si dhe cili ka qenë roli që ka patur secili prej variablave të pavarur tek rritja ekonomike do e shohim në pjesën në vazhvim e cila identifikon e trajton momentet kryesore të testimit empirik.

Kështu, më poshtë punimi vazhdon me evidentimin e rezultateve konkrete në lidhje me testimin linear të variablave të pavarur dhe stabilitetit politik si kryesues i tyre në raport me variablin e varur rritjen ekonomike, dhe më konkretisht referuar modelit empirik të këtij punimi, rritjes së PBB-së. Trajtesa empirike u drejtua nga hipoteza kryesore e përgjithshme se performanca e sistemit ekonomik në terma të rritjes ekonomike për rastin e grup-shteteve të Ballkanit Perëndimor ndikohet edhe nga faktorë të karakterit politik. Pra, përveç ndikimit të pranuar gjerësisht në literaturën e shkencave ekonomike mbi rolin e faktorëve ekonomikë (investimet, shpenzimet qeveritare, liria ekonomike, etj) tek ecuria e rritjes ekonomike në një vend, hipoteza e përgjithshme paraqiti nevojën edhe të trajtimit e hulumtimit të rolit ndërhyrës që faktorë të karakterit politik mund të kenë tek rritja ekonomike. Dhe, në lidhje me këtë, mbështetur edhe tek literatura e ekonomisë politike të rritjes, faktorë të tjerë ndikues të supozuar në raport me rritjen përtej faktorëve endogjenë ekonomikë propozuam stabilitetin politik e bashkë me të nivelin e demokracisë në vend e korrupsionin.

Nga regresioni i ekuacionit kryesor të modelit për të testuar e parë rolin e këtyre variablave tek rritja e Produktit të Brendshëm Bruto, u përftua informacioni i mëposhtëm i paraqitur në tabelë:

Tabela 6.2: Regresioni i vlerësimit të rolit të grup variablave politikë tek rritja e PBB-së³⁴⁸

Rritja e PBB(së)	(1)	(2)	(3)	(4)
Shpenzimet Qeveritare	0.113228*	0.098265*	0.034253**	0.063232
	(0.0222134)	(0.043271)	(0.0022162)	(0.1153011)
Arsimimi	0.042372	0.0033217	0.1987644*	0.0023761
	(0.2387631)	(0.116729)	(0.0431765)	(0.1196541)
Investimet	0.247661*	0.3245874**	0.092422*	0.2116021**
	(0.0137623)	(0.0026231)	(0.0143624)	(0.0031421)
Demokracia	0.243353**	0.114982**	0.3105622**	-0.1176911*
	(0.0065324)	(0.0021331)	(0.0011324)	(0.0143671)
Liria ekonomike	0.035782	0.0001543	0.065534*	0.125644*
	(0.246846)	(0.4326411)	(0.0115423)	(0.15403321)
Stabiliteti Politik	-0.324527*	-0.254132*	-0.0324511	-0.231341***

³⁴⁸ Shënim: Numrat iu referohen secilit prej shteteve të marra në konsideratë në këtë studim, dhe më konkretisht nr.1 përkon me Shqipërinë, nr.2 përkon me Bosnjë Hercegovinën, nr.3 me Kroacinë dhe numri 4 me Maqedoninë.

	(0.034251)	(0.0117623)	(0.0011265)	(0.000986)
Korrupsioni	0.104252*	0.0043211**	-0.0352682*	0.067287*
	(0.0356321)	(0.0011532)	(0.01146011)	(0.0311241)
R ²	0.61324	0.6032	0.6213	0.6437
Nr. i observimeve	17	15	17	11
β ₀	5.234	9.341	6.5265	10.2466
Shënim: * 5% domethënie statistikore				
**10% domethënie statistikore				
***1% domethënie statistikore				
p - value (në kllapa)				

Ashtu si edhe në trajtimin e të dhënave përshkruese për grup-shtetet e marra në konsideratë në këtë studim, panorama që na paraqet testimi empirik për këto shtete evidenton dy linja kryesore: ekzistencën e një emëruesi të përbashkët në terma të logjikave kryesore që kanë variablat e pavarur me variablin e varur, si dhe evidentimin e marrëdhënieve specifike për kontekstet vendore në lidhjet midis disa variablave të pavarur me variablin e varur. Kështu, nëse shohim me radhë shtetet vëmë re se: për Shqipërinë një rol të rëndësishëm në ecurinë e rritjes ekonomike e ka stabiliteti politik me një koeficient prej -0.324527. Po kështu, një rol të konsiderueshëm shihet se luan edhe variabli i demokracisë koeficiente i të cilit është 0.243353. Nga ana tjetër mund të vëmë re se për grup-variablat e karakterit ekonomik, ashtu siç e thekson edhe literatura ekonomike, variablat investimet dhe shpenzimet qeveritare luajnë rol të rëndësishëm me një domethënie statistikore p-value < 5% respektivisht për secilin koeficient. Megjithatë, nëse i referohemi variablit të lirisë ekonomike e cila gjerësisht shihet si një vlerësues i mjedisit ekonomik në një kontekst të caktuar, e rrjedhimisht edhe stimuluese e aktivitetit ekonomik të tij, për rastin e Shqipërisë nuk shihet të luajë rol. Kjo padyshim ka shpjegimin e vet lidhur jo vetëm me faktin se vlerësimi treguesit të këtij variabli nuk është në vlerat e pëlqyeshme për këtë shtet, por edhe për shkak të procesit ende të papërfunduar, atij të krijimit të një ekonomie të hapur e të konsoliduar tregu. Kështu, nëse do i referohemi ekuacionit që prodhohet nga regresioni për këtë shtet, atëherë do të kishim: ‘rritja e PBB-së = 5.234 +0.113228 ‘shpenzime qeveritare’ +0.247661 ‘investime’ + 0.243353 ‘demokracia’ -0.324527 ‘stab. Politik’.

Nga ana tjetër, për Bosnjë Hercegovinën nga testimi empirik shohim se për këtë shtet, nëse iu referohemi grup-variablave politike, stabiliteti politik luan një rol të rëndësishëm me koeficient -0.254132 çka në raport me variablat e tjerë si demokracia e korrupsioni është relativisht më i lartë me domethënie statistikore të koeficientit p-value<5%. Kjo natyrisht, është e lidhur me kontekstin vendor, ku destabiliteti politik për shkak të konfliktit etnik si dhe shfaqjeve të herëpashershme të kësaj natyre konfliktesh prodhojnë një klimë e cila ndikon edhe tek ecuria e aktivitetit ekonomik, dhe padyshim tek rritja e PBB-së. Ndërsa, përsa i përket variablit të demokracisë dhe atij të korrupsionit evidentojmë koeficientët 0.114982 dhe 0.0043211 (p-value për të dy koeficientët <10%). Për më tepër, nga pikëpamja e grup-variablave ekonomike, mund të vëmë re se po ashtu statistikisht domethënës janë edhe variablat investimet si dhe shpenzimet qeveritare ku p-value<5% dhe 10 %.

Ndërsa, nëse i referohemi rastit të Maqedonisë shohim se variabli i stabilitetit politik, e po ashtu ai i demokracisë, respektivisht me koeficientë -0.231341 dhe -0.1176911 luajnë rol të rëndësishëm në ecurinë e rritjes ekonomike, e më konkretisht rritjes së PBB-së me një domethënie statistikore të koeficientëve respektivisht 1% dhe 5%. Nga ana tjetër, vihet re përsa u përket investimeve, arsimimit e shpenzimeve qeveritare, variabla të parë të lidhur me rritjen ekonomike të një vendi, shohim se në këtë aspekt rolin kryesor e luajnë investimet koeficienti i të cilave është 0.2116021 me një domethënie statistikore 10%. Rrjedhimisht, në këtë rast ekuacioni në lidhje me këtë shtet do të ishte: ‘*rritja e PBB-së*’ = $10.2466 + 0.2116021I - 0.1176911 \text{ democ} + 0.125644 \text{ ‘lecon’} + 0.231341 \text{ ‘stab pol’} - 0.067287 \text{ ‘corrup’}$.

Së fundmi, shohim rezultatet e testimit empirik për rastin e Kroacisë (tashmë vend anëtar i BE), një prej vendeve që në pikëpamje të ecurisë së të gjithë variablave është në një progres më të diferencuar në raport me shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Kështu, është interesante të shohim nga rezultatet se për këtë shtet variabli i pavarur i demokracisë është jo vetëm domethënës në shpjegimin e variablit të varur (me koeficient 0.3105622), por në pikëpamje të koeficientëve është krahasimisht më i madh sesa koeficienti i stabilitetit politik, i cili dukshëm për këtë shtet nuk shihet të ketë rol të theksuar në shpjegimin e ecurisë së PBB-së së vendit. Nga ana tjetër, korrupsioni, koeficienti i të cilit ndryshe nga shtetet e tjera është negativ, shihet të luajë rol të në shpjegimin e variablit të varur me një koeficient -0.0352682 dhe domethënie statistikore të tij $p\text{-value} < 5\%$. Po kështu, padyshim nëse u referohemi grup-variablave ekonomike, vëmë re se investimet e lira ekonomike luajnë rol domethënës në shpjegimin e trendeve të rritjes së PBB-së së vendit me koeficientë përkatësisht 0.2116021 dhe 0.125644 e $p\text{-value} < 10\%$ dhe 5% .

Një element interesant në këtë analizë është variabli i korrupsionit i cili për pjesën më të madhe të shteteve paraqet shenjë pozitive. Logjikisht do të prisnim që korrupsioni të ndikonte në një mënyrë të caktuar trendin e rritjes së PBB-së por duke ndikuar negativisht në ecurinë e saj. Në fakt, shenja pozitive e këtij variabli mund të shpjegohet me lehtësimin e ndërveprimit ekonomik e përmbushjes së objektivave të agjentëve të ndryshëm në afatshkurtër pikërisht nëpërmjet përdorimit të këtij instrumenti. Në fakt, nëse i referohemi edhe literaturës në një pjesë të vendeve në zhvillim, duket se shfaqet e njëjta tendencë.

Pra në përgjithësi mund të vëmë re se:

Nëse i referohemi variablit kryesor të pavarur, atij të stabilitetit politik (StabPol), shohim se ky variabël ka një ndikim statistikisht të rëndësishëm. Në pikëpamje të kahut pozitiv ose negativ të këtij ndikimi mund të shohim një ndikim negativ. Kjo shpjegohet me faktin se të dhënat e grumbulluara në lidhje me stabilitetin politik janë ato të prodhura nga Banka Botërore e më specifiku në kuadër të treguesve botërorë të mirëqeverisjes (WGI). Kjo, sepse BB vlerëson nivelin e destabilitetit politik në vend. Kjo do të thotë se në pikëpamje të rezultateve, destabiliteti politik ndikon negativisht tek rritja ekonomike. Nivele të larta të këtij variabli prezente në vendet e Ballkanit Perëndimor të marra në konsideratë nga studimi, në periudha të shkurtra kanë prodhuar tendenca rënie të rritjes së

PBB-së, ndërkohë që përmirësimet e tij kanë ndikuar në një mesatare të përgjithshme në përmirësimin e rritjes së PBB-së.

Kjo, është konfirmuese edhe e logjikës se prezenca e destabilitetit politik, krijon një mjedis jo fort të sigurt politik e ekonomik, çka frenon sipërmarrjen, investimet e interesin e agjentëve të ndryshëm ekonomikë për tu angazhuar në sektorin ekonomik.

Në lidhje me ndikimin e mundshëm të variablit të pavarur *democ* (demokracia) shohim se ky variabël pozicionohet si statistikisht i rëndësishëm. Pra, mund të shohim se demokracia si variabël i rëndësishëm i sistemit politik ndikon gjithashtu në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe sistemin ekonomik, nëpërmjet ndikimit të saj tek rritja ekonomike. Kahu i ndikimit të këtij variabli është pozitiv, në kuptimin që një sistem demokratik i konsoliduar dhe i zhvilluar nxit rritjen ekonomike të vendit. Kjo gjithashtu, vjen si rezultat edhe në përputhje me një linjë të rëndësishme të literaturës mbi rritjen e cila vlerëson ndikimin pozitiv të faktorëve politikë siç është demokracia tek rritja ekonomike. Ndikimi i saj pozitiv tek rritja e PBB-së në rastin e këtij studimi (variabël nëpërmjet të cilit është kuantifikuar koncepti i rritjes ekonomike), gjen shpjegimin tek ecuria e reformave demokratike në pikëpamje të konsolidimit të sistemit institucional, një frymë demokratike në funksionimin e tij si dhe një perceptimi, qëndrimi dhe bindjeje pozitive ndaj efektshmërisë së sistemit politik, frymë kjo e cila reflektohet edhe në sistemin ekonomik e veçanërisht tek rritja ekonomike.

Nëse i referohemi variablit tjetër të karakterit politik, korrupsionit, mund të themi se për këtë variabël prezantohet një ndikim relativisht i rëndësishëm tek rritja në disa shtete. Ky ndikim me kah pozitiv është tipik për rastin e vendeve në zhvillim. Nga ana tjetër është konfirmuese edhe e logjikës teorike ku dorëzania apo rryshfeti në sketorin publik, në vendet në zhvillim, shpesh shihen si lehtësues në përfundimin e procedurave në një kohë të shkurtër duke nxitur kështu efikasitetin e ndërveprimeve ekonomike.

- Nga ana tjetër nëse u referohemi grup faktorëve të karakterit ekonomik, variablat si arsimit, shpenzimet qeveritare e investimet kanë ndikim pozitiv tek variabli i varur i rritjes ekonomike. Kjo, padyshim ecën paralelisht me teorinë ekonomike të rritjes sipas së cilës investimet në kapitalin njerëzor e fizik si dhe konsumi qeveritar prodhojnë terrenin e ecurisë pozitive të PBB-së në një vend.

Po kështu, një pjesë e rëndësishme e testimit empirik është edhe vlerësimi i ekuacioneve ndihmëse të regresionit. Ato, ashtu siç është përmendur më sipër tentojnë të ofrojnë një panoramë të përgjithshme, jo vetëm të ndikimit të drejtpërdrejtë të stabilitetit politik e demokracisë tek rritja, por edhe të ndikimit të tërthortë të këtyre variablave të rëndësishëm të sistemit politik tek grup-variablat ekonomikë. Kështu, shohim se stabiliteti politik apo mungesa e tij (destabiliteti politik), ndikon jo vetëm në mënyrë të drejtpërdrejtë por edhe tërthorazi tek rritja e PBB-së nëpërmjet ndikimit të tij tek shpenzimet dhe investimet.

Po kështu edhe nga pikëpamja e demokracisë, shohim se ndikimi i saj është jo vetëm në mënyrë të drejtpërdrejtë tek rritja e PBB-së, cka përkon me ekuacionin e parë të modelit të regresionit, por edhe në mënyrë jo të drejtpërdrejtë. Pra, shohim se demokracia ndikon

tërthorazi rritjen ekonomike nëpërmjet ndikimit të saj tek shpenzimet qeveritare e investimet.

Një çështje interesante kur vihen nën shqyrtim marrëdhënie ndërmjet sistemeve të ndryshme, siç është ajo ndërmjet sistemit ekonomik dhe atij politik, është përpjekja për të parë nëse grup-variablat e karakterit politik ndikojnë në mënyrë të tërthortë variablin e pavarur nëpërmjet ndikimit të tyre tek variablat e karakterit ekonomik siç janë investimet, shpenzimet qeveritare, apo arsimi. Natyrisht, literatura ekonomike i sheh këta elementë si domethënës në ecurinë e rritjes ekonomike, mirëpo këta variabla nga ana tjetër, edhe ata vetë janë një shumatore e ndikimeve të karakterit ekonomik dhe atij politik. Këtë element të fundit ne e shohim nëpërmjet ekuacioneve ndihmëse të cilat për secilin nga shtetet tentojnë të prodhojnë logjikën e ndikimit të mundshëm të faktorit politik tek to.

Kështu, tabela e mëposhtme vlerëson ndikim e tërthortë të mundshëm të variablave të karakterit politik tek variabli i investimeve. Siç mund ta shohim, stabiliteti politik duket të ketë ndikim tek investimet, po ashtu edhe niveli i demokratizimit të një vendi. Kështu, vëmë re se për pjesën më të madhe të vendeve stabiliteti politik duket se ndikon rritjen me koeficientët e përkatës si më poshtë, nëpërmjet ndikimit të tij tek investimet. Ky është një ndikim negativ, sepse ashtu siç e kemi theksuar më sipër si tregues në regression është marrë indeksi i destabilitetit politik. Sërisht këtu kemi konfirmimin e logjikës nga korpusi teorik se prezenca e stabilitetit politik, krijon një mjedis të sigurt politik e ekonomik, çka nxit sipërmarrjen, investimet e interesin e agjentëve të ndryshëm ekonomikë për tu angazhuar në sektorin ekonomik. Nga ana tjetër, lidhjen e variablit të demokracisë me investimet e shpjegojmë me ato që quhen ‘themele’ të demokracisë. Më konkretisht, një demokraci si themel të saj në mënyrën e rregullimit të aktivitetit ekonomik ka kapitalizmin, pra tregun e hapur e të lirë. Rrjedhimisht, demokratizimi do të pritej të ndikonte pozitivisht në rritjen e investimeve, sepse synon nga pikëpamja e rregullimit të sektorit ekonomik, një ekonomi të hapur.

Tabela 6.3: Regresioni i ekuacionit ndihmës me variabël të varur investimet

I	(1)	(2)	(3)	(4)
Demokracia	0.101321*	0.02856311*	0.123561***	0.224673*
	(0.04325)	(0.031256)	(0.0008651)	(0.0482341)
Liria ekonomike	0.0453217	0.0024157	0.098231	0.089432
	(0.21453)	(0.453217)	(0.3214514)	(0.3421561)
Stabiliteti politik	-0.256842**	-0.2126722*	-0.112561**	0.34789
	(0.009832)	(0.0398721)	(0.0082315)	(0.629873)
Korrupsioni	0.056378	0.0034255	-0.021467	0.0498721
	(0.439761)	(0.865321)	(0.245613)	(0.896273)
R ²	0.613245	0.601325	0.598782	0.583213
Nr. i observimeve	17	15	17	11

β_0	-0.564711	-0.547311	-0.27689	0.985643
Shënim: * 5% domethënia statistikore				
**10% domethënia statistikore				
***1% domethënie statistikore				
p - value (në kllapa)				

Nëse i referohemi ekuacionit të dytë ndihmës për të parë ndikime të mundshme të tërthorta të grup-variablave të karakterit politik tek variabli i shpenzimeve qeveritare, shohim se variabli kryesor i cili duket se ka një ndikim tek rritja e PBB-së në mënyrë të tërthortë është variabli i demokracisë dhe stabilitetit politik. Në fakt, ky rezultat shpjegohet edhe nën perspektivën e funksionimit të demokracive të sotme. Një pjesë e konsiderueshme e literaturës vlerëson se në demokraci, synimi kryesor i mbajtjes apo fitimit të pushtetit, mbështetet nga angazhimi i qeverisë brenda sistemit social nëpërmjet shpenzimeve publike, për të fituar kështu mbështetjen e qytetarëve. Politika këto të cilat gjejnë zbatueshmëri në kontekstin e një klime politikisht të qetë e stabël (nëse i referohemi edhe lidhjes me logjikën e stabilitetit politik).

Tabela 6.4: Regresioni i ekuacionit ndihmës me variabël të varur shpenzimet qeveritare

GE	(1)	(2)	(3)	(4)
Demokracia	0.313426** (0.081234)	0.230671* (0.0327891)	0.0334511*** (0.0004321)	0.1043298* (0.0112458)
Liria ekonomike	0.0213451 (0.6734251)	0.342311* (0.0421457)	0.0134277 (0.2367823)	0.087534 (0.2387534)
Stabiliteti politik	-0.2321904* (0.0321781)	-0.134671** (0.0032451)	-0.246721* (0.0213481)	-0.175521** (0.0023411)
Korrupsioni	0.3421454 (0.5639021)	0.087354 (0.4367194)	-0.245312 (0.7263511)	0.3675321 (0.4578324)
R ²	0.5873	0.6023	0.5921	0.5921
Nr. i observimeve	17	15	17	11
β_0	15.3452	13.8751	5.6723	8.3527
Shënim: * 5% domethënia statistikore				
**10% domethënia statistikore				
***1% domethënie statistikore				
p - value (në kllapa)				

Së fundmi, në pikëpamje të variablit të arsimit, si një element i rëndësishëm stimulues i rritjes së kapitalit human në një vend, shohim se grup-variablat politikë në pikëpamje të këtij variabli kanë një ndikim të ndjeshëm domethënës nëpërmjet lirisë ekonomike dhe stabilitetit politik. Në fakt, stabiliteti politik nisur edhe nga baza teorike shihet si një faktor me rol në nxitjen e arsimit, kjo edhe për shkak të mundësisë që i ofrohet

qeverisë (në kontekstin e një situatë të qetë politikisht) për tu angazhuar në politikat arsimore. Nga ana tjetër, është interesant edhe rezultati në lidhje me lirinë ekonomike, e cila në pjesën më të madhe të vendeve ka një rol ndikues domethënës tek arsimimi, çka nënkupton se rritja apo përmirësimi i niveleve të lirisë ekonomike për këto vende, pritet të nxisë rritjen e variablit të arsimit.

Tabela 6.5: Regresioni i ekuacionit ndihmës me variabël të varur arsimin

Edu	(1)	(2)	(3)	(4)
Demokracia	0.027512 (0.2312762)	0.572731 (0.335791)	0.345611 (0.321667)	0.534523 (0.9825241)
Liria ekonomike	0.103621** (0.0089325)	0.20565* (0.0126532)	0.0136711* (0.0324155)	0.213462*** (0.0007625)
Stabiliteti politik	0.267891* (0.0342511)	0.221488 (0.061143)	0.0421356* (0.0487624)	0.221445** (0.003521)
Korrupsioni	0.329812 (0.6546341)	0.034211 (0.4579201)	0.4321155 (0.5421781)	0.3248562 (0.652177)
Nr. i observimeve	17	15	17	11
β_0	6.25146	11.23476	8.45342	12.3332
Shënim: * 5% domethënia statistikore **10% domethënia statistikore ***1% domethënie statistikore p - value (në kllapa)				

KAPITULLI 7

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Në këtë kapitull të fundit prezantohen përfundimet e studimit të ndërmarrë në lidhje me analizën e statusit të marrëdhënies që ekziston ndërmjet stabilitetit politik e variablave të tjerë politikë në raport me rritjen ekonomike në hapësirën e vendeve të Ballkanit Perëndimor, si vende me të cilat shihet edhe krahasueshmëria e zhvillimeve të brendshme ekonomiko-politike shqiptare.

Të përqendruara në këtë tematikë të veçantë, me qëllimin kryesor të evidentimit, analizimit dhe testimit të natyrës së marrëdhënies të sipërpërmendur, kapitulli prezanton përfundimet e studimit si dhe disa rekomandime që derivojnë nga përfundimet e tij. Për këtë, në pjesën e parë të kapitullit identifikohen përfundimet që lidhen me studimin e ndërmarrë të ndara në dy linja kryesore: grup-përfundime të një karakteri të përgjithshëm, evidentuar edhe nga rishikimi i literaturës, dhe një grup-përfundimesh të prodhuara nga rezultatet specifike të testimit empirik për rastin e grup-vendeve të Ballkanit Perëndimor. Ndër këto të fundit, prezantohen përfundimet që dëshmojnë për statusin e hipotezave të përgjithshme të studimit dhe atyre specifike (operacionale) në lidhje me natyrën e marrëdhënies së variablave të veçantë me njëri-tjetrin.

Për më tepër, nisur edhe nga natyra e përfundimeve, kapitulli finalizohet me disa rekomandime tentative përsa i përket rregullimeve ekonomiko-politike të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Ato shihen në kuadrin e perspektivave zhvillimore të sistemeve politike e ekonomike përkundrejt elementëve apo fenomeneve të veçanta (të cilat në këtë studim marrin statusin e variablave), si: stabiliteti politik apo mungesa e tij, rritja ekonomike, investimet, shpenzimet qeveritare, niveli i demokratizimit, korrupsioni, etj. Natyrisht, ky studim nuk është shterues përsa i përket fushës studimore në të cilën përqendrohet. Duke marrë në konsideratë edhe mungesën e konsiderueshme të studimeve të mirëfillta për këtë kategori vendesh nën logjikën e ekonomisë politike të rritjes, mendojmë se studime të tjera të karakterit empirik mund të ndërmerren për të testuar fenomene e elemente të tjerë të sistemit politik që ndërhyjnë në trendet e rritjes ekonomike të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Rrjedhimisht, kapitulli mbyllet edhe me prezantimin e kufizimeve të studimit.

7.1. PËRFUNDIME TË PËRGJITHSHME TEORIKE

Në këtë punim u tentua të hidhej dritë mbi dy elementë të rëndësishëm të sistemit ekonomik dhe atij politik në marrëdhënie me njëri-tjetrin: stabilitetin politik nga njëra anë, dhe rritja ekonomike nga ana tjetër. Vlerësuam se, në kuadrin e teorisë ekonomike të rritjes si dhe ekonomisë politike të rritjes, koncepti i politizimit të rritjes ekonomike ka prodhuar së fundmi të tjera dinamika studimore akoma më vertikale në lidhje me trendet zhvillimore të grup-shteteve të caktuara apo të një shteti të veçantë.

Është pikërisht koncepti i zhvillimit ai që është vendosur edhe në qendër të axhendës së politikave rajonale e botërore, sidomos pas viteve 90'. Vendet e Ballkanit Perëndimor, të përfshira në këtë proces ndryshimesh ekonomiko-politike, përfaqësojnë një rast studimor të vlefshëm dhe të rëndësishëm për të parë se si zhvillimi ekonomik, i vlerësuar nëpërmjet rritjes ekonomike, në nivelin mikro (shtetëror) ndikohet edhe nga faktorë të tjerë të karakterit politik, të cilët më parë janë përjashtuar nga modelet tradicionale të rritjes ekonomike. Në këtë kontekst, janë disa vështrime të përgjithshme tek të cilat mbërrijmë në kuadër të argumentave teorikë.

Së pari, hulumtimi i kontributeve teorike në përkufizimin e fenomenit të destabilitetit politik evidenton një shumëllojshmëri formash e elementësh nëpërmjet së cilave ai shfaqet, dhe rrjedhimisht vështirësi për të mbërritur në një konsensus të përgjithshëm përsa i përket përkufizimit. Duke përmbledhur kontributet e studiuesve të fushës në këtë aspekt, mund të pranojmë se destabilitetin politik e shohim si një fenomen brenda një konteksti të caktuar social-shtetëror, ku përgjatë një periudhe të caktuar kohore prodhohen shfaqje të ndryshme të dhunës, të cilat mund të reflektohen në kabinetin qeveritar e më gjerë në strukturimin e sistemit politik të një vendi. Duke qenë i lidhur ngushtësisht me kontekstin vendor dy elementë të tjerë përcaktues të tij janë ndryshueshmëria në kohë dhe ndryshueshmëria ndërmjet vendeve (në hapësirë).

Së dyti, edhe nga pikëpamja e treguesve nëpërmjet së cilave mundësohet operacionalizimi i konceptit të destabilitetit politik (i cili merr një rëndësi të veçantë sidomos në analizat sasiore të këtij fenomeni) mund të mbërrijmë në disa përfundime të përgjithshme. Kështu, shohim se një sistem politik shfaq stabilitet në kontekstin e kapaciteteve të larta politike, partive politike të institucionalizuara, shpërndarjes së barabartë të së ardhurave e normës së lartë të rritjes ekonomike. Ndërsa, një sistem politik që identifikohet me prezencë të destabilitetit politik i mungojnë elementët e mësipërm, dhe shfaqet apo treguesit të cilët prodhojnë vlerësime të tilla të destabilitetit politik janë: krizat qeveritare, grushtet e shtetit, revolucionet, demonstratat anti-qeveritare, rebelimet (trazirat), grevat e përgjithshme, luftat guerilase, spastrimet e vrasjet politike.

Paralelisht me shfaqjet dhe treguesit operacionalizues të konceptit të destabiliteti politik, në kuadrin e këtij studimi është mundësuar edhe një analizë hulumtuese dhe përmbledhëse e indekseve të prodhuara ndërkombëtarisht në lidhje me kuantifikimin e këtij fenomeni e përdorimin e tij për analizat sasiore. Nëse realizojmë një vlerësim paralel nëpërmjet kategorizimit të indekseve të stabilitetit politik dhe përkufizimit fillestar të marrë në konsideratë për këtë fenomen nga institucionet apo projektet që prodhojnë indekset, vëmë re se qasja kryesore që mbizotëron në ndërtimin e këtyre indekseve është të parit e konceptit të stabilitetit politik kryesisht nëpërmjet ekzistencës apo jo të

shfaqjeve të dhunshme në një vend të caktuar. Kjo reflektohet nga treguesit kryesorë të përdorur në ndërtimin e indekseve nga institucionet apo projektet e ndryshme. State Fragility Index, PITF, Peace and Conflict Instability Ledger dhe Country Indicators for Foreign Policy: Failed and Fragile States, Stabiliteti Politik dhe Mungesa e Dhunës, në ndërtimin e indeksit të stabilitetit politik vlerësojnë sigurinë ndër treguesit kryesorë. Qasja tjetër mbizotëruese është ajo e përqëndrimit tek një konceptim i stabilitetit politik kryesisht i bazuar në karakteristikat e sistemit politik të një vendi në pikëpamje të legjitimitetit, institucioneve, elitave e elementë të tjerë brenda sistemit.

Nga ana tjetër, rritja ekonomike, si një tregues i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik të një vendi, e parë në kuadrin e teorisë ekonomike të rritjes nuk mund të vlerësohet e izoluar vetëm brenda sistemit ekonomik. Në këtë kontekst, nëse do t'i referoheshim kategorisë së vendeve në zhvillim, dhe më specifiku të vendeve të Ballkanit Perëndimor, edhe për ta shpjegimi i dinamikave të zhvillimit ekonomik nevojitet të shihet i ndërlidhur me zhvillimet politike dhe me elementë apo fenomene specifike brenda këtyre zhvillimeve, siç janë: stabiliteti politik apo mungesa e tij, niveli i demokratizimit, korrupsioni, etj.

Në funksion të kësaj, së fundmi, në kuadrin e vlerësimeve të përgjithshme të karakterit teorik, disa elementë të rëndësishëm mund të identifikojmë në lidhje edhe me grupin e shteteve të marra nën studim.

Kështu, nga trajtesa teorike e punimit pamë se në kontekstin e procesit të modernizimit, dy nga tendencat më të cilat identifikohet ky i fundit janë procesi i demokratizimit dhe zhvillimi ekonomik. Të para në lidhje me njëra-tjetrën këto tendenca do të shpjegoheshin në këtë mënyrë: vende të cilat karakterizohen nga nivele të larta të proceseve modernizuese, dhe rrjedhimisht nivele të larta të zhvillimit ekonomik, do të jenë më të qëndrueshme e stabël politikisht. Më konkretisht, për vendet e Ballkanit Perëndimor, vlerësimet renditëse në lidhje me aspekte të veçanta të procesit të demokratizimit prezantojnë panoramën e një grupi vendesh ende larg demokracive të konsoliduara të shteteve të zhvilluara.

Ndërsa, nëse do të tenonim të strukturoni zhvillimet e sektorit ekonomik në periudha më specifike në këtë grup vendesh, do të evidentonim tre të tilla. Periudha e parë përkon me periudhën e ndryshimeve të karakterit politik, kryesisht ndryshimit të formës së regjimit, periudhë në të cilën sektori ekonomik u përball me sfida të shumta. Ashtu si në sistemin politik, sistemi ekonomik i këtyre vendeve iu nënshtrua ndryshimeve thelbësore të mënyrës së organizimit e funksionimit. Në një periudhë të mëvonshme, pas ndryshimeve politike e ekonomike të cilat përfaqësuan kalime të rëndësishme nga një format organizimi tek tjetri (kryesisht në vitet 2000'), vendet e Ballkanit filluan të shfaqin tregues makroekonomikë në rritje, e ndër to më kryesorja ishte rritja ekonomike të qëndrueshme. Kështu, rritja mesatare e PBB-së për rajonin e vendeve të Ballkanit Perëndimor sipas BB përlloritej rreth 5.7%. Së fundmi, periudha e tretë e zhvillimeve ekonomike të rajonit do të përkonte me krizën financiare e cila u shfaq në gjysmën e dytë të vitit 2007, dhe që e shfaqti ndikimin e saj në ekonominë e vendeve të Ballkanit e sidomos ato të Ballkanit Perëndimor vetëm rreth fundit të vitit 2008. Ajo u shoqërua me një dobësim të aktivitetit ekonomik, e ngadalësim të mëtejshëm të rritjes ekonomike të këtyre vendeve, dhe regjistrimet e rritjes ekonomike pozitive filluan vetëm pas vitit 2011.

7.2 PËRFUNDIME PRAKTIKE TË STUDIMIT

Nga pikëpamja praktike vumë re se për vendet e Ballkanit Perëndimor të marra në konsideratë ecuria e variablave të përfshira në studime në të njëjtat linja në pjesën më të madhe të kohës. Megjithatë, në raste të caktuara evidentoheshin devijanca nga trendi i përgjithshëm për shtete të veçanta. Natyrisht, ashtu siç e trajtuam, kjo vjen si pasojë e ndikimit që në momente të caktuara kanë faktorët e brendshëm kontekstualë në gërshetim edhe me mjedisin ndërkombëtar. Kështu për shembull, ecuria tepër e lartë e investimeve për rastin e Maqedonisë në vitet 2000' u trajtua jo vetëm si rezultat i përpjekjeve të këtij vendi drejt krijimit të një ekonomie tregu, por edhe si rezultat i anëtarësimit të saj në OBT, si dhe procesit të integritimit në Bashkimin Evropian.

Jo vetëm kaq, por diferencat e evidentuara në momente të veçanta për fenomene të cilat në kuadrin e testimit empirik janë përfshirë si pjesë e variablave të pavarur, janë reflektuar edhe tek diferenca në trendin e përgjithshëm të variablit të varur, rritjes së Produktit të Brendshëm Bruto. Kështu, nëse vumë re luhatje apo vlerësim negativ nga indeksi i Polity IV në lidhje me demokratizimin, vumë re se ecuria politike prodhonte ndikimet e saj edhe te rritja e PBB (rasti i Kroacisë).

Kështu, nëse risjellim në vëmendje hipotezën e përgjithshme të studimit si dhe hipotezat specifike (të mbështetura nga analiza teorike si dhe analiza e të dhënave përshkruese) nëpërmjet testimit empirik të tyre vumë re se:

Nëse i referohemi variablit kryesor të pavarur, atij të stabilitetit politik (StabPol), shohim se ky variabël ka një ndikim statistikisht të rëndësishëm. Në pikëpamje të kahut pozitiv ose negativ të këtij ndikimi mund të shohim një ndikim negativ. Kjo shpjegohet me faktin se të dhënat e grumbulluara në lidhje me stabilitetin politik janë ato të prodhura nga Banka Botërore e më specifiku në kuadër të treguesve botërorë të mirëqeverisjes (WGI). Kjo, sepse BB vlerëson nivelin e destabilitetit politik në vend. Kjo do të thotë se në pikëpamje të rezultateve, destabiliteti politik ndikon negativisht tek rritja ekonomike. Nivele të larta të këtij variabli prezente në vendet e Ballkanit Perëndimor të marra në konsideratë nga studimi, në periudha të shkurtra kanë prodhuar tendenca rënie të rritjes së PBB-së, ndërkohë që përmirësimet e tij kanë ndikuar në një mesatare të përgjithshme në përmirësimin e rritjes së PBB-së.

Kjo, është konfirmuese edhe e logjikës se prezenca e destabilitetit politik, krijon një mjedis jo fort të sigurt politik e ekonomik, çka frenon sipërmarrjen, investimet e interesin e agjentëve të ndryshëm ekonomikë për tu angazhuar në sektorin ekonomik.

Në lidhje me ndikimin e mundshëm të variablit të pavarur *democ* (demokracia) shohim se ky variabël pozicionohet si statistikisht i rëndësishëm. Pra, mund të shohim se demokracia si variabël i rëndësishëm i sistemit politik ndikon gjithashtu në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe sistemin ekonomik, nëpërmjet ndikimit të saj tek rritja ekonomike. Kahu i ndikimit të këtij variabli është pozitiv, në kuptimin që një sistem demokratik i konsoliduar dhe i zhvilluar nxit rritjen ekonomike të vendit. Kjo gjithashtu, vjen si rezultat edhe në përputhje me një linjë të rëndësishme të literaturës mbi rritjen e cila

vlërëson ndikimin pozitiv të faktorëve politikë siç është demokracia tek rritja ekonomike. Ndikimi i saj pozitiv tek rritja e PBB-së në rastin e këtij studimi (variabël nëpërmjet të cilit është kuantifikuar koncepti i rritjes ekonomike), gjen shpjegimin tek ecuria e reformave demokratike në pikëpamje të konsolidimit të sistemit institucional, një fryme demokratike në funksionimin e tij si dhe një perceptimi, qëndrimi dhe bindjeje pozitive ndaj efektshmërisë së sistemit politik, frymë kjo e cila reflektohet edhe në sistemin ekonomik e veçanërisht tek rritja ekonomike.

Nëse i referohemi varablit tjetër të karakterit politik, korrupsionit, mund të themi se për këtë variabël prezantohet një ndikim relativisht i rëndësishëm tek rritja në disa shtete. Ky ndikim me kah pozitiv është tipik për rastin e vendeve në zhvillim. Nga ana tjetër është konfirmuese edhe e logjikës teorike ku dorëzania apo rryshfeti në sketorin publik, në vendet në zhvillim, shpesh shihen si lehtësues në përfundimin e procedurave në një kohë të shkurtër duke nxitur kështu efikasitetin e ndërveprimeve ekonomike.

- Nga ana tjetër nëse u referohemi grup faktorëve të karakterit ekonomik, variablat si arsimi, shpenzimet qeveritare e investimet kanë ndikim pozitiv tek variabli i varur i rritjes ekonomike. Kjo, padyshim ecën paralelisht me teorinë ekonomike të rritjes sipas së cilës investimet në kapitalin njerëzor e fizik si dhe konsumi qeveritar prodhojnë terrenin e ecurisë pozitive të PBB-së në një vend.

Në përmbyllje të rezultateve tek të cilat mbërrin ky punim dhe duke parë nga e ardhmja, mund të themi se për rastin e këtyre vendeve të Ballkanit Perëndimor (si Shqipëria, Bosnjë Hercegovina, Maqedonia, Kroacia), strategjitë kryesore të politikave duhet të jenë strategji rritjeje. Kjo lidhet sigurisht me rëndësinë që ka për një ekonomi shtetërore rritja e cila nëpërmjet përmirësimit të kushteve të jetesës, reflekton ndryshime pozitive edhe në tregues të rëndësishëm të sistemit social në një vend.

7.3 REKOMANDIME

Si ekonomia politike empirike dhe ajo teorike konfirmuan faktin se më shumë stabilitet çon drejt ritmeve më të larta të rritjes ekonomike. Prej këtij përfundimi të përgjithshëm e rezultateve të tjera të evidentuara më sipër, si më poshtë po prezantojmë edhe disa rekomandime tentative përsa i përket çështjes studimore të këtij punimi:

- Evidentimi i marrëdhënieve të testuara në modelin empirik dhe fortësia e tyre, shtron nevojën nga ana e politikëbërësve për fokusimin në politika të cilat kanë si objektiv kryesor eliminimin faktorëve që në mënyrë të drejtpërdrejtë pengojnë rritjen. Në mënyrë të veçantë, në kuadrin e faktorëve politikë rol kryesor luan stabiliteti politik, i cili nevojitet të kuptohet e të bëhen përpjekje që nëpërmjet një kulture kompromisi, bashkëpunimi e bisedimi të eliminohen polaritetet e qëndrimeve dhe shfaqjet destabilizuese të tyre.
- Ashtu, siç e pamë nga rezultatet e prodhuara nga modeli empirik shihet nevoja e përqendrimit në politika ekonomike të cilat të nxisin ritmin e investimeve për të çuar drejt një rritjeje të qëndrueshme. Natyrisht, aty ku politika tenton të jetë jostabël, e mbështetur tek konflikti, tek mungesa e besueshmërisë dhe dobësia e

institucioneve, arritja e një niveli të caktuar investimesh përbën një sfidë e cila duhet të kapërcehet nga politikëbërësit³⁴⁹.

- Nga ana tjetër, këto politika nuk duhet të jenë të një karakteri të gjerë e të përgjithshëm, por të mirë orientuara dhe specifikuar drejt eliminimit të pengesave ndaj rritjes (destabiliteti politik, korrupsioni, nivelet e ulëta të investimeve, etj).
- Megjithatë, pavarësisht nevojshmërisë për ndërmarrjen e politikave të tilla, në ndërtimin dhe zbatimin e tyre, është e nevojshme edhe marrja në konsideratë e elementit të ‘besueshmërisë’. Në fakt, ky koncept neo-klasik makroekonomik, në aplikimin e tij në vende të cilat iu nënshtruan një ndryshimi të thellë socio-politik të tilla si Shqipëria apo vende të tjera të Ballkanit Perëndimor, ka nevojë të shihet me kujdes. Kjo, për shkak të mungesës së besimit në jetëgjatësinë e institucioneve, mungesës së besimit në zbatueshmërinë e politikave, mungesës së besimit në shërbimin e tyre afatgjatë, etj.
- Kështu, duke iu referuar qëllimit të përgjithshëm makroekonomik të vendeve të Ballkanit Perëndimor, atij të mbërritjes tek një rritje e qëndrueshme dhe një mjedis makroekonomik stabël, pika e kthesës (apo e ndryshimit) në këtë kontekst, mendojmë se përfaqësohet nga përmbushja e kushteve të identifikura edhe nga modeli: prezenca e një sistemi politik stabël, lufta ndaj korrupsionit, demokratizimi i proceseve institucionale, rritja e investimeve, si dhe zhvillimi i arsimit e sektorëve të tjerë të rëndësishëm për entitetin politik.

7.4 KUFIZIME TË STUDIMIT

Hulumtimi dhe analiza e çështjes së marrë në konsideratë në kuadrin e këtij studimi, pavarësisht përpjekjes për të qenë holistike, në kuptimin e kapjes së dinamikave dhe marrëdhënieve kryesore ndërmjet fenomeneve ekonomike dhe politike, natyrisht haset edhe me disa kufizime. Kjo, edhe për shkak të faktit se edhe vetë teoritë ekonomike duke qenë të hapura (open-ended) nuk ofrojnë kritika përjashtuese për modelet e rritjes në kuptimin e vlefshmërisë dhe shpjegueshmërisë së tyre, duke mos kufizuar kështu edhe aplikimin e modeleve konkurruese.

Kështu, përse i përket kufizimeve, ky studim nga pikëpamja e testimit empirik merr në konsideratë modelin së bashku me mënyrën e prezantuar të marrëdhënies ndërmjet variablave. Sigurisht që kjo mënyrë e testimit empirik nuk është një mënyrë shterruese e studimit të marrëdhënies ndërmjet destabilitetit politik dhe rritjes ekonomike së bashku

³⁴⁹ Shënim: Edhe përdorimi i konceptit të politikëbërësit duhet të konsiderohet me kujdes. Ashtu siç e kemi theksuar më sipër sistemi ekonomik i një vendi është produkt i politikëbërjes, pra sistemit politik. Për këtë, ashtu siç konfirmohet edhe nga Stiglitz *et al.*, (2006), ‘demokracitë nuk mund t’ua lenë politikën makroekonomike teknokratëve, sepse politika makroekonomike është thelbësisht politike; ajo përfshin shkëmbime për të cilat duhet vendosur vetëm gjatë një procesi politik’. (Stiglitz, J. Ocampo, A. J. Spiegel, Sh. Ffrench-Davis, R. Nayyar, D., (2006), *Stability with Growth: Macroeconomics, Liberalization and Development*, Oxford University Press, Nju Jork, fq. 34).

me faktorë të tjerë ndërhyrës të karakterit ekonomik apo politik. Ajo u prodhua si rezultat i një analize të modeleve të tjera të përdorura si dhe përshtatshmërisë me kontekstin vendor që studimi merr në konsideratë (vendet e Ballkanit Perëndimor).

Po kështu, do të theksonim se edhe variabla të tjerë (të natyrës ekonomike e politike) mund të përfshihen e bëhen pjesë e modeleve të marra në konsideratë për të parë ndikimin e tyre tek rritja ekonomike. Madje, një pjesë e variablave të përfshirë në model në statusin e variablave të pavarur, në të tjera analiza e studime empirike prezantohen si variabla të varur. Kjo është në varësi të natyrës dhe objektivave të studimit të cilat identifikohen paraprakisht, si dhe bazës teorike e cila legjitimon përfshirjen e tyre në model.

Gjithashtu, nga pikëpamja e të dhënave, duke qënë se modelet përdorin të dhëna sasiore dytësore të prodhuara përgjatë kohës nga institute e agjenci të ndryshme, gjithsesi ekziston njëfarë gabimi në mbledhjen e përpunimin e tyre (pavarësisht se niveli i këtij gabimi është shumë më i ulët sesa në të dhënat sasiore parësore), çka reflektohet edhe në koeficientin e korrelacionit që prodhon regresioni. Për më tepër, gabimi reflektohet edhe në dimensionet apo aspektet e veçanta të secilit variabël (fenomen) që këto institucione marrin në konsideratë, për të ndërtuar treguesit përkatës të fenomeneve politike apo ekonomike. Kjo, sidomos për variablat e natyrës politike. Ndërsa, përsa i përket variablave ekonomikë, e kryesisht rritjes ekonomike, për vendet në zhvillim të cilat kanë specifika të veçanta në kuadër të rritjes duke përfshirë këtu edhe Ballkanin Perëndimor, trendi i saj shpesh mund të paraqesë pengesa në se trajtohet nëpërmjet mesatarizimit të periudhave të njëjta.

SHTOJCA

SHTOJCA I. SHKURTIME

(BB) - Banka Botërore

(ERBD) - Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

(GCR) - Raporti i Konkureshmërisë së Qeverisë

(DS) - Destabiliteti Politik

(FMN) - Fondi Monetar Ndërkombëtar

(WEF) - Forumi Ekonomik Botëror

(CPI) - Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit

(OBT) - Organizata Botërore e Tregëtisë

(MENA) - Vendet e Lindjes së Mesme dhe Amerikës së Veriut

(OLS) - Metoda e katrorëve më të vegjël

(PITF) - Task Forca e Destabilitetit Politik

(GCR) - Raporti Botëror i Konkureshmërisë

(TSLS) - Metoda e katrorëve më të vegjël me dy shkallë

(WGI) - Treguesit Botërorë të Qeverisjes

(CPI) - Indeksi i Perceptimeve të Korrupsionit

**SHTOJCA II. PËRMBLEDHJE E STUDIMEVE EMPIRIKE NË RAPORTET
SISTEM POLITIK-SISTEM EKONOMIK**

Autori/Viti	Çështja nën studim, fokusi, elementët e ve[antë	Rezultatet kryesore të studimit
Brunetti dhe Weder (1995)	Marrëdhënia ndërmjet sistemit politik dhe performances ekonomike të një vendi.	(De)stabiliteti politik rezulton të jetë një vlerësues më i mirë në marrëdhënien ndërmjet demokracisë dhe performancës ekonomike.
Pitlik (2008)	Performanca ekonomike vlerësohet marrëdhënie me institucionet demokratike në prodhimin e reformave të tregut.	Reformat e politikave ekonomike në periudha krizash nuk kanë nevojë për një qeverisje autoritare
Ali (2001)	Marrëdhënien ndërmjet destabilitetit politik, pasigurisë së politikave dhe rritjes ekonomike.	Nuk është destabiliteti politik që ndikon në mënyrë domethënëse rritjen ekonomike, por destabiliteti i politikave i cili ka një ndikim më të madh dhe më të rëndësishëm.
Jong-A-Pin (2006)	Ndikimet e secilit dimensioneve të destabilitetit politik (protestat civile, agresionin politikisht të motivuar, destabilitetin brenda rregjimit politik, dhe destabilitetin e rregjimit politik) tek rritja ekonomike afatgjatë	Destabiliteti i rregjimit politik dhe protestat civile janë të lidhura në mënyrë të rëndësishme me rritjen ekonomike.
Zureiqat (2005)	Marrëdhënia ndërmjet destabilitetit politik dhe rritjes ekonomike	Konfirmon hipotezën sipas së cilës destabiliteti politik shkakton një rënie të rritjes ekonomike
Aisen dhe Vega (2011)	Vlerësimin e destabilitetit politik nëpërmjet ndryshimeve të kabinetit në raport me rritjen ekonomike	Destabiliteti politik ndikon negativisht në reduktimin e ndjeshëm të rritjes ekonomike
Alesina, A., Ozler, S., Roubini, N., Swagel, P., (1996)	Vlerësimin e ndikimit të destabilitetit politik tek rritja ekonomike	Destabiliteti politik redukon rritjen ekonomike
Ozler dhe Tabellini	Marrëdhënia ndërmjet	Destabiliteti i lartë dhe

(1991)	destabilitetit politik dhe borxheve të jashtme që një shtet krijon.	shkalla e lartë e polarizimit [ojnë drejt një preference për konsum për të tashmen nga ana e qeverisë sesa për të ardhmen
Polterovich dhe Popov (2007)	Marrëdhënia ndërmjet rritjes ekonomike, demokracisë, dhe institucioneve	Në vende me probleme në aspektin e ligjit e rendit, demokratizimi ndikon negativisht edhe në rritjen ekonomike
Plümper dhe Martin (2003)	Marrëdhënia ndërmjet shpenzimeve qeveritare, demokracisë dhe rritjes ekonomike	Sa më shumë demokratik të jetë një vend, aq më e mirë është cilësia e shpenzimeve qeveritare
Dawson (2008)	Marrëdhënia ndërmjet zhvillimit financiar dhe rritjes ekonomike	Politikat e zhvillimit të sektorit financiar nëpërmjet rritjes së likuiditeteve, promovojnë edhe rritjen ekonomike
Gerring, J. Bond, P. Brandt, W. Moreno, C., (2005)	Marrëdhënia e demokracisë me rritjen ekonomike	Demokracia ndikon tek rritja ekonomike, dhe kjo marrëdhënie është më e fortë kur variabli i demokracisë konsiderohet si një koncept kumulativ dhe i përshkallëzuar
Kaufmann dhe Kraay (2002)	Niveli i korrelacionit dhe kahun i shkakësisë ndërmjet qeverisjes së mirë dhe rritjes ekonomike	Korrelacion i fortë dhe pozitiv me drejtim nga qeverisja e mirë tek rritja ekonomike
Mobarak (2005)	Kanali komunikues dhe ndërlidhës ndërmjet demokracisë dhe rritjes ekonomike	Ekzistenca e demokracisë dhe niveleve të larta të saj kanë një ndikim negativ tek paqëndrueshmëria e rritjes. Ndërsa paqëndrueshmëria në vetvete ul rritjen ekonomike.
Aron (2000)	Lidhja ndërmjet cilësisë së institucioneve, investimeve dhe rritjes	Korniza institucionale ndikon tek rritja
Mamoona dhe Murshed (2009)	Cilësia e institucioneve dhe roli i akumulimit të kapitalit njerëzor në marrëdhënie me mirëqënien ekonomike në një vend të caktuar dhe më	Zhvillimi i kapitalit njerëzor, dhe kuadri institucional ndikojnë mirëqënien ekonomike. (me cilësi të institucioneve kuptohen faktorët që [ojnë

	specifikisht në marrëdhënie me rritjen ekonomike	drejt qeverisjes së mirë, si: stabiliteti politik, llogaridhënia, shteti i së drejtës, cilësia burokratike, si dhe kontrolli i korrupsionit)
Persson (2002)	Ndikimi i aspektit strukturor të institucioneve (formati qeverisës dhe lloji i sistemit zgjedhor të aplikuar në një vend) tek politikat publike	Sistemet zgjedhore mazhoritare janë të lidhura me programe shpenzimesh të kufizuara, dhe formatet presidenciale të qeverisjes prodhojnë qeveri më të vogla.
Henisz (2000)	Marrëdhënia ndërmjet institucioneve politike dhe rritjes ekonomike	Nuk ofron përgjigje përfundimtare në lidhje me natyrën e marrëdhënies ndërmjet institucioneve politike dhe rezultateve ekonomike
Mijiyawa (2008)	Ndikimi i institucioneve tek rritja ekonomike e qëndrueshme	Tek indeksi i përbërë politiko-ekonomik i institucioneve, të gjitha kategoritë e tyre ndikojnë tek rritja ekonomike, por me një rol më të rëndësishëm të institucioneve rregullatore pikërisht tek ky variabël.
Beck dhe Laeven	Marrëdhënia ndërmjet institucioneve dhe rritjes ekonomike në vendet paskomuniste	Varësia që vende të caktuara kanë nga burimet natyrore si dhe nga kohëzgjatja e eksperiencës demokratike janë shkaktarë të vonimit të ndërtimit të institucioneve të tregut e një sistemi politik më të hapur. Institucionet janë një variabël i rëndësishëm në shpjegimin e zhvillimit ekonomik dhe rritjes në vendet paskomuniste.
Mauro (1995)	Marrëdhënia ndërmjet korrupsionit dhe rritjes ekonomike	Korrupsioni ka një ndikim negative tek investimet, duke ulur kështu edhe rritjen ekonomike.
Drury, C. A. Krieckhaus, J.	Marrëdhënia demokraci-korrupsion-rritje	Vendet të cilat janë demokraci shihet se

Lusztig, M., (2006)	ekonomike	korrupsioni nuk ka ndonjë ndikim të drejtpërdrejtë tek rritja ekonomike, ndërsa në vende të tjera jodemokratike duket se rritja ekonomike preket duke pësuar rënie nga korrupsioni.
---------------------	-----------	---

SHTOJCA III.

Mesatarja e vlerësimit të Polity IV (demok+autok)

Vitet/Shtetet	Shqipëria	Bosnjë Hercegovina	Kroacia	Maqedonia
1996	0	-66	-5	6
1997	5	-66	-5	6
1998	5	-66	-5	6
1999	5	-66	-88	6
2000	5	-66	8	6
2001	5	-66	8	6
2002	7	-66	8	9
2003	7	-66	8	9
2004	7	-66	8	9
2005	9	-66	9	9
2006	9	-66	9	9
2007	9	-66	9	9
2008	9	-66	9	9
2009	9	-66	9	9
2010	9	-66	9	9
2011	9	-66	9	9
2012	9	-66	9	9

Mesatarja e vlerësimit të të drejtave politike e lirive civile

Vitet/Shtetet	Shqipëria	Bosnjë Hercegovina	Kroacia	Maqedonia
1996	4	5	4	3.5
1997	4	5	4	3.5
1998	4.5	5	4	3
1999	4.5	5	4	3
2000	4.5	4.5	2.5	3.5
2001	3.5	4.5	2	4
2002	3	4	2	3

2003	3	4	2	3
2004	3	3.5	2	3
2005	3	3.5	2	3
2006	3	3	2	3
2007	3	3.5	2	3
2008	3	3.5	2	3
2009	3	3.5	1.5	3
2010	3	3.5	1.5	3
2011	3	3.5	1.5	3
2012	3	3	1.5	3

Totali i vlerësimit të treguesve të indeksit të lirisë ekonomike

Vitet/Shtetet	Shqipëria	Bosnjë Hercegovina	Kroacia
1996	53.8	29.4	48
1997	54.8	29.4	46.7
1998	53.9	29.4	51.7
1999	53.4	29.4	53.1
2000	53.6	45.1	53.6
2001	56.6	36.6	50.7
2002	56.8	37.4	51.1
2003	56.8	37.4	53.3
2004	58.5	40.6	53.1
2005	57.8	44.7	51.9
2006	60.3	55.6	53.6
2007	61.4	54.4	53.4
2008	62.4	53.9	54.1
2009	63.7	53.1	55.1
2010	66	56.2	59.2
2011	64	57.5	61.1
2012	65.1	57.3	60.9

BIBLIOGRAFIA

- Abeyasinghe, R., (2004), 'Democracy, political stability, and developing country growth: theory and evidence', *Honors Projects*, Nr. 17, Illinois Wesleyan University, fq. 1-32.
- Acemoglu, D. Johnson, S. Robinson, A. J. Yared, P., (2008), 'Income and Democracy', *American Economic Review*, Vol. 98(3):808-842.
- Acemoglu, D. Robinson, A. J. Johnson, S. Yared, P., (2009), 'Reevaluating the modernization hypothesis', *Journal of Monetary Economics*, Vol. 56(8):1043-1058.
- Acemoglu, D., (2006), 'Modeling inefficient institutions', *Cambridge Collections Online*, Cambridge University Press, 341-380.
- Aisen, A. Veiga, J.F., (2011), 'How does political instability affect economic growth?', *IMF Working Paper*, WP/11/12, International Monetary Fund, 1-28.
- Akça, H. Ata, Y. A. Karaca, C., (2012), 'Inflation and corruption relationship: evidence from panel data in developed and developing countries', *International Journal of Economics and Financial Issues*, Vol. 2(3): 281-291.
- Akçay, S. "Corruption and economic growth: A cross-national study", *Ankara Üniversitesi SBF Dergisi*, Vol. 57(1).
- Ake, C., (1975), 'A definition of political stability', *Comparative Politics*, Vol. 7(2):271-283.
- Albania's Parliamentary Elections 2001*, (2001), Balkans Briefing, International Crisis Group.
- Alesina, A. Perotti, R., (1994), 'The political economy of growth: a critical survey of the recent literature', *The World Bank Economic Review*, Vol. 8(3): 351-371.
- Alesina, A., Ozler, S., Roubini, N., Swagel, P., (1996), 'Political instability and economic growth', *Journal of Economic Growth*, Vol. 1(2): 189-211.
- Ali, M. A., (2001), 'Political Instability, Policy Uncertainty, and Economic Growth: An Empirical Investigation', *Atlantic Economy Journal*, Vol. 29(1): 87-106.
- Anastasakis, O., (2008), 'The EU's political conditionality in the Western Balkans: towards a more pragmatic approach', *Southeast European and Black Sea Studies*, Vol. 8: 365-377.
- Aristoteli, (2003), *Politika*, Plejad, Tiranë.
- Aron, J., (2000), 'Growth and Institutions: A Review of the Evidence', *The World Bank Research Observer*, Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/ Banka Botërore, Vol. 15(1): 99-135.
- Banka Botërore, (1997), *World Development Report: the state in a changing world*, Oxford University Press, Nju Jork.
- Banka Botërore, (2002), *World Development Report: Building Institutions for Markets*, Oxford University Press, Nju Jork.
- Banka Botërore, (2013), *World Development Report: Jobs*, Washington DC.

- Banka Botërore, *PBB për frymë*,
<http://data.worldbank.org/indicator/NY.GDP.PCAP.CD?page=4>
- Banka Botërore, *Political Stability*, i gjendshëm në:
<http://info.worldbank.org/governance/wgi/pdf/pv.pdf>
- Banka Botërore, *Worldwide Governance Indicators*:
<http://info.worldbank.org/governance/wgi/index.aspx#home>
- Barolli, B., (2005), 'An overview of the Albanian history: with main emphasis on economy', Nr. 34:241-266, i gjendshëm në:
http://dspace.lib.niigatau.ac.jp:8080/dspace/bitstream/10191/947/1/18_0202.pdf
- Barro, J. R., (1996), 'Democracy and growth', *Journal of Economic Growth*, Vol 1: 1-27.
- Baum, A. M. Lake, A. D., (2003), 'The political economy of growth: Democracy and Human Capital', *American Journal of Political Science*, Vol. 47(2): 333-347.
- Beck, Th. Laeven, L., (2005), 'Institution building and growth in transition economies', Banka Botërore, 1-56.
- Bideleux, R. Jeffries, I., (2007), *The Balkans: A post-communist history*, Routledge, Londër & Nju Jork.
- Bieber, F., (2013), 'The Western Balkans are dead-long live the Balkans: Democratization and the limits of the EU', *Unfinished Business: The Western Balkans and the International Community*, 1-10.
- Bildt, C., (2001), 'A Second Chance in the Balkans', *Foreign Affairs*, Vol. 80(1):148-158.
- Blanco, L. Grier, R., (2007), 'Long live democracy: the determinants of political instability in Latin America', *Journal of Development Studies*, Vol. 45(1):76-95.
- Boix, C, Stokes, S., (2003), 'Endogenous democratization', *World Politics*, Vol. 55(4): 517-549.
- Boix, C., (2009), 'Development and democratization', *IBEI Working Papers/26*.
- Bollen, A. Jones, T. S., (1982), 'Political Instability and direct foreign investment: the motor vehicle industry, 1948-1965', *Social forces*, Vol. 60(4): 1070-1088.
- Bollen, A. K., (1990), 'Political democracy: conceptual and measurement traps', *Studies in Comparative International Development*, Vol. 25(1): 7-24.
- Bozic-Milkjovic, I., (2007), 'Westren Balkans in the process of European Integration- Economic networking and the region's development', *Facta Universitatis: Economics and Organization*, Vol. 4(1): 79-90.
- Brada, J, Kutan, A, M, Yigit, T, M., (2004): The effects of transition and political stability on foreign direct investment inflows: Central Europe and the Balkans, *WDI Working Paper*, No. 729, fq. 1-38
- Brunetti, A. Weder, B., (1995), 'Political Sources of Growth: A Critical Note on Measurement', *Public Choice*, Vol. 82(1/2):125-134.
- Bunce, V., (1999), 'The Political Economy of Post-socialism', *Slavic Review*, Special Issue: Ten Years after 1989: What Have We Learned, Vol. 58(4): 756-793.

- Campos, F. N. Nugent, B. J., (2002), 'Who is afraid of political instability', *Journal of Development Economics*, Vol. 67: 157-172.
- Carment, D. Samy, Y., (2012), 'Assesing state failure: a country indicators for foreign policy report', *Country Indicators for Foreign Policy*, <http://www4.carleton.ca/cifp/app/serve.php/1407.pdf> ;
<http://www4.carleton.ca/cifp/>
- Carmignani, F., (2003), 'Political instability, uncertainty and economics', *Journal of Economic Surveys*, Vol. 17(1): 1-52, Blackwell Publishing Ltd.
- Center for Global Policy, <http://globalpolicy.gmu.edu/>
- Center for Global Policy, <http://globalpolicy.gmu.edu/political-instability-task-force-home/>
- Center for the Study of Complex Systems, *Economic growth*, (online course 8).
- Cervellati, M. Fortunato, P. Sunde, U. (2007) *Violence during democratization and the quality of democracy*, fq 1; aksesuar mw Shtator 2012,
<http://www2.dse.unibo.it/cervellati/pdf/violence.pdf>
- Chan, J., To, H. P., Chan, E., 'Reconsidering social cohesion: developing a definition and analytical framework for empirical research', *Social Indicators Research*, 2006, Vol. 75(2): 273-302.
- Chen, E. L., (2007), 'Development First, Democracy Later? Or Democracy First, Development Later?: The Controversy over Development and Democracy", *Punim i prezantuar nw mbledhjen vjetore të Shoqatës së Shkenave Politike të Jugut*, Los Anxhelos, SHBA.
- Choi, E and Woo, J. (2010), 'Political corruption, economic performance, and electoral outcomes: a cross-national analysis', *Contemporary Politics*, Vol. 16(3): 249-262.
- Cukierman, A. Edwards, S. Tabellini, G., 1992, 'Seignorage and Political instability', *The American Economic Review*, Vol. 82 (3): 537-555.
- Dahl, R., *Poliarkia: pjesëmarrja dhe opozita*, 2005, Pegi, Tiranë.
- Dawson, P. J., (2008), 'Financial development and economic growth in developing countries', *Progress in Development Studies*, Vol. 8(4): 325–331.
- de Haan, J., (2007), 'Political institutions and economic growth reconsidered', *Public Choice*, Vol. 131:281-292, Springer Sience+Business Media.
- de Schweinitz, K., (1959), 'Industrialization, labor controls, and democracy', *Economic Development and Cultural Change*, Vol. 7(4): 385-404.
- del Monte, A. dhe Papagni, A. "Public Expenditure, Corruption, and Economic Growth: The case of Italy", 1-24.
- Della Porta, D., (2002), *Introduzione alla scienza politica*, il Mulino, Bolonja.
- Dodge, R., Daly, A., Huyton, J., & Sanders, L., (2012), 'The challenge of defining wellbeing', *International Journal of Wellbeing*, Vol. 2(3), 222-235.
- Douglas A. Hibbs, Jr., (1973), *Mass political violence: a cross-national causal analysis*, John Wiley & Sons, Nju Jork.

- Douglas, A., Hibbs, Jr., (2001), 'The politicization of growth theory', *Kyklos*, Vol 54: 257-278.
- Drazen, A., (2000), 'How does politics affect economic outcomes? Insights from 'New' political economy', Essay on political economy, fq 1-5.
- Drury, C. A. Kriekhaus, J. Lusztig, M., (2006), 'Corruption, democracy, and economic growth', *International Political Science Review*, Vol. 27(2): 121-136.
- Duff, A. E. McCamant, F. J., (1968), 'Measuring social and political requirements for system stability in Latin America', *The American Political Science Review*, Vol. 62(4):1125-1143.
- Duma, G., (2011), *Cikël leksionesh: Teoritë e kuptimit dhe adminsitrimin të sistemeve*.
- Dunning, Th., (2005), 'Resource dependence, economic performance, and political instability', *The Journal of Conflict Resolution*, Vol. 49(4): 451-482.
- Easton, D. Dennis, J., 'The child's acquisition of regime norms: political efficacy', *The American Political Science Review*, 1967, Vol. 61(1): 25-38.
- Ebben, W dhe de Vaal, A. (2009), 'Institutions and the Relation between Corruption and Economic Growth', pg.27, aksesuar më 10 gusht 2012 http://www.degit.ifw-kiel.de/papers/degit_14/c014_014.pdf/Accessed.
- Ekiert, G. Kubik, J. Vachudova, A. M., (2007), 'Democracy in the post-communist world: an unending quest?', *East European Politics and Societies*, Vol. 21(7): 7-30.
- Epstein, L.D. Bates, R. Goldstone, J. Kristensen, I. O'Halloran, Sh., (2006). Democratic transitions. *American Journal of Political Science*, Vol. 50(3): 551-569: kopje e disponueshme në: http://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=92018.
- Eschenbach, F. Hoekman, B., (2006), 'Services Policy Reform and Economic Growth in Transition Economies', *Review of World Economics / Weltwirtschaftliches Archiv*, Vol. 142(4):746-764.
- Feierabend, V. I. Feierabend, R. L., (1966), 'Aggressive behaviours within polities, 1948-1962: A cross national study', *Journal of Conflict Resolution*, Vol. 10(3):249-271.
- Feng, Y., (1997), 'Democracy, Political Stability and Economic Growth', *British Journal of Political Science*, Vol. 27(3):391-418.
- Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe*, (1980), Akademia e Shkencave të Republikës së Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë.
- Friedman, M., (2005), *Kapitalizmi dhe liria*, Dita 2000, Tiranë.
- Friedrich, C.J., (1972), *The Pathology of Politics, Violence, Betrayal, Corruption, Secrecy and Propaganda*, New York: Harper and Row.
- Frye, T., (1997), 'A politics of institutional choice: post-communist presidencies', *Comparative Political Studies*, Vol. 30: 523-552.
- Fukuyama, F. 2005, 'Stateness First', *Journal of Democracy*, Vol. 16 (1): 83-88.
- Galenson, W., (1959), *Labor and Economic Development*. Nju Jork: John Wiley and

- Geddes, B., (2007), 'What causes democratization?', në *The Oxford Handbook of Comparative Politics*, redaktuar nga Boix, C. Stokes, S., Oxford University Press, fq. 317 - 339.
- Gerring, J. Bond, P. Brandt, W. Moreno, C., (2005), 'Democracy and Historical Growth A historical Perspective', *World Politics*, Vol. 57(3): 323-367.
- Gilley, B., (2006), 'The determinants of state legitimacy: results for 72 countries', *International Political Science Review*, Vol. 27(1): 47-71.
- Gleditsch, P. E. Wallensteen, P. Eriksson, M. Sollenberg, M. Strand, H., (2002), 'Armed conflict 1946-2001: A new dataset', *Journal of Peace Research*, Vol. 39(5), fq. 615 - 637, Sage Publications.
- Gleditsch, S. K. Choung, L. J., (2004), 'Autocratic transitions and democratization', prezantuar në International Studies Association, Montreal dhe në konferencën 'Bringing leaders and politics back into international relations'.
- Goldsmith, A., A., (1987), 'Does Political Stability Hinder Economic Development? Mancur Olson's Theory and the Third World', *Comparative Politics*, Vol. 19(4): 471-480.
- Goldstein, J. S., (2001), *Marrëdhëniet Ndërkombëtare*, Dituria, Tiranë.
- Goldstone, A. J. Bates, H. R. Epstein, L. D. Gurr, R. T. Lustik, B.M. Marshall, G. M. Ulfelder, J. Woodward, M., (2010), 'A global model for forecasting political instability', *American Journal of Political Science*, Vol. 54(1):190-208.
- Goldstone, J.A. Gurr, T.R. Marshall, M.G. Ulfelder, J., (2004), 'It's all about state structure: new findings on revolutionary origins from global data', *Homo Oeconomicus*, Vol. 21(3): 429-455.
- Gujarati, N. D., (2004), *Basic Econometrics*, Fourth edition, The McGraw-Hill Companies.
- Gurr, T. R., 'Persistence and Change in Political Systems, 1800-11971', *The American Political Science Review*, 1974, Vol. 68 (4), fq.1482-1504.
- Hall, E. R. Jones, I. C., (1999), 'Why do some countries produce so much more output per worker than others?', *The Quarterly Journal of Economics*, Vol. 114(1): 83-116.
- Hall, R. D., (1999), 'Representations of place: Albania', *The Geographical Journal*, Vol. 165(2):161-172.
- Hausmann, R. Rodrik, D. Velasco, A., (2005), 'Growth diagnostics', fq.1-35/i gjendshëm në:
<http://www.hks.harvard.edu/fs/drodrik/Research%20papers/barcelonafinalmarch2005.pdf>
- Helliwell, F. J., (1992), 'Empirical linkages between democracy and economic growth', *Working Paper No. 4066*, National Bureau of Economic Research, fq. 1-28.
- Hellman, S. J., (1998), 'Winners take all: the politics of partial reform in post-communist transitions', *World Politics*, Vol. 50(2): 203-234.

- Henisz, J. W., (2000), 'The institutional environment for economic growth', *Economics and Politics*, Vol. 12(1): 1-31.
- Hewitt, J. J. Wilkenfeld, J. Gurr, R. T., *Peace and Conflict 2012*, Center for International Development and Conflict Management,
http://www.cidcm.umd.edu/pc/executive_summary/exec_sum_2012.pdf
- Heywood, A., (2008), *Politika*, Dudaj, Tiranë.
- Hodgson, G. M., (2006), 'What are institutions?', *Journal of Economic Issues*, Vol. XL(1): 1-24.
- Huntington, P. S., (1965), 'Political development and political decay', *World Politics*, Vol 17(3): 386-430.
- Huntington, S. (1968), "Political Order in Changing Societies", New Haven:Yale University Press.
- Huntington, S., (2006), *Political Order in Changing Societies*, Yale University, Londër.
- Hurwitz, L. (1973), 'Contemporary Approaches to Political Stability', *Comparative Politics*, Vol. 5 (3): 449-463.
- Ickes, K., (2003), 'Albania: the rebuilding and stabilization of a country', i gjendshëm në: <http://muggins.org/papers/Albania-Stabilization.pdf>
- Ickes, W. B., (1996), 'Endogenous Growth Models', fq.1, i gjendshëm në: <http://econ.la.psu.edu/~bickes/endogrow.pdf>
- International Republican Institute (IRI), (1996), *IRI Observation Report on the Albanian Parliamentary Elections of May 1996*, i gjendshëm online në: <http://www.iri.org/sites/default/files/Albania's%201996%20Parliamentary%20Elections.pdf>
- Intriligator, D. M., (1983), *Handbook of Econometrics*, Vëllimi I, North-Holland Publishing Company.
- Johnson, S. Kaufman, D. Shleifer, A., (1997), 'The unofficial economy in transition', *Brookings Papers on Economic Activity*, Vol. 2: 159-239.
- Johnson, S. Kaufman, D. Zoido-Lobaton, P., (1998), 'Regulatory discretion and the unofficial economy', *American Economic Review*, fq 1-10.
- Johnston, M., (1998), 'Fighting systemic corruption: social foundations for institutional reform. *European Journal of Development Research*, Vol. 10(1): 85-104.
- Jong-A-Pin, R., (2006), 'On the measurement of political instability and its impact on economic growth', fq.1-33, fq.22/ i disponueshëm në <http://som.eldoc.ub.rug.nl/FILES/reports/themeC/2006/06C05/06C05.pdf>
- Jung, F. Sunde, U., (2010), *Lipset Reconsidered: A Rational Theory of the Stability of Democracy*; aksesuar në Shtator 2012, http://www.google.al/#hl=en&tbo=d&scient=psyab&q=++Lipset+reconsidered&oq=++Lipset+reconsidered&gs_l=serp.3...38007.41421.0.41622.19.18.0.0.0.3.975.5891.0j3j5j2j2j3j1.16.0.les%3B..0.0...1c.1.2.serp.BCQIJsSmv2c&pbx=1&bav=on.2,or.r_gc.r_pw.r_qf.&fp=18778b63627b71c6&biw=1366&bih=643.

- K.W.Deutch, (1961), 'Social Mobilization and Political Development', *American Political Science review*, Vol. 55.
- Kaldor, N., (1980), *Essays on the economic stability and growth*, Holmes &Meier Publishers, Inc. Nju York.
- Karasavoglou, G. A., (2011), *Economies of the Balkan and Eastern Europe Countries in the Changed World*, Cambridge Scholars Publishing, Britani e Madhe.
- Kaser, M., (2001): Economic continuities in Albania's turbulent history. *Europe-Asia Studies*, Vol. 53(4): 627-637.
- Kaufmann, D. Kraay, A. Mastruzzi, M., (2010), 'The worldwide governance indicators: methodology and analytical issues', *Policy Research Working Paper:5430*, Grupi i Kërkimit për Zhvillim i Bankës Botërore.
- Kaufmann, D. Kraay, A., (2002), 'Growth without governance', 5th Economia Panel Meeting, Universiteti i Harvardit, Banka Botërore, 1-60.
- Keman, H., (1999), 'Political stability in divided societies: a rational-institutional explanation', *Australian Journal of Political Science*, Vol. 34(2): 249-268.
- Konsensusi i Uashingtonit, OBSH, i gjendshëm në:
<http://www.who.int/trade/glossary/story094/en/>
- Kombet e Bashkuara, *Investment Policy Review: The Former Yugoslav Republic of Macedonia*, Konferenca e Kombeve të Bashkuara mbi Tregëtinë dhe Zhvillimin, Nju Jork, 2012.
- Koyuncu, C. Ozturkler, H. dhe Yilmaz, R., (2010), 'Privatization and corruption in transition economies: a panel study', *Journal of Economic Policy Reform*, Vol. 13(3): 277-284.
- Krasniqi, A., (2006), *Partitë Politike në Shqipëri (1920-2006)*, Instituti Shqiptar i Studimeve të Politikave, Tiranë.
- Kutan, A. Douglas, Th. and Judge, W. 'Does corruption hurt economic development?: Evidence from Middle Eastern, North African and Latin American countries', 1-27, i gjendshëm në <http://www.siu.edu/business/economicsandfinance/pdf/070102.pdf>.
- Leftwich, A., (2005), 'Democracy and development: is there institutional incompatibility', *Democratization*, Vol. 12(5):686-703.
- Leite, C. dhe Weidman, J., (1999), 'Does mother nature corrupt? Natural resources, corruption and economic growth'. *International Monetary Fund Working Paper*, WP/99/85.
- Lerner, D., (1958), *The passing of the traditional society: modernizing the middle east*, Nju Jork: Free Press.
- Lessenski, M., (2010), 'How are the Balkans weathering the storm of the economic crisis: comparing the implications across countries in the regional and European context', *The Western Balkans: between the economic crisis and the European perspective*, Institute for Regional and International Studies, Sofje.

- Lewis, G. P., (2000), *Political Parties in Post-Communist Eastern Europe*, Taylor & Francis e-Library.
- Lipset, S. M., (1959): Some Social Requisites of Democracy: Economic Development and Political Legitimacy. *American Political Science Review*, Vol. 53: 69-105. doi:10.2307/1951731.
- Lipset, S.M., (1960), 'The social requisites of democracy revisited: 1993 Presidential Address', *American Sociological Review*, Vol. 59(1):1-22.
- Loewenberg, G. Patterson S. C., *Comparing Legislatures*, 1979, Boston: Little, Brown and Co.
- Mamoon, D. Murshed, M.S., (2009), 'Want economic growth with good quality institutions? Spend on education', *Education Economics*, Vol. 17(4): 445-468.
- Margolis, J. E., (2010), 'Civil Wars', *Understanding political Stability and Instability*, Vol. 12 (3): 326-345.
- Margolis, J. E., (2012), 'Estimating state instability', *Studies in Intelligence*, Vol. 56 (1): 13-24.
- Marshall, G. M. Cole, R. B., *State Fragility Index and Matrix 2011*, Center for Global Polity, <http://www.systemicpeace.org/SFI/matrix2011c.pdf>
- Martin, R. Sunley, P., (1998), 'Slow convergence? The new endogenous growth theory and regional development', *Economic Geography*, Vol. 74(3):201-227.
- Mauro, P. (1995), "Corruption and Growth", *Quarterly Journal of Economics*, Vol.110(3): 681-712
- Mauro, P. (1997), 'Why worry about corruption', International Monetary Fund, aksesuar në 11 gusht 2012 në : <http://www.imf.org/external/pubs/ft/issues6/issue6.pdf>
- Mauro, P. (2007), 'World Bank Researchers and the Study of Corruption', *Journal of World Affairs*, Vol. 13(2): 67-77.
- Mayer, L., *Politikat krahasuese: kombet dhe teoritë në një botë që ndryshon*, 2003, Botime Ora, Tiranë.
- Mayfield, J., 'The scholarly contradictions in understanding the history and legacy of Communist Albania', *European Heritage History*, i gjendshëm në: <http://euroheritage.net/albaniahistoriography.shtml>
- Maylor, H. Blackmon, K., (2005), *Research Business and Management*, Palgrave Macmillan, Londër.
- McArthur, W. J. Sachs, D.J., (2000), 'Institutions and geography: comment on Acemoglou, Johnson and Robinson (2000)', *NBER Working Paper Series*, Working Paper, Nr. 8114, National Bureau of Economic Research.
- Mijiyawa, G. A., (2008), 'Sustained Economic Growth: Do Institutions Matter, and Which One Prevails?', *Cato Journal*, Vol. 28(3): 385-420.
- Minassian, G., (2002), 'The economic environment in Albania, Bulgaria, Macedonia FYR, and Greece: A cross country study', *Eastern European Economics*, Vol. 40(4): 45-82.

- Miranda, F., (2007), *Oligarchical Politics and Its Implications on Regime Stability*, 53-58, i gjendshëm në
<http://journals.upd.edu.ph/index.php/kasarinlan/article/download/553/486>.
- Mishler, W. Hildreth, A., 'Legislatures and political stability: an explanatory analysis', *The Journal of Politics*, 1984, Vol. 46(1): 25-59.
- Mo, P.H., (2001), 'Corruption and Economic Growth', *Journal of Comparative Economics*, Vol. 29: 66-79.
- Mobarak, M. A., (2005), 'Democracy, volatility and economic development', *The Review of Economics and Statistics*, Vol. 87(2): 348-361.
- Moore, J., (1999), 'Obstacles to Development in the Balkans', *Challenge*, Vol. 42(5):102-113
- Moore, M. Schmitz, H., (2008), 'Idealism, Realism and the Investment Climate in Developing Countries', *Working Paper*, No. 307, Institute of Development Studies, Britani e Madhe.
- Mungiu-Pippidi, A., (2006), 'Corruption: diagnosis and treatment', *Journal of Democracy*, Vol. 17(3): 86-99.
- North, D., (1990), *Institutions, Institutional Change, and Economic Performance*, Cambridge University Press, Nju Jork.
- Nur-tegin, K., Czap, J. H., (2012), 'Corruption: Democracy, Autocracy, and Political Stability', *Economic Analysis & Policy*, Vol. 42 (1):51-66.
- OECD, (2009), *Policy responses to the economic crises: investing in innovation for long-term growth*, fq 1-37, i gjendshëm në: <http://www.oecd.org/sti/42983414.pdf>
- Olson, M., (1965), *Rise and Decline of Nations*, Harvard University Press, Kembrixh.
- Olson, M., (1982), *The Rise and Decline of Nations: Economic Growth, Stagflation, and Social Rigidities*, New Haven: Yale University Press.
- OSBE, (2009), *OSCE/ODIHR Election Observation Mission Final Report*.
- Oxford English Dictionary*, 2011,
<http://www.oed.com/view/Entry/188535?redirectedFrom=stability#eid>, parw mw 03, Dhjetor, 2012.
- Ozler, S. Tabellini, G., (1991), 'External debt and political instability', *NBER Working Papers Series*, No. 3772, National Bureau of Economic Research, fq. 1-27.
- Penev, S., (2012), *Economic and European perspectives for the Western Balkan countries*, Westminster Foundation of Democracy, Western Balkans Parliamentary network of committees for economy, finance and budget, Faculty of Economics and Business, Sarajevo, Institute of Economic Sciences, Beograd.
- Persson, T. Tabellini, G., (1999), 'The size and scope of government: comparative politics with rational politicians', *European Economic Review*, Vol. 43: 699-735.
- Persson, T., (2002), 'Do Political Institutions Shape Economic Policy?', *Econometrica*, Vol. 70(3): 883-905.

- Persson, T., Tabellini, G. Trebbi, F., (2003) 'Electoral rules and corruption', *Journal of the European Economic Association*, Vol. 1: 958-989.
- Pitlik, H., (2008), 'The Impact of Growth Performance and Political Regime Type on Economic Policy Liberalization', *KYKLOS*, Vol. 61(2):258–278.
- Plümer, Th. Martin, W. C., (2003), 'Democracy, Government Spending, and Economic Growth: A Political-Economic Explanation of the Barro-Effect', *Public Choice*, Vol. 117(1/2): 27- 50, fq. 44.
- Polity IV Project: Political Regime Characteristics and Transitions, 1800-2011, <http://www.systemicpeace.org/polity/polity4.htm>
- Polterovich, V. Popov, V., (2007), 'Democratization, quality of institutions, and economic growth', *TIGER Working Paper Series Nr. 102*, Transformation, Integration, and Globalization Economic Research, 1-46.
- Przeworski, A., (2004), 'Democracy and economic development', në Edward D. Mansfield dhe Richard Sisson (eds.), *The Evolution of Political Knowledge*. Columbus: Ohio State University Press, 1-27.
- Przeworski, A. Alvarez, M. Cheibub, J. A. Limongi, F., (2000), *Democracy and Development: Political Institutions and Well-being in the World 1950-1990*, Cambridge University Press.
- Przeworski, A. Limongi, F., (1997), 'Modernization: theories and facts', *World Politics*, Vol. 49(2):155-183, Cambridge University Press.
- Przeworski, A., (1991), *Democracy and the Market*, Cambridge University Press, Nju Jork.
- Riha, F.J.T., (1994), 'Missing: Morality in the transformation of former socialist countries', *International Journal of Social Economics*, Vol. 21: 10-31.
- Ringen, S., (2011), 'The measurement of democracy: towards a new paradigm', *Society*, Vol. 48: 12-16.
- Rodrik, D. Subramanian, A. Trebbi, F., (2002), 'Institutions rule: the primacy of institutions over geography and integration in economic development', *NBER Working Paper*, Nr. 9305.
- Romer, M. P., 'Economic Growth: The concise encyclopedia of economics', i disponueshëm në: <http://www.econlib.org/library/Enc1/EconomicGrowth.html>
- Sachs, D. J. Warner, A., (1995), 'Economic reform and the process of global integration', *Brookings Papers on Economic Activity*, The Brookings Institution.
- Samimi, J. A. Monfared, M. Moghaddasi, R. Azizi, K., (2011), 'Political Stability and FDI in OIC Countries', *Journal of Social and Development Sciences*, Vol. 1(1):18-23.
- Sarkar, A., (2010), 'On the political economy of a backward region', *Indian Growth and Development Review*, Vol. 3(2): 122-137.
- Schmidt, G. M., (2012), *Teoritë e demokracisë*, Botart, Tiranë.
- Schrodinger, E., (1946), *What is life?*, Cambridge University Press.

- Schwab, K. Sala-i-Martin, X., (2012), *The Global Competitiveness Report 2012-2013*, Forumi Ekonomik Botëror (WEF), Gjenevë.
- Serbos, S., (2008), 'European integration and South Eastern Europe: Prospects and challenges for the Western Balkans', *UNISCI Discussion Papers*, 18, 95-112.
- Stojanov, D., *Hungary and Bosnia Herzegovina: A Success and a failure of transition*, Working Papers, Nr. 149, Institute for World Economics, Hungarian Academy of Sciences, Budapest, 2004.
- Shala, A., (1997), 'Social and political change in post-communist Albania, the 1990's', Institute of Social Studies, Graduate School of Development Studies.
- Shaw, P. Katsaiti, S. M. Jurgilas, M., (2011), 'Corruption and growth under weak identification', *Economic Inquiry*, Vol. 49(1):264-275.
- Shepsle, A. K, Weingast, R. B, (1981), 'Structure induced equilibrium and legislative choice', *Public Choice*, Martinus Nijhoff Publishers, Hollandw.
- Shepsle, K. A., (1995), 'Studying institutions: some lessons from the rational choice approach', *Political Science in History*, Cambridge University Press, Kembrixh.
- Shivley, W.P., (1993), *Power and Choice: An Introduction to Political Science*, McGraw-Hill, Inc.
- Sipas përmbledhjes akademike, Universiteti i Princeton, i gjendshëm në: www.princeton.edu/wwac/academic-review/files/.../2.7_Huntington.doc
- Huntington, S., (1987), 'Goals of Development', në *Understanding Political Development*, Huntington dhe Weimer eds.
- Skardziute, A., (2010), 'Corruption in Albania', *Civil Society Against Corruption*, Hertie School of Governance.
- Smith, E., (2008), *Using Secondary Data in Educational and Social Research*, McGraw Hill, Open University Press, Angli.
- Stepan, A., (1978), *The state and society: Peru in comparative perspective*, Princeton University Press, Princeton.
- Stiglitz, E. J., (2004), 'Post Washington Consensus', Initiative for Policy dialogue, prezantuar në Barcelonë në konferencën "From the Washington Consensus towards a new Global Governance".
- Stiglitz, J. Ocampo, A. J. Spiegel, Sh. Ffrench-Davis, R. Nayyar, D., (2006), *Stability with Growth: Macroeconomics, Liberalization and Development*, Oxford University Press, Nju Jork.
- Stone, W. R., (2002), *Lending credibility: The International Monetary Fund and the Post-Communist Transition*, Princeton University Press.
- Strum, J-E. de Haan, J., (2005), 'Determinants of long-term growth: new results applying robust estimation and extreme bounds', *Research Paper Series*, Nr.12, Thurgauer Wirtschaftsinstitut.
- Swaleheen, M. Stansel, D., (2007), 'Economic freedom, Corruption and growth', *Cato Journal*, Vol. 27(3): 343-358.

- Tabellini, G., (2004), 'The role of the state in economic development', *CESIFO Working Paper*, Nr.1256.
- Taylor, M., Herman, M.V., (1971), 'Party systems and government stability', *The American Political Science Review*, Vol. 65(1):28-37.
- The Controversy over Development and Democracy, 1-36/ i disponueshëm në www.democracy.uci.edu/files/democracy/docs/conferences/.../chen.pdf
- Transition Report 2013*, European Bank for Reconstruction and Development (ERBD).
- Trentmann, F., (1998), 'Political culture and political economy: interest, ideology and free trade', *Review of International Political Economy*, Vol. 5(2): 217-251.
- Vickers, M., (1999), *The Albanians*, London: I. B. Tauris.
- Wight, B. J., (2011), 'Public Policy, Human Instincts, and Economic Growth', *The Independent Review*, Vol. 15(3): 351–365, ISSN 1086–1653.
- Williams, G. Duncan, A. Landell-Mills, P. Unsworth, S., (2009), 'Politics and Growth', *Development Policy Review*, Vol. 27 (1): 5-31.
- Worldwide Governance Indicators, *Country Data Report for Albania, 1996-2012*, Banka Botërore.
- Wright, J., (2008), 'Political Competition and Democratic Stability in New Democracies', *British Journal of Political Science*, Cambridge University Press, Vol. 38(2):221-245.
- Wright, Q., (1953), 'Economic and Political Conditions of World Stability', *The Journal of Economic History*, Vol. 13(4): 368-369, Cambridge University Press.
- Xhaferaj, E., (2011), 'Party-system and social cleavages: the case of the post-communist Albanian elections', *PECOB's Papers Series*, Vol. 10, Itali, fq.7/ i gjendshëm në: www.pecob.eu
- Younis, M. Lin, X. X. Selvarathinam, S., (2008), 'Political stability and economic growth', *Amerian Journal of Applied Sciences*, Vol. 5(3): 2003-208.
- Zureiqat, M. H., (2005), 'Political Instability and Economic Performance: A Panel Data Analysis', *Award Winning Economics Papers*, Nr.1. fq. 1-35.

Burime interneti

Fondi Monetar Ndërkombëtar, të dhëna të marra nga http://www.quandl.com/IMF-International-Monetary-Fund/MAP_WEO_UNEMP_ALB-World-Economic-Outlook-Unemployment-Rate-Albania

Global Observatory, *Catalogue of indices*, i gjendshëm në: <http://www.theglobalobservatory.org/indices.html#conflict>

Indeksi i Demokracisë i Freedom House, (2013), i gjendshëm në:
<<http://www.freedomhouse.org/report-types/freedom-world>>

Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit, (2013), Transparency International, i gjendshëm në:
<<http://www.transparency.org/cpi2013/results>>

The Economist Intelligence Unit, i gjendshëm në:
<http://viewswire.eiu.com/index.asp?layout=VWArticleVW3&article_id=874361472>

The Economist Intelligence Unit, *Social Unrest*, i gjendshëm në:
<http://viewswire.eiu.com/site_info.asp?info_name=social_unrest_table&page=noads>

The Fund for Peace, i gjendshëm në:< <http://global.fundforpeace.org/>>

The World Bank Group, (2012), *Worldwide Governance Indicators*, i gjendshëm në:
<<http://info.worldbank.org/governance/wgi/index.asp>>

<http://news.bbc.co.uk>

<http://www.cec.org.al>

<http://www.km.gov.al>